



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

Manuali i Procedurave për Antitrustin, dokument i brendshme të punës së Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me procedurat për zbatimin e ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

## Hyrje

Manuali i Procedurave Antitrust i Autoritetit të Konkurrencës, në lidhje me zbatimin e nenit 4, nenit 8 dhe 9 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (ligji) është një mjet pune i brendshëm, që synon të ofrojë njohuritë praktike për stafin mbi mënyrën e kryerjes së hetimeve, në zbatim të ligjit.

Manuali i Procedurave për Antitrustin nuk përmban udhëzime detyruese për stafin dhe procedurat e parashtuara në të mund dhe duhet të përshtaten me rrethanat e çështjes përkatëse. Ai orientohet drejt nevojave praktike të ekipeve të ngarkuara me çështjet. Udhëzimet praktike të dhëna në Manual nuk pretendojnë të jenë të plota apo shteruese dhe jo të gjitha çështjet që mund të lindin janë trajtuar, apo diskutuar në të njëjtin nivel detajimi.

Manuali është një mjet praktik pune, që evoluon përmes përditësimeve për të pasqyruar përvojat e reja të fituara gjatë zbatimit të rregullave të konkurrencës të përcaktuara në ligj, si dhe të Rregulloreve dhe udhëzimeve të tjera të miratuara në zbatim të tij.

Në raste kontradiktash ndërmjet këtyre rregullave dhe Manualit të Procedurave për Antitrustin, zbatohen ato të parat. Anëtarëve të stafit i është rekomanduar që, në rast dyshimi, të marrin gjithmonë udhëzime nga eprorët lidhur me linjën e saktë të veprimit për një situatë të caktuar.

Manuali i Procedurave për Antitrustin do të jetë dokument publik, i cili do të ofrojë transparencë më të madhe rreth procedurave të Autoritetit të Konkurrencës gjatë zbatimit të rregullave të konkurrencës.

Fakti që modulet janë të disponueshme për publikun nuk e ndryshon karakterin e tyre si udhëzime ekskluzivisht të brendshme për stafin. Rrjedhimisht, modulet e publikuara nuk gjenerojnë apo modifikojnë asnjë të drejtë ose detyrim që lind në kuadër të rregullave të konkurrencës, të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore.

# Lista e moduleve

---

1. Procedurat e vendimmarrjes
2. Marrëdhëniet me kryetarët e seancave dëgjimore
3. Bashkëpunimi me Autoritetet Kombëtare të Konkurrencës (ECN)
4. Bashkëpunimi me Gjykatat Kombëtare
5. Bashkëpunimi me Autoritetet e Konkurrencës në Vendet e Treta
6. Kërkesat për informacion (Neni 18 i Rregullores nr. 1/2003)
7. Hetimet ndaj sektorëve (Neni 17 i Rregullores nr. 1/2003)
8. Kompetenca për të marrë deklarata (Neni 19 i Rregullores nr. 1/2003)
9. Trajtimi i aplikimeve për lehtësim nga gjocat
10. Hapja e procedurave
11. Deklarata e Kundërshtimeve (DK)
12. Aksesit në dosje dhe Konfidencialiteti
13. E drejta për t'u dëgjuar (Faza me shkrim dhe seanca dëgjimore)
14. Komiteti Këshillimor
15. Vendimi për ndalim (Neni 7 i Rregullores nr. 1/2003)
16. Vendimi për angazhim (Neni 9 i Rregullores nr. 1/2003)
17. Masat e përkohshme (Neni 8 i Rregullores nr. 1/2003)
18. Konstatimi i pamundësisë për zbatim (Neni 10 i Rregullores nr. 1/2003)
19. Zgjidhjet ligjore (Neni 23 i Rregullores nr. 1/2003)
20. Sanksionet financiare periodike (Neni 24 i Rregullores nr. 1/2003)
21. Trajtimi i ankesave
22. Udhëzimet joformale
23. Mbyllja e procedurave
24. Mbyllja administrative e dosjes
25. Ndjekja e vendimeve
26. Çështjet gjyqësore
27. Përdorimi i gjuhëve
28. Publikimi i vendimeve

# 1 Procedurat e vendimmarrjes

1.	Parimet e përgjithshme që rregullojnë vendimmarrjen në Komision	2
1.1.	Burimet	2
1.2.	Parimi i kolegjalitetit dhe procedurat e vendimmarrjes	2
	1.2.1. Vendimet e bazuara në parime: procedurat në formë verbale apo të shkruar	2
	1.2.2. Masat e menaxhimit dhe administrimit: delegimi, nëndelegimi dhe delegimi i drejtpërdrejtë i kompetencave	3
	1.2.3. Masat ekskluzivisht administrative	3
1.3.	Përfshirja e shërbimeve të tjera	4
2.	Zgjedhja e procedurës së zbatueshme të vendimmarrjes në çështjet e antitrustit	4
2.1.	Masat e rezervuara për Kolegjin	4
	2.1.1. Procedura në formë verbale	5
	2.1.2. Procedura në formë të shkruar	5
2.2.	Delegimi i kompetencave të Komisioneri për Konkurrencën	5
	2.2.1. Delegimi i kompetencave të Komisioneri për Konkurrencën në lidhje me zbatimin e Rregullores nr. 1/2003	6
	2.2.2. Delegimi i kompetencave në lidhje me Njoftimet për Lehtësim nga Gjobat	9
	2.2.3. Delegimi i kompetencave në lidhje me bashkëpunimin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanadanë	10
	2.2.4. Delegimi i kompetencave të posaçme	10
2.3.	Masat që i nëndelegohen Drejtorit të Përgjithshëm nga Komisioneri për Konkurrencën	10
2.4.	Masat që i delegohen kryetarëve të seancave dëgjimore nga Komisioni	11
2.5.	Masat ekskluzivisht administrative (“de pure gestion”)	13
3.	Përfshirja e shërbimeve të tjera	14
3.1.	Konsultimet ndërmjet shërbimeve përpara miratimit të masave të rezervuara për Kolegjin	14
	3.1.1. Zgjedhja e departamenteve që duhet të konsultohen	14
	3.1.2. Procedura e konsultimit	15
3.2.	Përfshirja e Shërbimeve të tjera përpara miratimit të masave në kuadër të procedurave të delegimit dhe nëndelegimit të kompetencave	15
	3.2.1. Miratimi paraprak i nevojshëm i Shërbimit Juridik	15
	3.2.2. Përfshirja e shërbimeve të ndryshme nga Shërbimi Juridik	15

# 1. Parimet e përgjithshme që rregullojnë vendimmarrjen në Komisionin e Konkurrencës

## 1.1. Burimet

- (1) Mënyra e funksionimit dhe vendimmarrjes së Komisionit parashikohet
- në **nenin 19 të ligjit “Komisioni i Konkurrencës”**, Komisioni i Konkurrencës është organi vendimmarrës i Autoritetit dhe përbëhet nga pesë anëtarë. Ai vepron si një organ kolegjal i përhershëm
  - në **nenin 24 të ligjit “Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit”**, Komisioni ka këto detyra dhe përgjegjësi: a) harton politikën kombëtare të konkurrencës; c) miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të Autoritetit; ç) mbikëqyr punën e Sekretariatit për zbatimin e dispozitave të këtij ligji; d) merr vendime sipas këtij ligji; dh) nxjerr rregullore dhe udhëzime në zbatim të këtij ligji; e) brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës paraqet në Kuvend raportin vjetor të Autoritetit; ë) me kërkesën e komisioneve të Kuvendit, jep vlerësime për çështje që lidhen me konkurrencën dhe legjislacionin në këtë fushë; f) u jep vlerësime dhe rekomandime organeve të administratës qendrore e vendore dhe institucioneve të tjera publike, shoqatave tregtare, sindikatave, shoqatave të konsumatorit, dhomave të tregtisë dhe të industrisë, për çështjet që lidhen me konkurrencën; g) përfaqëson Autoritetin, brenda dhe jashtë vendit, në marrëdhëniet me institucionet e tjera dhe ato simotra; gj) përcakton përparësitë e hetimeve dhe afatet përkatëse për to.
  - në **nenin 26 të ligjit “Marrja e vendimeve”**, 1. Marrja e vendimeve është e vlefshme kur në mbledhjen e Komisionit janë të pranishëm të paktën katër anëtarë, prej të cilëve njëri duhet të jetë Kryetari ose Zëvendëskryetari, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 23 të këtij ligji. 2. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm. Në rast barazimi të votave, vota e kryesuesit të mbledhjes është vendimtare. Abstenimi nuk lejohet.
  - në **nenin 39 të ligjit “E drejta e palëve për t'u dëgjuar”**, Ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve kanë të drejtë të shprehen për çështjen, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga Komisioni. Komisioni e bazon vendimin vetëm në pretendime, për të cilat palëve u është dhënë mundësia për t'u shprehur.
  - në **Rregulloren “Për Funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”**, miratuar me Vendimin e Komisionit të konkurrencës nr. 563 datë 25.1.2018.

## 1.2. Parimi i kolegjalitetit dhe procedurat e vendimmarrjes

Sipas nenit 19 të ligjit “Komisioni i Konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës është organi vendimmarrës i Autoritetit të Konkurrencës. Komisioni e bazon vendimmarrjen në **parimin e kolegjalitetit**. Me fjalë të tjera, në parim, **vendimet** e Komisionit **duhen marrë bashkërisht** nga të gjithë Komisionerët dhe të gjithë këta të fundit janë **bashkërisht përgjegjës** për ato vendime.

Vendimet e Komisionit merren gjatë mbledhjeve javore të Komisionit përmes procedurës në formë të shkruar.

## 2. Zgjedhja e procedurës së zbatueshme të vendimmarrjes në çështjet e antitrustit

- (2) Në këtë seksion përshkruhen rregullat për zgjedhjen e procedurës së zbatueshme të vendimmarrjes në një çështje lidhur me antitrustin. Nënseksionet 2.1 deri në 2.5 përshkruajnë kompetencat e vendimmarrësve dhe përkatësisht trajtojnë: tagrat e rezervuar për Komisionit, tagrat e nëndeleguar për Sekretarin e Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës; tagrat e deleguar për kryetarët e seancave dëgjimore; mundësinë për të marrë masa ekskluzivisht administrative.

### 2.1. Masat e rezervuara për Komisioni

- (3) Të gjitha vendimet përfundimtare të marra mbi thelbin e çështjes (duke përfshirë masat e përkohshme) dhe/ose vendimet e bazuara në parime që mbartin një marzh të gjerë gjykimi janë të rezervuara për Komisionin.
- (4) Këto akte të Komisionit përfshijnë:
- të gjitha vendimet e Komisionit për konstatimin dhe urdhërimin e ndalimit të një shkeljeje;
  - të gjitha vendimet e Komisionit për urdhërimin dhe rinovimin e masave të përkohshme ;
  - të gjitha vendimet e Komisionit për ndërmarrjen e angazhimeve në formë të detyrueshme,
  - të gjitha vendimet e Komisionit për konstatimin e pamundësisë për të zbatuar nenet 4 dhe 9 të ligjit;
  - vendimet për nisjen e një hetimi ndaj një sektori të veçantë të ekonomisë ose ndaj një lloji të caktuar marrëveshjeje e parashikuar në nenin 41, 42 dhe 43 të ligjit;
  - Vendimi i Komisionit për kërkimin e informacionit nga ndërmarrjet dhe shoqatat e

ndërmarrjeve (Neni 33 i ligjit);

- Vendimi i Komisionit që urdhëron inspektimin e ndërmarrjeve dhe shoqatave të ndërmarrjeve (Neni 36 i ligjit);
- vendimmarrja për një deklaratë kundërshtimesh dhe lëshimi i saj për ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve dhe vendosja e një afati kohor për kthim përgjigjeje (Nenet 57/1 dhe 58 e ligjit).
- të gjitha vendimet e Komisionit për vendosjen e gjobave për shkeljet e së drejtës procedurale ose materiale (Nenet 73,74,75 dhe 76 të ligjit),
- të gjitha vendimet e Komisionit për shumën përfundimtare të një sanksioni financiar;
- të gjitha vendimet e Komisionit për miratimin e rregulloreve e udhëzimeve ;

#### 2.1.1. Procedura në formë verbale

- (5) Nëse Komisioni i Konkurrencës konstaton që për arsye të rëndësisë së tyre ekonomike ose politike masat në fjalë duhet të diskutohen, atëherë përdoret procedura në formë verbale.

#### 2.1.2. Procedura në formë të shkruar

- (6) Përgjithësisht, procedura në formë të shkruar përdoret për të gjitha masat që duhet të miratohen drejtpërsëdrejti nga vetë Komisioni, por që nuk kanë nevojë për diskutim në mbledhjen e Komisionit.
- (7) Relatimi i përfundimeve dhe propozimeve të raportit hetimor të përgatitur nga Sekretariati, në çdo fazë të hetimit, bëhet nga Sekretari Përgjithshme, Kryetari mund të caktojë për relatimin e çështjes një Anëtar të Komisionit ose nga Kabineti

#### 2.2.1. Delegimi i kompetencave në lidhje me Njoftimet për Lehtësim nga Gjobat

- (8) Ekzistojnë rregullorja “Për gjobat dhe Lehtësimin prej tyre”, të miratuara me vitet 1996, 2002 dhe 2006 përkatësisht.

##### 2.2.2.1 Njoftimi për Lehtësim nga Gjobat i vitit 2002

- (9) Komisionit të Konkurrencës i janë dhënë kompetencat e mëposhtme në lidhje me zbatimin e Njoftimit për Lehtësim nga Gjobat:
  - kompetenca për të **informuar** ndërmarrjen se natyra dhe përmbajtja e provave që propozon të zbatojë në një fazë të mëvonshme **do të përmbushë kushtet për dhënien e imunitetit të kushtëzuar ose, nga ana tjetër, që ajo nuk përmbush kushtet** për dhënien e imunitetit të kushtëzuar (rregullorja “Për gjobat dhe Lehtësimin

prej tyre”);

- kompetenca për të **dhënë imunitet të kushtëzuar** me shkrim për ndërmarrjet që përmbushin kushtet e përcaktuara më lartë ose, **nga ana tjetër**, kompetenca **për të refuzuar një aplikim për imunitet të kushtëzuar** kur konstatohet se kushtet e përcaktuara nuk janë përmbushur;
- kompetenca për të informuar me shkrim, jo më vonë se data e lëshimit të deklaratës së kundërshtimeve, se ndërmarrjet i përmbushin kushtet për **reduktim të gjobave** lidhur me synimin e Komisionit për të reduktuar shumën e gjobës ose, **nga ana tjetër**, për të **refuzuar**, jo më vonë se data e njoftimit të deklaratës së kundërshtimeve, **një aplikim për reduktim të gjobave** kur konstatohet se kushtet e parashikuara në Njoftimin për Lehtësim nga Gjobat nuk janë përmbushur.

### 2.3. Masat ekskluzivisht administrative (“de pure gestion”)

- (10) Masat ekskluzivisht administrative nuk janë vendime që i nënshtrohen një procedure zyrtare miratimi, por nxirren nga shërbimet e Sekretarit të Autoritetit të Konkurrencës sipas ndarjes së brendshme të detyrave të përcaktuara në Rregulloren “Për funksionimin e AK”.
- (11) Në praktikë, masat ekskluzivisht administrative janë kryesisht masa rutinore me natyrë teknike dhe/ose akte që nuk kanë efekte detyruese.
- (12) Është e pamundur të renditen të gjitha masat ekskluzivisht administrative, pasi çdo masë që nuk është nën kompetencën e të gjithë Komisionit apo nuk është objekt vendimmarrjeje në kuadër të delegimit të kompetencave, përfshihet në atë kategori.
- (13) Masat ekskluzivisht administrative të ndërmarra nga personat përgjegjës për trajtimin e çështjeve janë, për shembull:

–**kërkesat e thjeshta për informacion** (Nene 33,34 dhe 55 i ligjit)

–**inspektimi i thjeshtë** i bazuar vetëm në urdhrin me shkrim nga Sekretari i Përgjithshëm (Neni 28);

–realizimi i procedurave hetimore dhe i kontrollit të përqendrimeve në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin;

–publikimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës në Buletinin Zyrtare dhe në faqen zyrtare elektronike të AK;

–Raportimi në mënyrë periodike dhe mujore tek Kryetari i Komisionit.

–Ndjekja dhe zbatimi i Vendimeve të Komisionit të Konkurrencës.

### 3. Përfshirja e shërbimeve të tjera

- (14) Mbeshtetur ne strukturën organizative të Autoritetit te Konkurrencës dhe Rregullores së funksionimit parashikohet se drejtorët e drejtorive, **punojnë në bashkëpunim të ngushtë dhe në mënyrë të koordinuar** për përgatitjen ose zbatimin e vendimeve të Komisionit.
- (15) Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregjeve Prodhuese ka për detyrë mbikëqyrjen dhe hetimin e kushteve të tregut për rastet e abuzimit me pozitën dominuese, marrëveshjeve të ndaluara dhe përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjeve, në tregjet prodhuese, ku bëjnë pjesë por jo vetëm, këto tregje prodhuese: energjia; gazi dhe karburantet; ndërtimi; pyjet; industria nxjerrëse dhe minerale; agrikultura/bujqësia, blegtoria; peshkimi; mallrat kimike; fasoneria; si dhe çdo veprimtari tjetër prodhuese. Drejtoria në fillim të çdo muaji i paraqet Sekretarit të Përgjithshëm një raport të aktivitetit mujor të drejtorisë si dhe një plan të punëve që do të trajtohen nga drejtoria në muajin në vijim. Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregjeve Prodhuese në përfundim të monitorimit apo inspektimit, përgatit raportin lidhur me tregun përkatës, të cilin ja paraqet Komisionit nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm. Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregjeve Prodhuese nëpërmjet monitorimeve dhe inspektimeve të autorizuar nga Komisioni, nëse konstaton shkelje të ligjit, propozon për vendosjen e sanksioneve për shkeljet e konstatuara. Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregjeve Prodhuese monitoron zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve të lëna nga Komisioni i Konkurrencës, kur konstatohet mos zbatimi i tyre nga ndërmarrjet apo institucionet shtetërore, Drejtoria propozon për masa përkatëse për zbatimin e tyre. Drejtoria në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike bën vlerësime mbi aktet normative të cilat mund të sjellin kufizime të konkurrencës në tregjet prodhuese që ai mbikëqyr.
- (16) Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregjeve të Shërbimit /Jo-Prodhuere ka për detyrë mbikëqyrjen dhe hetimin e kushteve të tregut për rastet e abuzimit me pozitën dominuese, marrëveshjeve të ndaluara dhe përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjeve, në tregjet prodhuese, ku bëjnë pjesë por jo vetëm, këto tregje shërbimesh dhe veprimtari të tjera joprodhuere: tregu i komunikimeve elektronike; teknologjisë së informacionit dhe medias; tregu financiar; shëndetësia; turizmi; transporti, si dhe shërbimet e çdo natyre tjetër. Drejtoria në fillim të çdo muaji i paraqet Sekretarit të Përgjithshëm një raport të aktivitetit mujor të drejtorisë si dhe një plan të punëve që do të trajtohen nga drejtoria në muajin në vijim. Drejtoria në përfundim të monitorimit apo inspektimit, përgatit raportin lidhur me tregun përkatës, të cilin ja paraqet Komisionit nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm. Drejtoria nëpërmjet monitorimeve dhe inspektimeve të autorizuar nga Komisioni, nëse konstaton shkelje të ligjit, propozon për vendosjen e sanksioneve për shkeljet e konstatuara. Drejtoria monitoron zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve të lëna nga Komisioni i Konkurrencës, kur konstatohet mos zbatimi i tyre nga ndërmarrjet apo institucionet shtetërore, Drejtoria propozon për masa përkatëse për zbatimin e tyre. Drejtoria në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike bën vlerësime mbi aktet normative të cilat mund të sjellin kufizime të konkurrencës në tregjet e shërbimeve dhe veprimtarive të tjera jo-prodhuese që ai mbikëqyr.

- (17) Drejtoria e Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve ka për detyrë të kryej vlerësimin e kushteve të tregjeve, nëpërmjet analizave komplekse ekonomike në rastet e përqendrimeve, studimeve të përgjithshme, monitorimit dhe inspektimit të tregut. Drejtoria në fillim të çdo muaji i paraqet Sekretarit të Përgjithshëm një raport të aktivitetit mujor të drejtorisë si dhe një plan të punëve që do të trajtohen nga drejtoria në muajin në vijim. Drejtoria në përfundim të monitorimit, inspektimit apo vlerësimit të përqendrimit, përgatit raportin lidhur me tregun dhe ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim, të cilin ja paraqet Komisionit nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm. Drejtoria e Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve administron bazat e të dhënave të përgjithshme për tregun dhe veçanërisht për çdo përqendrim të vlerësuar. Për rastet e përqendrimeve të ndërmarrjeve që kanë një ndryshim të qëndrueshëm kontrolli, Drejtoria kryen vlerësime dhe analizat përkatëse në zbatim të neneve 53-64 të ligjit. Në rastet kur përqendrimi shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës sipas ligjit, Drejtoria me autorizim të Komisionit, kryen inspektime për të realizuar hetimet e thelluara në lidhje me transaksionet e njoftuara në Autoritet, të cilat mund të autorizohen me kushte dhe detyrime sipas ligjit. Në përfundim të inspektimeve, Drejtoria përgatit raportin për Komisionin, me propozimet e mundshme për masat strukturore që duhet të ndërmerren nga shoqëritë njoftuese dhe impaktin që do të kenë në treg. Drejtoria e Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm informon me shkrim Komisionin për datën e saktë të dorëzimit të njoftimit, të dokumenteve bashkëlidhur dhe formës së njoftimit të plotësuar nga palët pjesëmarrëse në përqendrim, në zbatim të Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” si dhe akteve të tjera nënligjore të dala në zbatim të ligjit për kontrollin e përqendrimeve.
- (18) Drejtoria Juridike, Integritetit dhe e Çështjeve Gjyqësore kryen vlerësime të akteve dhe projekt-akteve ligjore dhe nënligjore lidhur me përputhshmërinë e tyre me ligjin dhe shkallen e kufizimit, ose të pengimit të konkurrencës, me synim përafrimin e legjislacionit vendas me “Acquis Communautaire” dhe mbrojtjen e konkurrencës. Drejtoria në fillim të çdo muaji i paraqet Sekretarit të Përgjithshëm një raport të aktivitetit mujor të drejtorisë si dhe një plan të punëve që do të trajtohen nga drejtoria në muajin në vijim. Drejtoria me autorizim ndjek dhe mbron interesat e Autoritetit në proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit, nëpërmjet përgatitjes së prapësimeve, ankimeve, rekurseve, përgatitjes dhe hartimit të materialeve për në gjykatë dhe informon Kryetarin dhe Sekretarin e Përgjithshëm për mbarëvajtjen e tyre. Drejtoria asiston drejtoritë e Autoritetit me ndihmë juridike për ankesa, shkresa apo akte të ndryshme, kur është e nevojshme ndihmon edhe në procedurat e inspektimit ndaj ndërmarrjeve nën shqyrtim. Drejtoria harton informacione, shkresa, raporte dhe përgjigjet për bazueshmërinë ligjore të çdo akti juridik që i kërkohet. Drejtoria ka si detyrë të kontribuojë në procesin e integritetit evropian në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit dhe Planit Kombëtar të Integritetit Evropian, zbatimin me korrektësi të përparësive të identifikuar nga BE që lidhen me fushën e veprimit të Autoritetit të Konkurrencës, i cili është lider dhe koordinues i Kapitullit 8 “Politika e Konkurrencës”. Drejtoria bashkërendon punën me strukturat brenda Autoritetit, për angazhimet dhe detyrat që dalin në kuadër të procesit të Stabilizim - Asociimit, përfshirë procesin e përafrimit të legjislacionit vendas me Acquis dhe ngritjen e kapaciteteve administrative brenda AK-së.

Drejtoria harton raportin mbi veprimtarinë e institucionit, progres-raporteve, takimet e Komitetit të Stabilizim Asociimit, takimet e Nënkomitetit “Tregu i brendshëm dhe konkurrenca”, si dhe përgatit raporte e tabela të përputhshmërisë të projekt-aktit juridik me acquis e BE-së me synim përafrimin për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme lidhur me aktivitetin e Autoritetit.

- (19) Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit ka për detyrë organizimin dhe krijimin e kushteve të punës nëpërmjet menaxhimit ekonomik, efektiv, eficient të burimeve financiare në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe atyre njerëzore në përputhje me ligjin “Për nëpunësin civil”, duke siguruar që politikat e menaxhimit të burimeve njerëzore të ofrojnë shërbime eficiente që plotësojnë kërkesat e institucionit lidhur me stafin dhe inkurajojnë zhvillimin e personelit. Drejtoria e menaxhon fondet buxhetore, siguron zbatimin e rregullave dhe ligjeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nëpërmjet ofrimit të një informacioni sa më të saktë kontabël, ruajtjes së dokumentacionit financiar dhe korrespondencës brenda dhe jashtë institucionit. Drejtoria krijon, administron, sistemon, përditëson dhe ruan të dhënat e dosjeve të personelit, të çdo nëpunësi të institucionit (dosjen individuale), mbikëqyr plotësimin e nevojave në Autoritet lidhur me burimet njerëzore, për aftësimin profesional të punonjësve dhe kontrollon zbatimin e ligjit “Për nëpunësin civil” dhe rregullave të funksionimit të brendshëm të Autoritetit. përgatit programimin, planifikimin, garantimin e cilësisë së dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të AK-së dhe siguron zbatimin e buxhetit të miratuar. Drejtoria kryen të gjitha veprimeve financiare, harton dhe zbaton buxhetin e shtetit dhe vendimeve financiare, administron dokumentacionin financiar, mirëmban, kontrollon dhe analizon treguesit e përdorimit të buxhetit të shtetit dhe deri tek mbyllja e miratimi i bilancit kontabël vjetor të institucionit. Drejtoria mban kontabilitetin nëpërmjet regjistrimit kronologjik të të gjitha veprimeve në përputhje me ligjin për kontabilitetin, dokumentacionin e bankës si urdhër – pagesat, librin e shpenzimeve dhe ditari i bankës ku regjistrohen në mënyrë kronologjike të gjitha veprimet kontabële dhe bëhet situacioni mujor dhe progresiv i rakorduar me degën e thesarit. Drejtoria protokollon korrespondencën e institucionit dhe çdo dokument tjetër zyrtar, indeksin dhe përditëson inventarët e dokumenteve, mban dhe nxjerr dokumente sipas kërkesave, menaxhon arkivën dhe mban marrëdhënie me Arkivin Qëndror. Drejtoria përgatit dokumentacionin e nevojshëm për pjesëmarrje në konferenca, ëorkshope, seminare, apo takime ndërkombëtare të titullarit, si dhe realizon lidhjet me organizatorët dhe institucionet në vendin pritës. Drejtoria përgatit informacione dhe raporte për eprorët përpara dhe pas organizimeve/pjesëmarrjeve lidhur me përfaqësime të AK-së në veprimtarinë kombëtare dhe ndërkombëtare. Drejtoria e Integritetit dhe Komunikimit ndjek dhe asiston në zhvillimin e negociatave për nënshkrimin e memorandumeve dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritetet vendase dhe të huaja, koordinon lidhjen dhe bashkëpunimin me institucionet e huaja si (ICN), (OECD), (UNCTAD), etj. dhe Autoritetit të Konkurrencës, duke siguruar pikat e kontakteve me zyrat homologe përkatëse si dhe përditësimin e këtij informacioni.

“Departamentet që nuk janë informuar dhe që e konsiderojnë veten gjithashtu si përgjegjëse kryesore për produktet, shërbimet ose fushat e politikave në fjalë, mund të informohen në çdo

kohë për një çështje të caktuar, pas bërjes së një kërkesë të arsyetuar.”

### (3) Masat për të cilat informimi është i detyrueshëm

(65) Masat për të cilat informimi është i detyrueshëm janë:

- **Vlerësimi paraprak** në procedurën për miratimin e një vendimi që i bën të detyrueshme angazhimet (rregullorja për angazhimet).
- Vendimi i Komisionit për **hapjen e procedurave** pas një vendimi për bërjen të detyrueshme të angazhimeve (Neni 45 dhe 61 të ligjit).
- Vendimi i Komisionit për vendosjen e **sanksioneve financiare** për shkelje të rregullave thelbësore
- **Refuzimi i ankesës** me vendim të Komisionit për **arsye të pamjaftueshme për veprim përmes një hetimi të mëtijshëm**

#### *3.2.2.1 Aktet për të cilat nuk nevojitet informimi paraprak i shërbimeve të tjera*

(66) Një sërë masash që duhet të miratohen përmes delegimit ose nëndelegimit të kompetencave nuk parashikojnë **informimin paraprak të shërbimeve të tjera**.

(67) I tillë është rasti kur (a) është i nevojshëm konfidencialiteti i plotë, si për shembull në rastin e inspektimeve të papritura të urdhëruara me vendim ose lidhur me trajtimin e aplikimeve për lehtësim nga gjobat ose (b) masa lidhet me administrimin teknik të çështjes për kryerjen e procedurave ose për seancën dëgjimore, ose me publikimin e akteve të Komisionit në Gazetën Zyrtare ose aksesin në dosje.

(68) Regjimi i mosinformimit zbatohet për masat e mëposhtme:

- refuzimi nga Komisioni për të **transmetuar informacion konfidencial** (Neni 30 i ligjit)
- Korenspondenca **për kërkimin e informacionit** nga ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve (Neni 33;34 dhe 55 e ligjit);
- **Autorizimi** i Komisionit që **urdhëron inspektimin** e ndërmarrjeve dhe shoqatave të ndërmarrjeve;
- **angazhimi** i shkruar nga Komisioni për **mospërdorim të informacioneve të caktuara** të shkëmbyera në Rrjetin Evropian të Konkurrencës (ECN+) për vendosjen e sanksioneve mbi një aplikim për lehtësim të gjobave ose mbi disa persona të caktuar;

- **Refuzimi** i Komisionit për të lejuar ankuesin që të shprehë pikëpamjet e veta në seancën dëgjimore;
  - **refuzimi** i Komisionit **për të dëgjuar palë të treta** (të ndryshme nga marrësit e deklaratës së kundërshtimeve ose ankuesit) për pamjaftueshmëri interesi ;
  - **refuzimi** i Komisionit **për të ftuar palë të treta** (të ndryshme nga marrësit e deklaratës së kundërshtimeve ose ankuesit) për të shpalosur argumentet e tyre në seancën dëgjimore ;
- (69) Regjimi i “mosinformimit” zbatohet edhe në lidhje me aplikimin e delegimit të kompetencës për **zbatimin e Njoftimeve për Lehtësim nga Gjobat të viteve 2002 dhe 2007**. Vendimet për dhënien (ose mosdhënien) e imunitetit të kushtëzuar ose aktet që informojnë aplikantët mbi synimin e Komisionit për të ofruar (ose për të refuzuar) reduktimin e gjobave, rrjedhimisht mund të miratohen pa informuar paraprakisht Shërbimet e tjera.

### 3.2.2.2 Rasti i veçantë i refuzimit të ankesave për arsye thelbësore

- (70) Refuzimet e ankesave **për arsye thelbësore** janë refuzime ankesash përmes së cilave Komisioni konstaton, pas një vlerësimi të fakteve të dëshmuara, se sjellja e ankimuar nuk cenon nenet 4 ose 9 të Ligjit. Këtu duhet bërë një dallim me refuzimet e ankesave për arsye të tjera, ku përfshihen refuzimet e ankesave për pamjaftueshmëri interesi nga AK, për arsye procedurale ose për pamjaftueshmëri provash nga ankuesi lidhur me akuzat e ngritura.
- (71) Kjo rezulton në përdorimin e regjimit të komplikuar për refuzimin e ankesave, si më poshtë:
- për refuzime të ankesave për arsye thelbësore;
  - për refuzimet e ankesave për arsye të pamjaftueshme për veprim përmes një hetimi të mëtejshëm (“mungesë interesi nga AK-ja”), departamentet që kanë përgjegjësinë kryesore duhet të informohen.
  - nuk kërkohet informim paraprak për refuzimet e ankesave për arsye të tjera;

## 1. Seanca degjimore

- (1) Në zbatim të nenit 39 të ligjit “E drjeta e palëve për tu dëgjuar”, Komisioni mund të zhvillojë përpara marrjes së vendimit përfundimtar, seanca dëgjimore, ku palëve në proces, atyre të interesuara, si dhe institucione shtetërore që kanë lidhje me çështjen u jepet mundësia për t’u shprehur me shkrim dhe/ose me gojë.
- (2) Komisioni gjatë seancave dëgjimore asistohen nga Kabineti. Sekretariati duhet të bashkëpunojnë plotësisht me ta. Gjatë seancave dëgjimore Komisionerët duhet të marrin

kopje të të gjitha dokumenteve të vlefshme për përmbushjen e funksioneve të tyre. Ata gjithashtu kanë akses tek të gjitha dosjet që lidhen me procedurat e konkurrencës.

- (3) Komisionerët gjatë seancave dëgjimore janë përgjegjës për të garantuar respektimin e ushtrimit efektiv të të drejtave procedurale. Ata kanë funksione dhe kompetenca të ndryshme. Së pari, ata kanë kompetenca vendimmarrëse në lidhje me disa çështje të caktuara procedurale. Kryetarët e seancave dëgjimore duhet të mbahen të informuar për zhvillimet e procedurave për çështjet e lidhura me antitrustin, kartelet dhe bashkimet deri në momentin dorëzimit të një projektvendimi final pranë Komisionit. Kjo zbatohet që nga momenti i nisjes së procedurave në çështjet e antitrustit dhe bashkimeve.
- (4) Këtu përfshihen:
  - Të gjitha raportet e përgatitura nga Sekretari i Përgjigthëm, duhet të përcillen edhe te kryetarët e seancave dëgjimore.
  - Në rastet e angazhimeve , duhet të përcillen kopjet e vlerësimeve paraprake, si dhe informacioni i dhënë për të gjitha hapat e rëndësishëm gjatë procedurës, që rezultojnë në një projektvendim sipas nenit 45 dhe 61 të Ligjit (Angazhimet).
  - Komisionerët duhet të jenë plotësisht të informuar për çështjet që mund të kenë ndikim në procedurë. Letrat e fakteve dhe/ose deklaratat plotësuese të kundërshtimeve, për shembull, kanë rëndësi të ashtu siç kanë edhe proceset e riorientimit të çështjeve.

### **3 Bashkëpunimi me Autoritetet Kombëtare të Konkurrencës në BE dhe shkëmbimi i informacionit**

- (1) Autoriteti i Konkurrencës bazuar në nenin 71, të ligjit nr. 9121/2003 “Këmbimi i të dhënave me autoritetet simotra”:
  1. Autoriteti, brenda përgjegjësi të veta, në bazë të një marrëveshjeje dypalëshe ose shumëpalëshe, si dhe në bazë të një kërkesë, mund t'i japë të dhëna ose dokumente që zotëron a siguron strukturës përkatëse në Komisionin European ose autoriteteve të huaja simotra, në përputhje me legjislacionin shqiptar, duke ruajtur reciprocitetin dhe me kusht që këto autoritete të respektojnë rregullat e sekretit tregtar me të njëjtat garanci si në Shqipëri.
  2. Autoriteti mund të kryejë hetime, me kërkesë të autoriteteve të huaja simotra, me kusht ruajtjen e reciprocitetit.
  3. Nëse kërkesa e autoriteteve të huaja simotra për ndihmë në kryerjen e hetimeve ose transferimin e të dhënave të zotëruara ose të siguruara nga Autoriteti, rrezikon pavarësinë, sigurinë, interesat themelore ekonomike ose rendin publik të Republikës së Shqipërisë, pranimi i saj do të refuzohet.
- (2) Gjithashtu në bazë të nenit 72 të ligjit nr. 9121/2003 “Pezullimi ose mbyllja e procedurave”:

Kur Autoriteti dhe autoritetet e huaja simotra, të cilat kanë lidhur marrëveshje dypalëshe ose

shumëpalëshe ndërmjet tyre, kanë pranuar një ankesë ose kanë vepruar me nismën e tyre, në mbështetje të ligjeve përkatëse të konkurrencës për të njëjtën shkelje, fakti që një nga autoritetet është marrë me çështjen, mund të shërbejë si bazë e mjaftueshme për të tjerët, për pezullimin e procesit ose për refuzimin e ankesës.

- (3) Autoriteti i konkurrencës I jep një rendësi të vecantë edhe marrëdhënieve ndërkombetare. AK cdo vit ka synuar forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare me institucionet homologe, forumet dhe qendrat e trajnimeve të konkurrencës në rajon e më gjerë. AK bashkëpunon me rrjetet ndërkombëtare të konkurrencës si OECD, International Competition network, OECD-GVH/RCC, UNCTAD si dhe ka memorandume bashkëpunimi me autoritetet homologe.
- (4) **OECD:** AK merr pjesë në forumin global të konkurrencës në kuadër të OECD ku paraqet kontributin e AK në raste të caktuara, si dhe përdor praktikën me të mira, metodologjitë dhe rekomandimet e OECD.
- (5) **OECD-GVH/RCC** në Budapest si një nga forumet më të rëndësishme ku: Çështjet e konkurrencës diskutohen ndërkombëtarisht nga vendet pjesëmarrëse; Prezantimi dhe diskutimi i qasjeve teorike adekuatë më të fundit, rasteve/praktikave më të mira hipotetike dhe konkrete; Mundësi e AK për të shkëmbyer eksperiencat shqiptare për rastet, në seminare dhe për të mësuar nga autoritetet e tjera të konkurrencës. Publikimi i rasteve shqiptare në Buletinin e RCC-së dy herë në vit. Përdorimi i instrumentit të RFI (request for information) për raste dhe problematika të ndryshme, i cili është një instrument shëftiv në punën e e AK.
- (6) **UNCTAD:** AK ka kërkuar vullnetarisht një “Peer Review” të UNCTAD-it për zbatimin e Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës në Shqipëri. Gjatë punimeve të Konferencës së 7-të të UNCTAD-it (Gjenevë, 7 korrik 2015), u mbajt një seancë e posaçme për vlerësimin e politikës dhe ligjit të konkurrencës në Shqipëri. Në kuadër të UNCTAD-it u organizuan një sërë kursesh trajnimi me gjyqtarë, me qëllim shkëmbimin e njohurive mbi parimet dhe rregullat e Ligjit të Konkurrencës, të cilat ishin si më poshtë: Prill dhe Qershor 2016, Tiranë, trajnim me gjyqtarë nga Gjykata Administrative, Gjykata e Rrethit dhe e Apelit, si dhe nga Gjykata Civile; Seminare me komunitetin e biznesit dhe qarqet akademike dhe komunitetin e studentëve për promovimin e kulturës së konkurrencës veçanërisht në tregjet dixhitale.
- (7) **International Competition Network:** ACA është pjesë e Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës, Pjesëmarrja në seminare, onferenca, call conferences, dërgimi i pyetësorëve dhe shkëmbimi i përvojës së tij me Autoritetet Ndërkombëtare të Konkurrencës; ACA përdor Manualin dhe Metodologjitë e ICN-së për të çuar më tej njohuritë dhe ekspertizën e stafit në rastet e konkurrencës.
- (8) AK ndër vite ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me AK si me poshtë:
  - Autoriteti i Konkurrencës së Maqedonisë (2007)
  - Autoriteti Hungarez i Konkurrencës (2009)
  - Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (2009)
  - Autoriteti Turk i Konkurrencës (2010)- Shqipëri, Bosnia-Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Maqedoni, Greqi and Turqi

- Autoriteti Bullgar i Konkurrencës (2012)- Shqipëri, Bosnia-Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Kosovë, Maqedon, Mal i Zi and Serbi
- Autoriteti Italian (2013)
- Autoriteti Austriak i Konkurrencës (2014)
- Autoriteti Turk i Konkurrencës (2018)
- Autoriteti Maltez i Konkurrencës (2019)
- Autoriteti Kroat i Konkurrencës (2019)
- Autoriteti Spanjoll i Konkurrencës (2020)
- Autoriteti Gjeorgian i Konkurrencës (2022)
- Autoriteti Armen i Konkurrencës(2023)

- (9) Gjatë vitit 2020, Komisioni i Konkurrencës në zbatim të PKIE (2020-2022), si dhe në funksion të përmbushjes së qëllimit të ligjit nr.9121/2003 ka realizuar transpozimin e direktivave të BE në legjislacionin kombëtar të konkurrencës, ku konkretisht u miratua: Udhëzuesi “Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qenë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e ligjit nr. 9121/2003 dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut”, miratuar me VKK nr. 697, datë 30.06.2020 sipas Direktives ECN+<sup>1</sup>.

Udhëzuesi parashikon sa më poshtë:

#### UDHËZUES

#### **“Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qenë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut”<sup>2</sup>**

1. Nenet 4 dhe 9 të Ligjit nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (këtu e më poshtë ligji nr.9121/2003) duhet të zbatohen në mënyrë efektive për të siguruar që konkurrenca në treg të mos kufizohet, shtrembërohet apo deformohet. Zbatimi efektiv i neneve 4 dhe 9 është i domosdoshëm për të siguruar tregje konkurruese dhe të hapura, në të cilat ndërmarrjet konkurrojnë më shumë bazuar në meritat e tyre dhe pa pengesa hyrjeje në treg, duke i mundësuar atyre të gjenerojnë të ardhura dhe të krijojnë vende pune. Konkurrenca mbron konsumatorët dhe ndërmarrjet aktive në treg, nga praktikatat që synojnë drejt çmimeve të produkteve artificialisht të larta.

<sup>1</sup> <https://caa.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/23.pdf>

<sup>2</sup> 32019L0001, DIRECTIVE (EU) 2019/1 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 11 December 2018 to empower the competition authorities of the Member States to be more effective enforcers and to ensure the proper functioning of the internal market, PE/42/2018/REV/1, OJ L 11, 14.1.2019,

2. Nenet 4 dhe 9 të ligjit janë në përputhje me nenet 101 dhe 102 të Traktatit të Funkzionimit të Bashkimit Evropian (TFBU). Udhëzuesi bazohet në parimet mbi të cilat mbështetet edhe praktika e BE-së, qëllimi i së cilës është të sigurojë që Autoriteti i Konkurrencës (këtu e më poshtë AK) të ketë burime të përshtatshme financiare, njerëzore, teknike dhe burime teknologjike dhe kompetenca të zbatimit të ligjit dhe politikës së vendosjes së sanksioneve ku legjislacioni kombëtar, dispozitat e ligjit nr.9121/2003 të zbatohen paralelisht me nenet e TFEU.
3. AK ka të gjitha kompetencat për të kërkuar informacion në lidhje me ndërmarrjen që i nënshtrohet procedurave hetimore, përfshirë informacioni në formë dixhitale, pavarësisht nga forma në të cilin është ruajtur. AK ka të gjitha kompetencat për të kryer inspektime, të sigurojë mbrojtjen e deklaratave të dhëna në kudër të Programit të Lehtësimit nga Gjohat bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Ligji nr.9121/2003 parashikon dispozita konkrete lidhur me pavarësinë institucionale të burimeve njerëzore, kompetenca lidhur me zbatimin e ligjit dhe sanksionimit të shkeljeve administrative, duke qenë konform edhe neneve 101 dhe 102 TFEU, ndërkohë që ka agjenci konkurrence në vendet e BE , ku ndërmarrjet mund t'i shpëtojnë përgjegjësisë nga pagesa e gjobave/sanksioneve thjesht nëpërmjet procesit të ristrukturimit (një vendimi me angazhime).
5. Neni 4 dhe 9 i ligjit duhet të zbatohet njësoj siç zbatohen edhe nenet 101 dhe 102 të TFEU, sepse në këtë mënyrë parandalon pengesat për hyrjen në treg, duke krijuar tregje më të drejta konkurruese, ku ndërmarrjet konkurrojnë bazuar në meritat e tyre. Ndërmarrjet nuk mund të konkurrojnë bazuar në meritë nëse ekzistojnë streha të sigurta për praktikant anti-konkurruese, për shembull, sepse provat/të dhënat lidhur me praktikant anti-konkurruese nuk mund të grumbullohen ose sepse ndërmarrjet janë në gjendje t'i shpëtojnë përgjegjësisë së tyre nga gjohat. Ndërmarrjet, dekurajohen për të hyrë në tregje të tilla, për të ushtruar të drejtat e tyre dhe për të ofruar produkte. Konsumatorit në këtë rast do ti mungonte përfitimi që do të siguronte nga zbatimi efektiv i parimeve të konkurrencës.
6. Boshllëqet dhe kufizimet në mjetet dhe garancitë që duhet të ketë legjislacioni mbi të cilin funksionon një autoritet konkurrence, kufizon fuqitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit (101 dhe 102 TFEU). Ky sistem ka lidhje me mbështetjen që duhet ti japin autoritetet e konkurrencës së vendeve të ndryshme njëri tjetrit lidhur me masat që marrin për gjetjen /zbulimin e fakteve me qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe asistencës së ndërsjellët. Ky bashkëpunim nuk do të mirë funksionojë nëse autoritetet e konkurrencës së vendeve të ndryshme përdorin mjete jo të përshtatshme për zbulimin e fakteve. Në këtë aspekt, këto autoritete konkurrence nuk janë në gjendje t'i ofrojnë njëri-tjetrit ndihmë të ndërsjellë<sup>3</sup>.

<sup>3</sup> Për shembull, në shumicën e Shteteve Anëtare, ndërmarrjet që operojnë përtej kufijve u shmangen pagimit të gjobave

7. Për të siguruar një zbatim të barabartë të ligjit për ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në treg dhe për të reduktuar kushtet e pabarabarta për konsumatorët, duhet të vendosen garanci themelore të pavarësisë, burime të përshtatshme financiare, njerëzore, teknike dhe burime teknologjike dhe kompetenca të zbatimit të ligjit dhe politikës së vendosjes së ku legjislacioni kombëtar, dispozitat e ligjit nr.9121/2003 të zbatohen paralelisht me nenet e TFEU.
8. Vendosja e garancive themelore për të siguruar që AK zbaton nenet 4 dhe 9 të ligjit në mënyrë të njëtrajtshme dhe efektive, duhet të realizohet duke ruajtur garancinë lidhur me pavarësinë institucionale dhe të burimeve dhe duke siguruar rregulla të detajuara dhe të hollësishme mbi instrumentet zbatuese dhe sanksionuese që duhet të këtë AK. AK duhet të ketë të gjitha instrumentet ligjore për të rritur më tej efektivitetin e aktivitetit të tij, të tilla si kompetencat për të vendosur sanksione/gjobë për personat fizikë ose, të drejtën për të kryer inspektime tek ato ndërmarrje që i nënshtrohen inspektimit.
9. Rregulla të hollësishme janë të nevojshme në lidhje me kushtet për dhënien e imunitetit/lehtësimit nga gjobat në rastet e marrëveshjeve të ndaluara. Ndërmarrjet do të zbulojnë marrëveshjet e ndaluara/kartelet e fshehta në të cilat kanë marrë pjesë, nëse kanë siguri të mjaftueshme ligjore/juridike se do të përfitojnë nga imuniteti nga gjobat. Dallimet midis programeve të lehtësimit nga gjobat në autoritet të ndryshme të konkurrencës në Shtetet Anëtare, çojnë në pasiguri ligjore për aplikantët e mundshëm në kuadër të programit të lehtësimit nga gjobat. Kjo mund të dobësojë nismën/inisjativën e tyre për të aplikuar për të përfituar nga programi i lehtësimit nga gjobat. Nëse programi i lehtësimit nga gjobat do të zbatohet nëpërmjet aplikimit të rregullave më të qarta dhe të harmonizuara, kjo jo vetëm që do të kontribuonte në nxitjen/inisjativën që aplikantët do të kishin për të zbuluar marrëveshjet e ndaluara/ kartelet e fshehta, në mënyrë që zbatimi i rregullave të konkurrencës të jetë sa më efektiv të jetë e mundur, por gjithashtu të garantojë një mjedis/fushë të barabartë për ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitete në treg. Kjo nuk duhet të parandalojë zbatimin e Programit të lehtësimit nga Gjobat për të gjitha shkeljet e rregullave të konkurrencës, që mbulojnë jo vetëm marrëveshjet e ndaluara/kartelet e fshehta, por edhe shkeljet e tjera në kuadër të nenit 4 të ligjit apo të pranohen aplikime në kuadër të programit të lehtësimit nga gjobat të depozituara nga persona fizikë që veprojnë në emrin e tyre.
10. Udhëzuesi nuk duhet të zbatohet në rastet kur parashikohet vendosja e sanksioneve penale ndaj personave fizikë. Udhëzuesi gjithashtu nuk duhet të zbatohet në rastet që parashikohet vendosja e sanksioneve administrative ndaj personave fizikë, të cilët nuk veprojnë si aktor i pavarur ekonomik në treg.
11. Zbatimi i nenit 4 dhe 9 të ligjit i është besuar institucionit të Autoritetit të Konkurrencës. AK është përgjegjës për kryerjen e hetimeve, për marrjen e vendimeve ku vendosen edhe

---

thjesht për faktin se nuk kanë një përfaqësi ligjore në disa prej territoreve të Shteteve Anëtare në të cilat ato janë aktive.

sanksione administrative dhe kanë të drejtën të marrin vendime edhe lidhur me zbulimin e shkeljeve përsa i takon neneve 4 dhe 9 të ligjit.

- 12.** Ushtrimi i kompetencave të dhëna AK, duhet të jenë në përputhje me parimet e përgjithshme në mbrojtje të të drejtave themelore si lidhur me kryerjen e hetimeve ashtu edhe me vendosjen e sanksioneve. Respektimi i të drejtave të palëve kanë të bëjnë si me administrimin e mirë dhe respektimin e të drejtave të mbrojtjes nga ana e ndërmarrjeve, ashtu edhe me të drejtën për t'u dëgjuar nga ana e ndërmarrjeve. Në mënyrë të veçantë, AK duhet të informojnë palët nën hetim në lidhje me gjetjet e raportit të hetimit në kuadër të nenit 4 dhe 9 të ligjit, përpara se të merret një vendim që konstaton në shkelje. Palët duhet të kenë mundësinë për të paraqitur pikëpamjet e tyre mbi këto gjetje, përpara se të merret një vendim i tillë përfundimtar. Palët, të cilave u është bërë me dije fakti lidhur me një shkelje potenciale të neneve 4 apo 9 të ligjit, duhet të kenë të drejtë të aksesojnë dosjen hetimore të AK, të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre të mbrojtjes në mënyrë efektive. E drejta për të aksesuar dosjen, duhet t'i nënshtrohet interesit legjitim të ndërmarrjeve për mbrojtjen e sekreteve të tyre të biznesit dhe nuk duhet të shtrihet në informacione konfidenciale, dokumente të brendshme dhe korrespondenca të ndryshme midis Sekretariatit dhe Komisionit. Për më tepër, në lidhje me vendimet e AK, në veçanti ato vendime që konstatojnë shkelje të nenit 4 apo 9 të ligjit, dhe vendosjen e kushteve dhe detyrimeve ose gjobave, adresuesit duhet të kenë të drejtën për tu dëgjuar. AK gjatë zbatimit të nenit 4 dhe 9 të ligjit, duhet ti kryejë procedurat brenda një afati kohor të arsyeshëm, duke marrë parasysh specifikat e secilit rast. Respektimi i procedurave duhet të krijojë një ekuilibër midis respektimit të të drejtave themelore të ndërmarrjeve dhe zbatimin efikas të parashikimeve të nenit 4 dhe 9 të ligjit.
- 13.** AK ka kompetencat e duhura për të zbatuar nenet 4 dhe 9 të ligjit, në mënyrë të paanshme dhe në interes të përbashkët të zbatimit efektiv të rregullave të konkurrencës.
- 14.** Pavarësia operationale e AK, duhet të forcohet në mënyrë që të sigurohet zbatimi efektiv dhe i njëtrajtshëm i neneve 4 dhe 9 të ligjit, të cilat janë në përputhje me nenet 101 dhe 102 të TFEU. Aktiviteti i AK duhet të mbrohet nga ndërhyrjet potenciale të jashtme ose presioni politik që mund të rrezikojë vlerësimin e pavarur të çështjeve. Për këtë qëllim, arsyet në lidhje me shkarkimin nga AK i vendimmarrësve që ushtrojnë kompetencat e vendimmarrjes, duhet të përcaktohen paraprakisht me dispozita ligjore, siç edhe parashikon edhe neni 22 i ligjit nr.9121/2003, për të hequr çdo dyshim të arsyeshëm në lidhje me paanshmërinë dhe pabarazinë e tyre ndaj faktorëve të jashtëm. Në mënyrë të ngjashme, duhet të përcaktohen në dispozitat ligjore rregulla dhe procedura të qarta dhe transparente për zgjedhjen, rekrutimin ose emërimin e këtyre personave, siç edhe parashikon neni 21 i ligjit nr.9121/2003. Për më tepër, për të siguruar paanshmërinë e AK, gjobat që vendosen për shkeljet e neneve 4 dhe 9 të ligjit, nuk duhet të përdoren për të financuar drejtpërdrejt AK.

15. Për të siguruar pavarësinë operationale të AK, drejtuesit e tyre, personeli dhe ata që marrin vendime duhet të veprojnë me integritet dhe të përmbahen nga çdo veprim që është i papajtueshëm me kryerjen e detyrave të tyre. Për të siguruar vlerësimin e pavarur nga eprorët, stafi dhe ata që marrin vendime, ata duhet të përmbahen nga çdo veprim i papajtueshëm, qoftë fitimprurës apo jo, qoftë gjatë punësimit ose mandatit të tyre dhe për një periudhë të arsyeshme pas kësaj.
16. Kjo do të thotë që gjatë punësimit ose mandatit të tyre, personeli dhe ata që marrin vendime, nuk mund të jenë pjesë e procedurave në zbatim të nenit 4 dhe 9 të ligjit, nëse kanë qenë të përfshirë ose kanë të bëjnë direkt me ndërmarrjet ose shoqatat e ndërmarrjeve, në të cilat ata kanë qenë të punësuar ose janë angazhuar në mënyrë tjetër profesionale, nëse kjo ka mundësi të rrezikojë paanshmërinë e tyre në një rast specifik. Në mënyrë të ngjashme, stafi dhe ata që marrin vendime, si dhe të afërmit e tyre të ngushtë, nuk duhet të kenë ndonjë interes për ndonjë biznes ose organizatë që është subjekt i procedurave për zbatimin e nenit 4 dhe 9 të ligjit, në të cilën marrin pjesë, nëse kjo ka mundësi për të kompromentuar paanshmërinë e tyre në një rast specifik. Vlerësimi nëse paanshmëria e tyre mund të dëmtojë në një rast specifik, duhet të marrë parasysh natyrën dhe madhësinë e interesit dhe nivelin e përfshirjes ose angazhimit të individit në fjalë. Kur është e nevojshme të sigurohet paanshmëria e hetimit dhe procesit të marrjes së vendimeve, individit në fjalë duhet t'i kërkohet që të heqë dorë nga çështja specifike.
17. Kjo gjithashtu do të thotë që, për një periudhë të arsyeshme pas largimit nga AK, sa herë që personeli ose vendimmarrësit, të cilët ishin angazhuar me procedura të caktuara në zbatim të nenit 4 dhe 9 të ligjit, në punën e tyre të re, nuk duhet të përfshihen me të njëjtin rast. Kohëzgjatja e asaj periudhe mund të përcaktohet duke marrë parasysh natyrën e profesionit të ri të individëve në fjalë, si dhe nivelin e përfshirjes dhe përgjegjësisë së tyre në të njëjtat procedura gjatë punësimit ose mandatit të tyre në AK.
18. AK ka publikuar një kod sjelljeje që mbulon rregullat për konfliktin e interesave. AK ka miratuar si Kodin e Etikës ashtu edhe Rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin e Konkurrencës”.
19. Pavarësia operationale e AK nuk duhet të parandalojë as rishikimin gjyqësor, as mbikëqyrjen parlamentare, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Kërkesat e llogaridhënies kontribuojnë në sigurimin e besueshmërisë dhe legjitimitetit të veprimeve të AK. Këtu përfshihen edhe publikimi nga AK i raporteve periodike –Raporti Vjetor-lidhur me aktivitetin e AK para Parlamentit. AK gjithashtu kontrollohet ose monitorohet lidhur me shpenzimeve financiare, me kusht që kjo të mos ndikojë në pavarësinë e institucionit.
20. AK duhet të jetë në gjendje të vendosë përparësitë lidhur me procedurat e tyre në kuadër të zbatimit të nenit 4 dhe 9 të Ligjit, me qëllim që të shfrytëzohen në mënyrë të efektshme

burimet e institucionit, dhe t'i lejojnë atij të përqendrohet në parandalimin, zbulimin dhe ndalimin e sjelljeve anti-konkurruese që shtrembërojnë konkurrencën në treg. Për këtë qëllim, AK duhet të jetë në gjendje të refuzojë ankesat me arsyetimin se nuk ato nuk kanë përparësi, me përjashtim të ankesave të paraqitura nga autoritetet publike lidhur me zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit. Sidoqoftë AK mund të shprehet lidhur me një ankesë jashtë objektit të ligjit apo kur nuk ka bazë ligjore për të vepruar dhe të ndërmerren veprime lidhur me një ankesë.

- 21.** AK duhet të ketë burime të mjaftueshme, për sa i përket stafit të kualifikuar, të aftë të kryejnë vlerësime juridike dhe ekonomike, mjete financiare, ekspertizë teknike dhe teknologjike dhe pajisje, duke përfshirë mjete adekuate të teknologjisë së informacionit, për të siguruar që ata janë në gjendje të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efektive gjatë respektimit të dispozitave të nenit 4 dhe 9 të Ligjit.
- 22.** Pavarësia e AK duhet ti mundësojë institucionit të vendosë në mënyrë të pavarur për shpenzimin e alokimeve të buxhetit me qëllim të kryerjes së detyrave të tyre, pa cënuar rregullat, procedurat dhe kuadrin ligjor lidhur me buxhetin.
- 23.** Për të siguruar që AK ka burimet e nevojshme për të kryer detyrat e tij, AK përdor mjete të ndryshme të financimit. Bazuar në nenin 31 të ligjit nr.9121/2003, buxheti vjetor për financimin e veprimtarisë së Autoritetit përbën zë më vete në Buxhetin e Shtetit dhe miratohet nga Kuvendi.
- 24.** AK paraqet raporte vjetore mbi aktivitetet dhe burimet e tij para Kuvendit. Bazuar në nenin 24 të ligjit nr.9121/2003, AK brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës paraqet në Kuvend raportin vjetor të Autoritetit. AK është pjesë e Platformës Ndërinstitucionale të Kuvendit, me anë të së cilës monitorohen zbatimi i rekomandimeve të dhëna në fushën e konkurrencës.
- 25.** AK duhet të ketë si mjetet e duhura për të kryer hetime ashtu edhe të drejtën për të marrë vendime në mënyrë që të zbatohen në mënyrë efektive nenet 4 dhe 9 të ligjit.
- 26.** AK duhet të ketë të drejtën për të kryer hetime për të zbuluar çdo marrëveshje, vendim ose praktikë të bashkërenduar të ndaluar nga neni 4 i ligjit ose çdo abuzim të pozitës dominuese të ndaluar nga neni 9 i ligjit në çdo fazë të procedurave. AK duhet të jetë në gjendje t'i zbatojë këto kompetenca për ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve që janë ndërmarrjet nën hetim lidhur me zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit ashtu si dhe me aktorët e tregut të cilët mund të zotërojnë informacione që kanë rëndësi për procedura të tilla.
- 27.** Kompetencat hetimore të AK duhet të jenë adekuate për të përmbushur sfidat në kuadër të këtij mjedisi dixhital, dhe duhet t'i japin mundësi AK që të marrë të gjithë informacionet që lidhen me ndërmarrjen ose shoqatën e ndërmarrjeve që i nënshtrohen procedurave hetimore në formë dixhitale, duke përfshirë të dhënat e marra në kuadër të forensic IT, pavarësisht se si ruhet informacionet, të tilla si në laptop, telefona celularë, pajisje të tjera celulare ose ruajtje në cloud.

- 28.** AK duhet të jetë në gjendje të kryejë të gjitha inspektimet e nevojshme të ambienteve të ndërmarrjeve dhe shoqatave të ndërmarrjeve, ku ka dyshime të arsyetuara lidhur me shkeljen e nenit 4 dhe 9 të ligjit.
- 29.** Për të qenë efektiv, të drejtat që i jepen AK për të kryer inspektime duhet t'u mundësojë atyre akses/qasje në informacionet lidhur me ndërmarrjen ose shoqatën e ndërmarrjeve ose personit që i nënshtrohet inspektimit dhe që ka të bëjë me ndërmarrjen ose shoqatën e ndërmarrjeve nën hetimi. Kjo domosdoshmërisht duhet të përfshijë të drejtën për të kërkuar dokumente, skedarë ose të dhëna në pajisje që jo domosdoshmërisht janë identifikuar saktësisht paraprakisht. Pa një të drejtë të tillë, do të ishte e pamundur të merren informacionet e nevojshme për hetimin kur ndërmarrjet ose shoqatat e ndërmarrjeve mbajnë një qëndrim pengues ose refuzojnë të bashkëpunojnë. E drejta për të shqyrtuar/ekzaminuar libra ose regjistrime duhet të përfshijë të gjitha format e korrespondencës, përfshirë mesazhet elektronike, pavarësisht nëse ato duket se janë të palexuara ose janë fshirë.
- 30.** Për të minimizuar zgjatjen e panevojshme të inspektimeve, AK duhet të ketë të drejtën të vazhdojë të bëjë kërkime dhe të zgjedhin kopje ose ekstrakte librash dhe regjistrimesh që lidhen me biznesin e ndërmarrjes ose shoqatës së ndërmarrjeve që inspektohen në ambientet e autoritetit ose në ndonjë tjetër lokacion të përcaktuar. Kërkime të tilla duhet të sigurojnë respektimin e vazhdueshëm të të drejtave të mbrojtjes nga ana e ndërmarrjeve.
- 31.** Përvoja tregon se të dhënat e biznesit mund të mbahen në shtëpitë e drejtorëve, menaxherëve dhe anëtarëve të tjerë të stafit të ndërmarrjeve ose shoqatave të ndërmarrjeve. Për të siguruar që inspektimet janë efektive, AK duhet të ketë të drejtën për të hyrë në çdo ambient, duke përfshirë shtëpi private, nëse ekziston një dyshim i arsyeshëm se të dhënat/regjistrimet e biznesit të cilat mund të jenë të rëndësishme për të provuar një shkelje të neneve 4 dhe 9 të ligjit, po mbahen në ato ambiente. Kryerja e këtyre inspektimeve mund të asistohet edhe nga strukturat e policisë, si masë paraprake, për të kapërcyer kundërshtimin e mundshëm nga ata që i nënshtrohen inspektimit.
- 32.** AK duhet të ketë të drejtën për ti kërkuar ndërmarrjeve ose shoqatave të ndërmarrjeve të japin informacionin e nevojshëm për të zbuluar shkeljet e neneve 4 dhe 9 të ligjit. Për këtë qëllim, AK duhet të jetë në gjendje të kërkojë zbulimin e informacionit që do ti lejojë të hetojë shkeljet e synuara. Kjo duhet të përfshijë të drejtën për të kërkuar informacione në çfarëdo forme dixhitale, përfshirë postën elektronike dhe sistemin e mesazheve të çastit, pavarësisht se ku ruhet, duke përfshirë ruajtjen në cloud dhe në server, me kusht që të jetë i aksesueshëm/i arritshëm për ndërmarrjen ose shoqatën e ndërmarrjeve apo të adresuarin e kërkesës për informacion. Kjo e drejtë nuk duhet të rezultojë në një detyrim nga ana e ndërmarrjes ose shoqatës së ndërmarrjeve që është në disproporcion me kërkesat e hetimit. Për shembull, nuk duhet të rezultojë në shpenzime të tepërta për ndërmarrjen ose shoqatën e ndërmarrjeve. Ndërsa e drejta për të kërkuar informacion është thelbësore për zbulimin e

shkeljeve, kërkesa të tilla duhet të jenë të përshtatshme lidhur me qëllimin për të cilat kërkohen. Kërkesa të tilla nuk duhet ta detyrojnë një ndërmarrje ose shoqatë të ndërmarrjeve të pranojë se ajo ka kryer një shkelje, e cila është detyrë e AK ta vërtetojë. Ndërmarrjet ose shoqatat e ndërmarrjeve duhet t'iu përgjigjen pyetjeve faktike dhe të sigurojnë dokumente. Në mënyrë të ngjashme, AK duhet të kenë mjete efektive për të kërkuar çdo person tjetër fizik ose juridik të sigurojë informacione që mund të jenë të rëndësishme për zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit. Informacioni i dhënë mbi baza vullnetare si përgjigje ndaj kërkesave jo të detyrueshme për informacion, mund të jetë një burim i vlefshëm informacioni për zbatimin e ligjit të konkurrencës. Në mënyrë të ngjashme, sigurimi i informacionit nga palët e treta, të tilla si konkurrentët, klientët dhe konsumatorët në treg, me iniciativën e tyre mund të kontribuojnë në zbatimin efektiv të ligjit dhe AK duhet ta inkurajojë këtë.

- 33.** Kryerja e intervistave është një mjet i dobishëm për të mbledhur prova dhe për të ndihmuar AK të vlerësojë të dhënat e mbledhura tashmë. AK duhet të ketë mjete efektive për të thirrur për intervistë çdo përfaqësues të një ndërmarrjeje ose shoqate të ndërmarrjeve, çdo përfaqësues të personave të tjerë juridikë dhe çdo person fizik që mund të zotërojë informacione të rëndësishme për zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit.
- 34.** Është e domosdoshme që AK të jetë në gjendje të kërkojë nga ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve që të përfundojnë shkeljet e neneve 4 dhe 9 të ligjit, përfshirë këtu edhe rastin kur shkelja vazhdon edhe pse AK ka filluar zyrtarisht procedurat. Për më tepër, AK, duhet të ketë mjete efektive për të rikthyer konkurrencën në treg duke imponuar mjete juridike strukturore dhe të sjelljes, të cilat janë proporcionale me shkeljen e kryer dhe të cilat janë të nevojshme për të përfunduar shkeljen. Parimi i proporcionalitetit kërkon që, kur zgjedh midis dy mjeteve juridike (kushte dhe detyrime) njësoj efektive, AK duhet të zgjedhë atë që është më pak i rëndë për ndërmarrjen. Kushtet dhe detyrimet strukturore, siç janë detyrimi për të shitur një njësi biznesi, ndikon në pasuritë e një ndërmarrjeje dhe mund të supozohet se janë më të rënda për ndërmarrjen sesa kushtet dhe detyrimet/mjetet juridike të sjelljes. Sidoqoftë, kjo nuk duhet të parandalojë AK në justifikimin në vendosjen e një detyrimi dhe kushti strukturor nëse do të ishte më efektiv për ta çuar në përfundim të shkeljes sesa një detyrim dhe kusht të sjelljes.
- 35.** Masat e përkohshme mund të jenë një mjet i rëndësishëm për të siguruar që, ndërsa hetimi po vazhdon, shkelja që po hetohet nuk dëmton seriozisht dhe në mënyrë të pariparueshme konkurrencën. Ky mjet është i rëndësishëm për të shmangur zhvillimet e tregut që mund të jenë shumë të vështira për t'u rikthyer, me një vendim të marrë nga AK në fund të procedurës. Prandaj, AK duhet të ketë të drejtën të vendosë masa të përkohshme me vendim. Një vendim i tillë merret nëse AK ka bërë një konstatim paraprak lidhur me shkeljen e neneve 4 dhe 9 të ligjit dhe kur ekziston rreziku i dëmtimit serioz dhe të pariparueshëm të konkurrencës. Një vendim që imponon masa të përkohshme duhet të jetë

i vlefshëm vetëm për një periudhë të caktuar, qoftë deri në përfundimin e procedurave nga AK, ose për një periudhë të caktuar kohore, e cila mund të rinovohet aq sa është e nevojshme dhe e përshtatshme. Ligjshmëria, përfshirë proporcionalitetin e masave të tilla të mund të jenë objekt rishikimi në procedura apelimi ankimore ose procedurat gjyqësor.

- 36.** Kur, gjatë procedurave të cilat mund të çojnë në një marrëveshje ose praktikë të ndaluar, ndërmarrjet ose shoqatat e ndërmarrjeve ofrojnë angazhime pranë AK që lidhen me shqetësimet e ngritura të konkurrencës, AK merr vendime që i bëjnë këto angazhime të detyrueshme dhe të zbatueshëm për ndërmarrjet ose shoqatat e ndërmarrjeve në fjalë. Në parim, vendime të tilla angazhimi nuk janë të përshtatshme në rastin e marrëveshjeve të ndaluara/ karteleve sekrete, për të cilat AK duhet të vendosë gjobë. Vendimet me angazhime lidhen me faktin se nuk ka më arsye pse AK të vijojë procedurat, duke mos konkluduar kështu nëse ka pasur shkelje të neneve 4 dhe 9 të ligjit. Duhet të jetë në diskrecionin e AK nëse i pranon angazhime apo jo. Vendimet me angazhime nuk cenojnë kompetencat e AK lidhur me një konstatim të një shkeljeje dhe të vendosin lidhur me një çështje. Për më tepër, mjetet e monitorimit të zbatueshmërisë nga ana e ndërmarrjeve ose shoqatave të ndërmarrjeve të vendimit me angazhime dhe mjetet e vendosjes së sanksioneve në rastet e mosrespektimit të vendimit, janë mjete efektive për AK. Autoriteti duhet të ketë të drejtën për rihapjen e procedurave në rastet kur ka pasur ndryshime materiale në ndonjë prej fakteve mbi të cilat ishte bazuar një vendim me angazhime, ku ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjeve ka vepruar në kundërshtim me angazhimet e dhëna, ose kur një vendim me angazhime është bazuar në informacione jo të plota, të pasakta ose mashtruese të dhëna nga palët.
- 37.** Për të siguruar zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit, AK ka të drejtën për të vendosur gjoba efektive, proporcionale për ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve për shkelje të neneve 4 dhe 9, në procedurat administrative, që ndjek vet AK.
- 38.** Për të siguruar që ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve nxiten drejt zbatimit të masave hetimore dhe vendimeve të AK, Autoriteti ka të drejtën e vendosjes së sanksioneve administrative.
- 39.** Sanksionet administrative do të vendosen kur shkelja është kryer me dashje ose nga pakujdesia. Nocionet e dashjes dhe pakujdesisë duhet të lidhen me zbatimin e nenit 4 dhe 9 të ligjit dhe jo me përkufizimet sipas të drejtës penale. AK me vendim, vendos gjoba të cilat duhet të jenë efektive, proporcionale mbi ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve kur, me dashje ose nga pakujdesia, ato shkelin nenet 4 dhe 9 të ligjit.
- 40.** Gjobat vendoset në përpjesëtim me xhiron totale të realizuar të ndërmarrjeve dhe shoqatave të ndërmarrjeve objekt hetimi.
- 41.** Gjobat periodike janë një mjet kryesor për të siguruar që AK ka mjetet efektive për të adresuar mosrespektimin e vazhdueshëm dhe të ardhshëm nga ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve lidhur me masat dhe vendimet e Autoritetit sipas neneve 6,8,9,10,11, 12.

Gjobat periodike nuk duhet të zbatohen për gjetjet e shkeljeve që janë kryer në të kaluarën. E drejta për të vendosur gjoba periodike nuk cenon të drejtën e AK për të ndëshkuar mosrespektimin e masave të përmendura në nenin 13 (2). Gjobat periodike duhet të përcaktohen në përpjesëtim me xhiron mesatare ditore të ndërmarrjeve dhe shoqatave të ndërmarrjeve në fjalë.

42. Me qëllim të vendosjes së gjobave dhe gjobave periodike, termi "vendim" duhet të përfshijë çdo masë që prodhon efekte juridike detyruese të afta të ndikojnë në interesat e adresuesit duke sjellë një ndryshim të veçantë në pozicionin e tij juridik.
43. Për të siguruar zbatimin efektiv dhe të njëtrajtshëm të neneve 4 dhe 9 të ligjit, nocioni "ndërmarrje", i atribuohet një njësie ekonomike, edhe nëse përbëhet nga disa persona juridikë ose fizikë. Në përputhje me rrethanat, AK i referohet përkufizimit të nocionit të ndërmarrjes, për të gjetur një shoqëri mëmë përgjegjëse, dhe të vendosë sanksione administrative/gjobë, për sjelljen e një prej filialeve të saj, ku kompania mëmë dhe filiali i saj formojnë një njësi të vetme ekonomike. Për të parandaluar ndërmarrjet të shpëtojnë nga përgjegjësia dhe pagesa për gjobat për shkelje të neneve 4 dhe 9, përmes ndryshimeve ligjore ose organizative, AK duhet të jetë në gjendje të gjejë pasardhës ligjorë ose ekonomikë të ndërmarrjes përgjegjëse, dhe të vendosin gjobë mbi to.
44. Për të siguruar që gjobat e vendosura për shkelje të neneve 4 dhe 9 të ligjit, pasqyrojnë rëndësinë ekonomike të shkeljes, AK duhet të marrë parasysh gravitetin/rëndësinë e shkeljes. AK gjithashtu duhet të jetë në gjendje të vendosë gjoba që janë në përpjesëtim me kohëzgjatjen e shkeljes. Vlerësimi i gravitetit duhet të bëhet rast pas rasti për të gjitha llojet e shkeljeve, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes. Faktorët që mund të merren në konsideratë përfshijnë natyrën e shkeljes, pjesën e kombinuar të tregut të të gjitha ndërmarrjeve në fjalë, shtrirjen gjeografike të shkeljes, nëse shkelja është kryer, vlerën e shitjeve të produkteve nga ndërmarrjes për të cilat shkelja lidhet drejtpërdrejt ose indirekt me madhësinë dhe fuqinë e tregut të ndërmarrjes në fjalë. Ekzistenca e shkeljeve të përsëritura nga e njëjta ndërmarrje, tregon gatishmërinë e saj për të kryer shkelje të tilla dhe për këtë arsye është një tregues shumë domethënës që niveli i dënimit duhet të rritet për të arritur një pengim efektiv. Në përputhje me rrethanat, AK duhet të ketë mundësinë e rritjes së shumës së gjobës që do të vendoset për një ndërmarrje ose shoqatë ndërmarrjesh, kur Komisioni më parë ka marrë një vendim që konstaton se ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjeve ka shkelur nenet 4 dhe 9 dhe kjo ndërmarrje ose shoqata e ndërmarrjeve vazhdon të kryejë të njëjtën shkelje ose kryen një shkelje të ngjashme. AK duhet të marrë parasysh edhe qëndrueshmërinë ekonomike të ndërmarrjes në fjalë.
45. Përvoja ka treguar që shoqatat e ndërmarrjeve rregullisht luajnë rol në shkeljet e konkurrencës dhe kështu, AK duhet të jenë në gjendje të gjobisin shoqatat e tilla në mënyrë efektive. Kur vlerësohet graviteti i shkeljes, për të përcaktuar shumën e gjobës në procedurat e ngritura ndaj shoqatave të ndërmarrjeve, kur shkelja lidhet me veprimtaritë e

anëtarëve të saj, duhet të jetë e mundur të merret në konsideratë shuma e shitjeve të mallrave dhe shërbime për të cilat shkelja lidhet drejtpërdrejt ose indirekt nga ndërmarrjet që janë anëtare të shoqatës. Kur vendoset një gjobë jo vetëm për shoqatën, por edhe për anëtarët e saj, xhiroja e realizuar nga anëtarët, mbi të cilën është vendosur gjobë, nuk duhet të merret parasysh gjatë llogaritjes së gjobës për shoqatën. Për të siguruar ekzekutimin efektiv të gjobave të vendosura për shoqatat e ndërmarrjeve për shkeljet që ata kanë kryer, është e nevojshme të përcaktohen kushtet në të cilat është në diskrecionin e AK që të kërkojë pagimin e gjobës nga anëtarët e shoqatës, ku shoqata nuk ka aftësi pagueuse. Në këtë rast, AK duhet të ketë parasysh madhësinë relative të ndërmarrjeve që i përkasin shoqatës dhe, veçanërisht, situatën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Pagesa e gjobës nga një ose disa anëtarë të një shoqate nuk cenon rregullat e ligjit të konkurrencës që parashikojnë ekzekutimin e shumës së paguar nga anëtarët e tjerë të shoqatës.

46. Shuma maksimale e gjobës që është e mundur të vendoset për çdo shkelje të neneve 4 dhe 9 të ligjit, duhet të vendoset në një nivel jo më shumë se 10% të xhiros totale të ndërmarrjes në fjalë.
47. Programet e lehtësimit nga gjobat, janë një mjet kryesor për zbulimin e marrëveshjeve të ndaluara/karteleve sekrete, dhe kështu kontribuojnë si në zbulimin edhe në vendosjen e sanksioneve për shkeljet më serioze të ligjit të konkurrencës. Programi i Lehtësimit nga Gjobat duhet të ofrojë siguri ligjore në lidhje me statusin e imunitetit të tyre në programet përkatëse të lehtësimit, duke rritur kështu edhe nxitjen për të aplikuar në kuadër të programit të lehtësimit nga gjobat.
48. Në rastet e aplikimit në kuadër të Programit të lehtësimit nga gjobat, është e rëndësishme të ofrohet siguria juridike e duhur për ndërmarrjet aplikuese.
49. AK duhet të jetë në gjendje t’ju garantojë ndërmarrjeve imunitet nga gjobat dhe të ofrojë reduktim nga gjobat nëse kushte të caktuara dhe kritere të caktuara janë plotësuar. Shoqatat e ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë aktivitet ekonomik në emër të tyre, janë subjekt i aplikimit dhe zbatimit të të imunitetit nga gjobat ose reduktimit nga gjobat në rastet kur ata janë pjesëmarrës në një marrëveshje të ndaluar qoftë në emër të tyre qoftë në emër të anëtarëve të tyre.
50. Që një marrëveshje të konsiderohet e ndaluar dhe sekrete, jo të gjitha aspektet e sjelljes duhet të jenë sekrete. Në veçanti, një marrëveshje e ndaluar/kartel mund të konsiderohet një kartel i fshehtë kur ka elementë që e bëjnë më të vështirë zbulimin e sjelljes dhe të cilat nuk janë të njohura për publikun ose klientët ose furnitorët.
51. Në mënyrë që të kualifikohet në kuadër të programit të lehtësimit nga gjobat, aplikanti duhet të përfundojë përfshirjen e tij në marrëveshjen e ndaluar, përveç në rastet kur AK konsideron se përfshirja e vazhdueshme është e nevojshme për të ruajtur integritetin e hetimit, për shembull, për të siguruar që pjesëmarrësit e tjerë të mos zbulojnë se AK ka informacion për marrëveshjen/kartelin, para se të ndërmarrë masa hetimore siç janë

inspektimet e pa njoftuara.

52. Në mënyrë që të kualifikohet në kuadër të programit të lehtësimit nga gjobat, aplikanti duhet të bashkëpunojë plotësisht, në mënyrë të vazhdueshme dhe në mënyrë të shpejtë me AK. Kjo do të thotë, ndër të tjera, se aplikanti nuk duhet të shkatërrojë, falsifikojë ose fshehë provat e marrëveshjes së ndaluar/ të fshehtë të pretenduar. Kur një ndërmarrje po mendon të bëjë një aplikim, ekziston rreziku që drejtorët e saj, menaxherët dhe personeli tjetër mund të shkatërrojnë prova në mënyrë që të fshehin përfshirjen e tyre në një marrëveshje të ndaluar, por shkatërrimi i provave mund të ndodhë edhe për arsye të tjera. Prandaj, AK duhet të marrë parasysh rrethanat specifike nën të cilat provat u shkatërruan dhe rëndësinë e një shkatërrimi të tillë kur konsideron faktin nëse shkatërrimi i provave e vë në dyshim bashkëpunimin e mirëfilltë të aplikuesit.
53. Për të përmbushur kushtin e një bashkëpunimi të mirëfilltë, të plotë, të vazhdueshëm dhe të shpejtë, kur aplikohet pranë AK, aplikanti nuk duhet të zbulojë fakte ose ndonjë nga përmbajtjet e aplikimit të tij përveçse para AK. Kjo nuk e pengon aplikuesin të vijojë procedurat pranë autoriteteve të tjera publike në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi. Sidoqoftë, gjatë përmbushjes së detyrimeve të tij në bazë të atyre ligjeve përkatëse, aplikanti gjithashtu duhet të marrë parasysh rëndësinë e mos ndikimit negativisht në hetimin që AK po kryen.
54. Aplikantët duhet ti jepet mundësia e paraqitjes së Formularit të Lehtësimit nga Gjobat siç parashikohet në Programin për Lehtësimin nga Gjobat.
55. Ndërmarrjet që dëshirojnë të paraqesin një kërkesë për imunitet, duhet të jenë në gjendje që fillimisht ti kërkojnë AK për një vend në radhë për lehtësim para se të paraqesin zyrtarisht kërkesën për imunitet, në mënyrë që t'i jepet kërkuarit, kohë për të mbledhur informacionin dhe provat e nevojshme. E njëjta procedurë zbatohet edhe në rastin e kërkesave për reduktim nga gjobat.
56. Pasiguria juridike lidhur me faktin se drejtorët aktualë dhe të mëparshëm, menaxherët dhe anëtarët e tjerë të stafit të aplikantëve për imunitet janë të mbrojtur nga sanksione individuale, siç janë gjobat, s'kualifikimet etj, mund të parandalojnë aplikantët e mundshëm të aplikojnë për lehtësim nga gjobat. Lidhur me kontributin e tyre në zbulimin dhe hetimin e marrëveshjeve të ndaluara/karteleve sekrete, këta persona, në parim, duhet të mbrohen nga sanksionet në lidhje me përfshirjen e tyre në marrëveshjen e ndaluar/kartelin sekret. Një nga këto kushte është që kërkesa për imunitet duhet të paraprijë kohën kur ata persona u ndërgjegjësuat nga organet kompetente kombëtare për procedurat që mund të çonin në vendosjen e sanksioneve. Procedime të tilla përfshijnë momentin kur këta individë dyshohen për shkelje të ligjit të konkurrencës.
57. Në mënyrë që të ofrohet mbrojtja e duhur në situata ku përfshihen më shumë se një juridiksion, AK duhet të mbajë kontakte me autoritete homologe të konkurrencës.
58. Për të siguruar zbatimin efektiv të neneve 4 dhe 9 të ligjit, duhet të parashikohen rregulla lidhur edhe me pezullimet dhe afatet përkatëse. Një pezullim i tillë ose ndërprerje nuk duhet

të ndalojë AK që të mbajnë ose të vendosë periudhat pezullimi, me kusht që kohëzgjatja e këtyre periudhave të pezullimit të mos e bëjë zbatimin efektiv të neneve 4 dhe 9 praktikisht të pamundur ose tepër të vështirë.

- 59.** Rreziku i nxjerrjes së materialit vetë-inkriminues jashtë kontekstit të hetimit për qëllimet e të cilit është siguruar mund të dobësojë nxitjen/stimujt për aplikantët e mundshëm për të bashkëpunuar me AK. Si pasojë, pavarësisht nga forma në të cilën paraqiten deklaratat e programit të lehtësimit nga gjobat, informacioni në këto deklarata, që është marrë me anë të aksesit/qasjes në dosje, duhet të përdoret vetëm kur është e nevojshme në disa raste shumë të kufizuara, për ushtrimin e të drejtave të mbrojtjes në procedurat para gjykatave, raste të cilat lidhen drejtpërdrejt me rastin për të cilin është dhënë ky akses/qasje. Kjo nuk parandalon AK të botojë vendimet e saj në përputhje me ligjin.
- 60.** Provat janë një element i rëndësishëm në zbatimin e neneve 4 dhe 9 të Ligjit. AK duhet të marrë në konsideratë provat përkatëse, pavarësisht nëse ato janë të shkruara, verbale ose në një formë elektronike ose të regjistruar. Kjo duhet të përfshijë edhe regjistrimet e fshehta të bëra nga persona fizikë ose juridikë që nuk janë autoritete publike, me kusht që ato regjistrime të mos jenë burimi i vetëm i provave. Kjo nuk duhet të cenohet të drejtën për t'u dëgjuar. AK i konsideron mesazhet elektronike si prova relevante, pavarësisht nëse ato mesazhe duket sikur janë të palexuara ose janë fshirë.
- 61.** AK bashkëpunon me autoritetet homologe me qëllim zbatueshmërinë e neneve 4 dhe 9 të ligjit, nëpërmjet mjeteve të cilat lehtësojnë dhe mbështesin këtë bashkëpunim.

62. AK duhet të ketë kompetenca lidhur me pavarësinë institucionale, të burimeve, dhe fuqive zbatuese dhe gjobitëse/sanksioneve, për të qenë në gjendje të zbatojë në mënyrë efektive nenet 4 dhe 9 të ligjit

### **Kreu I**

#### **Subjekti, Fusha e Zbatimit dhe Përkufizime**

##### **Neni I**

##### **Subjekti dhe fusha e zbatimit**

1. Udhëzuesi përcakton rregulla të caktuara për të siguruar që AK ka garancitë e nevojshme të pavarësisë institucionale, burimeve, të zbatimit dhe të vendosjes së sanksioneve për të qenë në gjendje të zbatojë në mënyrë efektive nenin 4 dhe 9 të ligjit, në mënyrë që konkurrenca në treg të mos shtrembërohet dhe që konsumatorët dhe ndërmarrjet të mos vendosen në dis-avantazh nga ligjet dhe kuadri rregullator, të cilat nuk e lejojnë AK të jetë zbatues efektiv.
2. Udhëzuesi parashikon edhe rregulla të caktuara lidhur me bashkëpunimin e përbashkët të AK me autoritetet e tjera homologe lidhur me mbrojtjen e konkurrencës dhe funksionimin e tregut.

##### **Neni 2**

##### **Përkufizimet**

1. Për qëllimet e këtij udhëzuesi, përkufizimet e mëposhtme zbatohen për:
  - "Autoriteti i Konkurrencës"-AK, nënkupton institucionin sipas përkufizimit të dhënë në nenin 18 të Ligjit 9121/2003;
  - "Ligji i Konkurrencës"-ligji nënkupton Ligji nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar.
  - "Gjykatë"- nënkupton sistemin gjyqësor shqiptar , në të cilin shqyrtohen vendimet lidhur me çështjet e konkurrencës.
  - "Procedurë"- nënkupton procedurat para AK për zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit, derisa të jenë mbyllur procedurat e tilla duke marrë një vendim sipas neneve 10, 12 ose 13 të këtij udhëzuesi;
  - "Ndërmarrje"- siç përmendet në nenet 4 dhe 9, nënkupton çdo entitet të angazhuar në një aktivitet ekonomik, pavarësisht nga statusi i tij ligjor dhe mënyra e financimit të tij; "Marrëveshje e ndaluar/'kartel' -nënkupton një marrëveshje ose praktikë të bashkërenduar midis dy ose më shumë konkurrentëve, që synojnë të koordinojnë sjelljen konkurruese të tyre në treg ose të ndikojnë/influencojnë në parametrat përkatës të konkurrencës, përmes praktikave të tilla si (por pa u kufizuar vetëm në to) fiksimi ose koordinimi i çmimeve të blerjes ose shitjes ose kushteve të tjera të tregtimit, përfshirë edhe të drejtat e pronësisë intelektuale, ndarjen/alokimin e pjesëve të prodhimit ose shitjes, ndarjen e tregjeve dhe

- klientët, përfshirë manipulimin e ofertave në procedurat e prokurimeve publike, kufizimet e importeve ose eksporteve ose veprimeve anti-konkurruese ndaj konkurrentëve të tjerë;
- “Marrëveshje e fshehtë/kartel i fshehtë”- nënkupton një marrëveshje të ndaluar/kartel, ekzistenca e të cilit fshihet pjesërisht ose tërësisht;
  - “Imunitet nga gjocat”- nënkupton një përjashtim nga gjoca që do t'i vendosej një ndërmarrjeje, për pjesëmarrjen e saj në një kartel të fshehtë, në mënyrë që të shpërblehet për bashkëpunimin e ndërmarrjes me AK, në kuadër të Programit të Lehtësimit nga Gjocat;
  - “Reduktim nga gjoca”- nënkupton reduktimin/zvogëlimin e shumës së gjobës që do të vendosej/merrte një ndërmarrje për pjesëmarrjen e saj në një kartel të fshehtë, në mënyrë që ta shpërblejë atë për bashkëpunimin e saj me AK në kuadër të Programit të Lehtësimit nga Gjocat’
  - “Lehtësim nënkupton imunitet nga gjocat dhe reduktim të gjobave;
  - "Programi i lehtësimit nga gjocat"-nënkupton një program në lidhje me zbatimin e nenit 4 të ligjit, në bazë të së cilës një pjesëmarrës në një kartel të fshehtë, pavarësisht nga ndërmarrjet e tjera të përfshira në kartel, bashkëpunon në një hetim të AK, duke ofruar vullnetarisht të dhënat në lidhje me çfarë ka informacion dhe rolin që ka në marrëveshjen e fshehtë/kartel, në këmbim të të cilit ky pjesëmarrës e merr, me vendim ose me një ndërprerje të procedurave, imunitetin ose një reduktim/zvogëlim të gjobave për përfshirjen e tij në kartel;
  - “Formulari i lehtësimit nga gjocat”- nënkupton një deklaratë verbale ose me shkrim të dhënë vullnetarisht, ose në emër të ndërmarrjes ose të një personi fizik pranë AK, duke dhënë informacionin që zotëron kjo ndërmarrje ose personi fizik në një kartel dhe duke përshkruar rolin e tij në të, depozitim i cili kryhet posaçërisht pranë AK me qëllim të marrjes së imunitetit ose reduktimit/uljes së gjobave në kuadër të Programit të Lehtësimit nga Gjocat, duke mos përfshirë të dhëna/prova që ekzistojnë pavarësisht nga procedurat e nisura, pavarësisht nëse një informacion i tillë është apo jo në dosjen e AK, i ashtuquajtur i informacion para-ekzistues;
  - “Depozitimi/Procedura e zgjidhjes”<sup>4</sup> nënkupton një depozitim vullnetar nga, ose në emër

<sup>4</sup> [https://ec.europa.eu/competition/cartels/legislation/cartels\\_settlements/settlements\\_en.html](https://ec.europa.eu/competition/cartels/legislation/cartels_settlements/settlements_en.html)

Një procedurë zgjidhje përdoret nga Komisioni për të shpejtuar procedurën e marrjes së një vendimi lidhur me një marrëveshje të ndaluar, kur palët pranojnë gjetjet e Komisionit, dhe si rezultat marrin një ulje prej 10% të gjobës. Procedurat e Zgjidhjeve në krahasim me vendimet e angazhimeve: Një zgjidhje është e ndryshme nga një vendim me angazhime, sepse një vendim zgjidhjeje do të thotë që ka një shkelje dhe kërkon pranimin e fajit nga palët, ndërsa një vendim me angazhime nuk krijon të zbulohet një shkelje dhe nuk kërkon pranim nga palët; një vendim zgjidhjeje kërkon thjesht një "pushim dhe heqje" të sjelljes së kaluar, ndërsa vendimi me angazhime kërkon angazhim për sjelljen e ardhshme; një procedurë zgjidhjeje është e disponueshme vetëm për marrëveshjet e ndaluara ndërsa vendimet me angazhime janë të përshtatshme në të gjitha rastet e antitrustit, përveç marrëveshjeve të ndaluara. A settlement is used by the Commission to speed up the procedure for adoption of a cartel decision when the parties admit to the Commission's objections, and in return receive a 10% reduction in the fine. Settlements compared to commitments decisions: A settlement is different from a commitments decision in that: a settlement decision does establish an

të një ndërmarrjeje, për AK, duke përshkruar pranimin nga ana e ndërmarrjes, ose heqjen dorë nga mosmarrëveshja, pjesëmarrjen e saj në një shkelje të nenit 4 të ligjit dhe përgjegjësia e ndërmarrjes në atë shkelje, e cila u hartua posaçërisht për të mundësuar AK të zbatojë një procedurë të thjeshtuar ose të përshpejtuar;

- “Aplikues”- nënkupton një ndërmarrje që aplikon për të kërkuar imunitet, ose reduktimin/uljen e gjobave në kuadër të Programit të Lehtësimit nga Gjykatat;

## **Kreu II Të Drejtat Themelore**

### **Neni 3 Masat mbrojtëse**

1. Procedurat në lidhje me shkeljet e neneve 4 dhe 9 të ligjit, përfshirë ushtrimin e kompetencave të përmendura në këtë udhëzues nga AK, e cila do të zbatojë parimet e përgjithshme të parashikuara në Politikën e Konkurrencës, Kodin e Procedurave Administrative dhe kuadrin ligjor në fuqi.
2. AK ofron masat mbrojtëse ët duhura për ndërmarrjet, përfshirë të drejtën për tu dëgjuar dhe të drejtën për tu ankuar para një gjykate.
3. AK ofron afate kohore të përshtatshme dhe të arsyetuara për kryerjen e procedurave hetimore. AK para marrjes së vendimit përfundimtar, harton Raportin e Hetimit.

## **Kreu III Pavarësia dhe Burimet**

### **Neni 4 Pavarësia institucionale**

1. Për të garantuar pavarësinë institucionale të AK gjatë zbatimit të nenit 4 dhe 9 të ligjit, AK kryen detyrat e saj dhe ushtron kompetencat në mënyrë të paanshme dhe në interes të zbatimit efektiv dhe uniform të këtyre dispozitave.
2. Në veçanti, AK duhet të sigurojë se personeli dhe personat që marrin vendime ushtrojnë kompetencat sipas neneve 10 deri 13 dhe nenin 16 të këtij udhëzuesi:
  - a) Të jenë në gjendje të kryejnë detyrat e tyre dhe të ushtrojnë kompetencat e tyre për zbatimin

---

infringement and requires an admission of guilt from the parties, whereas a commitment decision does not establish an infringement and does not require any admission by the parties; a settlement decision simply requires a "cease and desist" of past behaviour, whereas commitments decision requires commitment to future behavior; a settlement procedure is only available for cartels whereas commitment decisions are appropriate in all antitrust cases except for cartels. Settlements compared to plea bargains: A settlement is not the same as a plea bargain. The Commission has to shoë the parties that it has sufficient evidence to bring a final decision, and must send a Statement of Objections.

- e neneve 4 dhe 9 të pavarur nga ndikimi politik apo ndikim tjetër të jashtëm;
- b) të mos kërkojnë dhe as të marrin ndonjë udhëzim nga qeveria ose ndonjë entitet tjetër publik ose privat kur kryejnë detyrat e tyre dhe ushtrimin e kompetencave të tyre për zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit, pa cenuar të drejtën e pushtetit qendror apo vendor, që kur është e aplikueshme, të nxjerrin rregulla të përgjithshme lidhur me politika, të cilat nuk kanë lidhje me hetime sektoriale ose procedura specifike lidhur me zbatimin e ligjit të konkurrencës.
  - c) Të mos ndërmarrin veprime që janë të papajtueshme me kryerjen e detyrave të tyre dhe / ose me ushtrimin të kompetencave të tyre për zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit dhe i nënshtrohen procedurave që sigurojnë që, për një periudhë të arsyeshme pas largimit nga detyra, ata nuk duhet të pranojnë të merren me procedurat hetimore antitrust për të cilat mund të krijohen konflikte interesi.
3. Personat që marrin vendime duke ushtruar kompetencat e parashikuara në nenet 10 deri 13 dhe nenin 16 të këtij udhëzuesi, nuk duhet të pushohen nga puna për arsye që lidhen me kryerjen e duhur të detyrave të tyre ose ushtrimin e duhur të kompetencave të tyre për zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit. Ata lirohen nga detyra vetëm në rastet e papajtueshmërisë të parashikuara në ligjin nr. 9121/2003 ose nëse janë shpallur fajtorë për shkelje të ligjit, me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Kushtet dhe kriteret e kërkuara për kryerjen e detyrave të tyre, dhe çfarë përbën shkelje e ligjit, parashikohen në dispozitat ligjore, duke marrë parasysh nevojën për të siguruar një zbatim efektiv.
  4. Anëtarët e Komisionit të Konkurrencës zgjidhen, dhe emërohen sipas procedurave të qarta dhe transparente të përcaktuara paraprakisht në dispozitat e ligjit nr.9121/2003.
  5. AK ka kompetencën për të vendosur prioritete dhe për të përcaktuar përparësitë e tyre për realizimin e detyrave në kuadër të zbatimit të neneve 4 dhe 9 të ligjit. AK duhet të ketë kompetencë për të refuzuar ato ankesa, me arsyetimin se AK nuk i konsideron ankesa të tilla prioritete. Kjo nuk cenon kompetencën e AK për të refuzuar ankesa edhe bazuar në dispozita të tjera ligjore.

## **Neni 5 Burimet e AK**

1. AK duhet të kenë një numër të mjaftueshëm personeli/stafi të kualifikuar dhe burime të mjaftueshme financiare, teknike dhe teknologjike që janë të nevojshme për kryerjen efektive të detyrave të tyre dhe për ushtrimin efektiv të kompetencave të tyre për zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit.
2. Për qëllimet e pikës 1, AK duhet të jetë në gjendje, të kryejë hetime me qëllim të zbatimit të neneve 4 dhe 9 të ligjit, të marrë dhe të miratojë vendime dhe të bashkëpunojë me autoritetet homologe për të siguruar zbatimin efektiv dhe të njëtrajtshëm të neneve 4 dhe

9. AK gjithashtu duhet të jetë në gjendje të jap rekomandime dhe opinione për institucionet dhe organet publike, lidhur me nisma ligjore, rregullatore dhe administrative të cilat mund të kenë ndikim në konkurrencën në tregun e brendshëm si dhe të promovojë ndërgjegjësimin publik lidhur me zbatueshmërinë e nenit 4 dhe 9 të ligjit.

3. Pa cenuar rregullat dhe procedurat e buxhetit kombëtar, AK duhet të jetë i pavarur në shpenzimin e buxhetit të alokuar me qëllim kryerjen e detyrave siç përcaktohen në paragrafin 2 më lart.
4. Bazuar në nenin 24 të ligjit nr.9121/2003, AK brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës paraqet në Kuvend raportin vjetor të Autoritetit. Ky raport vihet në dispozicion të publikut.

## **Kreu IV Kompetencat**

### **Neni 6**

#### **E drejta për të inspektuar ambientet e biznesit**

1. AK kryen inspektime të pa njoftuara në ambientet e ndërmarrjeve dhe shoqatave të ndërmarrjeve për zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit. Inspektorët e autorizuar të AK dhe personat e tjerë shoqëruar të autorizuar ose të caktuar për të kryer këto inspektime kanë të drejtën :
  - a) të hyjnë në mjediset, mjetet e transportit dhe në territorin e ndërmarrjeve dhe shoqatave të ndërmarrjeve;
  - b) të shqyrtojnë/ekzaminonjë librat dhe regjistrimet e tjera që lidhen me biznesin, pavarësisht nga forma në të cilin janë ruajtur, dhe kanë të drejtën për të aksesuar çdo informacion që është i aksesueshëm lidhur me subjektin që i nënshtrohet inspektimit;
  - c) të marrin ose të sigurojnë, në çfarëdo forme, kopje ose ekstrakte nga libra ose regjistrime të tilla dhe, kur ata i konsiderojnë ato të përshtatshme, të vazhdojnë bërjen e kërkimeve të tilla për informacione dhe zgjedhjen e kopjeve ose ekstrakteve në ambientet e AK;
  - d) të vulosin çdo ambient biznesi, libra ose regjistrime lidhur me periudhën hetimore dhe në masën e nevojshme për kryerjen e inspektimit;
  - e) të marrin shpjegime nga çdo përfaqësues ose anëtar i stafit të ndërmarrjes ose shoqatës së ndërmarrjeve për sqarime mbi fakte ose dokumente që lidhen me objektin dhe qëllimin e inspektimit dhe ti regjistrojnë këto përgjigje.
2. AK siguron që ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve t'i nënshtrohen inspektimeve të përmendura në paragrafin 1 më sipër. AK gjithashtu siguron që, kur një ndërmarrje ose shoqatë ndërmarrjesh kundërshtojnë një inspektim që është urdhëruar nga AK, AK kërkon asistencën e policisë, në mënyrë që t'iu mundësojë atyre të kryejnë inspektimet. Një ndihmë e tillë mund të kërkohet si masë paraprake.

### **Neni 7**

#### **E drejta për të inspektuar ambiente të tjera**

1. AK kur ka një dyshim të arsyeshëm se librat ose regjistrime të tjera që lidhen me biznesin dhe subjektin e inspektimit, të dhëna të cilat mund të jenë të rëndësishme për të provuar një shkelje të neneve 4 dhe 9 të ligjit, mbahen në ambiente, tokë ose mjete transporti, përveç atyre të përmendura në pikën (a) të Neni 6 (1) të këtij udhëzuesi, përfshirë shtëpitë e drejtorëve, menaxherëve dhe anëtarëve të tjerë të stafit të ndërmarrjeve ose shoqatat e ndërmarrjeve, AK ka kompetenca të kryejë inspektime të panjoftuara në ambiente të tilla, tokë dhe mjete transporti.
2. Këto inspektime nuk do të kryhen pa autorizimin paraprak të gjykatës.
3. Përfaqësuesit e AK dhe personat e tjerë shoqërues të autorizuar ose caktuar nga AK për të kryer një inspektim në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, kanë kompetencat e përcaktuara në pikat (a), (b) dhe (c) të nenit 6 (1) dhe nenit 6 (2).

### **Neni 8**

#### **Kërkesa për informacion**

1. AK mund të kërkojë nga ndërmarrje dhe shoqatat e ndërmarrjeve të japin të gjithë informacionin e nevojshëm për zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit, brenda një afati të caktuar dhe të arsyeshëm.
2. Kërkesa të tilla për informacion do të jenë proporcionale dhe nuk duhet të detyrojnë adresuesit e kërkesave për të pranuar shkelje të neneve 4 dhe 9 të ligjit. Detyrimi për të siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm përfshin informacionin i cili është i aksesueshëm nga ndërmarrjet ose shoqatat e ndërmarrjeve.
3. AK gjithashtu mund të kërkojë informacion nga çdo person tjetër fizik ose juridik, informacion i cili mund të jetë i rëndësishëm për zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit, dhe që duhet të depozitohet brenda një afati kohor specifik dhe të arsyeshëm.

### **Neni 9**

#### **Intervistat**

AK ka të drejtë që të thërrasë për t'u paraqitur për një intervistë çdo përfaqësues të një ndërmarrjeje ose një shoqate të ndërmarrjeve, çdo përfaqësues të personave të tjerë juridikë, dhe çdo personi fizik, kur një përfaqësues ose person i tillë mund të ketë informacione të rëndësishme për zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit.

### **Neni 10 Gjetja dhe përfundimi i shkeljes**

AK në rastet e konstatimit të shkeljeve të neneve 4 dhe 9 të ligjit, me vendim mund të kërkojë që ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve të interesuara të përfundojnë/ndalojnë menjëherë këtë shkelje. Për këtë qëllim, AK mund të vendosë çdo masë juridike/kushte dhe detyrime të sjelljes ose strukturore, të cilat janë proporcionale në lidhje me shkeljen e kryer dhe të domosdoshme për t'i dhënë fund shkeljes së kryer në mënyrë efektive. Kur vendoset ndërmjet dy kushteve dhe detyrimeve njësoj efektive, AK do të zgjedhë atë kusht dhe detyrim i cili është më pak i rëndë për ndërmarrjen, në përputhje me respektimin e parimit të proporcionalitetit.

### **Neni 11 Masat e përkohshme**

1. AK vepron me iniciativën e tyre për të urdhëruar me vendim marrjen e masave të përkohshme, për ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve, të paktën në rastet kur ekziston rreziku/urgjenca për një dëm serioz dhe të pariparueshëm të konkurrencës, në bazë të një konstatimi *prima facie* të shkeljes së neneve 4 dhe 9 të ligjit. Një vendim i tillë do të jetë proporcional dhe do të zbatohet qoftë për një periudhë të caktuar kohore, periudhë e cila mund të rinovohet për sa kohë është e nevojshme dhe e përshtatshme ose deri në marrjen e vendimit përfundimtar.
2. AK siguron ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e kësaj mase, të cilat mund të rishikohen në kuadër të se drejtës së ankimit.

### **Neni 12 Angazhimet**

1. AK gjatë kryerjes së procedurave hetimore me qëllim marrjen e një vendimi përfundimtar në zbatim të nenit 4 dhe 9 të ligjit kur konstatohet një shkelje, mund (pasi të kërkojë formalisht ose në mënyrë informale këndvështrimet e pjesëmarrësve të tregut) të marrë një vendim me angazhime detyruese, të ofruara nga ndërmarrjet ose shoqatat e ndërmarrjeve, kur këto angazhime i përshtaten dhe plotësojnë shqetësimet e ngritura të konkurrencës nga ana e AK. Një vendim i tillë mund të miratohet për një periudhë të caktuar, duke konkluduar se nuk ka më arsye/shkaqe për të vijuar procedurat hetimore nga AK.
2. AK ka të gjitha mjetet për të monitoruar zbatimin/implementimin e angazhimeve të përmendura në paragrafin 1.
3. AK mund të rihapë procedurat hetimore, kur ka pasur ndryshime materiale në ndonjë prej fakteve mbi të cilat ishte bazuar një vendim i përmendur në paragrafin 1 apo kur ndërmarrjet ose shoqatat e ndërmarrjeve veprojnë në kundërshtim me angazhimet e dhëna, ose kur një vendim i referuar në paragrafin 1 është bazuar në informacione jo të plota, të pasakta ose mashtruese të dhëna nga palët.

## **Kreu V** **Gjobat dhe pagesa periodike e gjobave**

### **Neni 13** **Gjobat për ndërmarrjet dhe shoqatat e lidhura me to**

1. AK me vendim vendos gjoba të cilat duhet të jenë efektive, proporcionale mbi ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve ku, me dashje ose nga pakujdesia, ato shkelin nenet 4 dhe 9 të ligjit.
2. Shuma e gjobës, e cila varet nga xhiro totale e realizuar në vitin e kaluar kalendarik, do të caktohet në mënyrë proporcionale për ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve kur me dashje ose nga pakujdesia:
  - a) Nuk respektojnë vendimet për inspektim të përmendur në nenin 6 (2);
  - b) Heqin vulat e vendosura nga përfaqësuesit e AK siç përmenden në pikën (d) të nenit 6 (1));
  - c) Në përgjigje të një pyetjeje të përmendur në pikën (e) të nenit 6 (1), ata japin një përgjigje të pasaktë, mashtruese, dështojnë ose refuzojnë të japin një përgjigje të plotë;
  - d) Japin informacione jo korrekte, jo të plota ose mashtruese në përgjigje të një kërkesë të përmendur në nenin 8 ose nuk japin informacionit brenda afatit kohor të caktuar;
  - e) Nuk paraqiten në një intervistë sipas parashikimeve të nenit 9;
  - f) Nuk respektojnë një vendim të përmendur në nenet 10, 11 dhe 12.
3. AK në rastet e përmendura sipas pikave 1 dhe 2 vendos gjoba efektive, proporcionale dhe duke patur për qëllim ndalimin e shkeljes.
4. AK zbaton nocionin e përkufizimit të ndërmarrjes, me qëllim të vendosjes së gjobave për ndërmarrjet mëmë dhe pasardhësit juridike dhe ekonomike të ndërmarrjeve.

### **Neni 14**

#### **Llogaritja e gjobave**

1. AK në llogaritjen e gjobës merr parasysh si rrethanat rënduese ashtu edhe kohëzgjatjen e shkeljes kur përcakton shumën e gjobës që do të vendoset për një shkelje të neneve 4 dhe 9 të ligjit.
2. Kur vendoset një gjobë për shkelje të neneve 4 dhe 9 të ligjit, mbi shoqatë ndërmarrjesh duke patur parasysh xhiron e anëtarëve të shoqatës, dhe që shoqata nuk ka aftësi paguese, shoqata është e detyruar të kërkojë kontribute nga anëtarët e saj, për të mbuluar mbulimin e shumës së gjobës.
3. Kur kontributet e përmendura në pikën 2 më sipër, nuk janë bërë plotësisht nga shoqata e ndërmarrjeve, brenda afatit të përcaktuar nga AK, ky i fundit mund të kërkojë pagimin e gjobës drejtpërdrejt nga ndonjë prej ndërmarrjeve, përfaqësuesit e së cilës ishin anëtarë

të organeve vendimmarrëse të asaj shoqate. Kur është e nevojshme për të siguruar pagimin e plotë të gjobës, pasi AK ka kërkuar pagimin nga ndërmarrje të tilla, ato gjithashtu mund të kërkojnë pagesa të shumës së papaguar të gjobës nga ndonjë prej anëtarëve të shoqatës që ishin aktivë në tregun në të cilin ka ndodhur shkelja. Sidoqoftë, pagesa e gjobës sipas kësaj pike, nuk do ti kërkohej ndërmarrjeve të cilat nuk e kanë zbatuar vendimin për shkeljen e rregullave të konkurrencë të marrë nga shoqata dhe/ose që nuk ishin në dijeni për ekzistencën e shkeljes apo kanë qenë aktivisht të distancuar nga kjo shkelje, para se të fillonte hetimi.

### **Neni 15**

#### **Shuma maksimale e gjobës**

1. Shuma maksimale e gjobës që mund të vendoset për ndërmarrjet ose shoqatën e ndërmarrjeve për shkelje të neneve 4 dhe 9 të ligjit, është deri në 10% të xhiros totale të ndërmarrjes ose shoqatës së ndërmarrjeve të vitit financiar paraardhës.
2. Kur një shkelje e kryer nga një shoqatë ndërmarrjesh ka të bëjë me aktivitetet e anëtarëve të saj, shuma e gjobës do të jetë deri në 10% e shumës së xhiros totale të vitit financiar paraardhës të secilit anëtar aktiv, në tregun e prekur nga shkelja e kryer. Sidoqoftë, përgjegjësia financiare e secilës ndërmarrje në lidhje me pagesën e gjobës nuk duhet të kalojë shumën maksimale të përcaktuar në përputhje me pikën 1 më sipër.

### **Neni 16**

#### **Gjoba periodike**

AK me vendim mund të vendosë gjoba periodike, proporcionale, për ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve. Gjoba të tilla periodike përcaktohen në proporcion me xhiron mesatare ditore totale të ndërmarrjeve ose shoqatave të ndërmarrjeve në vitin e mëparshëm financiar dhe llogariten nga data e caktuar me vendim për të detyruar këto ndërmarrje ose shoqata të ndërmarrjeve që të paktën:

- a) të sigurojnë informacion të plotë dhe të saktë në përgjigje të një kërkesë të përmendur në nenin 8;
- b) të paraqiten në një intervistë sipas parashikimeve të nenit 9.
- c) t'i nënshtrohet një inspektimi siç përmendet në nenin 6 (2);
- d) të zbatojnë një vendim të përmendur në nenet 10, 11 dhe 12

## **KAPITULLI VI**

### **Programi i lehtësimit nga gjobat**

#### **Neni 17**

#### **Imuniteti prej gjobave**

1. AK ka miratuar Programin e Lehtësimit nga Gjobat, që i lejon AK të japë imunitet prej gjobave, ndërmarrjeve, për zbulimin e pjesëmarrjes së tyre në marrëveshjet e ndaluara/kartelet e fshehta.
2. AK i jep imunitet prej gjobave aplikantëve në rastet kur:
  - a. përmbushen kushtet e përcaktuara në nenin 19;
  - b. zbulon pjesëmarrjen e tij në një marrëveshje të ndaluar/kartel të fshehtë;
  - c. është i pari që paraqet prova të cilat:
    - në kohën kur AK merr një aplikim, i mundëson AK të kryejë një inspektim në lidhje me marrëveshjen e fshehtë, me kusht që AK të mos kishte akoma në posedim prova të mjaftueshme për të kryer një inspektim të tillë ose nuk kishte kryer një inspektim të tillë deri në atë moment; ose
    - në pikëpamjen e AK, është e mjaftueshme që ajo të gjejë një shkelje, në kuadër të Programit të lehtësimit nga gjobat, me kusht që autoriteti të mos kishte ende në dispozicion të tij prova të mjaftueshme për të zbuluar një shkelje të tillë dhe që asnjë ndërmarrje tjetër nuk është kualifikuar më parë për imunitet prej gjobave sipas pikës (i) në lidhje me këtë marrëveshje të fshehtë.
3. Çdo ndërmarrje ka të drejtë për të përfituar nga imuniteti nga gjobat, me përjashtim të ndërmarrjeve që kanë ndërmarrë nisma për të detyruar ndërmarrjet e tjera të bashkohen me një marrëveshje të fshehtë ose për të vazhduar të jenë në të.
4. AK informon aplikantin nëse i është dhënë apo jo imunitet nga gjobat. Aplikanti mund të kërkojë që ai të informohet nga AK për rezultatin e aplikimit të tij, me shkrim. Në rastet kur AK refuzon një kërkesë për imunitet nga gjobat, aplikanti i interesuar mund të kërkojë që AK të marrë në konsideratë aplikimin e tij si një kërkesë për reduktim nga gjobat.

#### **Neni 18**

#### **Reduktimi i gjobave**

1. AK ka miratuar Programin e Lehtësimit nga Gjobat, që lejon Autoritetin të reduktojë gjobat për ndërmarrjet që nuk kualifikohen për imunitet nga gjobat.

2. AK garanton një reduktim të gjobave vetëm nëse aplikanti:
  - a. përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 19;
  - b. zbulon pjesëmarrjen e tij në një marrëveshje të ndaluar;
  - c. paraqet prova të marrëveshjes së ndaluar të pretenduar, prova të cilat paraqesin vlerë të konsiderueshme të shtuar për qëllimin e zbulimit të një shkeljeje, në kuadër të Programit të Lehtësimit nga Gjobat, në krahasim me provat që tashmë zotëron AK në kohën e aplikimit.
3. Nëse aplikanti paraqet prova bindëse të cilat AK i përdor për të provuar fakte shtesë që çojnë në një rritje të gjobave në krahasim me gjobat që përndryshe do të ishin vendosur për pjesëmarrësit në marrëveshjen e ndaluar, AK nuk do t'i marrë parasysh këto fakte shtesë kur të caktojë gjobën që do t'i vendoset aplikuesit, i cili siguroi këtë provë.

## Neni 19

### Kushtet e përgjithshme për lehtësimin

Për t'u kualifikuar për lehtësim si pjesëmarrjes në marrëveshje të ndaluar, aplikanti duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- I. Të përfundojë përfshirjen e tij në marrëveshjen e ndaluar të paktën direct pas aplikimit për lehtësim, përveçse më rastin kur sipas mendimit të AK, do të ishte e nevojshme për të vijueshmërinë e hetimeve;
- II. Bashkëpunon vërtet, plotësisht, në mënyrë të vazhdueshme dhe në mënyrë të shpejtë me AK nga koha e aplikimit të tij deri sa autoriteti të ketë mbyllur procedurat e tij të hetimit kundër të gjitha palëve nën hetim duke miratuar një vendim dhe një bashkëpunim i tillë përfshin:
  - a) t'i sigurojë AK menjëherë të gjitha informacionet dhe provat përkatëse në lidhje me marrëveshjen e ndaluar të pretenduar që është në posedim të aplikantit ose është i aksesueshëm për të, veçanërisht:
    - emrin dhe adresën e aplikantit,
    - emrat e të gjitha ndërmarrjeve të tjera që marrin pjesë ose kanë marrë pjesë në marrëveshjen e ndaluar të pretenduar;
    - një përshkrim të hollësishëm të marrëveshjes së ndaluar të pretenduar, përfshirë produktet e prekura, territoret e prekura, kohëzgjatjen dhe natyrën e sjelljes së pretenduar të marrëveshjes së ndaluar;
    - informacion mbi çdo aplikim në të kaluarën ose aplikim të mundshëm në kuadër të Programit të Lehtësimit nga Gjobat në të ardhmen, i bërë edhe në autoritete homologe, në lidhje me marrëveshjen e ndaluar të pretenduar.
  - b) të qëndrojë në dispozicion të AK për t'iu përgjigjur çdo kërkesë që mund të kontribuojë në vërtetimin e fakteve;
  - c) të vendosë në dispozicion të AK për intervista drejtorët, menaxherët dhe anëtarë të tjerë të stafit dhe duke bërë përpjekje për të vendosur në dispozicion të AK për intervista ish drejtorët, ish menaxherët dhe ish anëtarët e tjerë të stafit ;

- d) të mos shkatërrojë, falsifikojë, fsheh informacionin ose provat përkatëse;
- e) të mos zbulojë fakte dhe përmbajtjen e aplikimit për lehtësim përpara se AK të ketë përgatitur raportin e Hetimit në kuadër të procedurave hetimore, përveç rastit kur kanë rënë dakord për të vepruar ndryshe;

**III.** Gjatë depozitimit të aplikimit në kuadër të Programit të Lehtësimit nga Gjobat para AK nuk duhet të ketë:

- Shkatërruar prova, prova të falsifikuara ose të fshehura në kuadër të marrëveshjes së ndaluar;
- Zbuluar fakte, ose pjese të përmbajtjes së aplikimit të tij.

## **Neni 20**

### **Forma e deklaratës së lehtësimit**

1. Aplikantët paraqesin deklarata në kuadër të lehtësimit nga gjobat, aplikim i plotë ose i përmbledhur, me shkrim, dhe AK duhet të ketë një sistem, i cili u mundëson atyre të pranojnë deklarata të tilla ose në formë verbale ose me mjete të tjera që nuk i lejojnë aplikantët të marrin posedimin, kujdestarinë ose kontrollin e deklaratave të tilla të paraqitura.
2. Nëse kërkohet nga aplikuesi, AK me shkrim shprehet lidhur me pranimin e kërkesës së plotë ose të përmbledhur, duke vendosur datën dhe kohën e marrjes së aplikimit.
3. Aplikimi bëhet në gjuhën shqipe.

## **Neni 21**

### **Aplikimi për imunitet ndaj gjobave**

1. Ndërmarrjet që aplikojnë për imunitet prej gjobave, fillimisht u jepet një vend në radhë për lehtësim, ku ata e kërkojnë këtë, për një periudhë specifike, rast pas rasti, në mënyrë që aplikanti të mbledhë informacionin dhe provat e nevojshme, për të përmbushur kriteret/ pragun përkatëse për të përfituar nga imuniteti nga gjobat.
2. AK ka diskrecionin për ta pranuar apo jo kërkesën në përputhje me pikën 1 më sipër.

Një ndërmarrje që depoziton një kërkesë të tillë do të sigurojë informacione për AK të tilla si:

- a. emrin dhe adresën e aplikantit;
- b. shqetësimin që çoi në këtë kërkesë;
- c. emrat e të gjitha ndërmarrjeve të tjera që marrin pjesë ose kanë marrë pjesë në marrëveshjen e ndaluar të pretenduar;
- d. produktet dhe territoret e prekura;
- e. kohëzgjatjen dhe natyrën e marrëveshjes së ndaluar të pretenduar;
- f. informacione mbi çfarëdo aplikimesh të së kaluarës ose të mundshëm në të

ardhmen në kuadër të programit të lehtësimit, në lidhje me shkeljen e pretenduar

3. Çdo informacion dhe provë e dhënë nga aplikuesi brenda periudhës së specifikuar në përputhje me pikën 1, konsiderohet se është paraqitur në kohën e kërkesës fillestare.
4. Aplikanti do të jetë në gjendje të paraqesë një kërkesë në përputhje me pikën 1 në gjuhën shqipe.
5. AK i jep mundësinë ndërmarrjeve të cilat dëshirojnë të bëjnë një kërkesë për reduktimin nga gjobat, për të kërkuar fillimisht një vend në radhë në kuadër të programit të lehtësimit.

## Neni 22

### **Bashkëveprimi midis aplikimeve për imunitet ndaj gjobave si edhe sanksionet ndaj personave fizikë**

1. Drejtorët aktualë dhe të mëparshëm, menaxherët dhe anëtarët e tjerë të personelit të aplikantëve për imunitet ndaj gjobave, duhet të mbrohen plotësisht nga sanksionet e vendosura në kuadër të procedurave administrative në fushën e konkurrencës, përsa i përket përfshirjes dhe lidhjes së tyre në marrëveshjen e ndaluar, në kuadër të kërkesës dhe aplikimit për imunitet ndaj gjobave, nëse:
  - kërkesa për imunitet nga gjobat e ndërmarrjes tek AK , përmbush kërkesat e përcaktuara në pikat (b) dhe (c) të nenit 17 (2);
  - drejtorë aktualë dhe të mëparshëm, menaxherët dhe anëtarët e tjerë të stafit bashkëpunojnë në mënyrë aktive me AK ; dhe
  - aplikimi i ndërmarrjes për imunitet ndaj gjobave daton në kohën kur ata drejtorë aktualë ose të mëparshëm, menaxherë dhe anëtarët e tjerë të personelit, vihen në dijeni nga AK për procedurat që çojnë në imponimin e sanksioneve të referuara në këtë paragraf.
2. Drejtorët aktualë dhe të mëparshëm, menaxherët dhe anëtarët e tjerë të personelit të aplikantëve për imunitet ndaj gjobave mbrohen ndaj sanksioneve të vendosura , në lidhje me përfshirjen e tyre në marrëveshjen e ndaluar në kuadër të aplikimit për imunitet ndaj gjobave, për shkelje të dispozitave të nenit 4 të ligjit, nëse ato plotësojnë kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 dhe bashkëpunojnë në mënyrë aktive.

## **KAPITULLI VII ASISTENCA E PËRBASHKËT**

### Neni 23

#### **Bashkëpunimi midis autoriteteve të konkurrencës**

1. AK mund të ndërmarrë një inspektim ose intervistë në emër të dhe për llogari të një autoriteti homolog të konkurrencës, dhe në këtë raste zyrtarët dhe personat e tjerë

shoqërues të autorizuar ose të caktuar nga autoriteti homolog i konkurrencës do të lejohen të marrin pjesë dhe të ndihmojnë në mënyrë aktive AK, nën mbikëqyrjen e zyrtarëve të AK.

2. AK ka kompetencat e përmendura në nenet 6 deri 9 të këtij udhëzuesi. AK dhe autoriteti homolog i konkurrencës shkëmbejnë dhe përdorin informacione për qëllim të këtij hetimi.

#### **Neni 24**

##### **Kërkesë për njoftimin e gjetjeve paraprake dhe dokumenteve të tjera**

AK, me kërkesë të autoritetit homolog të konkurrencës, i njofton adresuesit për llogari të autoritetit homolog të konkurrencës sa më poshtë:

- çdo gjetje paraprake për shkeljen e pretenduar të neneve 4 dhe 9 të ligjit dhe çdo vendim që zbaton këto nene;
- çdo akt tjetër procedural të miratuar në kontekstin e procedurave hetimore, i cili duhet të njoftohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- çdo dokument tjetër të rëndësishëm që lidhet me zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit, përfshirë dokumentet që kanë të bëjnë me zbatimin e vendimeve që vendosin gjobë ose pagesa periodike të gjobave.

#### **Neni 25**

##### **Kërkesa për zbatimin e vendimeve që vendosin gjoba apo pagesa periodike**

1. Me kërkesë të autoritetit homolog, AK do të ekzekutojë vendime për vendosjen e gjobave ose pagesa periodike të gjobave të vendosura nga autoriteti homolog. Kjo do të zbatohet vetëm atëherë kur pasi të ketë bërë përpjekje të arsyeshme në territorin e vet, autoriteti homolog ka konstatuar se ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjeve kundër të cilave është bërë e zbatueshme pagesa e gjobës ose pagese periodike nuk ka pasuri të mjaftueshme në territorin e autoritetit homolog, për të mundësuar rimëkëmbjen nga një dënim i tillë me gjobë ose pagesë periodike.
2. Autoriteti homolog mund të kërkojë vetëm zbatimin e një vendimi përfundimtar.
3. Afatet e parashkrimit për ekzekutimin e gjobave ose pagesave periodike të gjobave rregullohen nga legjislacioni i autoritetit homolog.

#### **Neni 26**

##### **Parimet e përgjithshme të bashkëpunimit**

1. Në lidhje me kërkesat e përmendura në nenet 24 dhe 25 ato do të ekzekutohen nga AK në respektim të kuadrit ligjor të autoritetit homolog.
2. Kërkesat e përmendura në nenet 24 dhe 25 do të ekzekutohen pa vonesa të

- panevojshme me anë të një instrumenti të njëtrajtshëm/uniform, i cili duhet të tregojë:
- emrin, adresën e njohur të adresuesit dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm për identifikimin e adresuesit;
  - një përmbledhje të fakteve dhe rrethanave përkatëse;
  - një përmbledhje të kopjes së aktit bashkëlidhur që do të njoftohet ose zbatohet;
  - emrin, adresën dhe detajet e tjera të kontaktit të AK;
  - periudha brenda së cilës duhet të bëhet njoftimi ose zbatimi, siç janë afatet ligjore ose periudhat e parashkrimit.
3. Për kërkesat e përmendura në nenin 25, përveç kërkesave të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, instrumenti i njëtrajtshëm siguron si më poshtë:
    - informacion në lidhje me vendimin që lejon zbatimin në autoritetin homolog;
    - datën kur vendimi u bë i formës së prerë;
    - shumën e gjobës ose pagesës periodike të gjobës;
    - informacione që tregojnë përpjekjet e bëra nga autoriteti homolog për të zbatuar vendimin në territorin e vet.
  4. AK nuk është i detyruar të ekzekutojë një kërkesë të përmendur në nenin 24 ose 25 nëse:
    - kërkesa nuk përputhet me kërkesat e këtij neni;
    - AK paraqet arsyet që tregojnë se si ekzekutimi i kërkesës do të ishte në kundërshtim me politikën publike të vendit. Nëse AK ka ndërmend të refuzojë një kërkesë për ndihmë të përmendur në nenin 24 ose 25 ose kërkon informacion shtesë, ai duhet të kontaktojë autoritetin kërkues.
  5. AK mund të kërkojë nga autoriteti aplikant të bartë të gjitha kostot e arsyeshme shtesë, përfshirë përkthimin, punën dhe kostot administrative, në lidhje me veprimet e ndërmarra siç përmenden në nenin 23 ose 24.
  6. AK mund të rikuperojë shpenzimet e plota të bëra në lidhje me veprimet e ndërmarra siç përmenden në nenin 25 nga gjobat ose pagesa periodike të gjobave që ka mbledhur në emër të autoritetit aplikant, përfshirë kostot e përkthimit, punës dhe administratës. Nëse AK është i pasuksesshëm në mbledhjen e gjobave ose pagesave periodike të gjobave, ai mund të kërkojë nga autoriteti aplikant, të bartë shpenzimet e bëra.

## KAPITULLI VIII PERIUDHAT E KUFIZIMIT

### Neni 27

#### **Rregullat në periudhat e kufizimit për vendosjen e gjobave dhe pagesave periodike të gjobave**

1. Periudhat e kufizimit për vendosjen e gjobave ose pagesave periodike të gjobave, do të pezullohen ose ndërpriten përgjatë kohëzgjatjes së procedurave, në lidhje me një shkelje që ka për bazë të njëjtën marrëveshje, vendim të një shoqate, praktikë të bashkërenduar ose sjellje tjetër të ndaluar nga nenet 4 dhe 9 të ligjit. Pezullimi i periudhës së kufizimit do të fillojë (ose ndërprerja e periudhës së kufizimit do të bëhet) nga data e njoftimit të

masës së parë zyrtare hetimore në të paktën një ndërmarrje që i nënshtrohet procedurës hetimore. Kjo do të zbatohet për të gjitha ndërmarrjet ose shoqatat e ndërmarrjeve që kanë marrë pjesë në shkelje.

2. Pezullimi ose ndërprerja përfundon në ditën kur AK do të mbyllë procedurat e tij hetimore duke marrë një vendim të përmendur në nenin 10, 12 ose 13 të këtij udhëzuesi ose ka konkluduar se nuk ka arsye për veprim të mëtejshëm nga ana e institucionit.
3. Periudha e parashkrimit/kufizimit për vendosjen e gjobave ose pagesave periodike të gjobave do të pezullohet ose ndërpritet, për aq kohë sa vendimi i AK është objekt i procedurave gjyqësore.

## **KAPITULLI IX MASA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 28**

#### **E drejta aksesit si edhe kufizimet në përdorimin e informacionit**

1. Kur AK i kërkon një personi fizik të sigurojë informacione mbi bazën e masave të përmendura në pikën (e) të nenit 6 (1), nenin 8 ose nenin 9, ai informacion nuk do të përdoret si provë për të vendosur sanksione ndaj këtij personi fizik ose ndaj saj ose të afërmve të saj/tij.
2. AK, zyrtarët e institucionit, personeli dhe personat e tjerë që punojnë nën mbikëqyrjen e autoritetit, nuk duhet të zbulojnë informacionin për të cilin kanë marrë dijeni në bazë të kompetencave të përmendura në këtë udhëzues dhe që janë të llojit që mbulohet nga sekretit profesional, përveç rasteve kur zbulimi i tillë lejohet nga kuadri ligjor në fuqi.
3. E drejta e aksesit për programin e lehtësimit nga gjobat ose në procedurat e zgjidhjes, i jepet vetëm subjektit që i nënshtrohet procedurës përkatëse dhe vetëm për qëllime të ushtrimit të të drejtave të tyre të mbrojtjes.
4. Pala që ka përfutur akses në dosjen e procedurave hetimore të AK, mund të përdorë informacione të marra nga Programi i Lehtësimit nga Gjobat dhe Procedurat e Zgjidhjes, kur është e nevojshme, për të ushtruar të drejtat e saj të mbrojtjes në procedurat para gjykatës, në raste që lidhen drejtpërdrejt me çështjen për të cilën është dhënë aksesit, dhe vetëm kur këto procedura kanë të bëjnë:
  - a) alokimin/shpërdarjen midis pjesëmarrësve të marrëveshjes së ndaluar/kartelit të një gjobe të vendosur bashkërisht ndaj tyre nga AK;
  - b) rishikimi i një vendimi me të cilin AK konstatoi një shkelje të neneve 4 dhe 9 të ligjit.
5. Kategoritë e mëposhtme të informacionit të marra nga një palë gjatë procedurave hetimore përpara AK, nuk do të përdoren nga ajo palë në proceset gjyqësore, para se AK të mbyllë procedurat e tij hetimore në lidhje me të gjithë palët nën hetim, duke miratuar

një vendim sipas neneve 10 ose 12 ose që ndryshe ka përfunduar procedurat e tij:

- a) informacione që janë përgatitur nga persona të tjerë fizikë ose juridikë posaçërisht për procedurat hetimore të AK;
  - b) informacione që AK ka hartuar dhe ju ka dërguar palëve gjatë procedurës së tij hetimore;
  - c) procedurat e zgjidhjes që janë tërhequr.
6. Programet e Lehtësimit nga Gjjobat do të shkëmbehen midis autoriteteve homologe të konkurrencës:
- a) me pëlqimin e aplikantit;

### **Neni 29 Pranimi i provave**

Llojet e provave të pranueshme si provë nga AK përfshijnë dokumente, deklaratat me gojë, mesazhe elektronike, regjistrime dhe të gjitha objektet e tjera që përmbajnë informacion, pavarësisht nga forma që ai merr dhe mënyra në të cilin ruhen informacionet.

### **Neni 30 Hyrja në fuqi**

1. Ky udhëzues parashikon rregulla të cilat duhet të zbatohen në kuadrin ligjor ekzistues në fuqi në fushën e konkurrencës .
2. Ky udhëzues hyn në fuqi në 31 Dhjetor 2020.
3. Kapitulli VII “Asistenca e Përbashkët” dhe Kapitulli VIII “Periudhat e Kufizimit” , do të hyjnë në fuqi dhe do të zbatohen kur Shqipëria të jetë anëtare me të drejta të plota në Bashkimin Evropian.

## **Marrëdhëniet ndërkombëtare: Bashkëpunimi me Autoritetet e Konkurrencës në Vendet e Treta**

- (1) **EFTA** Shtetet EFTA nënshkruan një Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me Shqipërinë (MTL)<sup>1</sup> në Gjenevë, Zvicër, më 17 dhjetor 2009. Marrëveshja hyri në fuqi më 1 nëntor 2010 për Shqipërinë, Lihtenshtajnin dhe Zvicrën, 1 gusht 2011 për Norvegjinë dhe 1 tetor 2011 për Islandën.
- (2) Ndër të tjera Marrëveshja përmban një dispozitë neni 43 mbi rregullat e konkurrencës në lidhje me ndërmarrjet dhe përcakton vendimet dhe praktikatat që janë të papajtueshme me

---

<sup>1</sup> <https://efta.int/sites/default/files/documents/legal-texts/free-trade-relations/Albania/EFTA-Albania-Free-Trade-Agreement.pdf>  
<https://ëëë.efta.int/sites/default/files/documents/legal-texts/free-trade-relations/Albania/Protocol-amending-the-Free-Trade-Agreement-between-the-Republic-of-Albania-and-the-EFTA-States.pdf>

funksionimin e duhur të Marrëveshjes, të cilat zbatohen për aktivitetet e ndërmarrjeve publike dhe ndërmarrjeve për të cilat Palët kanë të drejta të veçanta ose ekskluzive. Komiteti i Përbashkët është i ngarkuar me shqyrtimin e një rasti, nëse ka një të tillë.

## 6 Kërkesat për informacion

1.	Hyrje	2
1.1.	Gjetja joformale e fakteve	2
1.2.	Kërkesat për informacion (Neni 18)	2
2.	Kërkesë për informacion me letër (Neni 18, paragrafi 2)	2
2.1.	Informacioni që mund të kërkohet	2
2.2.	Marrësit	3
2.3.	Gjuhët	4
2.4.	Hartimi i kërkesave të thjeshta për informacion	4
2.5.	Dërgimi i kërkesave për informacion	5
2.6.	Ndjekja e kërkesave për informacion	6
3.	Vendimi që kërkon informacion (Neni 18, paragrafi 3)	7
3.1.	Parimet e përgjithshme dhe përmbajtja	7
3.2.	Hapat procedurale	9
4.	Vendimi për vendosjen e gjobave ose sanksioneve	11
5.	Kufijtë e kompetencave për të kërkuar informacion: privilegji i mbrojtjes nga vetëfajësimimi 11	
5.1.	Parimi bazë	11
5.2.	Përkufizimi i vetëfajësimimit	12
5.3.	Kategoritë e pyetjeve që janë të pranueshme	12
5.4.	Si duhet të reagohet në rast se një kompani pretendon se një pyetje është e një natyre vetëinkriminuese	12
6.	Kërkesë për informacion dhe përdorimi tij nga autoritetet kombëtare të konkurrencës (Neni 12 dhe 18 i Rregullores 1/2003)	13
6.1.	Zgjedhja e bazës ligjore të një kërkesë	13
6.2.	Kërkesë e bazuar në nenin 12	14
6.3.	Kërkesë e bazuar në nenin 18	15

## 1. Hyrje

### 1.1. Gjetja joformale e fakteve

- (1) Të dhënat mbi ndërmarrjet dhe sektorët e industrisë, lajmet aktuale dhe historike, literatura ligjore dhe ekonomike, si dhe statistikat mund të merren nga bazat e të dhënave të jashtme tregtare, institucionale ose nga të dhënat e administruara në AK ndër vite. Nëse është e nevojshme, studime specifike mund të kërkohen nga ekspertë të jashtëm.
- (2) Të dhënat mund të merren edhe nëpërmjet kontakteve joformale me Autoritetin e Konkurrencës (në vijim AK).
- (3) Inspektorët e ngarkuara me çështjen mund të organizojnë takime ose telefonata joformale me ndërmarrjet.

### 1.2. Kërkesat për informacion (Neni 33)

- (4) Sipas nenit 33 të Ligjit nr. 9121/2003, Autoriteti ka kompetencën t’u kërkojë të tretëve, ndërmarrjeve dhe grupimeve të ndërmarrjeve të ofrojnë të gjithë informacionin e nevojshëm, për zbatimin e këtij ligji, përfshirë edhe ato, të cilat përmbajnë sekrete tregtare. Informacioni mund të kërkohet me shkresë të Sekretariatit “kërkesë e thjeshë” (Neni 33, pika 1) ose me vendim të KK (Neni 33, pika 2).
- (5) Kërkesat për informacion janë burimet kryesore për mbledhjen e informacionit mbi shkeljet e ligjit të konkurrencës. Ato përdoren gjerësisht edhe në kontekstin e hetimeve ndaj sektorëve.
- (6) Ndërmarrjet janë të detyruara t’u përgjigjen kërkesave me vendim të KK dhe kërkesave të Sekretariatit. Nëse ndërmarrjet ose grupimet e ndërmarrjeve u përgjigjen kërkesave duke dhënë informacion të pasaktë, të paplotë ose të rremë, ose nuk japin të dhëna brenda afatit kohor, të përcaktuar në vendimin e komisionit apo në kërkesën e Sekretariatit, ato mund të gjobiten (Neni 73, pika 1, germa “a” dhe neni 76, pika 1, germa ç). Gjatë hartimit të një kërkesë për informacion, personat përgjegjës për trajtimin e çështjes duhet të respektojnë të drejtën e ndërmarrjeve për të mos u vetëfajësuar.

## 2. Kërkesë për informacion me shkresë të Sekretariatit

### 2.1. Informacioni që mund të kërkohet<sup>2</sup>

- (7) Sipas nenit 33, Sekretariati mund t’i kërkojë ndërmarrjeve dhe grupimeve/shoqatave të ndërmarrjeve të ofrojnë të gjithë informacionin e nevojshëm. Duhet të theksohet fakti se

<sup>2</sup> Shih: - Njoftimin për praktikant më të mira për kryerjen e procedurave të lidhura me nenet 101 dhe 102 të TFBE-së (Gazeta Zyrtare C 308, 20.10.2011, f. 6) (“Njoftimi për praktikant më të mira për antitrustin”), paragrafët 33-35.

- Udhëzimin e AK nr. 4 “Për praktikant më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin enenit 4 dhe 9 të ligjit nr.9121, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar.

kërkesat për informacion, mund të dërgohen jo vetëm për ndërmarrjet nën hetim, por edhe për ndërmarrjet ose bashkimet e tjera të ndërmarrjeve, që mund të kenë informacione të rëndësishme për rastin. Informacioni është i nevojshëm, veçanërisht kur i mundëson Autoritetit të verifikojë ekzistencën e shkeljes së pretenduar të përmendur në kërkesë. Marrësi i një kërkesë për informacion, mbrohet nga parimi-privilegji i vetëfajësimit.

- (8) Sekretariati është ai që përcakton objektin dhe formatin e kërkesës për informacion. Në disa raste, Sekretariati mund të diskutojë paraprakisht me të adresuarit ose palë të tjera të prekura, objektin dhe formatin e kërkesës për informacion. Kjo mund të jetë veçanërisht e dobishme në rastet e kërkesave që lidhen me të dhëna sasiore. AK gjithashtu mund të shpjegojë analizën që synon të kryejë me të dhënat e kërkuara, në mënyrë që të përmirësojë efikasitetin e mbledhjes së të dhënave dhe për të siguruar që të dhënat janë të një cilësie të përshtatshme. Kjo ndodh veçanërisht në fazat e mëvonshme të një hetimi, pasi kërkesat e hershme mund të jenë të një natyre më të përgjithshme dhe synojnë kryesisht kuptim më të mirë të funksionimit të tregut në fjalë.<sup>3</sup>
- (9) Kur, në një përgjigje ndaj një kërkesë për informacion, ndërmarrjet dorëzojnë informacione qartazi të pasakta (në veçanti dokumente të cilat nuk lidhen me objektin e hetimit), AK për të mos penguar në mënyrë të panevojshme dosjen që është shpesh voluminoze, mund t'ia kthejë këtë informacion marrësit të kërkesës sa më shpejt të jetë e mundur pas marrjes së përgjigjes. Një njoftim i shkurtër i cili raporton këtë fakt do të futet në dosje.
- (10) Kërkesat për informacion nuk duhet të përfshijnë informacion konfidencial të dorëzuar nga palët/palët e treta.

## 2.2. Marrësit

- (11) Neni 33, pika 1, i jep Sekretariatit kompetencat për t'i kërkuar informacion ndërmarrjeve dhe shoqatave të ndërmarrjeve. Kërkesat mund t'i dërgohen çdo ndërmarrjeve ose shoqate ndërmarrjesh. Këtu nuk përfshihen vetëm ndërmarrjet ose shoqatat e ndërmarrjeve objekt i procedurave por edhe ankuesit ose palët e treta.
- (12) Kopjet origjinale, ose të njehsuara me origjinalin të të gjitha dokumenteve të kërkuara për t'u dorëzuar duhet të depozitohen, duke treguar pronësinë, ose përfaqësinë ligjore të ndërmarrjes në fjalë. Përgjegjësia për të ofruar informacionin dhe dhënia e dokumenteve të kërkuara nga ndërmarrja, ose degët/filialet, është e ndërmarrjes dhe përfaqësuesve të tyre dhe, në rastin e degëve/filialeve, pa ose me personalitet juridik, përgjegjësia është e përfaqësuesve të tyre ligjor sipas dispozitave të Statutit dhe/ose Aktit të Themelimit. Edhe avokatët e autorizuar përkatësisht mund të ofrojnë informacion në emër të klientëve të tyre. Në këtë rast ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjeve do të mbetet plotësisht

---

<sup>3</sup> Shihni:

- DG Competition best practices for the submission of economic evidence and data collection in cases concerning the application of Articles 101 and 102 TFEU and in merger cases / Udhëzim "Praktikat më të mira për dorëzimin e provave me karakter ekonomik dhe mbledhjen e të dhënave në rastet që kanë të bëjnë me zbatimin e artikujve 101 dhe 102 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe në rastet e përqendrimeve".
- Udhëzuesin e AK "Mbi praktikat më të mira për dorëzimin e provave me karakter ekonomik dhe mbledhjen e të dhënave, në rastet që kanë të bëjnë me zbatimin e 4 dhe 9 të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar si dhe në rastet e përqendrimeve."

përgjegjëse nëse informacioni i dhënë është i paplotë, i pasaktë ose çorientues.

- (13) Nëse është caktuar një avokat i autorizuar përkatësisht (me prokurë të dhënë në dosje), kërkesa për informacion mund t'i dërgohet ndërmarrjes përmes tij ose vetë ndërmarrjes duke i dërguar avokatit një kopje për mirësjellje.
- (14) Nëse nuk është caktuar asnjë avokat i autorizuar përkatësisht, kërkesa për informacion duhet t'i drejtohet drejtpërdrejt ndërmarrjes ose shoqatës së ndërmarrjeve.

### **2.3. Gjuha**

- (15) Në respektim të nenit 20 të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, informacioni i kërkuar duhet të depozitohet në gjuhën shqipe, duke qenë se procedura administrative kryhet në gjuhën dhe shkrimin shqip.

### **2.4. Hartimi i kërkesave për informacion**

- (16) Në bazë të nenit 33 të Ligjit nr. 9121/2003 dhe nenit 8 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, kërkesa për informacion dhe dhënia e dokumentacionit kryhet me shkrim dhe dorëzohet duke ndjekur procedurat sipas nenit 25 të kësaj Rregulloreje.
- (17) Kërkesa për informacion duhet të përmbajë shkurtimisht: a) faktet dhe rrethanat në lidhje me sqarimin që është kërkuar; b) qëllimin e kërkesës; c) afatin kohor për përgjigje ose dhënien e dokumenteve, përputhshmërinë me urgjencën e rastit dhe natyrën, sasinë dhe llojin e informacionit të kërkuar, si dhe marrjen parasysh të kohës së nevojshme për ta zotëruar atë; d) procedurat dhe mënyrat që do të ndiqen për dhënien e informacionit, nga ndërmarrjet tek të cilat gjenden këto dokumente ose informacioni i kërkuar; e) sanksionet e parashikuara në nenin 73 të Ligjit nr. 9121/2003 në rastin e refuzimit të ofrimit të informacionit, ose të dhënies të dokumenteve të kërkuara, ose për çdo informacion të pasaktë, të paplotë, ose të rremë apo vonesë në dhënien e tyre. Në kërkesën për informacion mund të specifikohet edhe nevoja për ofrimin e një versioni jokonfidencial.
- (18) Ndërmarrjeve u duhet dhënë një afat kohor i arsyeshëm për kthimin e përgjigjes së kërkesës, në varësi të gjatësisë dhe kompleksitetit të kërkesës duke marrë në konsideratë kërkesat e hetimit. Në përgjithësi, ky afat kohor do të jetë të paktën dy javë nga marrja e kërkesës. Nëse nga fillimi, konsiderohet se nevojitet një periudhë më e gjatë, afati për kthimin e përgjigjes së kërkesës për informacion do të përcaktohet përkatësisht. Kur objekti i kërkesës është i kufizuar, për shembull nëse mbulon vetëm një sqarim të shkurtër të një informacioni të dhënë më parë ose informacion lehtësisht të disponueshëm për marrësit e kërkesës, afati kohor do të jetë më i shkurtër (një javë ose më pak). Është më mirë të caktohet një datë për përgjigjen dhe jo një periudhë: p.sh. “Ju lutemi të siguroheni që informacioni i kërkuar nga ana juaj të depozitohet pranë Autoritetit të Konkurrencës brenda datës ... [DATA E PËRGJIGJES] mundësisht edhe në rrugë elektronike në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)”.
- (19) Kërkesa për informacion gjithashtu kërkon që marrësi të tregojë nëse ai e konsideron informacionin e dhënë në përgjigje si konfidencial. Në këtë rast, marrësi, duhet të sigurojë një version jo konfidencial të informacionit. Versioni jo-konfidencial i informacionit duhet të depozitohet në të njëjtin format si versioni konfidencial, në të cilin janë

zëvendësuar paragrafët. Në përgjithësi, versioni jo konfidencial duhet të depozitohet në të njëjtën kohë me dokumentet e tjera. Nëse ndërmarjet nuk i zbatojnë këto kërkesa, AK mund të supozojë se dokumentet ose deklaratat në fjalë nuk përmbajnë informacion konfidencial.

- (20) Ndërmarrjet që operojnë në tregun objekt hetimi, informohen për faktin se janë objekt i një hetimi paraprak, për objektin dhe qëllimin e këtij hetimi. Marrësve u kujtohet gjithashtu se nëse sjellja nën hetim zbulohet se ka ndodhur, kjo mund të përbëjë shkelje të neneve 4 dhe/ose 9 të Ligjit nr. 9121/2003.
- (21) Kërkesa për informacion mund të përmbajë edhe një pyetësor, në formë Shtojce, me të gjitha pyetjet të cilave duhet t'u përgjigjet marrësi. Për të ofruar një kontekst për pyetjet, pyetësori informon marrësin për objektin dhe qëllimin e hetimit. Pyetjet nuk duhet të nxisin përgjigje vetëinkriminuese (për më shumë informacion shihni seksionin 5).
- (22) Në raste të veçanta, Sekretariati mund të diskutojë paraprakisht me të adresuarit ose palë të tjera të prekura, objektin dhe formatin e kërkesës për informacion. Kjo mund të jetë veçanërisht e dobishme në rastet e kërkesave që lidhen me të dhëna sasiore.<sup>4</sup>

## 2.5. Dërgimi i kërkesave për informacion

- (23) Zakonisht, kërkesat për informacion nënshkruhen nga Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës.
- (24) Dërgimi i kërkesave për informacion kryhet: a) me postë, me shpërndarje të regjistruar; b) dorazi me konfirmimin e marrjes dijeni; c) faks, me një kërkesë për konfirmim me shkrim në datën e mbërritjes; d) teleks ose telegram. Në rastin e shërbimit me teleks, telegram ose me faks, dokumentet konsiderohen se janë marrë në datën në të cilën janë dërguar, përveç rasteve kur mund të provohet e kundërta. Kur njoftimet nënshkruhen nga përfaqësuesit e individëve, të ndërmarjeve ose të subjekteve, këta përfaqësues duhet të jenë të pajisur me dokument përfaqësimi.
- (25) Kur kërkesat për informacion dërgohen përmes një shërbimi postar të certifikuar me konfirmim marrjeje, ose me korrier, gjatë caktimit të afatit kohor, duhet të merret parasysh koha e nevojshme për dorëzimin e letrës.
- (26) Pavarësisht llojit të dërgimit të zgjedhur, kërkesa duhet të dorëzohet në zyrën e protokollit dhe arshivës të AK, e cila e regjistron në regjistër dokumentin e nisur, si dhe konfirmon shpërndarjen në rastet kur materiali dërgohet me postë ose dorazi. Korrespondenca e regjistruar vendoset në dosje dhe arkivohet në Arkivin e Autoritetit të Konkurrencës.

## 2.6. Ndjekja e kërkesave për informacion

### Rikujtesat dhe kërkesat për shtyrje afati

- (27) Nëse kërkohet nga marrësi, mund të jepet një shtyrje afati. Marrësi duhet të japë arsytet për kërkesën për shtyrje afati, shumë kohë përpara përfundimit të afatit dhe në formë të shkruar (letër ose email). Nëse Autoriteti e konsideron kërkesën të justifikuar, do të jepet kohë shtesë (në varësi të kompleksitetit të informacionit të kërkuar dhe faktorëve të tjerë).

---

<sup>4</sup> Shihni praktikat më të mira për dorëzimin e provave me karakter ekonomik.

Autoriteti mund të bjerë gjithashtu dakord me marrësin e kërkesës se pjesë të caktuara të informacionit të kërkuar që kanë rëndësi të veçantë ose janë lehtësisht të disponueshme për marrësin, do të ofrohen brenda një afati më të shkurtër kohor, ndërsa për sigurimin e informacionit të mbetur do të jepet kohë shtesë. Në rast se jepet një shtyrje afati, afati i ri kohor duhet t'i komunikohet marrësit.

- (28) Nëse ndërmarrjet i përgjigjën kërkesës, por nuk dërgojnë një version jokonfidencial të përgjigjes së tyre ose nuk argumentojnë pretendimin e tyre për konfidencialitet dhe nuk ofrojnë një përshkrim konciz të secilës pjesë të informacionit të fshirë, zakonisht dërgohen një ose dy rikujtesa. Nëse ndërmarrjet nuk përmbushin detyrimet e tyre për të dhënë një version jokonfidencial, veçanërisht nëse janë kujtuar për të, Autoriteti mund të supozojë se informacioni i dhënë nuk përmban informacion konfidencial. Vetëm nëse disa informacione janë dukshëm konfidenciale, Autoriteti mund të hartojnë vetë një version jokonfidencial.

### **Përgjigje të pasakta ose çorientuese ndaj kërkesës për informacion**

- (29) Ndaj ndërmarrjeve dhe shoqatave të ndërmarrjeve të cilat, me dashje ose nga pakujdesia, ofrojnë informacion të pasaktë, të paplotë ose të rremë në përgjigje të një kërkesë të thjeshtë të bërë në përputhje me nenin 33, pika 1, mund të vendosen gjopa në përputhje me nenin 73, pika 1, germa “a”. Për më shumë informacion shihni seksionin 4.

### **Mungesa e përgjigjes ndaj një kërkesë për informacion**

- (30) Nëse ndërmarrja të cilës i është kërkuar informacioni nuk i përgjigjet kërkesës për informacion, Komisioni mund të vendosë të dërgojë një kërkesë për informacion me vendim (Neni 33, pika 2).

### **Privilegji i mbrojtjes nga vetëfajësimi**

- (31) Pyetjet duhet të përpilohen në mënyrë që të mos kërkojnë përgjigje vetëfajësimi.  
(32) Kur marrësi i një kërkesë për informacion në përputhje me nenin 33, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 refuzon t'i përgjigjet një pyetjeje në një kërkesë të tillë duke përdorur privilegjin e mbrojtjes nga vetëfajësimimi, ai mund t'a referojë çështjen në kohë pas marrjes së kërkesës dhe përpara përfundimit të afatit kohor fillestar të caktuar pranë Autoritetit të Konkurrencës. Marrësi thjesht mund të mos i përgjigjet kësaj pyetjeje.

## **3. Vendimi që kërkon informacion (Neni 33, pika 2)**

### **3.1. Parimet e përgjithshme dhe përmbajtja**

- (33) Sipas nenit 33, pika 2 të Ligjit nr. 9121/2003, kur ndërmarrjet ose personat nuk japin të dhënat e kërkuara, ose japin të dhëna të paplota brenda periudhës së caktuar në kërkesën e Sekretariatit, ose kur Komisioni e vlerëson të nevojshme, ai i kërkon të dhënat nëpërmjet një vendimi.  
(34) Në bazë të nenit 33 të Ligjit nr. 9121/2003 dhe nenit 8 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, vendimi për kërkim të dhënash/informacioni

- dhe dhënia e dokumentacionit kryhet me shkrim dhe dorëzohet duke ndjekur procedurat sipas nenit 25 të kësaj Rregulloreje. Në vendimin e Komisionit përcaktohen baza ligjore, qëllimi, afati kohor, brenda të cilit duhet të sigurohen të dhënat, si dhe gjobat e parashikuara në ligj, në rast mospërmbushjeje të vendimit.
- (35) Vendimi për kërkim të dhënash/informacioni duhet të arsyetohet. Arsyetimi mund të jetë shumë konciz. Referuar nenit 33, pika 3, të ligjit nr. 9121/2003, në vendimin e Komisionit përcaktohen baza ligjore, qëllimi, afati kohor, brenda të cilit duhet të sigurohen të dhënat, si dhe gjobat e parashikuara në ligj, në rast mospërmbushjeje të vendimit. Ky vendimi duhet të përmbajë shkurtimisht: a) faktet dhe rrethanat në lidhje me sqarimin që është kërkuar; b) bazën ligjore dhe qëllimin e kërkesës; c) afatin kohor për përgjigje ose dhënien e dokumenteve, përputhshmërinë me urgjencën e rastit dhe natyrën, sasinë dhe llojin e informacionit të kërkuar, si dhe marrjen parasysh të kohës së nevojshme për ta zotëruar atë; d) procedurat dhe mënyrat që do të ndiqen për dhënien e informacionit, nga ndërmarrjet tek të cilat gjenden këto dokumente ose informacioni i kërkuar; e) sanksionet e parashikuara në nenin 73 dhe 76 të Ligjit nr. 9121/2003 në rastin e refuzimit të ofrimit të informacionit, ose të dhënies të dokumenteve të kërkuara, ose për çdo informacion të pasaktë, të paplotë, ose të rremë apo vonesë në dhënien e tyre.
- (36) Në vendimin e Komisionit për kërkim të dhënash/informacioni mund të specifikohet edhe nevoja për ofrimin e një versioni jokonfidencial të të dhënave/informacionit në rast se marrësi e konsideron informacionin e dhënë në përgjigje si konfidencial. Versioni jokonfidencial i informacionit duhet të depozitohet në të njëjtin format si versioni konfidencial, në të cilin janë zëvendësuar paragrafët. Në përgjithësi, versioni jokonfidencial duhet të depozitohet në të njëjtën kohë me dokumentet e tjera. Nëse ndërmarrjet nuk i zbatojnë këto kërkesa, Komisioni mund të supozojë se dokumentet ose deklaratat në fjalë nuk përmbajnë informacion konfidencial.
- (37) Kërkesat e përcaktuara në vendimin e Komisionit duhet të jenë proporcionale dhe nuk duhet të detyrojnë marrësin e kërkesave për të pranuar shkelje të neneve 4 dhe 9 të ligjit, duke u kujtuar atyre privilegjin kundër dhënies së informacionit vetëfajësues dhe se nëse sjellja nën hetim konfirmohet se ka ndodhur, kjo mund të përbëjë shkelje të neneve 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003.
- (38) Vendimi që kërkon informacion i drejtohet ndërmarrjeve përkatëse dhe ndjek të njëjtin rregull gjuhësor si për kërkesat e thjeshta për informacion me shkresë të Sekretariatit. (Shihni me lart Nenin 2.3, pika 15). Vini re se nëse lejohet përdorimi edhe i një gjuhe tjetër, ajo duhet të shprehet në vendim, si për shembull: “Komisioni vëren se [MARRËSI] pranon që vendimi të miratohet edhe në [gjuhën e zgjedhur]”.
- (39) Në mënyrë të ngjashme me kërkesat e thjeshta për informacion, pronarët e ndërmarrjeve ose përfaqësuesit e tyre dhe në rastin e personave juridikë, kompanitë ose firmat, ose shoqatat që nuk kanë personalitet juridik, personat e autorizuar për t'i përfaqësuar me ligj ose në bazë të statutit të tyre duhet të ofrojnë informacionin e kërkuar në emër të ndërmarrjes ose shoqatave së ndërmarrjeve përkatëse. Avokatët e autorizuar përkatësisht mund të japin informacion në emër të klientëve të tyre. Në këtë rast ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjeve do të mbetet plotësisht përgjegjëse nëse informacioni i dhënë është i paplotë, i pasaktë ose çorientues.
- (40) Kur marrësi i një vendimi për kërkim të dhënash/informacioni nuk është në gjendje që t'i përgjigjet kërkesës së Komisionit brenda afatit kohor të përcaktuar në të, ai mund t'ia referojë çështjen këtij Komisioni. Një kërkesë e tillë duhet të bëhet në kohën e duhur

përpara përfundimit të afatit kohor fillestar të caktuar. Komisioni vendos nëse duhet të jepet shtyrja e afatit, duke marrë në konsideratë gjatësinë dhe kompleksitetin e kërkesës për informacion dhe kërkesat e hetimit.

- (41) Komisioni vendos gjoba, në përputhje me nenin 73, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 9121/2003, mbi ndërmarrjet ose grupimet e ndërmarrjeve kur, me dashje ose nga pakujdesia në përgjigje të një kërkesë të bërë me vendim të Komisionit në përputhje me nenin 33, pika 2, ato japin të dhëna të pasakta, të paplota ose të rreme, ose nuk japin të dhëna brenda afatit kohor të përcaktuar në vendimin e komisionit, sipas nenit 33, pika 3, të ligjit. Gjobat në përputhje me nenin 73, pika 1, gërma a), mund të kombinohen me sanksione financiare periodike në përputhje me nenin 76, pika 1, gërma ç).
- (42) Nëse një vendim në përputhje me nenin 33, pika 2 dhe 3, të ligjit 9121/2003, kombinohet me një vendim që cakton shumën e përkohshme të gjobave periodike në përputhje me nenin 76, pika 1, gërma ç), vendimi në zbatim të nenit 33, pika 2 dhe 3, do të specifikojë nivelin e përkohshëm të pagesës periodike ditore (deri në 5 për qind të xhiros mesatare ditore në vitin financiar paraardhës). Shuma përfundimtare e pagesës periodike të gjobës do të caktohet në një vendim të dytë në përputhje me nenin 76, pika 3, në bazë të nivelit të pagesës periodike ditore të përcaktuar në vendimin e Komisionit për kërkim të dhënash/informacioni. Megjithatë, nëse informacioni është dhënë, Komisioni mund të llogarisë një shumë përfundimtare të pagesës periodike të gjobës, më të ulët sesa ajo që do të ishte në mbështetje të vendimit fillestar. Parashikimet e nenit 75, pika 2, të këtij ligji zbatohen edhe për këtë pikë.

### **3.2. Hapat procedurale**

- (43) Komisioni i Konkurrencën ka kompetencën për të miratuar një vendim që kërkon informacion në përputhje me nenin 33, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 9121/2003, dhe kompetencën për të miratuar një vendim që vendos gjoba periodike (të përkohshme) për ndërmarrjet ose grupimet e ndërmarrjeve në përputhje me nenin 76, pika 1, të këtij ligji.
- (44) Duhet bërë dallimi ndërmjet:
- vendimeve që kërkojnë të dhëna/informacion në përputhje me nenin 33, pika 2 dhe 3, (pa vendosur gjoba periodike);
  - vendimeve që kërkojnë të dhëna/informacion dhe vendosin gjoba periodike (të përkohshme) në përputhje me nenin 33, pikat 2, 3, dhe nenin 76, pika 1, gërma ç), dhe pika 3.

#### **Vendimi që kërkon informacion pa gjoba periodike**

- (45) Konsultim me Sekretariatit/Drejtorinë përkatëse për ndjekjen e procedurës hetimore. Një vendim Komisioni për kërkim të dhënash/informacioni në përputhje me nenin 33, pikat 2 dhe 3, i cili nuk vendos gjoba periodike të përkohshme, nuk është e nevojshme të publikohet në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 9121/2003.

#### **Vendimi që kërkon informacion dhe që vendos gjoba periodike**

- (46) Procedura përbëhet nga dy faza:

***Faza e parë: Vendimi i parë që kërkon informacion dhe përcakton vendosjen e gjobave periodike.***

- (47) Hapat procedurale janë si më poshtë:
- Konsultim me Sekretariat/Drejtorinë përkatëse për ndjekjen e procedurës hetimore. Hartimi i projektvendimit i cili duhet të përcaktojë nivelin e përkohshëm të pagesës periodike ditore (deri në 5 për qind të xhiros mesatare ditore në vitin financiar paraardhës) dhe datën e fillimit.
  - Miratimi i vendimit.
- (48) Një vendim në përputhje me nenin 33, pikat 2 dhe 3, i cili vendos gjoba periodike të përkohshme, nuk është e nevojshme të publikohet në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 9121/2003, pavarësisht vendimit përfundimtar në zbatim të nenit 76, pika 3 (shihni më poshtë):

***Faza e dytë: vendimi i dytë për përcaktimin e shumës përfundimtare të gjobave/sanksioneve financiare***<sup>5</sup>

- (49) Hapat kryesore procedurale janë si më poshtë:
- Sapo të ketë përfunduar afati për ofrimin e informacionit, një shkresë e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i dërgohet ndërmarrjes duke i kujtuar pasojat financiare të moszbatimit të vendimit.
  - Pasi të jetë dhënë informacioni (pas përfundimit të afatit të përmendur në vendimin e parë, nëse nuk ka një vendim të dytë), nga Sekretariati hartohet një Raport mbi zbatimin e vendimit të Komisionit, ku pasqyrohet edhe përlllogaritja e shumës përfundimtare të gjobave.
  - Pas shqyrtimit të Raportit përkatës nga Komisioni, ai i përcillet ndërmarrjes nga Sekretariati i Përgjithshëm. Shuma përfundimtare e pagesës periodike të gjobës mund të caktohet në një shifër më të ulët sesa ajo që do të ishte në mbështetje të vendimit fillestar. (Neni 76, pika 3, e ligjit nr. 9121/2003).
  - Aksesi në dosje do të kufizohet në kërkesën për informacion që ka qenë në origjinë të vendimit të parashikuar dhe korrespondencën pasuese për këtë çështje me ndërmarrjen në fjalë.
  - Seancë dëgjimore (nëse kërkohet nga ndërmarrja).
  - Përgatitja e projektvendimit;

<sup>5</sup> Për domosdoshmërinë e një procedure me dy hapa, me një vendim të parë që përcakton nivelin e gjobave periodike dhe vendimin e dytë që vendos gjobat përfundimtare, shihni vendimin e GJED-së të 22 shtatorit 1989, Hoechst v Commission, çështjet e përbashkëta 46/87 dhe 227/88, ECR [1989] 2859. Gjykata konfirmoi në këtë vendim se nuk është e nevojshme që Komisioni të dërgojë një deklaratë kundërshtimesh dhe të mbajë një seancë dëgjimore verbale përpara vendimit të parë që përcakton gjobat periodike të përkohshme. Megjithatë, para se të dërgohet vendimi i dytë përfundimtar për sanksionet financiare përfundimtare, ky detyrim ekziston. Për rrjedhojë, vendosja e sanksioneve financiare është proceduralisht e vështirë. Për ta shkurtuar atë, duhet të kombinohet vendimi në zbatim të nenit 18, paragrafi 3 me vendimin e parë në zbatim të nenit 24, paragrafi 1, germa “d” të Rregullores 1/2003 (nene këto të cilat korespondojnë me nenin 33, pikat 2 dhe 3, dhe nenin 76, pika 1, germa ç), të ligjit nr. 9121/2003).

- Miratimi i vendimit nga Komisioni.
- Njoftimi i vendimit nga Sekretariati i Përgjithshëm drejtuar ndërmarrjeve përkatëse.
- Njoftimi për shtyp.
- Publikimi i vendimit (Neni 47 i ligjit nr. 9121/2003).

#### 4. Vendimi për vendosjen e gjobave ose sanksioneve

- (50) Nëse është më i përshtatshëm miratimi i një vendimi për vendosjen e gjobave në përputhje me nenin 73, pika 1, gërma a), apo miratimi i një vendimi për vendosjen e gjobave periodike në përputhje me nenin 76, pika 1, gërma ç), varet nga situata individuale. Gjobat në përputhje me nenin 73 mund të kombinohen edhe me sanksione financiare periodike në përputhje me nenin 76. Në caktimin e nivelit të gjobave duhet të merren parasysh sanksionet financiare periodike tashmë të vendosura dhe *vice versa*.
- (51) Komisioni me vendim, në përputhje me nenin 73 të ligjit nr. 9121/2003, mund të vendosë gjoba për ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve kur, me dashje ose nga pakujdesia:
- ato japin të dhëna të pasakta, të paplota ose të rreme në përgjigje të një kërkesë të thjeshtë të bërë në përputhje me nenin 33, pika 1, (Neni 73, pika 1, gërma a), ose;
  - në përgjigje të një kërkesë të bërë me vendim të Komisionit në përputhje me nenin 33, pika 2, ato japin të dhëna të pasakta, të paplota ose të rreme ose nuk japin të dhëna brenda afatit kohor, të përcaktuar në vendimin e komisionit (Neni 33, pika 3, e ligjit).
- (52) Gjobat/sanksionet financiare periodike (neni 76, pika 1, gërma ç) mund të vendosen me vendim për ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve për t'i detyruar ato që të japin informacion të plotë dhe të saktë, siç kërkohet nga vendimi i marrë në zbatim të nenit 33, pikat 2 dhe 3.

#### 5. Kufijtë e kompetencave për të kërkuar informacion: privilegji i mbrojtjes nga vetëfajësimimi

##### 5.1. Parimi bazë

- (53) Parimi i mbrojtjes nga vetëfajësimimi mbron ndërmarrjet nga detyrimi për t'iu përgjigjur pyetjeve vetëfajësuese, d.m.th. të pranojnë ekzistencën e një shkeljeje të legjit për mbrojtjen e konkurrencën (në të cilin ato kanë marrë pjesë).
- (54) Sipas praktikës gjyqësore të përcaktuar në *Orkem*<sup>6</sup>, një ndërmarrje mund të përdorë privilegjin e mbrojtjes nga vetëfajësimimi vetëm nëse plotësohen dy kushte: (1) ndërmarrjes i është kërkuar të pranojë ekzistencën e një shkeljeje të legjislacionit të konkurrencës (në të cilën ajo ka marrë pjesë) dhe (2) është detyruar t'iu përgjigjet pyetjes.
- (55) Nëse një ndërmarrje u përgjigjet në mënyrë vetëfajësuese pyetjeve të cilave nuk është e detyruar t'iu përgjigjet (p.sh. një përgjigje që shkon përtej kompetencave hetimore të Autoritetit), kjo përgjigje mund të konsiderohet si bashkëpunim spontan nga ana e ndërmarrjes që mund të justifikojë një ulje të një gjobe të mundshme jashtë objektit të

<sup>6</sup> Çështja 374/87, *Orkem v. Commission* [1989] ECR 3283

njoftimit për lehtësimin nga gjobat.

## 5.2. Përkufizimi i vetëfajësimit

- (56) Në vendimin *Orkem* (paragrafi 34) GJED cilëson se “Komisioni nuk mund të detyrojë një ndërmarrje të japë përgjigje të cilat mund të përfshijnë pranimin e ekzistencës së një shkeljeje nga ana e saj që i takon Komisionit ta vërtetojë”. Ndonjëherë dallimi i saktë ndërmjet pyetjeve vetëfajësuese dhe pyetjeve të ligjshme mund të jetë i vështirë për t’u bërë. Megjithatë, indikacionet e mëposhtme mund të jenë të dobishme.
- (57) Nëse një pyetje është e një natyre vetëfajësuese ose jo duhet të vlerësohet nga një perspektivë objektive (anketues mesatar dhe i arsyeshëm) dhe jo nga perspektiva e marrësit (perspektivë subjektive). Nuk është me rëndësi se çfarë informacioni zotëron Komisioni në momentin e drejtimit të pyetjes. *Kjo qasje siguron një interpretim objektiv të ligjit, në përputhje me parimin e sigurisë juridike, si një element thelbësor i shtetit të së drejtës<sup>7</sup>, duke mos përkeqësuar në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave.* Rekomandohet të vlerësohet nëse një kompani mund t’i përgjigjet pyetjeve sinqerisht pa pranuar fajin.

## 5.3. Kategoritë e pyetjeve që janë të pranueshme

- (58) Në përputhje me praktikën europiane gjyqësore, dy lloje pyetjesh janë në përputhje të plotë me privilegjin e mbrojtjes nga vetëfajësimiti (pra, këto lloj pyetjesh janë të ligjshme).
- (59) Paraqitja e provave shkresore në zotërim të ndërmarrjes mund të kërkohej gjithmonë pa shkelur privilegjin e mbrojtjes nga vetëfajësimiti. Kjo zbatohet pavarësisht nëse dokumentet në fjalë përmbajnë prova fajësuese ose jo, të cilat mund të përdoren kundër marrësit të kërkesës ose kundër çdo pale tjetër të tretë.
- (60) Pyetjet që kërkojnë vetëm informacion faktik janë zakonisht të pranueshme dhe nuk shkelin privilegjin e mbrojtjes nga vetëfajësimiti.

## 5.4. Si duhet të reagohej në rast se një ndërmarrje pretendon se një pyetje është e një natyre vetëfajësuese

- (61) Kur marrësi i një kërkesë për informacion, në përputhje me nenin 33, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003, pretendon se pyetjet shkelin privilegjin e mbrojtjes nga vetëfajësimiti, ai ka të drejtë të mos u përgjigjet këtyre pyetjeve.
- (62) Nëse Autoriteti është i bindur se pyetjet e tij nuk janë të një natyre vetëfajësuese, ai duhet të njoftojë marrësin e kërkesës për informacion për qëndrimin e tij.
- (63) Nëse pas refuzimit të ndërmarrjes për t’iu përgjigjur kërkesës së thjeshtë për informacion, miratohet një vendim në përputhje me nenin 33, pika 2, në këtë vendim duhet të pasqyrohet qëndrimi i arsyetuar i Autoritetit mbi pretendimin e ndërmarrjes për natyrën

<sup>7</sup> Në Vendimin nr. 24 datë 04.05.2021 Gjykata Kushtetuese në lidhje me parimin e sigurisë juridike ka vlerësuar se, para së gjithash, ligji duhet kuptuar saktë dhe drejt, prandaj duhet të dalë i qartë qëllimi i hartimit të tij. Ai duhet të përcaktojë mjetet e ndërhyrjes, subjektet të cilave u drejtohet, raportet e caktuara të sjelljes dhe mënyrën e zbatimit të tij. Rezultati që synohet duhet të jetë i pritshëm dhe pasojat të parashikueshme për subjektet të cilave u drejtohet ligji në tërësi ose dispozita të veçanta të tij.

vetëfajësuese të pyetjeve. Marrësi i vendimit në zbatim të nenit 33, pika 2, do të kujtohet në çdo rast lidhur me privilegjin e mbrojtjes nga vetëfajësimimi.

# Kuadri i hetimeve ndaj sektorit si një instrument i konkurrencës

---

<b>1. Hyrje</b>	<b>2</b>
1.1. Qëllimi i kryerjes së hetimeve ndaj sektorit	2
1.2. Struktura e këtij dokumenti	2
<b>2. Identifikimi i sektorit dhe objekti</b>	<b>3</b>
<b>3. Përgatitja e një hetimi ndaj sektorit</b>	<b>4</b>
3.1. Afatet kohore dhe planifikimi i burimeve	4
3.2. Zgjedhja e instrumenteve të përshtatshme hetimore	5
3.3. Proporcionaliteti i masave hetimore të zgjedhura	6
3.4. Përgatitja e kërkesave për informacion dhe hetimi i sektorit	6
3.5. Përgatitja e projektvendimit	8
<b>4. Miratimi dhe zbatimi i vendimit për nisjen e një hetimi ndaj sektorit</b>	<b>8</b>
4.1. Raporti paraprak mbi gjetjet e hetimit	9
4.2. Raporti përfundimtar dhe përzgjedhja e masave vijuese	10

## 1. Hyrje


- (1) Hetimet në sektor të ndryshëm të ekonomisë, të cilët kanë si synim vënien në zbatim të neneve 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003, janë një pjesë thelbësore e punës së Autoritetit të Konkurrencën. Megjithatë, hetimet në sektorët e ekonomisë janë një instrument konkurrence tejet specifik që kërkon shumë burime (duke përfshirë ndërmarrjet që operojnë në këta sektor, të cilave u kërkohet informacion gjatë procedurave hetimore). Për rrjedhojë, është e nevojshme të bëhet një përgatitje e kujdesshme.

### 1.1. Qëllimi i kryerjes së hetimeve në sektor të ndryshëm të ekonomisë

- (2) Qëllimi i një hetimi të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë, në përputhje me nenin 41 të ligjit nr. 9121/2003, është marrja e njohurive më të mira rreth një sektori të caktuar të ekonomisë, ose mbledhja e informacionit mbi mundësinë e ekzistencës së ndonjë lloji të caktuar marrëveshjeje apo praktike në sektorë të ndryshëm, me qëllim vënien në zbatim të neneve 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003. Hetimet e përgjithshme në sektorët e ekonomisë realizohen duke shfrytëzuar kompetencat hetimore të Autoritetit. Objektivi final i hetimit të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë duhet të jetë identifikimi i fushave ku mund të nevojiten masa rregulluese. Për rrjedhojë, duhet të bëhet dallimi ndërmjet një hetimi në sektorë të ekonomisë dhe hetimeve kundër ndërmarrjeve të caktuara.

### 1.2. Struktura e këtij dokumenti

- (3) Ky seksion identifikon hapat kryesorë që duhen marrë për të kryer një hetimi të përgjithshëm në sektor të ekonomisë, si dhe jep udhëzime rreth aspekteve specifike për këtë lloj procedure.
- (4) Së pari, identifikohen arsyet e mundshme që tregojnë se pse është i nevojshëm një hetim në një sektor të ekonomisë, si dhe një përmbledhje e çështjeve që duhen trajtuar dhe e grupeve përkatëse të interesit (seksioni 2).
- (5) Pasi Komisioni merr vendimin e brendshëm për të sugjeruar nisjen e një hetimi të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë, bëhet një planifikim konkret i hetimeve ndaj sektorit, ku përfshihet planifikimi i burimeve, afatet e detajuara kohore dhe përgatitja e masave të parashikuara hetimore (seksioni 3).
- (6) Seksioni 4 përshkruan miratimin e vendimit për nisjen e një hetimi të përgjithshëm në sektor dhe zbatimin e tij.  
Zbatimi përfshin të gjithë punën analitike të ndërmarrë nga Autoriteti bazuar në informacionin e mbledhur, si dhe mund të përfshijë hartimin e një raportit të ndërmjetëm paraprak dhe mbledhjen e komenteve nga grupet e interesit. Pas konsultimit me grupet e interesit, zakonisht përgatitet një raport përfundimtar dhe merret një vendim i brendshëm lidhur me masat vijuese të nevojshme.
- (7) Veprimet pas publikimit të raportit përfundimtar mund të përfshijnë hetimin në tregje të veçanta apo përpjekje të tjera për të rritur konkurrencën në sektor, p.sh., rekomandime për përmirësimin e kuadrit rregullator, si dhe monitorimin e mëtejshëm të sektorit në lidhje me praktika specifike.
- (8) Figura në vijim ilustron ecurinë tipike të një hetimi në sektor me kalimin e kohës.



## 2. Identifikimi i sektorit dhe objekti

- (9) Ashtu si në tregje të veçanta, hetimet e përgjithshme në sektor të ekonomisë (këtu e në vijim: hetimi në sektor) mund të jenë pjesë thelbësore e aktivitetit për monitorimin e tregut që realizon Autoriteti i Konkurrencës dhe e njohurive të saj të përgjithshme rreth sektorit.
- (10) Bazuar në këto konstatime, mund të vlerësohet situata e konkurrencës në sektorin përkatës, në veçanti, nëse ngurtësia e çmimeve ose rrethana të tjera të bëjnë të mendosh se konkurrenca në treg kufizohet ose shtrembërohet (Neni 41 i ligjit nr. 9121/2003), pra nëse duket se ekziston një problem i lidhur me konkurrencën. Këto “rrethana të tjera” mund të përfshijnë një gamë të gjerë çështjesh të ndryshme, si p.sh., kufizimi i aksesit në treg për konkurrentët.
- (11) Nëse, bazuar në monitorimin e përgjithshëm të tregut, konstatohet se:
- përmbushen kriteret e përmendura në nenin 41, pika 1, dhe;
  - vetëm ndërmarrja e masave të tjera për gjetjen e fakteve mund të sigurojë informacion shtesë sqarues,
- atëherë duhet të merret një vendim lidhur me proporcionalitetin e nisjes së një hetimi të përgjithshëm në sektorin përkatës të ekonomisë.
- (12) Për rrjedhojë, duhet vendosur nëse një hetim në sektor përbën një instrument të përshtatshëm për të zbuluar apo qartësuar shkaqet e një shtrembërimi dhe/ose kufizimi të mundshëm të konkurrencës.
- (13) Në këtë aspekt, pyetjet në vijim mund të ndihmojnë për të kuptuar nëse nisja e një hetimi në sektor është zgjedhja e duhur:
- *Së pari, a është hetimi në sektor instrumenti i përshtatshëm për të arritur qëllimin e nenit 41, p.sh., për të mbledhur informacion të rëndësishëm për shtrembërimin/kufizimin e konkurrencës?*

Hetimi në sektor është i përshtatshëm kur ka gjasa, *ex ante*, që përmes këtij instrumenti të

sigurohet informacioni i nevojshëm për të kuptuar sektorin dhe për të realizuar një vlerësim të konkurrencës.

- *A mund të sigurohet informacioni përkatës në një mënyrë më të mirë, përmes mjeteve të tjera?*

Grupet duhet të reflektojnë nëse informacioni mund të përftohet përmes mjeteve të tjera që kërkojnë më pak kohë dhe burime (për industrinë dhe Autoritetin). Për shembull, në rastet kur:

- ka indikator se kontaktet joformale me aktorët e tregut (p.sh., telefonatat, takimet me ndërmarrjet ose shoqatat e ndërmarrjeve në treg) do të ishin padyshim të mjaftueshme për të qartësuar shqetësimet e ngritura, ose;
- qëllimi kryesor është marrja e njohurive sa më të thella mbi teknikat specifike të sektorit dhe problemi i ngritur mund të trajtohet më mirë duke autorizuar një studim të specializuar se sa duke nisur një hetim në sektor.

### **3. Përgatitja e hetimit në sektor**

(14) Për të përgatitur hetimin në sektor, grupi përgjegjës do të përballet me detyrat në vijim:

- hartimi i afateve kohore të detajuara dhe planifikimi paraprak i burimeve;
- përgatitja/finalizimi i pyetësorëve;
- përgatitja e inspektimeve të mundshme (kur konsiderohet e nevojshme);
- identifikimi i ekspertëve të jashtëm për të dhënë informacion specifik ose për të kontrolluar rezultate të caktuara të hetimit, sipas rastit; dhe
- përgatitja e projektvendimit për hapjen e hetimit për t'u miratuar nga Komisioni.

(15) Nga momenti që nisin përgatitjet për një hetim të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë, grupi i hetimit duhet të sigurohet se është i informuar mbi çdo veprim të planifikuar ose të ndërmarrë nga autoritetet përkatëse rregullatore të sektorit.

### **3.1. Afatet kohore dhe planifikimi i burimeve**

- (16) Hartimi i afateve kohore të detajuara dhe planifikimi paraprak i burimeve janë pikat kryesore për fillimin e përgatitjes. Të dyja duhet të jenë realiste dhe të marrin në konsideratë përvojën e hetimeve të mëparshme në sektorët e ekonomisë për sa i përket kërkesave të brendshme të lidhura me kohën dhe burimet.
- (17) Hartimi i afateve kohore duhet të përfshijë të gjitha hapat përkatëse proceduriale, duke përfshirë përgatitjet për nisjen e hetimit në sektor, fazat e zbatimit, mbledhjen e materialeve dhe analizimin e tyre, si dhe hartimin e raportit me konkluzionet e hetimit.
- (18) Planifikimi paraprak i burimeve duhet të marrë në konsideratë fazat e ndryshme të hetimit. Për të identifikuar sektorin dhe për të përgatitur masat inspektuese që përdoren gjatë hetimit, si p.sh., përgatitja e pyetësorëve dhe, kur është e nevojshme, e inspektimeve, mund të nevojitet vetëm një grup i vogël i posaçëm ndërsa në fazat e mëpasshme (p.sh., analizimi dhe vlerësimi i informacionit të mbledhur) do të nevojitet një grup shumë më i madh.
- (19) Grupi i ngarkuar me çështjen duhet të shqyrtojë gjithashtu nëse do të ishte më efikase (dhe e

mundshme) që të nënkontrktohen disa pjesë të analizës tejet të sofistikuar të të dhënave, në vend që të mbështetet tek ekspertët e brendshëm. Në varësi të detyrës, disa pjesë të analizës mund të kryhen, për shembull, nga konsulentët e jashtëm.

- (20) Gjithashtu, duhet të merren në konsideratë nevojat specifike të trajnimit të stafit (p.sh., trajnimi për softëerë specifike).

### **3.2. Zgjedhja e instrumenteve të përshtatshme hetimore**

- (21) Pasi të ketë qartësuar objektin e hetimit dhe çështjet për t'u hetuar, grupi i hetimit do të duhet të organizojë mbledhjen faktike të informacionit.
- (22) Pikënisja e çdo hetimi janë burimet e informacionit në dispozicion të publikut. Në këtë kontekst, grupi duhet të verifikojë gjithashtu nëse ka statistika zyrtare të përshtatshme apo burime të tjera të besueshme informacioni për të gjithë industrinë, si dhe nëse ekzistojnë standarde për formatet e të dhënave (p.sh., INSTAT).
- (23) Për marrjen e informacionit duhet të përzgjidhet instrumenti më i përshtatshëm. Për të mbledhur informacionin e nevojshëm mund të përdoren një sërë instrumentesh, të tilla si:
- Kërkesat për informacion në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 9121/2003;
  - Marrja e deklaratave në përputhje me nenin 10 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”;
  - Inspektimet në përputhje me nenin 36 dhe 37 të ligjit nr. 9121/2003, si dhe nenin 9 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”;
  - Blerja e grupeve të të dhënave;
  - Masat joformale përgatitore/shoqëruese: p.sh., anketat, takimet me grupet e interesit, vizitat në terren etj.

### **3.3. Proporcionaliteti i masave hetimore të zgjedhura**

- (24) Për secilën prej masave të zgjedhura për përfitim të informacionit të nevojshëm, grupi duhet të verifikojë nëse masa përkatëse është proporcionale, pra nëse masa është e përshtatshme dhe e nevojshme (nëse një masë më pak kufizuese dhe më pak e vështirë nuk mund të përdoret për të arritur të njëjtin rezultat). Në parim, duhet të zgjidhet masa më pak e vështirë, p.sh., pyetësorët në vend të inspektimeve kur ato janë të mjaftueshme për të marrë informacionin e nevojshëm. Inspektimet mund të jenë të përshtatshme në rastet kur, për të kuptuar problemet e mundshme të konkurrencës në sektor, nevojitet informacion që ka, për shembull, natyrë tejet konfidenciale dhe strategjike dhe që mund të fshihet ose shkatërrohet me lehtësi. Duhet pasur parasysh se në disa raste anketat mund të jenë një instrument i përshtatshëm për mbledhjen e informacionit.

### **3.4. Përgatitja e kërkesave për informacion dhe hetimi i sektorit**

- (25) Hetimi konkret i sektorit është një fazë tejet kritike, pasi në fund të fundit sukcesi i një hetimi varet nga përshtatshmëria, cilësia dhe besueshmëria e të dhënave të mbledhura. Në hetimet e mëparshme në sektorët e ekonomisë, kërkesat për informacion kanë luajtur një rol kyç në marrjen e të dhënave të nevojshme. Për këtë arsye, janë dhënë disa parime të përgjithshme që synojnë të ndihmojnë në strukturimin e përpjekjeve hetimore në lidhje me kërkesat për informacion.

### 3.4.1. Të identifikohet me kujdes informacioni që duhet mbledhur përmes hetimit në sektor

- (26) Objekti i hetimit, në kontekstin e hetimeve në sektor të ndryshëm të ekonomisë, është më i gjerë se sa në procedurat individuale. Përcaktimi i informacionit që duhet mbledhur është thelbësor për të pasur një rezultat të suksesshëm të hetimit në sektor.
- (27) Më poshtë jepet një kuadër i përgjithshëm i informacionit që mund të jetë i dobishëm për të kryer një analizë të konkurrencës së një sektori të caktuar.  
Skema referencë e informacionit që mund të jetë i dobishëm për vlerësimin e konkurrencës së një sektori:
- (1) informacion mbi tregjet e produkteve dhe tregjet gjeografike:
- o të dhënat e produktit;
  - o zëvendësueshmëria e produktit;
  - o tregjet përkatëse në rrjedhën e sipërme ose të poshtme;
  - o kufijtë gjeografikë të tregjeve të produkteve;
- (2) informacion lidhur me shkallën e rivalitetit ndërmjet furnitorëve ekzistues:
- o pjesët e tregut, qëndrueshmëria e pjesëve të tregut, përqendrimi;
  - o marrëdhëniet vertikale/ kushtet e aksesit në inputet dhe teknologjinë kryesore;
  - o praktikat tipike tregtare (p.sh., kohëzgjatja normale e kontratave, klauzolat tipike);
  - o rëndësia e efekteve të rrjetit;
  - o ndikimi i rregullores;
  - o faktorët që lehtësojnë koordinimin (ngjashmëria e firmave, transparenca e tregut, shoqatat tregtare etj.).
- (3) informacion mbi fuqinë kundërvepruese të blerësve:
- o numri dhe madhësia e blerësve;
  - o asimetritë e informacionit, kostot e ndërrimit;
  - o masat mbrojtëse rregullatore.
- (4) informacion mbi efektin e konkurrencës potenciale:
- o barrierat në hyrje (ekonomitë e shkallës, kostot e ndërrimit, barrierat rregullatore etj.)
- (5) informacion mbi rezultatin e procesit konkurrues:
- o çmimi (tendencat dhe krahasimet);
  - o cilësia (tendencat dhe krahasimet);
  - o niveli i prodhimit;
  - o rentabiliteti;
  - o norma e inovacionit;
  - o efikasiteti i firmave.

### 3.4.2. Hartimi i kërkesave për informacion

- (28) Grupi duhet të përcaktojë se çfarë nevojitet për të vlerësuar sektorin nga pikëpamja e konkurrencës. Skema referencë e paraqitur më sipër mund të jetë një pikënisje e dobishme, por

duhet të vlerësohet në mënyrë të detajuar duke pasur parasysh specifikat e sektorit përkatës (p.sh., mund të ketë variabla të tjerë të rëndësishme).

- (29) Gjithashtu, në këtë fazë përpilohen listat e marrësve të kërkesave për informacion. Duhet të garantohet se marrësit e përzgjedhur përfaqësojnë sektorin. Gjithashtu, mund të identifikohet një numër i vogël kompanish, të cilat mund të pyeten për të testuar draft-pyetësorin, pasi të kenë nisur hetimet në sektor (përpara se pyetësorët përfundimtarë t'u dërgohen marrësve).
- (30) Gjithashtu, nevojitet një vlerësim i pyetjeve të propozuara duke pasur parasysh faktin se mungesa e përgjigjeve apo përgjigjet e paplota në disa pjesë të pyetësorit dhe mospërmbushja e kërkesave për informacion në përgjithësi, do të duhet të ndiqet me qëllim që të mos vihet në rrezik hetimi në sektor. Në këtë aspekt, grupi i hetimit në sektor do të duhet të krijojë disa mekanizma për të garantuar dërgimin e rikujtesave dhe për të organizuar një ndjekje të përshtatshme.
- (31) Të dhënat sasiore përpunohen më lehtë dhe mund të japin informacione të rëndësishme, por të dhënat cilësore mund të jenë të nevojshme për të kuptuar çështje specifike dhe për të interpretuar të dhënat sasiore të përfutuara.
- (32) Me qëllim përpunimin e të dhënave, grupi duhet të identifikojë analizat përkatëse dhe, në varësi të instrumenteve të përpunimit të të dhënave që do të përdoren, për shembull mjetet analitike mund të projektohen dhe programohen në këtë fazë. Grupi duhet të vendosë nëse do të nevojitet një softëer i specializuar statistikor për përpunimin e të dhënave. Nëse koha e lejon diçka të tillë, në këtë pikë mund të mblidhet dhe përpunohet një kampion ose model i të dhënave, për të testuar mjetet analitike, përpara se të mblidhet kampioni i plotë i të dhënave.

### **3.5. Përgatitja e projektvendimit**

- (33) Projektvendimi i Komisionit për fillimin e hetimit të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë duhet të përgatitet dhe konsultohet brenda Autoritetit, në kohën e duhur. Hapat proceduriale që duhen ndjekur në kuadër të procesit të miratimit shpjegohen në seksionin 4.

## **4. Miratimi dhe zbatimi i vendimit për nisjen e hetimit në një sektor të ekonomisë**

- (34) Pas planifikimit fillestar dhe përgatitjes për nisjen e hetimit në sektorin përkatës, siç përshkruhet më sipër, zakonisht duhet të realizohen detyrat në vijim:
- hapat e nevojshme proceduriale për miratimin e vendimit për nisjen e hetimit të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë nga Komisioni;
  - zbatimi i masave hetimore të përcaktuara në fazën përgatitore (sipas rastit: inspektimet, kërkesat për informacion, duke përfshirë mekanizmin për sqarimet pas kërkesave për informacion etj.);
  - sipas rastit, caktimin e ekspertëve të jashtëm për projektet dhe/ose kontrollin e rezultateve, si dhe mbikëqyrjen/koordinimin e punës së tyre/inputit;
  - analizimi i provave të mbledhura me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve paraprake;
  - konsultimet e brendshme dhe finalizimi i vlerësimit në një raport paraprak;
  - prezantimi publik i raportit paraprak;
  - konsultimi me publikun;
  - raporti përfundimtar.
- (35) Pas miratimit të vendimit të Komisionit për nisjen e hetimit në sektor, duhet të zbatohen masat 7 hetimore të përgatitura në fazën përpara miratimit të vendimit. Sipas rastit, përgatiten pyetësorët (mundësisht përmes anketimeve) dhe kryhen inspektimet e mundshme.

- (36) Gjatë fazës përgatitore (përpara nisjes formale të hetimit në sektor), pasi janë përgatitur draft-pyetësorët, siç përmendet më sipër, grupi mund të dojë të testojë fillimisht pyetësorët me një grup të vogël kompanish për të vlerësuar dhe strukturuar përgjigjet e mundshme.
- (37) Nëse përdoren kërkesat për informacion, siç ka gjasa të ndodhë në një hetim në sektor, atëherë duhet të merren në konsideratë mjetet për dorëzimin e pyetësorëve. Sa më shpejt që të jetë e mundur, në firmat përkatëse duhet të përcaktohen personat e kontaktit, të cilët janë përgjegjës për shkëmbimin e të gjithë informacionit me Autoritetin. Kur kjo nuk është e mundur, do të ishte më e përshtatshme që të dërgohej një letër te Drejtori Ekzekutiv dhe/ose Drejtori i Departamentit Juridik se sa të dërgohen e-maile në adresat qendrore ose të përgjithshme. Pas caktimit të personit të kontaktit, e-maili është një metodë e përshtatshme për të komunikuar me firmën.

#### **4.1. Raporti paraprak mbi gjetjet e hetimit**

- (38) Duke qenë se gjatë hetimit mblidhet informacion, grupi i hetimit do të jetë përgjegjës për analizimin e këtij informacioni dhe për formulimin e gjetjeve paraprake lidhur me karakteristikat kryesore të sektorit përkatës, si dhe me natyrën e arsyeve që mund të çojnë në shtrembërimet apo kufizimet e mundshme të konkurrencës. Duke qenë se analizimi i të dhënave do të jetë faza thelbësore e çdo hetimi dhe do të përcaktojë në një masë të madhe suksesin e hetimit, atëherë duhet dhënë kohë e mjaftueshme për analizën, reflektimin dhe diskutimet.
- (39) Neni 41, pika 3, e ligjit nr. 9121/2003 përcakton se Autoritetit “mund të publikojë një raport për rezultatet e hetimit të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë” dhe “mund të ftojë palët e interesuara të shprehën për rezultatet e hetimit”. Edhe pse kjo nuk është një kërkesë ligjore, si rregull i përgjithshëm mund të konsiderohet e përshtatshme që Autoriteti të publikojë konkluzionet e tij paraprake në formën e një dokumenti mbi “problematikat” ose të një raporti paraprak. Konsultimi me publikun rreth raportit të ndërmjetëm rrit transparencën e procedurave dhe mund të lejojë dhënien e komenteve nga të gjithë grupet e interesit mbi pikëpamjet paraprake të Autoritetit.
- (40) Është e rëndësishme të theksohet se hetimi në një sektor të ekonomisë nuk ka si qëllim që të përcaktojë drejtpërdrejt shkeljet e neneve 4 dhe 9 në raste individuale. Zakonisht, për këtë qëllim duhen marrë masa të mëtejshme hetimore. Për rrjedhojë, zakonisht raporti publik nuk do t’u referohet shkeljeve specifike të nenit 4 dhe/ose nenit 9. Gjithashtu, është e qartë se raporti nuk duhet të përmbajë informacion konfidencial.
- (41) Për ta përmbledhur, raporti duhet të përmbajë sa më shumë prova faktike që të jetë e mundur rreth mënyrës së funksionimit të tregut dhe duhet të përcjellë të kuptuarit e Autoritetit rreth sektorit<sup>1</sup> (duke përjashtuar informacionin konfidencial dhe sekretet tregtare).
- (42) Edhe pse zakonisht publikohet një raport paraprak, ka situata kur gjykohet e përshtatshme kryerja e inspektimeve të mëvonshme në raste individuale. Në këtë rast nuk publikohet një raport publik paraprak (kjo vlen sigurisht edhe për deklaratat e tjera të mundshme publike), pasi diçka e tillë mund të çojë në shkatërrimin e provave. Në mënyrë alternative, paralelisht me hetimin ndaj sektorit mund të iniciohen hetime që duhet të shoqërohen me inspektime, si dhe mund të realizohen inspektime përpara publikimit të raportit paraprak.

#### **4.2. Raporti përfundimtar dhe përzgjedhja e masave vijuese**

- (43) Pas publikimit të raportit paraprak dhe vlerësimit të komenteve të marra, grupi i hetimit do të përgatisë një draft tekst ku parashtrahet një vlerësim përfundimtar i gjetjeve të hetimit dhe ku 8

<sup>1</sup> Niveli i specifikave të këtij raporti do të varet sigurisht nga objekti i hetimit.

konstatohen shqetësimet e identifikuara të konkurrencës.

#### 4.2.1. Vlerësimi përfundimtar

- (44) Vlerësimi përfundimtar mund të marrë formën e një projektraporti përfundimtar. Projektraporti përfundimtar do të përmbajë një diskutim, shqyrtim dhe vlerësim të arsyeve/evidencave/gjetjeve që mund të çojnë në shtrembërimin ose kufizimin e konkurrencës në sektorin e analizuar. Në të njëjtën kohë, raporti duhet të identifikojë veprimet specifike që Komisioni mund të ndërmarrë për të adresuar çështjet në fjalë.
- (45) Në parim, mund të merren tre lloje të ndryshme masash pas një hetimi në sektor:
- masat zbatuese specifike;
  - iniciativat ligjore, dhe;
  - iniciativat që synojnë zgjerimin e fushëveprimit të konkurrencës në sektor, në mënyra të tjera.
- (46) Nisja e procedurave në zbatim të ligjit për mbrojtjen e konkurrencën, duhet të konsiderohet nga Autoriteti si masa vijuese më e natyrshme. Megjithatë, problemet e konkurrencës, të identifikuara si rezultat i hetimeve në sektor të ekonomisë, mund të kërkojnë gjithashtu përdorimin e instrumenteve alternative dhe përfshirjen e autoriteteve rregullatore, p.sh. në rastet kur pengesat strukturore ndaj konkurrencës mund të trajtohen duke nxitur ndryshime të kuadrit rregullator ose ligjor.

#### 4.2.2. Raporti publik përfundimtar

- (47) Normalisht, pritet që Autoriteti të publikojë një raport përfundimtar në fund të hetimit, edhe pse kjo nuk është një kërkesë ligjore. Megjithatë, grupi i hetimit duhet të marrë në konsideratë atë që mund të arrihet duke publikuar gjetje të caktuara që rezultojnë nga hetimi ndaj sektorit.
- (48) Siç shpjegohet më sipër, raporti përfundimtar mund të marrë forma të ndryshme: në veçanti, raporti mund të publikohet në formën e një Dokumenti të Punës të Stafit të Autoritetit ose të një Njoftimi të Komisionit. Gjithashtu, është e mundur të kombinohet një dokument më gjithëpërfshirës i stafit, ku përcaktohen detajet e metodologjisë, aspektet teknike, gjetjet dhe konstatimet, me një Njoftim të Komisionit që fokusohet në gjetjet kryesore dhe masat e propozuara për zgjidhjen e problematikve në sektor.
- (49) Është e rëndësishme të theksohet se vetë raporti përfundimtar mund të luajë rol në përpjekjet për eliminimin e pengesave të caktuara të konkurrencës (p.sh., përmes efektit të tij parandalues), ose mund të rrisë ndërgjegjësimin e përgjithshëm të rregullatorëve dhe grupeve të tjera të interesit.
- (50) Në të njëjtën kohë, në rastet kur janë planifikuar masa të tjera zbatuese, koha e inspektimeve të mundshme duhet të merret në konsideratë në publikimin e raportit përfundimtar me qëllim që të mos pengojë zbatimin e masave duke njoftuar paraprakisht publikun.

#### 4.2.3. Hapat e mëtejshme

- (51) Zakonisht, një nga pasojat e hetimit të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë mund të jenë hetimet në rastet individuale, veçanërisht kur hetimi në sektor ka treguar se praktikrat e përdorura gjerësisht nga ndërmarrjet mund të çojnë në shtrembërimin dhe/ose kufizimin e konkurrencës në sektor. Një tjetër masë e mundshme vijuese e hetimeve në sektor janë masat rregullatore të përmendura më sipër.
- (52) Autoriteti mund të zgjedhë gjithashtu që të vazhdojë me monitorimin specifik të një sektori të caktuar, për shembull, në lidhje me praktika të caktuara që i konsideron si potencialisht problematike për konkurrencën në bazë të nenit 41 të ligjit nr. 9121/2003. Pas marrjes së

njohurive rreth një sektori, është e rëndësishme që Autoriteti të vazhdojë t'i ruajë këto njohuri. Gjithashtu, mund të parashikohen iniciativa të tjera, ku përfshihen format e ndryshme të rritjes së ndërgjegjësimit (si advokacia).

## **8 Kompetenca për të marrë deklaratata**

1. Hyrje	2
2. Qëllimi dhe përdorimi i intervistës	2
3. Kërkesat procedurale dhe themelore	3
3.1. Intervistuesi	3
3.2. I intervistuari	3
3.3. Vendndodhja	4
3.4. Paralajmërimet në fillim të intervistës	4
3.5. Pyetjet që bëhen gjatë intervistës	5
3.6. Regjistrimi dhe trajtimi i deklaratave	5
3.7. Aksesimi në dosje dhe mbrojtja e informacionit konfidencial	6
3.8. Përdorimi i informacionit të dhënë gjatë intervistave	6

## 1. Hyrje

- (1) Neni 36, gërma d), i ligjit nr. 9121/2003, i jep Inspektorëve të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës dhe personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga Komisioni për kryerjen e inspektimeve, mundësinë që t'i kërkojnë çdo përfaqësuesi ose punonjësi të ndërmarrjes shpjegime për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e inspektimit. Dispozitat e tjera procedurale për realizimin e intervistave janë parashikuar në nenin 10 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, ku përcaktohet se inspektorët e Autoritetit, me autorizim të Komisionit, mund të intervistojnë çdo person fizik ose juridik që jep pëlqimin për t’u intervistuar, me qëllim mbledhjen e informacionit të lidhur me objektin e një hetimi për zbulimin e shkeljes së rregullave të konkurrencës. Për udhëzime të mëtejshme, shihni gjithashtu Udhëzimin “Për praktikat më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e nenit 4 dhe 9 të ligjit nr.9121, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar”.
- (2) Informacioni i dhënë nga të intervistuarit mund të përdoret si provë gjatë vijimësisë së procedurës.
- (3) Intervista realizohet në mënyrë vullnetare. Referuar sa më lart, i intervistuari mund ta ndërpresë intervistën në çdo moment. Është e rëndësishme të bëhet dallimi ndërmjet mundësisë për të realizuar një intervistë në përputhje me nenin 10 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës” dhe mundësisë për të bërë pyetje verbale gjatë një inspektimi në përputhje me nenin 36, gërma d), të ligjit nr. 9121/2003. Punonjësit e një ndërmarrjeje (pavarësisht nëse janë përfaqësues që kanë autoritetin për të folur në emër të ndërmarrjes apo pjesëtarë të tjerë të stafit) janë të detyruar t’u përgjigjen vetëm pyetjeve verbale të bëra gjatë inspektimeve. Vetëm në lidhje me këto pyetje dhe në përputhje me disa kushte të caktuara, Komisioni mund të vendosë gjoba sipas nenit 73, pika 1, gërma “ç” të ligjit nr. 9121/2003, nëse përgjigjet janë të pasakta, të paplota, të rreme ose nëse përfaqësuesi nuk përgjigjet apo refuzon të përgjigjet.

## 2. Qëllimi dhe përdorimi i intervistës

- (4) Sipas nenit 10 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, inspektorët e autorizuar nga Komisioni mund të realizojë intervista me qëllim mbledhjen e informacionit të lidhur me objektin e një hetimi dhe zbulimin e shkeljes së rregullave të konkurrencës. Sa më lart, intervistat nuk janë thjesht një instrument për të mbledhur informacione të përgjithshme rreth tregut, pa pasur lidhje me një hetim. Edhe pse neni 10 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës” konfirmon praktikën e Autoritetit në çështjet e lehtësimit nga gjobat, ai parashikon për herë të parë mundësinë për të realizuar intervista dhe për të regjistruar deklaratat në të gjitha rastet e tjera. Ky instrument i ri mund të përdoret në një mënyrë proaktive, duke ftuar personat fizikë/juridikë për një intervistë. Megjithatë, duke pasur parasysh natyrën vullnetare të intervistës, normalisht nuk mund të nxirren konkluzione negative nga refuzimi për t’u intervistuar ose për t’iu përgjigjur pyetjeve të caktuara (përveçse në kontekstin e aplikimeve për imunitet, kur ky refuzim mund të rezultojë në mosbashkëpunim të plotë).
- (5) Për sa i përket çështjes se sigurisë për objektin e hetimit, në momentin e intervistës duhet të ketë të paktën një rast të regjistruar me një numër specifik të çështjes. Intervista mund të rezultojë në hapjen e çështjeve të tjera, por të intervistuarit duhet t’i kërkohej të konfirmojë nëse informacioni i dhënë në intervistë mund të përdoret edhe për këto çështje të reja të sapo

hapura.

- (6) Komisioni e përdor rregullisht këtë instrument në çështjet e lehtësimit nga gjobat, në të cilat ndërmarrjet japin vullnetarisht informacion që mund të përdoret në hetimet e kartelit. Megjithatë, ky instrument nuk është i kufizuar në çështjet e lehtësimit nga gjobat dhe mund të përdoret edhe për të intervistuar ndërmarrjet që nuk janë subjekt i një hetimi.
- (7) Duhet të theksohet se informacioni i dhënë vullnetarisht nga një ndërmarrje gjatë një interviste mund të justifikojë një reduktim të gjobës, pavarësisht një kërkesë specifike për lehtësim nga gjobat, veçanërisht kur lidhet me informacione vetëfajësuese që ndihmojnë Komisionin në përcaktimin e shkeljes. Duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë pyetjeve vetëfajësuese pasi atyre jo vetëm që nuk është e nevojshme t'u jepet përgjigje, por mund të shkaktojnë edhe probleme të diskriminimit ndërmjet aplikantëve në kontekstin e çështjeve të lehtësimit nga gjobat.
- (8) Edhe pse nuk përjashtohet mundësia që i intervistuari t'i mbështesë deklaratat e tij me prova të tjera (p.sh., dokumente), rekomandohet që intervista të kufizohet vetëm në deklaratat verbale. Provat e tjera duhet të përcillen në kuadër të një aplikimi për lehtësim nga gjobat ose në vijim të një kërkesë për informacion (Neni 33 i ligjit nr. 9121/2003) sepse kërkesat për informacion në veçanti i japin Komisionit më tepër garanci lidhur me saktësinë dhe plotësinë e informacionit të dhënë.
- (9) Procedura për marrjen e deklaratave në përputhje me nenin 10 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, zbatohet vetëm kur i intervistuari dhe Autoriteti bien dakord shprehimisht se biseda do të regjistrohet si një intervistë formale. Mbetet në gjykimin e Autoritetit që të vendosë se kur i propozon intervistat. Megjithatë, një palë mund t'i kërkojë gjithashtu Autoritetit që deklarata e saj të regjistrohet si një intervistë. Kjo kërkesë do të pranohet në parim, duke iu nënshtruar nevojave dhe kërkesave të realizimit të duhur të procedurës.

### **3. Kërkesat procedurale dhe themelore**

#### **3.1. Intervistuesi**

- (10) Komisioni autorizon inspektorët për të intervistuar çdo person me pëlqimin e tij, për zbulimin e shkeljes së rregullave të konkurrencës. Për këtë qëllim, inspektorët duhet që në fillim të intervistës t'u lexojë bazën ligjore dhe qëllimin e intervistës dhe t'u kujtojë natyrën e saj vullnetare. Ata gjithashtu duhet të informojnë personin e intervistuar mbi qëllimin e tyre për të regjistruar intervistën. Intervista mund të bëhet me çdo formë, duke përfshirë dhe atë me anë të telefonit ose në mënyrë elektronike. Inspektorët regjistrojnë çdo deklaratë të dhënë nga ana e personave të intervistuar në çdo formë. Një kopje e regjistrimit i vihet në dispozicion personit të intervistuar për miratim. Kur është e nevojshme, inspektorët caktojnë një afat kohor brenda të cilit personi i intervistuar mund të deklarojë çdo korrigjim të bërë në deklaratë.

#### **3.2. I intervistuari**

- (11) I intervistuari mund të jetë një person fizik, ose një person juridik i përfaqësuar në mënyrën e duhur nga një person fizik. Shembuj tipikë janë pjesëtarët aktualë ose të mëparshëm të stafit të një ndërmarrjeje (pavarësisht funksionit të tyre në ndërmarrje), ekspertët e çështjeve të specializuara ose një avokat që vepron për llogari të një klienti. Punonjësit e një ndërmarrjeje duhet të pyeten në fillim të një interviste nëse veprojnë për llogari të një ndërmarrjeje (si person

juridik), ose për llogari të tyre (si person fizik). Kur ka dyshime lidhur me këtë aspekt, të intervistuarit duhet t'i kërkohet që të japë dokumente mbështetëse lidhur me identitetin dhe funksionin e tij/saj.

- (12) I intervistuari duhet të japë shprehimisht pëlqimin për t'u intervistuar. Siç shpjegohet më sipër, i intervistuari mund të tërheqë plotësisht ose pjesërisht pëlqimin e tij/saj në çdo moment dhe pa dhënë arsye (p.sh., duke mos iu përgjigjur pyetjeve të caktuara).
- (13) Asnjë person nuk mund të pengohet nga punëdhënësi aktual ose i mëparshëm që të japë një intervistë, përveçse kur ai/ajo vepron për llogari të ndërmarrjes. Megjithatë, motivet e të intervistuarit duhet të merren në konsideratë kur vlerësohet besueshmëria e deklaratave të bëra prej tij/saj si prova në procedurën vijuese.
- (14) I intervistuari mund të vendosë që të shoqërohet nga një person i përzgjedhur prej tij/saj, si p.sh., nga një avokat. Asnjë palë e tretë nuk mund të marrë pjesë në intervistë përveç atyre që asistojnë të intervistuarin ose intervistuesit. Në veçanti, nëse punonjësi nuk vepron për llogari të ndërmarrjes, punëdhënësit nuk kanë të drejtë të informohen rreth takimit dhe/ose të marrin pjesë në takim (përveçse kur punonjësit bien dakord për diçka të tillë).

### **3.3. Vendndodhja**

- (15) Zakonisht, intervistat zhvillohen në ambientet e Autoritetit, por mund të zhvillohen edhe në ambientet e ndërmarrjes përkatëse. Edhe pse zakonisht nevojitet që i intervistuari dhe intervistuesi të jenë fizikisht të pranishëm në të njëjtën dhomë gjatë intervistës, intervistat mund të realizohen përmes çdo mjeti, p.sh., me telefon ose video-konferencë.

### **3.4. Paralajmërimet në fillim të intervistës**

- (16) Përpara se të fillojë intervista, intervistuesi ka detyrimin të tërheqë vëmendjen e të intervistuarit rreth çështjeve në vijim (për shembull, duke i lexuar deklaratën që i intervistuari duhet të firmosë në fund të intervistës):
  - baza ligjore e intervistës;
  - natyra vullnetare e intervistës (duhet marrë pëlqimi i të intervistuarit);
  - qëllimi i intervistës (pra, mbledhja e informacionit rreth objektit të një hetimi);
  - mundësia e regjistrimit të intervistës dhe synimi për të regjistruar intervistën në rastin në fjalë.
- (17) Për më tepër, rekomandohet që të tërhiqet vëmendja e të intervistuarit rreth faktit që:
  - ai/ajo gëzon të drejtën që të shoqërohet nga një avokat;
  - në një fazë të mëvonshme mund të jetë e nevojshme që të jepet akses në dosje. Për këtë qëllim, rekomandohet që të diskutohet me të intervistuarin (në veçanti kur ai/ajo është një person fizik që jep një deklaratë pa njohurinë e punëdhënësit të tij/saj aktual ose të mëparshëm) nëse do të preferonte që të mbetet anonim, për aq sa është e mundur.
  - disa pyetje mund të kenë natyrë vetëfajësuese. Në këtë rast, intervistuesi duhet të shpjegojë pasojat ligjore të përgjigjeve ndaj këtyre pyetjeve. Në rastin e aplikantëve për imunitet, duhet të nënvizohet në veçanti se mosdhënia e përgjigjeve ndaj pyetjeve mund të ndikojë në

vlerësimin e Komisionit lidhur me faktin nëse aplikanti vazhdon të jetë bashkëpunues. Për sa i përket aplikantëve për lehtësim nga gjobat, mund të përmendet, në një mënyrë neutrale, se këto përgjigje mund të ndikojnë në përcaktimin e nivelit përfundimtar të reduktimit të gjobës, brenda diapazonit të dhënë të reduktimit. Për sa i përket ndërmarrjeve të tjera të intervistuar, duhet të përmendet se dhënia e përgjigjeve ndaj këtyre pyetjeve (për llogari të ndërmarrjes në fjalë) mund të justifikojë reduktimin e një gjobe të vendosur më vonë nga Komisioni, nëse informacioni i dhënë ndihmon Komisionin për të përcaktuar ekzistencën e një shkeljeje (për të cilën ndërmarrja mund të konsiderohet përgjegjëse). Megjithatë, në çdo rast duhet të specifikohet gjithashtu se nuk ka asnjë lloj detyrimi për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve.

- (18) Për të vërtetuar se intervistuesit i kanë përmbushur detyrimet ligjore, rekomandohet që i intervistuari të nënshkruajë një deklaratë që e konfirmon diçka të tillë. Deklarata duhet t'i jepet të intervistuarit në fund të intervistës për t'u firmosur prej tij/saj.

### **3.5. Pyetjet që bëhen gjatë intervistës**

- (19) Siç u shpjegua më sipër, të gjitha pyetjet e bëra gjatë intervistës duhet të jenë të lidhura me objektin e një hetimi.
- (20) Duke marrë parasysh faktin se i intervistuari nuk është i detyruar të bashkëpunojë në mënyrë aktive me Autoritetin dhe se nuk mund të vendosen sanksione në rastin e mosbashkëpunimit, lejohet që gjatë intervistave të bëhen pyetje vetëfajësuese.

### **3.6. Regjistrimi dhe trajtimi i deklaratave**

- (21) Autoriteti gëzon të drejtën që të regjistrojë deklaratat e të intervistuarit. Kjo mund të bëhet
- duke marrë shënime dhe duke përgatitur procesverbalin e intervistës;
  - duke regjistruar të gjithë intervistën në çdo formë, si dhe duke përgatitur një transkriptim;
  - duke i lejuar të intervistuarit që të dorëzojë një version me shkrim të deklaratave verbale të dhëna.
- (22) I takon intervistuesve që të vendosin se cila është metoda më e mirë e regjistrimit për rastin në fjalë, duke marrë në konsideratë nevojën që kjo deklaratë, e vërtetuar nga i intervistuari, të përdoret si provë në procedurën vijuese, si dhe nevojën e të intervistuarit për të mbrojtur interesat e tij/saj legjitimë (p.sh. risku i zbulimit të deklaratave për lehtësim nga gjobat përpara gjykatave kombëtare ose risku i hakmarrjes nëse zbulohet identiteti i të intervistuarit [mund të njihet zëri i regjistruar]).
- (23) Për të rritur saktësinë e deklaratave, një kopje e regjistrimit dhe transkriptimi i regjistrimit duhet t'i vihen në dispozicion të intervistuarit për t'u miratuar/korrigjuar nga ky i fundit. Autoriteti vendos një afat kohor brenda të cilit personi i intervistuar mund t'i komunikojë atij çdo korrigjim që i duhet bërë deklaratës dhe transkriptimit. Rekomandohet që të vendoset një afat i shkurtër kohor me qëllim që transkriptimet përfundimtare të jenë gati sa më shpejt që të jetë e mundur.
- (24) Autori i deklaratës, ose avokati i tij, duhet të nënshkruajë dokumentin/transkriptimin përfundimtar si një kopje e vërtetë dhe e saktë e deklaratave të tij/saj, me qëllim që ky informacion të mund të përdoret si provë në procedurën vijuese. Pasi dokumenti nënshkruhet, ai bëhet pjesë e dosjes së çështjes.

- (25) I intervistuari mund të heqë dorë nga e drejta për të marrë deklaratën me shkrim ose regjistrimin dhe transkriptimin, veçanërisht për të shmangur procedurat e zbulimit para gjykatave. Në këtë rast, i intervistuari kontrollon dhe vërteton saktësinë e regjistrimit dhe të transkriptimit në ambientet e Autoritetit (shihni më tej në Modulin e aplikimit për lehtësim nga gjokat).

### **3.7. Aksesit në dosje dhe mbrojtja e informacionit konfidencial**

- (26) Në rastet kur Autoriteti duhet të japë akses në dosje, ai do të duhet të japë gjithashtu akses në regjistrimet e çdo interviste të realizuar gjatë hetimit dhe të përfshirë në dosje.
- (27) Gjatë këtij procesi, Autoriteti duhet të garantojë mbrojtjen e sekreteve tregtare ose të informacioneve të tjera konfidenciale. Kjo mund të përfshijë mbrojtjen e identitetit të të intervistuarit (veçanërisht nëse punëdhënësi nuk është në dijeni të faktit se një nga punonjësit e tij ka dhënë një intervistë).
- (28) Për detaje rreth përgatitjes dhe dhënies së aksesit në dosje, shihni Modulin përkatës për aksesin në dosje.

### **3.8. Përdorimi i informacionit të dhënë gjatë intervistave**

- (29) Informacioni i dhënë gjatë intervistave mund të përdoret si provë gjatë procedurës vijuese. Megjithatë, Autoriteti duhet të vlerësojë me kujdes besueshmërinë e deklaratave, në veçanti nëse ka marrë informacione kontradiktore ose nëse ka arsye që vënë në dyshim besueshmërinë e të intervistuarit.
- (30) Sipas nenit 30 të ligjit nr. 9121/2003, informacioni i mbledhur në përputhje me nenin 36, gërma d) të ligjit nr. 9121/2003 dhe nenin 10 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës” mund të përdoret vetëm për qëllimin për të cilin është përfutur. Rrjedhimisht, informacioni i dhënë në kuadër të një çështjeje të caktuar nuk mund të përdoret për një çështje tjetër në proces, përveçse kur i intervistuari bie dakord se intervista është realizuar duke pasur si qëllim edhe këtë hetim tjetër. Në këtë rast duhet të merret konfirmim me shkrim.

## **9 Lehtësimit nga gjobat**

1. Hyrje
2. Kushtet për dhënien e lehtësimit nga gjoba
3. Lehtësimit i plotë nga gjoba  
Lehtësimit i pjesshëm nga gjoba

## 1. Hyrje

- (1) Ky manual u jep udhëzime praktike personave përgjegjës për administrimin e çështjeve lidhur me procedurën për trajtimin e aplikimeve për imunitet dhe për lehtësim nga gjobat (referuar bashkërisht në vijim si “aplikimet për lehtësim nga gjobat”). Manuali është një dokument në ndryshim të vazhdueshëm, i cili përditësohet rregullisht. Për rrjedhojë, ai duhet të trajtohet si një pikë reference e dobishme dhe jo si një grup udhëzimesh detyruese.

### 1.1. Baza Ligjore

- (2) **Ligji nr. 9121/2003:** Në nenin 77 “Lehtësimi nga gjobat”, përcaktohet se: një ndërmarrjeje, të përfshirë bashkë me të tjerat në një marrëveshje të ndaluar, sipas nenit 4, mund t'i jepet lehtësimi, i plotë ose i pjesshëm, nga gjobat, nëse ajo ndihmon në zbulimin dhe ndalimin e marrëveshjes së ndaluar, si dhe në përcaktimin e personave përgjegjës, duke siguruar të dhëna, të pazotëruara më parë nga Autoriteti. Komisioni u jep ndërmarrjeve këshillë për lehtësim nga gjobat, duke treguar edhe kushtet për zbatimin e saj, të përcaktuara në “Rregulloren për gjobat dhe lehtësimin e tyre”. Kjo këshillë u transmetohet ndërmarrjeve dhe nuk publikohet. Në rastin e një vendimi, Komisioni mund të japë lehtësim nga gjobat në përpjesëtim me kontributin e dhënë për zbardhjen, zbulimin dhe ndalimin e shkeljes, nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në këshillën për lehtësim.
- (3) **Rregullorja për gjobat dhe lehtësimin e tyre:** Në Kreut III “Lehtësimi nga gjobat” përcaktohet se ndërmarrjet nën hetim këshillohen nga ana e Komisionit për mundësinë e përfitimit të lehtësimit nga gjoba nëse bashkëpunon me Autoritetin sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9121/2003 dhe kësaj rregulloreje. Në këtë krah përcaktohen llojet e lehtësimit nga gjobat dhe procedurat që duhen ndjekur për të përfituar prej tyre.
- (4) **Programi i Lehtësimit nga Gjjobat:** Mbështetur në nenin 77 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, në Rregulloren “Për Gjjobat dhe Lehtësimin prej tyre”, Autoriteti i Konkurrencës me vendimin nr. 382, datë 17. 11 . 2015 ka miratuar “Programin e Lehtësimit nga Gjjobat” dhe “Formularin e Aplikimit për Lehtësimin nga Gjjobat”. “Lehtësimi” nënkupton imunitetin por edhe reduktimin nga çdo gjobë që do të vendosej për një pjesëmarrës në një marrëveshje të ndaluar, në shkëmbim të zbulimit vullnetar të informacionit për sa i përket kartelit, para ose përgjatë fazës hetimore të një rasti. Programi vendos një strukturë për vlerësimin e bashkëpunimit të ndërmarrjeve të cilat janë palë në marrëveshje dhe praktika që janë objekti i ligjit. Programi i lehtësimit nga gjobat është një instrument i rëndësishëm në luftën kundër marrëveshjeve të ndaluara, duke qenë se ato inkurajojnë ndërmarrjet që të ofrojnë informacion pranë Autoritetit të Konkurrencës, në lidhje me shkeljet e mundshme të konkurrencës. Programi i Lehtësimit nga gjobat, lejon Autoritetin e Konkurrencës që të ofrojë imunitet të plotë ose reduktim nga gjobat, që në të kundërt do të ishin vendosur për një pjesëmarrës në marrëveshje të ndaluar, gjithmonë në shkëmbim të zbulimit të informacionit mbi këtë marrëveshje të ndaluar dhe bashkëpunimit me Autoritetin e Konkurrencës. Duke pasur parasysh natyrën “sekrete” të marrëveshjeve të ndaluara, kjo politikë e lehtësimit nga gjobat synon në zbulimin e karteleve dhe në forcimin e rregullave të konkurrencës.

### 1.2. Çfarë përmban programi i lehtësimit nga gjoba për anëtarët e Kartelit?

- (5) Kur një shkelje e ligjit përfshin aktivitetet e Kartelit, gjobat mund të arrijnë deri në 10 % të xhiros vjetore të një ndërmarrje. Me anë të programit të lehtësimit anëtarët e Kartelit mund t'i

pakësojnë pjesërisht gjodat e tyre financiare ose ti shmangin ato tërësisht. Prandaj programi i lehtësimit i jep atyre një stimul real për të dhënë informacion.

- (6) Programi i lehtësimit nga gjodat, ka të bëjë me marrëveshjet dhe praktikatat e bashkërenduara ndërmjet dy ose më shumë konkurrentëve, që synojnë të kufizojnë konkurrencën nëpërmjet p.sh fiksimit të blerjeve ose çmimeve të shitjeve, shpërndarjes së produkteve ose kuotave të shitjes apo ndarjes së tregjeve përfshirë edhe bid ridding.
- (7) Programi zbatohet ndaj ndërmarrjeve që veprojnë në treg dhe që janë ose kanë qenë pjesë e marrëveshjeve të ndaluara. Me qëllim që të sigurohet se programi i lehtësimit punon me efektivitet, është megjithatë e rëndësishme të mbrohen sa më tepër të jetë e mundur nëpunësit dhe drejtorët e ndërmarrjes duke aplikuar imunitet dhe mbrojtje nga sanksionet individuale.
- (8) Programi, gjithashtu ofron mbrojtje të informacionit të dhënë për përftimin e lehtësimit. Me qëllim sigurimin e mekanizmave për bashkëpunim duke inkurajuar aplikuesit për raportim vullnetar në lidhje me marrëveshjet e ndaluara dhe aktivitetet në lidhje me to, është e nevojshme mbrojtja në lidhje me informacionin e dhënë. Informacioni në lidhje me një lehtësim nuk mund të përdoret nga ndonjë autoritet tjetër. Ky informacion mund të shkëmbehet midis institucioneve/Autoriteteve homologe vetëm kur vetë aplikuesi bie dakord për shkëmbimin, ose kur institucioni marrës ofron një angazhim me shkrim që të mos përdorë informacionin e marrë ose çdo informacion tjetër që mund të marrë pas kësaj date, për të vendosur gjobë/sanksione mbi aplikuesin, pjesët e tij ose nëpunësit.

### **1.3. Çfarë forme ka lehtësimi nga gjoda?**

- (9) Lehtësimi nga gjodat mund të jetë i plotë ose i pjesshëm.

### **1.4. Çfarë lloj veprimtarie përfshihet?**

- (10) Për qëllimet e programit të lehtësimit nga gjodat, termi Kartel ose Veprimtari Karteli përdoret për marrëveshjet midis ndërmarrjeve, vendime të shoqatave të ndërmarrjeve ose praktika bashkërenduese që shkelin Ligjin dhe përfshin:
  - (i) Fiksimit e çmimit;
  - (ii) Kufizimi i prodhimit ose vendosja e kuotave;
  - (iii) Ndarjen e tregut;
  - (iv) Bid Rigging (marrëveshjet në oferta).

## **2. Kushtet për dhënien e lehtësimit nga gjoda**

(11) Një ndërmarrje kualifikohet për të përftuar lehtësim nga gjoda, nëse:

- 1) Përfundon përfshirjen e saj në shkeljen e pretenduar, pas aplikimit të saj, deri në masën që përfshirja e saj në vijim duhet të jetë e arsyeshme, përsa i takon inspektimeve të kryera nga Autoriteti;
- 2) Bashkëpunon mbi baza të plota dhe të vazhdueshme me Autoritetin e Konkurrencës,

nga koha e aplikimit deri në përfundimin e rastit dhe kjo përfshin në veçanti:

- Sigurimi pranë Autoritetit i të gjithë informacionit të nevojshëm dhe të dhënave që zotërohen nga aplikuesi ose nën kontrollin e tij;
  - Qëndrimi në dispozicion të Autoritetit për t'u përgjigjur ndaj çdo lloj kërkesë që, në këndvështrimin e Autoritetit, mund të ndihmojë në krijimin e fakteve domethënëse;
  - Duke vënë në dispozicion dhe deri në një masë të arsyeshme, punonjësit e mëparshëm dhe drejtorët të gatshëm për t'u intervistuar nga Autoritetit;
  - Duke mos shkatërruar, falsifikuar apo fshehur informacion të rëndësishëm ose të dhëna; dhe
  - Duke mos zbuluar fakte ose ndonjë element të aplikimit për lehtësim nga gjoba të paktën para se Autoriteti të ketë njoftuar raportin e hetimit/objeksionet e tij tek palët.
- 3) Përpara aplikimit për lehtësim nga gjoba nuk duhet të:
- Ketë shkatërruar të dhëna, të cilat janë objekt i aplikimit, ose
  - Ketë zbuluar, direkt ose indirekt, fakte ose ndonjë të dhënë tjetër lidhur me aplikimin që mendon të kryejë tek ndonjë autoritet tjetër konkurrence.

### 3. Lehtësimi i plotë nga gjoba

1) Kushti Referuar Ligjit Nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” si dhe Rregullores “Për Gjobat dhe Lehtësimin prej Tyre” për të përfituar lehtësim të plotë nga programi i lehtësimit nga gjobat duhet të plotësohen kriteret e mëposhtme:

1. Komisioni i Konkurrencës (Komisioni) mund të japë lehtësim të plotë nga çdo gjobë, nëse kjo ndërmarrje është e para që ndihmon në zbulimin dhe ndalimin e marrëveshjes së të ndaluar, si dhe/ose në përcaktimin e personave përgjegjës duke siguruar prova dhe të dhëna, të pazotëruara më parë nga Autoriteti, që i mundësojnë këtij të fundit të:

a) të fillojë një hetim në lidhje me një marrëveshje të ndaluar;

b) të zbulojë një shkelje në bazë të nenit 4 të Ligjit.

2) Për përfitim nga lehtësimi i plotë i gjobës ndërmarrja duhet:

a) T'i sigurojë Autoritetit, një kopje ose përshkrim të marrëveshjes së ndaluar, ku përfshihen: qëllimi, veprimtaria, funksionimi, produktet përkatëse, tregu përkatës, zgjatja dhe vlerësimi i volumit të tregut të ndikuar nga marrëveshja e ndaluar, data e lidhjes së marrëveshjes, vendndodhja, përmbajtja dhe pjesëmarrësit në marrëveshje si dhe përshkrime të tjera të cilat ndihmojnë Autoritetin në zbulimin e shkeljes.

b) Të japë emrin dhe adresën e ndërmarrjes që aplikon për lehtësim nga gjoba si dhe emrat dhe adresat e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje.

c) Të japë emrat, pozicionet, vendndodhjet e zyrave dhe kur është e nevojshme, adresat e të gjithë individëve të cilët, për sa ka dijeni ndërmarrja kërkuese, janë ose kanë qenë të

përfshirë në marrëveshjen e ndaluar, duke përfshirë të gjithë ata individë të cilët kanë qenë të përfshirë për llogari të kërkuarit.

- d) Të informojë Autoritetin, nëse ndërmarrja është tërhequr nga pjesëmarrja në marrëveshjen e ndaluar;
  - e) Të qëndrojë në dispozicion të Autoritetit, për t'iu përgjigjur kërkesave që mund të kontribuojnë për rastin;
  - f) Të mos shkatërrojë, falsifikojë ose korrigjojë informacionin përkatës ose të dhënat që lidhen me marrëveshjen e ndaluar;
  - g) Të japë të dhëna të tjera që lidhen me marrëveshjen e ndaluar.
- 3) E rëndësishme Lehtësimi nga gjobat, nuk do të jepet nëse, në kohën e aplikimit, Autoriteti ka pasur të dhëna të mjaftueshme:
- a) për të ndërmarrë një hetim, në lidhje me një marrëveshje të ndaluar;
  - b) ka ndërmarrë një hetim të tillë;
  - c) për të marrë një vendim nga Komisioni.
- 4) Kur përfiton nga lehtësimi

Lehtësimi nga gjoba, do të jepet në rastin kur Autoriteti në kohën e aplikimit nuk kishte të dhëna të mjaftueshme për të zbuluar një shkelje sipas nenit 4 të Ligjit.

Ndërmarrja, e cila ka ndërmarrë nismën të detyrojë ndërmarrjet e tjera të bashkohen në marrëveshje, ose të qëndrojnë në të, nuk përfiton nga ky lehtësim.

- 5) Si mund të aplikoj për lehtësim nga gjoba? Procedura për lehtësim të plotë nga gjoba

Ndërmarrja që kërkon lehtësim të plotë nga gjobat, paraqet pranë Autoritetit një kërkesë për t'u konsideruar e imunizuar plotësisht ose pjesërisht nga gjoba.

Autoriteti nuk pranon kërkesën për lehtësim nga gjobat kur ajo është depozituar pas përfundimit të raportit të hetimit.

Kërkuesi informon Autoritetin për aplikimet për lehtësimet e mëparshme ose që ai ka përfituar.

Pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar, Komisioni verifikon nëse ky dokumentacion është i mjaftueshëm për të dhënë lehtësimin, dhe vendos për dhënien e lehtësimit të kushtëzuar me shkrim.

Komisioni përcakton afatin kohor, brenda të cilit kërkuesi, duhet të sjellë informacionin dhe të dhënat e kërkuara, me qëllim plotësimin e kriterëve për lehtësim nga gjobat. Në rast të mosrespektimit të kriterëve të mësipërme, kërkuesi nuk përfiton lehtësim nga gjobat.

Nëse ndërmarrja nuk ka plotësuar kriteret dhe afatet e vendosura, Autoriteti informon me shkrim atë. Në një rast të tillë, ndërmarrja mund të tërheqë aplikimin ndaj lehtësimit, ose

t'i kërkojë Autoritetit të marrë në konsideratë kërkesën e saj për lehtësim të pjesshëm nga gjobat.

Nëse të dhënat e depozituara nuk konsiderohen të mjaftueshme nga ana e Komisionit, ai njofton me shkrim ndërmarrjen, që aplikimi i saj për lehtësim është refuzuar. Në çdo rast, ndërmarrja mund të kërkojë nga Komisioni, që kërkesa e saj për aplikimin të konsiderohet si aplikim për reduktim nga gjoba (lehtësim i pjesshëm).

Komisioni merr vendimin përfundimtar për të garantuar lehtësim nga gjoba në përfundim të procedurave të tij. Nëse komisioni ka dhënë një lehtësim të kushtëzuar, dhe zbulon se aplikuesi ka vepruar si detyruar për lidhjen e marrëveshjes, ose që aplikuesi nuk ka përmbushur të gjitha kushtet që lidhen me lehtësimin, komisioni informon aplikuesin menjëherë.

Komisioni nuk merr në konsideratë kërkesa të tjera për lehtësim nga gjobat, para se të jetë shprehur për një aplikim ekzistues në lidhje me të njëjtën shkelje.

#### 4. Lehtësimi i pjesshëm nga gjoba

Ndërmarrja, që njofton pjesëmarrjen në një marrëveshje të ndaluar dhe që nuk plotëson kushtet për lehtësim të plotë nga gjoba, mund të aplikojë për të përfituar lehtësim të pjesshëm nga gjoba.

##### 1) Për të përfituar lehtësim të pjesshëm nga gjoba ndërmarrja duhet:

T'i sigurojë Autoritetit vlera të shtuara në lidhje me marrëveshjen e ndaluar. Në vlerësimin që kryen Autoriteti, merren në konsideratë provat që kanë lidhje me shkeljen dhe kohën kur është kryer ajo. Këto prova kanë më shumë vlerë, sesa provat e krijuara më pas. Në mënyrë të ngjashme, provat e lidhura drejt për drejt me faktet në fjalë, do të konsiderohen me një vlerë më të madhe se sa ato indirekte.

Koncepti i vlerës së shtuar ka të bëjë me faktin nëse provat e dhëna, në varësi të natyrës dhe të detajeve që ato paraqesin, i shtojnë mundësitë Autoritetit që të provojë shkeljen e pretenduar, duke siguruar argumenta shtesë për të provuar këtë shkelje.

##### 2) Sa është masa e lehtësimit të pjesshëm?

Me qëllim që të përcaktohet niveli i duhur i reduktimit të gjobës, Komisioni merr në konsideratë kohën në të cilën janë depozituar të dhënat (përfshirë edhe faktin nëse aplikuesi është ndërmarrja e parë apo e dyta apo e treta...e kështu me radhë...e cila aplikon). Komisioni në vendimin përfundimtar, vendos për nivelin e lehtësimit të pjesshëm nga gjobat për:

- a) Ndërmarrjen e parë, në masën 30-50%;
- b) Ndërmarrjen e dytë, në masën 20-30%;
- c) Ndërmarrjet vijuese, në masën deri në 20%.

Me qëllim që të përcaktohet niveli i lehtësimit të pjesshëm nga gjoba, Autoriteti merr parasysh kohën në të cilën janë paraqitur provat dhe shkallën në të cilën paraqitet vlera e shtuar. Komisioni mund të marrë parasysh nivelin dhe vijueshmërinë e çdo bashkëpunimi

të ofruar nga ndërmarrja.

- 3) Si mund të aplikoj për lehtësimin e pjesshëm nga gjoba? Procedurat për lehtësimin të pjesshëm nga gjoba.

Ndërmarrja që kërkon lehtësim të pjesshëm nga gjoba paraqet një kërkesë me shkrim pranë Autoritetit duke sjellë të dhëna të mjaftueshme për marrëveshjen në fjalë. Në kërkesë, duhet të identifikohet qartë koha e paraqitjes së saj.

Me marrjen e kërkesës të ndërmarrjes, Autoriteti i lëshon kësaj te fundit një vërtetim me shkrim duke konfirmuar datën e marrjes së provave në dorëzim.

Nëse Komisioni arrin në përfundimin se provat e paraqitura nga ndërmarrja përbëjnë vlerë të shtuar, atëherë informon ndërmarrjen me shkrim, jo më vonë se sa data në të cilën raporti i hetimit i është dërguar ndërmarrjes, duke e njoftuar atë për përfitimin e lehtësimit të pjesshëm nga gjoba. Shuma totale e zbritjes nga gjoba duhet të përcaktohet deri në përfundim të hetimit.

Komisioni informon me shkrim ndërmarrjet në rast se arrin në përfundimin se ndërmarrja nuk përfiton nga ky lehtësim.

# 10 Hapja e procedurave

---

1.	Arsyeja për hapjen e procedurave	2
2.	Koha: kur duhen hapur procedurat?	2
3.	Kushtet për hapjen e procedurave	2
4.	Hartimi i vendimit për hapjen e procedurave	4
5.	Miratimi dhe njoftimi i vendimit	4
6.	Publikimi i hapjes së procedurave	4
7.	Mundësia për të ndryshuar objektin e hetimit pas hapjes së procedurave	5
8.	Takimi për situatën aktuale	5
9.	Rishikimi i dokumenteve kryesore të dorëzuara	6

## 1. Arsyeya për hapjen e procedurave

- (1) Hapja (ose “nisja”) e procedurave është një akt formal i Komisionit.<sup>1</sup>
- (2) Komisioni do të hapë procedurat sipas nenit 42, kur bazuar në vlerësimin fillestar të sekretariatit arrihet në konkluzionin se duhet të kryhen hetime të mëtejshme lidhur me çështjen, si dhe kur objekti i hetimit është përcaktuar në mënyrë të saktë.
- (3) Hapja e procedurave tregon një angazhim nga ana e Komisionit për të hetuar më tej çështjen me prioritet. Për rrjedhojë, Sekretariati i Autoritetit do të alokojë burime për çështjen dhe do të përpiqet të trajtojë çështjen në kohën e duhur.

## 2. Koha: kur duhen hapur procedurat?

- (4) Në përputhje me nenin 41 të ligjit 9121/2003 Autoriteti, me nismën e tij, me kërkesën e Kuvendit ose me kërkesën e institucioneve rregullatore të sektorëve përkatës, mund të kryejë një hetim të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë, nëse ngurtësia e çmimeve ose rrethana të tjera të bëjnë të mendosh se konkurrenca në treg kufizohet ose shtrembërohet.
- (5) Gjithashtu sipas nenit 4 të Rregullores për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës miratuar me Vendimin nr 176 datë 24.02.2011 të Komisionit të Konkurrencës, Sekretariati mund të fillojë një procedure paraprake hetimore:
  - a) Me nismën e tij, me vendim të Komisionit;
  - b) Në bazë të një ankese të të tretëve,
  - c) Çdo herë që kërkohet nga Komisioni.

## 3. Kushtet për hapjen e procedurave

- (1) Kushtet për hapjen e procedurave janë të dyfishta:
  - Procedurat hapen sipas nenit 4 pika 2 të rregullores për procedurat hetimore, “me qëllim evidentimin nëse ka ose jo shenja të pengimit, kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg, të cilat mund të shërbejnë si shkaqe për hapjen e hetimit të thelluar nga Komisioni, sipas nenit 5 të kësaj Rregulloreje”.
  - Duke pasur parasysh pasojat ligjore të lidhura me hapjen e procedurave, pikëpamja e Komisionit duhet të mbështetet nga disa faktorë objektivë. Duhet të ketë **indikacione të arsyeshme të një shkeljeje të mundshme**.

## 4. Hartimi i vendimit për hapjen e procedurave

- (2) Vendimi për hapjen e procedurave duhet të jetë i shkurtër. Duke qenë se ky vendim u përcillet palëve, duhet të hartohet në mënyrë sa më të qartë. Në thelb, në vendim specifikohet se është marrë vendimi për hapjen e procedurave në përputhje me nenin nenin 41 të ligjit 9121/2003 .

---

<sup>1</sup> Shihni Çështjen 48/72 *Brasserie de Haecht* [1973] ECR 77, paragrafi 16 dhe pikën 52 të Njoftimit të Komisionit për bashkëpunimin brenda Rrjetit të Autoriteteve të Konkurrencës (Gazeta Zyrtare C 101, 27.4.2004, f.43), (“Njoftimi për Rrjetin”). Lidhur me hapjen e procedurave në përgjithësi, shihni Njoftimin për praktikën më të mira për kryerjen e procedurave të lidhura me nenet 101 dhe 102 të TFBF-së (Gazeta Zyrtare C 308, 20.10.2011, f. 6) (“Njoftimi për praktikën më të mira për antitrustin”).

- (3) Vendimi për hapjen e procedurave identifikon palët që janë subjekt të procedurës dhe përshkruan shkurtimisht objektin e hetimit. Në veçanti, ai përcakton sjelljen që përbën shkelje të supozuar të neneve 4 dhe/ose 9 të ligjit 9121/2003, dhe normalisht identifikon tregun përkatës, tregun gjeografik dhe sektorin/sectorët ku ndodh kjo sjellje.
- (4) Duhet të nënvizohet se hapja e procedurave nuk prezumon në asnjë mënyrë ekzistencën e një shkeljeje. Hapja e procedurave thjesht tregon se Drejtoria Përkatëse e cila organizon hetimin do ta ndjekë më tej çështjen me prioritet. Ky dallim i rëndësishëm bëhet i qartë në vendimin që u njoftohet palëve, si dhe në të gjitha komunikimet publike lidhur me hapjen e çështjes.
- (5) Sipas nenit 4, pika 8 e rregullores, Raporti i hetimit paraprak, ndër të tjerave përmban:
  - a) Tregun përkatës, Objekti i hetimit, bazën ligjore, datën e fillimit të hetimit;
  - b) Emri, adresa dhe të dhëna të tjera të palëve të dyshuara për shkelje të ligjit;
  - c) Të dhënat dhe informacionet e grumbulluara gjatë hetimit, si dhe analizën e tyre;
  - d) Shpjegimet e dhëna nga palët, intervistat e kryera me persona të lidhur me çështjen;
  - e) Gjetjet dhe rekomandimet përkatëse.

## **5. Miratimi dhe njoftimi i vendimit**

- (6) Sipas nenit 5 pika 4 të rregullores për procedurat hetimore Vendimi për fillimin e hetimit, ju njoftohet palëve që janë subjekt i procedurave, ndërmarrjeve dhe palëve përkatëse, si dhe personit i cili ka interes të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm në këtë hetim dhe që ka depozituar të dhëna dhe/ose ankesë lidhur me fillimin e këtij hetimi.
- (7) Në përputhje me nenin 5 të rregullores, njoftimi dorëzohet nga një zyrtar i Sekretariatit, ose një nëpunës tjetër, dorazi, ose nëpërmjet postës, duke konfirmuar marrjen dijeni. Nëse është e pamundur ose veçanërisht e vështirë që ky shërbim të kryhet personalisht, nisur nga numri i madh i adresave dhe njoftimeve, ai gjithashtu mund të njoftohet edhe nëpërmjet publikimit tek të paktën dy gazeta ditore kombëtare me shtrirje të gjerë ose ndonjë formë tjetër e përshtatshme publikimi.

## **6. Publikimi i hapjes së procedurave**

- (8) Sipas nenit 5, pika 7 të rregullores, njoftimi që hetimi ka filluar duhet gjithashtu të publikohet në Buletinin Zyrtar të Autoritetit duke treguar detajet përkatëse, si dhe në faqe interneti-n e Autoritetit.
- (9) Gjithashtu sipas nenit 47 të ligjit 9121/2003, autoriteti publikon fillimin e hetimit të thelluar në “Buletinin zyrtar” të Autoritetit. Në njoftim përcaktohen qëllimi i hetimit, argumentet për fillimin e hetimit dhe palët që hetohen. Autoriteti, nëpërmjet njoftimit, fton edhe palë të treta të marrin pjesë në hetim, nëse ato janë të interesuara. Mungesa e publikimit nuk pengon fillimin dhe kryerjen e hetimit. Në këtë rast publikimi botohet në numrin e parë të ardhshëm të “Buletinit zyrtar” të Autoritetit.
- (10) Vendimet e Komisionit, të marra për shkeljen e neneve 4 dhe 9, botohen në “Buletinin zyrtar”

të Autoritetit. Publikimi përmban emërtimin, selinë, veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, përmbajtjen kryesore të vendimit, si dhe gjobat

## **7. Mundësia për të ndryshuar objektin e hetimit pas hapjes së procedurave**

- (11) Hapja e procedurave nuk kufizon të drejtën e Komisionit për të zgjeruar (ose reduktuar) objektin dhe/ose marrësit e hetimit në një moment të mëvonshëm; p.sh., hetimi i thelluar ose një riorientim i çështjes mund të nënkuptojë përfshirjen dhe hetimin e aspekteve të reja ose heqjen dorë nga disa aspekte të çështjes<sup>2</sup>. Në rastin e zgjerimit të hetimit, është e nevojshme të hapen procedurat lidhur me shkeljet shtesë.
- (12) Sipas nenit Neni 46 të ligjit, Komisioni mund të revokojë ose të ndryshojë vendimet e veta, duke vendosur kushte a detyrime, ose të rifillojë procedurën kur:
- a) njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit, kanë ndryshuar;
  - b) palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;
  - c) vendimi është bazuar në të dhënat jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.

## **8. Takimi për situatën aktuale**

- (13) Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në përputhje me nenin 39 të ligjit 9121/2003, me iniciativën e tij ose me kërkesë, përpiqet t'u japë palëve që janë subjekt i procedurave mundësi të mjaftueshme për diskutime të hapura dhe të sinqerta, si dhe për të bërë të ditura pikëpamjet e tyre gjatë procedurës.<sup>3</sup>
- (14) Në këtë aspekt, Sekretariati mund të organizojë një takim pak kohë pas hapjes së procedurave, duke informuar palët që janë subjekt i procedurave rreth çështjeve të identifikuar në këtë fazë dhe objektit të parashikuar të hetimit<sup>4</sup>.
- (15) Ky takim u jep palëve mundësinë që të reagojnë fillimisht ndaj çështjeve të identifikuar, si dhe mund të shërbejë gjithashtu për të asistuar në marrjen e një vendimi lidhur me kuadrin e përshtatshëm për hetimin e saj të mëtejshëm.
- (16) Zakonisht, takimet për situatën aktuale zhvillohen në ambientet e Autoritetit, por mund të organizohen edhe me telefon apo videokonferencë, sipas rastit. Përfaqësuesit e Autoritetit të Konkurrencës në takime përzgjidhen sipas rëndësisë së çështjes, rast pas rasti.

## **9. Rishikimi i dokumenteve kryesore të dorëzuara**

- (17) Në përputhje me nenin 42 pika 2 të ligjit 9121 si dhe nenit 3 pika 2 të rregullores për procedurat

---

<sup>2</sup> Vendimi për përfshirjen ose jo të elementëve të rinj duhet të marrë në konsideratë ekuilibrin ndërmjet objektit dhe kohëzgjatjes së hetimit.

<sup>3</sup> Shihni kapitullin 2.9 të Njoftimit për praktikant më të mira për antitrustin.

<sup>4</sup> Shihni Njoftimin për praktikant më të mira për antitrustin, paragrafi 63, nënparagrafi 1. Takimet e mëtejshme për situatën aktuale do të ofrohen në një fazë mjaftueshëm të avancuar të hetimit, si dhe pas përgjigjes së palëve ndaj Deklaratës së Kundërshtimeve ose pas seancës dëgjimore (shihni Njoftimin për praktikant më të mira për antitrustin, paragrafi 63, nënparagrafi 2 dhe paragrafi 64).

hetimore, aksesit në dosje nuk parashikohet gjatë fazes së hetimit paraprak.

## 11 Njoftimi i Raportit hetimor

### 1. Qëllimi i njoftimit të raportit hetimor

- (1) Sipas nenit 18 të rregullores për procedurat hetimore, Komisioni konstaton se pretendimet e paraqitura nga inspektorët e Sekretariatit, në bazë të të dhënave të mbledhura gjatë hetimit, janë të bazuara, autorizon Sekretariatit që të informojë palët me shkrim mbi pretendimet e ngritur kundër tyre. Raporti i Hetimit duhet t'i vihet në dispozicion secilit prej tyre.
- (2) Sekretariati, kur u dërgon Raportin e Hetimit palëve, duhet të përcaktojë një afat kohor brenda të cilit palët mund të sjellin me shkrim pretendimet e tyre. Komisioni nuk është i detyruar të pranojë pretendimet e paraqitura pas këtij afati të vendosur kohor.
- (3) Palët mund të në paraqitjen e prapësimeve të tyre me shkrim, të përcaktojnë të gjitha pretendimet, të cilat janë të përshtatshme për mbrojtjen e tyre kundrejt pretendimeve të ngritura nga inspektorët e Sekretariatit. Ata duhet të bashkëlidhinçdo dokument përkatës, si prova të pretendimeve të tyre. Ata duhet të japin një kopje origjinale, si dhe një kopje elektronike, ose në rastet kur nuk e posedojnë një kopje elektronike 3 (tre) kopje të pretendimeve të tyre, si dhe dokumenteve bashkëlidhur. Ata mund t'i propozojnë Komisionit që të dëgjojë persona të tjerë që mund të mbështesin pretendimet e tyre.
- (4) Qëllimi i njoftimit të raportit është të informojë palët e prekura rreth kundërshtimeve të ngritura kundër tyre, me qëllim që t'u mundësojë të ushtrojnë të drejtat e tyre për t'u mbrojtur, me shkrim ose në mënyrë verbale (në seancë dëgjimore). Ndërmarrjet përkatëse duhet të pajisen me të gjithë informacionin që ju nevojitet për t'u mbrojtur në mënyrë efektive dhe për të dhënë komente rreth pretendimeve të bëra ndaj tyre.
- (5) Për rrjedhojë, njoftimi i raportit hetimor është një masë mbrojtëse procedurale thelbësore për të garantuar respektimin e të drejtës për t'u dëgjuar në të gjitha procedurat.<sup>5</sup>
- (6) Për sa është e mundur, njoftimi duhet të bëhet kur faza e gjetjes së fakteve konsiderohet e realizuar. Nëse shfaqen elementë të rinj pas këtij njoftimit, mund të jetë e nevojshme që të dërgohet një njoftim plotësues, i cili mund të vonojë në një masë të konsiderueshme përfundimin e hetimit.<sup>6</sup>

---

<sup>5</sup> Çështja C-395/96 P, *CMB e.a./Commission* 2000 [ECR] I-1365, paragrafi 142, referuar Çështjeve të Bashkuara 100/80 deri në 103/80 *Musique Diffusion Française and Others v Commission* [1983] ECR 1825, paragrafët 10 dhe 14.

<sup>6</sup> Çështja C-167/04 P *JCB Service v. Commission*, [2004] ECR II-49, paragrafi 52.

## 2 Aksesit në dosje dhe konfidencialiteti

1.	Hyrje	3
1.1.	Kuadri ligjor	3
1.2.	Kujt i jepet akses në dosje?	3
1.3.	Kush jep akses në dosje?	4
1.4.	Kur jepet akses në dosje?	4
2.	Fushëveprimi i aksesit në dosje	4
2.1.	Përkufizimi i dosjes	4
2.2.	Përkufizimi i dokumenteve të aksesueshme/të paaksesueshme	5
2.2.1.	<i>Dokumentet e brendshme</i>	5
2.2.2.	<i>Informacioni konfidencial</i>	7
2.3.	Objekti i kërkesës për konfidencialitet	8
2.3.1.	<i>Kuadri ligjor</i>	9
2.3.2.	<i>Sekreti profesional</i>	9
2.3.3.	<i>Zbulimi i informacionit konfidencial</i>	9
2.4.	Trajtimi i kërkesave për konfidencialitet	11
2.4.1.	<i>Informimi i kompanive mbi depozitimin e kërkesave për konfidencialitet</i>	11
2.4.2.	<i>Menaxhimi i kërkesave për konfidencialitet</i>	12
3.	Procedura për zbatimin e aksesit në dosje	13
3.1.	Përmbajtja e dosjes	13
3.1.1.	<i>Koha dhe mënyra e përgatitjes së aksesit në dosje</i>	13
3.1.2.	<i>Dokumentet që do të jenë pjesë e dosjes</i>	14
3.2.	Organizimi i aksesit në dosje	14
3.2.1.	<i>Aksesi elektronik në dosje përmes AMÇ-së</i>	14
3.2.2.	<i>Aksesi në dosje për çështjet e lehtësimit nga gjambat</i>	17
3.3.	Ofrimi i aksesit në dosje	18
4.	Trajtimi i aksesit të mëtejshëm në dosje pas lëshimit të Raportit hetimor	19
4.1.	Aksesi në përgjigjet e palëve lidhur me DK-në	19

4.2. Aksesit në dosje në rastin e Deklaratës Plotësuese të Kundërshtimeve (DPK) ose në Letrat e Fakteve	21
<b>5. Situatat specifike</b>	<b>21</b>
5.1. Aksesit në informacion përtej dosjes hetimore të Komisionit	21
5.2. Dokumentet që rezultojnë nga dosjet e çështjeve të ndryshme	22
5.3. Procedura e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (Neni 15 i Rregullores 773/2004): Aksesit në informacionin përkatës	22
5.4. Vendimi për angazhim (Neni 9 i Rregullores 1/2003)	23
5.5. Refuzimi i ankesave: aksesit në informacionin ku Komisioni është bazuar për pikëpamjet (opinionet) paraprahe	23
<b>6. Praktikrat e ndryshme procedurale të aksesit në dosje</b>	<b>23</b>
6.1. Procedura me negociim për qëllime zbulimi	24
6.2. Rregullat për akses në informacione konfidenciale në një bazë të dhënash (data room)	24

## 1. Hyrje

- (1) Aksesimi me dosjet kërkon njohuri ligjore dhe procedurale dhe nënkupton një vlerësim thelbësor të kërkesave për konfidencialitet. Kjo është shpeshherë një detyrë komplekse duke marrë parasysh kontradiktën ndërmjet dy interesave bazë, d.m.th. nga njëra anë, të drejtat e mbrojtjes së palëve që janë objekt hetimi dhe, nga ana tjetër, mbrojtjen e informacionit konfidencial nga autori i dokumentit.
- (2) Përgatitja për akses në dosje është një detyrë e gjatë nga pikëpamja kohore dhe duhet të nisë shumë kohë përpara. Menaxhimi i duhur i aksesit në dosje është një pjesë thelbësore e trajtimit të çështjeve. Personat përgjegjës për trajtimin e çështjeve, organizojnë aksesin në dosje sipas standardeve më të larta.

### 1.1. Kuadri ligjor

- (3) E drejta e palëve për akses në dosje parashikohet në nenin 17 të rregullores për procedurat hetimore.

### 1.2. Kujt i jepet akses në dosje?

- (4) Sipas pikës 1 të nenit 17, palët e përfshira drejtpërdrejtë në procedurat lidhur me nenet 4, 5 dhe 9 të Ligjit kanë të drejtë për akses në çdo dokument të hartuar ose përkohësisht të ruajtur nga Komisioni dhe Sekretariati pas njohjes së tyre me Raportin e Hetimit sipas nenit 18 1. Palët e përfshira drejtpërdrejtë në procedurat lidhur me nenet 4, 5 dhe 9 të Ligjit kanë të drejtë për akses në çdo dokument të hartuar ose përkohësisht të ruajtur nga Komisioni dhe Sekretariati pas njohjes së tyre me Raportin e Hetimit sipas nenit 18 të kësaj Rregulloreje.

### 1.3. Kur jepet akses në dosje?

- (5) E drejta e aksesit duhet të ushtrohet duke paraqitur një kërkesë të arsyetuar me shkrim, sipas të cilës personi përgjegjës i Sekretariatit duhet të veprojnë sipas rastit, brenda 30 ditëve, duke njoftuar kështu dhe Komisionin.

## 2. Fushëveprimi i aksesit në dosje

### 2.1. Përkufizimi i dosjes

- (6) “Dosja e Komisionit” gjatë një hetimi lidhur me konkurrencën përmban të gjitha dokumentet e marra, të përpiluara dhe/ose të mbledhura nga Sekretariati gjatë hetimit që ka rezultuar në ngritjen e kundërshtimeve nga Komisioni. Termi “dokumente” përfshin të gjitha format e mjeteve të informacionit.
- (7) Nuk janë pjesë e dosjes: shënimet, propozimet dhe dokumentet e tjera të hartuar nga Sekretariati ose Komisioni, si pjesë e studimit ose përgatitjes së dokumenteve zyrtare në lidhje me rastin.
- (8) Duhet të merren të gjitha masat paraprake për të mbrojtur identitetin e një informatori që ka shprehur dëshirën të qëndrojë anonim.

## 2.2. Përkufizimi i dokumenteve të aksesueshme/të paaksesueshme

- (9) Sipas parimit të barazisë së palëve, të gjitha dokumentet, qofshin ato prova fajësuese ose shfajësuese dhe informacione të tjera, të cilat janë marrë, përpiluar dhe/ose mbledhur nga Sekretariati në dosjen e hetimore duhet të bëhen të aksesueshme.<sup>7</sup>
- (10) Ekzistojnë vetëm dy përjashtime:
- dokumentet e brendshme institucionale,
  - dokumentet konfidenciale, duke përfshirë sekretet tregtare dhe informacionet e tjera konfidenciale<sup>8</sup>.

### 2.2.1. Dokumentet e brendshme

- (11) Dokumentet e brendshme institucionale nuk mund të jenë as fajësuese dhe as shfajësuese. Ato nuk përbëjnë pjesë të provave ku Komisioni mund të bazojë vlerësimin e një çështjeje. Duke marrë parasysh mungesën e vlerave të tyre dëshmuese, ky kufizim aksesit në dokumentet e brendshme nuk cenon ushtrimin e duhur të së drejtës së palëve për t'u mbrojtur.
- (12) Dokumentet e brendshme janë dokumente të tilla si draftet, opinionet, memorandumet ose shënimet nga Komisioni ose nga Sekretariati, duke përfshirë korrespondencën midis tyre.
- (13) **Procesverbalet e takimeve**, nëse përmbajnë vlerësime të brendshme, konsiderohen si dokumente të brendshme. Sipas praktikës gjyqësore, e drejta e aksesit në dosje nuk parashikon që departamentet e Komisionit të hartojnë procesverbalet e takimeve me asnjë person ose ndërmarrje<sup>9</sup>.
- (14) Sipas Njoftimit për praktikën më të mira për antitrustin<sup>10</sup>, Sekretariati i AK mund të organizojë takime joformale (ose të kryejë telefonata) me palët që janë objekt i procedurave, me ankuesit ose palët e treta gjatë fazës hetimore. Kur mbahet një takim me kërkesë të palëve, ankuesve ose palëve të treta, ata duhet të hartojnë paraprakisht axhendën e propozuar me pikat që do të diskutohen në takim, si dhe një memorandum ose prezantim që i trajton këto pika më me hollësi. Palët, ankuesit ose palët e treta ftohen, pas takimeve ose telefonatave, për të diskutuar mbi çështjet thelbësore dhe për të arsyetuar deklaratat apo parashtrimet e tyre me shkrim. Në varësi të kërkesave për anonimitet, shënimi do të përfshijë ndërmarrjen(t) që kanë marrë pjesë në takim, (ose që kanë marrë pjesë në telefonatën lidhur me çështjet thelbësore), orën dhe temën(at) e trajtuara në takim (ose në telefonatën përkatëse). Drejtoria e Përgjithshme për Konkurrencën, pas një takimi ose kontakti joformal me palët, ankuesit ose palët e treta, mund t'ju kërkojë atyre që të japin informacione me shkrim ose i fton ata që të bëjnë një deklaratë.
- (15) **Kur komisionohen ekspertë të jashtëm** në lidhje me procedurat, korrespondenca

<sup>7</sup> Njoftimi për aksesin në dosje, paragrafi 7-10.

<sup>8</sup> Njoftimi për aksesin në dosje, paragrafi 10.

<sup>9</sup> Çështjet e Bashkuara T-191/98 dhe T-212/98 deri te T-214/98 *Atlantic Container Line and others v Commission* (TACA) [2003] ECR II-3275, paragrafët 349-359.

<sup>10</sup> Njoftimi për praktikën më të mira për antitrustin, paragrafi 42 e në vijim.

ndërmjet Komisionit dhe ekspertit të jashtëm, në parim, përfshin dokumente të brendshme<sup>11</sup>. Këtu përfshihet korrespondenca që përmban vlerësimin e punës së ekspertit, duke përfshirë draft-raportin, ose korrespondenca në lidhje me aspektet financiare të studimit. Si rrjedhojë, kjo korrespondencë do të jetë e paaksesueshme<sup>12</sup>. Megjithatë, mund të aksesohen rezultatet e një studimi të autorizuar në lidhje me procedurat, me qëllimin për t'u përdorur si provë, si dhe dokumentet e nevojshme për të kuptuar metodologjinë e zbatuar gjatë studimit ose për të testuar saktësinë teknike të metodologjisë.

- (16) Një rast tjetër i veçantë i dokumenteve të brendshme është **korrespondenca e AK me autoritetet e tjera ndërkombëtare dhe dokumentet e brendshme të marra nga këto autoritete.**

### 2.2.2. Informacioni konfidencial

- (17) (Informacioni konfidencial përmban sekrete tregtare dhe informacione të tjera konfidenciale. Në bazë të Neni 30 të ligjit, Anëtarët e Komisionit dhe të gjithë punonjësit e Sekretariatit ose personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni për zbatimin e këtij ligji ruajnë sekretin profesional dhe nuk u japin të dhëna konfidenciale, të siguruar gjatë kryerjes së detyrave të tyre, asnjë personi ose institucioni, me përjashtim të rasteve kur duhet të dëshmojnë përpara gjykatës. Kjo vlen dhe pas mbarimit të detyrës.
- (18) Publikimet e Autoritetit nuk duhet të përmbajnë të dhëna që përbëjnë sekret tregtar.
- (19) **Sekretet tregtare** janë informacione konfidenciale për ushtrimin e veprimtarisë së një ndërmarrjeje, zbulimi i të cilave mund të dëmtojë rëndë ndërmarrjen në fjalë.<sup>13</sup> Shembuj të informacioneve që mund të klasifikohen si sekrete tregtare përfshijnë: informacionin teknik dhe/ose financiar lidhur me ekspertizën e një ndërmarrjeje, metodat e vlerësimit të kostos, sekretet dhe proceset e prodhimit, burimet e furnizimit, sasitë e prodhuara dhe të shitura, pjesën e tregut, listat e distributorëve dhe klientëve, planet e marketingut, strukturën e kostove dhe çmimit dhe strategjinë e shitjeve.<sup>14</sup>
- (20) **Informacionet e tjera konfidenciale** janë informacione të ndryshme nga sekretet tregtare, për sa kohë që zbulimi i tyre do të dëmtonte rëndë një person ose ndërmarrje.<sup>15</sup> Në varësi të rrethanave specifike të secilës çështje, kjo mund të zbatohet për informacionin e ofruar nga palë të treta rreth ndërmarrjeve, që mund të vendosë në situatë shumë të vështirë ekonomike ose tregtare konkurrentët e tyre ose partnerët tregtarë, si

<sup>11</sup> Shihni paragrafin 21 të Raportit Vjetor 2005, në seksionin Njoftimi i ri për aksesin në dosje.

<sup>12</sup> Shihni paragrafin 14 të Njoftimit për aksesin në dosje dhe Çështjen T-210/01 *General Electric v Commission* [2005] ECR II-5575: Duke iu referuar raportit të profesor Choi-t, që përbënte bazën e teorisë së Komisionit për paketat e produkteve, Gjykata vuri re se refuzimi i Komisionit, i bazuar në një kërkesë për konfidencialitet nga Rolls-Royce, për të dhënë akses në të dhënat ku bazohej modeli i Choi-t nuk kishte ndikim në rezultatin e procedurës administrative. Gjykata konstatoi se Komisioni ka të drejtë të kërkojë opinione të ndryshme, duke përfshirë opinionet e ekspertëve të jashtëm, për të kontrolluar saktësinë e analizës. Kur Komisioni nuk bazohet në opinionin e një eksperti të jashtëm në DK-në dhe në vendimin e tij përfundimtar si provë që mbështet çështjen e tij kundër një ndërmarrjeje, opinioni mbetet thjesht një pikëpamje e shprehur nga një person i vetëm dhe nuk merr rëndësi të veçantë në kontekstin e procedurës administrative. Rrjedhimisht, edhe pse është shprehur nga një ekspert, kjo pikëpamje nuk mund të konsiderohet as dëshmi favorizuese dhe as jofavorizuese (paragrafi 671). Nëse dokumentet në fjalë do të konsideroheshin pjesë përbërëse e dosjes reale të Komisionit, ato do të klasifikoheshin si dokumente të brendshme, duke marrë parasysh statusin dhe përmbajtjen e tyre dhe rrjedhimisht aplikanti nuk do të kishte akses në to (paragrafi 672).

<sup>13</sup> Çështja T-353/94, *Postbank NV v Commission*, datë 18.9.1996, paragrafi 87.

<sup>14</sup> Njoftimi për aksesin në dosje, paragrafi 18.

<sup>15</sup> Njoftimi për aksesin në dosje, paragrafi 20, përfshin sekretet shprehimisht ushtarake në kategorinë e informacioneve të tjera konfidenciale.

dhe klientët apo furnitorët e tyre. Gjykata me juridiksionin përkatës dhe Gjykata e Drejtësisë kanë pranuar se është e ligjshme që këtyre ndërmarrjeve t'u refuzohet zbulimi i disa letrave të marra nga klientët e tyre, sepse në të kundërt dërguesit mund të zbulohen lehtësisht dhe të përballen me rrezikun e masave hakmarrëse<sup>16</sup>. Për këtë arsye, nocioni i informacioneve të tjera konfidenciale mund të përfshijë informacione që do të bënin të mundur që palët të identifikonin ankuesit ose palët e treta të tjera, kur ato kanë një dëshirë të arsyetuar për të mbetur anonimë.<sup>17</sup>

(21) Për ta ilustruar, zakonisht Komisioni nuk i konsideron llojet e mëposhtme të informacionit si sekrete tregtare ose informacione të tjera konfidenciale:

- të dhënat nga ose rreth një kompanie tjetër (si p.sh. njoftimet e çmimeve, të dhënat e shitjeve etj., të ndryshme nga ato që merren në zbatim të një kontrate me atë kompani), përveçse kur është kërkuar konfidencialitet (p.sh., për të parandaluar zbulimin e përmbajtjes së atij informacioni);
- informacioni i zbuluar jashtë kompanisë përkatëse (si për shembull objektivat e çmimeve, rritjet, datat e zbatimit dhe emrat e klientëve, nëse janë zbuluar për palë të treta);
- faktet lidhur me një aplikim për imunitet ose reduktim të gjobave, kur këto fakte synojnë të ofrojnë prova për një shkelje të pretenduar, përveçse kur zbulimi i këtyre fakteve mund të dëmtojë politikën e Komisionit për lehtësimin nga gjobat;
- emrat dhe pozicionet e punëmarrësve ose personave të tjerë të përfshirë në një shkelje.

(32) Sekretet tregtare dhe dokumentet e tjera konfidenciale nuk konsiderohen më konfidenciale nëse:

- janë ndërkohë të zbuluara jashtë kompanisë ose
- e kanë humbur rëndësinë e tyre tregtare, për shembull, për shkak se ka kaluar kohë (si rregull i përgjithshëm, informacionet e lidhura me xhiron, shitjet, të dhënat për pjesën e tregut dhe të ngjashme, nëse datojnë më shumë se 5 vjet më parë, nuk quhen më konfidenciale).<sup>18</sup>

(33) **Korrespondenca lidhur me konfidencialitetin** për dhënien e konfidencialitetit (duke përfshirë të dhënat e përgjithshme të emailit etj.) është kaq ngushtësisht e ndërlidhur me çështjen e konfidencialitetit, saqë zakonisht nuk duhet t'i zbulohet palëve. Është e rekomandueshme të specifikohet qartësisht në indeksin e dosjes se dokumenti përmban “korrespondencën e kërkesave për konfidencialitet”, në mënyrë që palët ta kuptojnë përse dokumenti nuk është i aksesueshëm.

---

<sup>16</sup> Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ka dhënë mendimin e saj për këtë çështje në rastet e pretendimeve për abuzim të një pozite dominuese (Neni 102 i TFBE-së) (Çështja T-65/89, *BPB Industries and British Gypsum* [1993] ECR II-389; dhe Çështja C-310/93P, *BPB Industries and British Gypsum* [1995] ECR I-865), dhe në çështjet e bashkimeve (Çështja T- 221/95 *Endemol v Commission* [1999] ECR II-1299, paragrafi 69 dhe Çështja T-5/02 *TetraLaval v Commission* [2002] ECR II-4381, paragrafi 98 e në vijim).

<sup>17</sup> Njoftimi për aksesin në dosje, paragrafi 19-20.

<sup>18</sup> Njoftimi për aksesin në dosje, paragrafi 23.

## 2.3. Objekti i kërkesës për konfidencialitet

- (34) Informacioni do të klasifikohet si konfidencial kur ofruesi i informacionit e ka arsyetuar kërkesën e tij për konfidencialitet dhe ka ofruar një version jokonfidencial që është pranuar përkohësisht nga Komisioni.
- (35) Trajtimi i kërkesave për konfidencialitet gjeneron një ngarkesë pune të konsiderueshme dhe grupet e punës të ngarkuara me çështjen duhet t'i menaxhojnë ato sa më parë të jetë e mundur. Këto kërkesa duhen zgjidhur përpara komunikimit të raportit hetimor dhe dhënies së aksesit në dosje.

### 2.3.1. Sekretit profesional

- (36) Sipas Gjykatës së Përgjithshme<sup>19</sup>, në mënyrë që informacioni të përfshihet në detyrimin e ruajtjes së sekretit profesional, duhet të:
- zbulohet vetëm për një numër të kufizuar personash,
  - nëse zbulohet, mund të shkaktojë dëm serioz ndaj personit që e ka ofruar atë ose ndaj palëve të treta dhe
  - nëse zbulohet, interesat që mund të dëmtohen si pasojë e zbulimit, mbi baza të arsyeshme, duhet të gëzojnë mbrojtje.

Gjykata me juridiksionin përkatës ka pohuar se koncepti i sekretit profesional është më i gjerë se ai i sekretit tregtar dhe rrjedhimisht, dokumentet e mbrojtura nga parimi i ruajtjes së sekretit profesional mund të zbulohen kur jepet akses në dosje për qëllime të të drejtave për t'u mbrojtur, me kusht që të mos përmbajnë sekrete tregtare<sup>20</sup>.

### 2.3.2. Zbulimi i informacionit konfidencial

- (37) Klasifikimi i përkohshëm i një informacioni si konfidencial nuk përbën pengesë për zbulimin e tij, nëse ky informacion është i domosdoshëm për të provuar një shkelje të pretenduar (“provë fajësuese”) ose mund të jetë i nevojshëm për të shfajësuar një palë (“provë shfajësuese”).<sup>21</sup>
- (38) Në këtë rast, nevoja për të garantuar të drejtat e palëve për t'u mbrojtur duke ofruar nivelin më të lartë të mundshëm të aksesit në dosjen e Komisionit mund të mbizotërojë mbi detyrimin për të mbrojtur informacionin konfidencial të palëve të tjera.<sup>22</sup>
- (43) **Vlerësimi i zbulimit:** Komisioni vlerëson nëse nevoja për të provuar një shkelje ose e drejta e palëve për t'u mbrojtur mund të mbizotërojë mbi mbrojtjen e konfidencialitetit, në situata specifike. Grupi i punës i ngarkuar me çështjen duhet ta bëjë këtë vlerësim sa më parë të jetë e mundur. **Faktorët e mëposhtëm, edhe nëse janë potencialisht kontradiktorë, mund të kenë**

<sup>19</sup> Çështja T-198/03 *Bank Austria Creditanstalt AG v Commission* [2006] ECR II-1429, paragrafi 71; edhe Çështja T-474/04, *Pergan v Commission* [2007] ECR II-4225, paragrafi 65 e në vijim.

<sup>20</sup> Çështja T-198/03 *Bank Austria Creditanstalt AG v Commission*, paragrafi 29.

<sup>21</sup> Shihni nenin 27, paragrafi 2 të Rregullores 1/2003; Nenin 15, paragrafi 3 të Rregullores 773/2004, Njoftimi për aksesin në dosje, paragrafi 24.

<sup>22</sup> Çështja T-30/91 *Solvay v Commission* [1995] ECR II-1775, paragrafi 81: "Në procedurat ku parashikohet mbrojtje sipas Rregullores nr. 17, Komisioni nuk është autoriteti i vetëm që përcakton se cilat dokumente janë të vlefshme për mbrojtjen. Komisioni duhet t'u japë mundësinë këshilltarëve të ndërmarrjeve të prekura për të shqyrtuar dokumentet që mund të jenë me rëndësi, në mënyrë që të përcaktohet vlera e tyre provuese për mbrojtjen." 35

### **ndikim:**

- rëndësia e informacionit për të përcaktuar nëse është kryer një shkelje apo jo, si dhe vlera e tij provuese;
- domosdoshmëria e informacionit;
- niveli përkatës i ndjeshmërisë (në çfarë mase do të dëmtoheshin interesat e personit ose ndërmarrjes në fjalë nga zbulimi i informacionit)
- opinioni paraprak për seriozitetin e shkeljes së pretenduar.

Duhet të merret në konsideratë interesi publik për të provuar një shkelje të ligjit për konkurrencën, interesi që kanë palët për disponueshmërinë e informacioneve shfajësuese në dosje për përgatitjen e mbrojtjes së tyre dhe interesi i ofruesve të informacionit për mbrojtjen e informacionit konfidencial. Interesi i këtyre të fundit varet nga dëmi që zbulimi mund të shkaktojë ndaj çështjes individuale. Për shembull, nëse informacioni do t'u jepet kompanive me pozitë dominuese në treg, duhet marrë në konsideratë edhe rreziku për hakmarrje ndaj ofruesve të informacionit.<sup>23</sup> Informacioni i ofruar nga individë që kërkojnë konfidencialitet/anonimitet duhet të trajtohet me kujdesin maksimal.

- (44) Udhëzime praktike: Grupi i ngarkuar me çështjen mund të zgjedhë që t'u japë ofruesve të informacionit një version paraprak jokonfidencial të dokumenteve të tyre. Megjithatë, në varësi të karakteristikave të çështjes individuale, mund të jetë e vlefshme që të sheshohen konfliktet e interesit për të zbuluar informacionin konfidencial (vetëm) pjesërisht ose në mënyrë anonime.<sup>24</sup>

### **Komisioni mund:**

- Të përdorë informacione të marra në mënyrë jokonfidenciale ose anonime kundër marrësit të vendimit përfundimtar. Sipas praktikës gjyqësore<sup>25</sup>, Komisioni gëzon të drejtën që, në vendimin përfundimtar, të përdorë informacione konfidenciale të marra vetëm në mënyrë jokonfidenciale ose anonime. Gjykata me juridiksionin përkatës ka deklaruar se Komisioni mund të përdorë një element prove edhe nëse nuk e zbulon identitetin e informatorit për marrësin e Raportit hetimor.
- Të detyrojë ofruesit e informacionit që të zbulojnë (pjesërisht) informacionin që do të përdoret në vendimin përfundimtar ose që mund të ketë fuqi shfajësuese. Natyra konfidenciale e një dokumenti nuk përbën pengesë për zbulimin në të tilla raste. Komisionit i lejohet që të zbulojë dhe përdorë informacionin e nevojshëm për të provuar një shkelje.
- Shumë mosmarrëveshje mund të evitohen nëse palëve iu bëhet e qartë se pranimi ose refuzimi i një kërkesë për konfidencialitet bëhet me qëllimin e krijimit të Raportit Hetimor dhe nuk përjashton në asnjë mënyrë vlerësimin e mëvonshëm të konfidencialitetit të informacionit në versionin publik të vendimit që do të publikohet në internet.

<sup>23</sup> Çështja T-65/89 *BPB Industries and British Gypsum* [1993] ECR II-389; Çështja C-310/93 P *BPB Industries and British Gypsum* [1995] ECR I-865.

<sup>24</sup> Kjo duhet të bëhet nëse është realisht e pamundur që kompanitë, të cilave u jepet informacioni, të identifikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ofruesin e informacionit. Kjo varet nga rrethanat e secilës çështje.

<sup>25</sup> Çështja T-44/00, *Mannesmann Röhrenwerke* [2004] ECR II-2223, paragrafi 84.

## **2.4. Trajtimi i kërkesave për konfidencialitet**

### **2.4.1. Informimi i kompanive mbi depozitimin e kërkesave për konfidencialitet**

- (45) Grupi i Punës i ngarkuar me çështjen i kërkon rregullisht ofruesit të informacionit një version jokonfidencial të dokumenteve origjinale, kur kërkon ose merr informacion, kur merr ankesa, përgjigje, gjatë seancave dëgjimore etj.
- (46) Pas inspektimeve dhe dorëzimit të pakërkuar të informacionit, Grupi i Punës i ngarkuar me çështjen duhet të sqarojë se cilat dokumente mund të kthehen, pasi nuk lidhen objektivisht me hetimin dhe kërkon menjëherë statusin e konfidencialitetit për dokumentet e mbetura, duke i dërguar një letër palëve në të cilën iu kërkon një version jokonfidencial të këtyre dokumenteve, bashkëngjitur dërgesës duke i kopjuar ato në një CD-ROM, sipas rastit.
- Grupi i Punës i ngarkuar me çështjen mund/do t'i kërkojë ofruesit të informacionit të japë versionet paraprake jokonfidenciale të dokumenteve, në të cilat ofruesi duhet fillimisht të theksojë vetëm informacionin që konsiderohet konfidencial ose sekret tregtar, në mënyrë që të mund të lexohet.
  - Më pas, informacioni i konsideruar konfidencial nga ofruesi i informacionit mund të identifikohet lehtësisht nga Grupi i Punës i ngarkuar me çështjen. Teksti i theksuar së bashku me tabelën e kërkesave për konfidencialitet, ku jepet arsyeja e kërkesës për konfidencialitet dhe, nëse është e nevojshme, një përmbledhje jokonfidenciale e informacionit konfidencial, do të përbëjë bazën e diskutimeve për trajtimin e përmbajtjes.
  - Menjëherë pasi Grupi i Punës i ngarkuar me çështjen nis përgatitjen e aksesit në dosje, ai do të vlerësojë kërkesat për trajtim konfidencial dhe do të shqyrtojë siç duhet dokumentet e dorëzuara.
  - Sapo të pranohen kërkesat për konfidencialitet, Grupi i Punës i ngarkuar me çështjen kërkon hartimin e një versioni përfundimtar të dokumentit, nga i cili janë fshirë informacionet konfidenciale (duke përfshirë shtojcat).
  - Në përgjithësi, konfidencialiteti nuk mund të kërkohej për të gjithë dokumentin ose për seksione të plota të tij, pasi zakonisht informacioni konfidencial mund të mbrohet me censurime të kufizuara.
  - Dokumenti jokonfidencial duhet të mbahet në të njëjtin format si versioni origjinal. Pra, nëse ofruesi i informacionit kërkon konfidencialitet vetëm për disa pjesë të dokumentit, ofruesi duhet të mundësojë një version jokonfidencial të aksesueshëm të TË GJITHË dokumentit, d.m.th. nëse është dorëzuar një dokument me pesë faqe, versioni jokonfidencial i atij dokumenti duhet të përmbajë 5 faqe gjithashtu. Titujt e dokumenteve dhe/ose titujt e kolonave nuk duhet të censurohen, ndërsa kolonat ose hapësirat në tabela dhe/ose figura nuk duhet të lihen bosh.
- (47) Nëse ofruesit e informacionit nuk përgjigjen ose nuk arrijnë të respektojnë dispozitat që parashikojnë mënyrën e dorëzimit të kërkesave për konfidencialitet (në veçanti detyrimin për të justifikuar siç duhet kërkesën dhe për të dorëzuar një përmbledhje kuptimplotë për informacionin e censuruar), Komisioni mund të supozojë se dokumentet ose deklaratat në fjalë nuk përmbajnë informacion konfidencial dhe se ndërmarrja nuk ka kundërshtime ndaj zbulimit të dokumenteve ose deklaratave përkatëse në tërësi. 37

## 2.4.2. Menaxhimi i kërkesave për konfidencialitet

- (48) Është e rekomandueshme që të zgjidhen të gjitha mosmarrëveshjet mbi kërkesat për konfidencialitet përpara dërgimit të Raportit Hetimor pranë palëve, në mënyrë që të garantohet aksesimi i plotë në dosje.
- (49) Në praktikë, Grupi i Punës i ngarkuar me çështjen zakonisht përpiqet që fillimisht të zgjidhë çështjet e kërkesave të pajustificuara për konfidencialitet, në mënyrë joformale me ofruesin e informacionit. Drejtoria e Përgjithshme për Konkurrencën informon me shkrim ofruesin e informacionit se
- do t'i pranojë përkohësisht kërkesat që janë në dukje të arsyetuara. Në çdo rast, ofruesi i informacionit duhet të ketë parasysh të drejtën e Komisionit për të rishqyrtuar vlerësimin e tij fillestar në një fazë të mëvonshme të trajtimit të çështjes<sup>26</sup>, ose
  - nuk e pranon tërësisht ose pjesërisht kërkesën për konfidencialitet, jep arsye për qëllimin e zbulimit të këtij informacioni dhe cakton një afat kohor brenda të cilit ofruesi i informacionit mund të informojë me shkrim Komisionin për pikëpamjet e tij.
- (50) Nëse, pas dorëzimit të pikëpamjeve të ofruesit të informacionit, mosmarrëveshja mbi kërkesën për konfidencialitet vazhdon, AK do të informojë me shkrim kompaninë përkatëse se informacioni i tyre do të zbulohet, me përjashtim të rastit kur një kërkesë e arsyetuar për konfidencialitet është depozituar pranë kryetarit të seancës dëgjimore brenda një afati të caktuar. Kjo letër duhet të dërgohet së bashku me konfirmimin e marrjes, ndërsa një kopje i dorëzohet kryetarit të seancës dëgjimore.

## 3. Procedura për zbatimin e aksesit në dosje

### 3.1. Përmbajtja e dosjes

- (51) Përgatitja e aksesit në dosje dhe përpunimi i kërkesave për konfidencialitet që rrjedhin nga kjo përgatitje gjenerojnë ngarkesë të konsiderueshme pune dhe kërkojnë personel të mjaftueshëm dhe planifikim realist.

#### 3.1.1. Koha dhe mënyra e përgatitjes së aksesit në dosje

- (52) Personat e ngarkuar me çështjen duhet të nisin përgatitjen sa më parë të jetë e mundur.
- (53) Në momentin e përgatitjes së Raportit Hetimor, klasifikimi i dokumentave si pjesë ose jo të dosjes hetimore e cila do të njihen palët duhet të **verifikohet** për të gjitha dokumentet. Kjo është e nevojshme për të reduktuar rreziqet e zbulimit të paqëllimshëm të dokumenteve të paaksesueshme, si dhe për të reduktuar rreziqet e mosrespektimit të të drejtave për t'u mbrojtur (duhet garantuar aksesimi i të gjitha dokumenteve që vërtetojnë shkeljen ose shfaqësimin).

#### 3.1.2. Dokumentet që do të jenë pjesë e dosjes

- (54) Përgatitja për aksesin në dosje përfshin:

---

<sup>26</sup> Duhet të mbahet parasysh se Njoftimi për akses në dosje parashikon shprehimisht mundësinë e pranimit të përkohshëm të kërkesave të arsyetuara për konfidencialitet, të shoqëruara me versionet jokonfidenciale, ndërkohë që rezervon dhe mundësinë për të revokuar pranimin e përkohshëm në një fazë të mëvonshme (shihni paragrafin 42 të Njoftimit për aksesin në dosje).

- Dokumentet, të cilat pas shqyrtimit nuk lidhen objektivisht me hetimin ose nuk i përgjigjen pyetjes së bërë në një kërkesë për informacion, mund të **hiqen**.
- **Disa versione** të të njëjtit dokument, të dërguara me email, faks, postë standarde etj., ngarkohen nga Njësia e protokollit elektronik në dosjen e çështjes dhe mund të fshihen nga Grupi i Punës i ngarkuar me çështjen vetëm në rast se dokumentet janë identike. Këto dokumente fshihen me arsyetimin: “kopje e IDxxx”. Në parim, hyrjet dhe skanimi i të dhënave i kryer nga Njësia e protokollit elektronik duhet të kontrollohen vazhdimisht nga kjo e fundit dhe Grupi i Punës i ngarkuar me çështjen. Versionet e papërfunduara, jokonfidenciale të të njëjtit dokument duhen shmangur. Mbani të aksesueshëm vetëm versionin përfundimtar dhe shënoni versionet e mëparshme si të paaksesueshme.
- **Versionet jokonfidenciale** duhet t'u kërkojnë rregullisht ofruesve të informacionit dhe duhet të vendosen në dosje (shihni seksionin 2.4.1 më sipër “Informimi i kompanive mbi depozitimin e kërkesave për konfidencialitet”).

### 3.2. Organizimi i aksesit në dosje

(55) Aksesit në dosje duhet të përgatitet si në vijim:

- Dosja, d.m.th. **dosja e çështjes që mbahet nga Njësia e protokollit**, duhet të jetë e plotë. Dokumentet që merren drejtpërdrejt nga Grupi i Punës i ngarkuar me çështjen duhet të dërgohen menjëherë pranë Njesisë së protokollit për regjistrim.
- **Për çdo dokument të paaksesueshëm** (përveç dokumenteve të brendshme), duhet të vihet në dispozicion një version i aksesueshëm, ose, kur nuk është e mundur, duhet të ofrohet një përshkrim i përmbledhur. Kjo e dhënë i mundëson palëve të kuptojnë natyrën e dokumentit dhe bën të mundur që ato të paraqesin argumentet e tyre se përse dokumenti duhet të zbulohet pavarësisht karakterit të tij konfidencial.
- **Për “dokumentet e brendshme”**, nuk ofrohet një përshkrim i dokumentit. Dokumenti përshkruhet thjesht si “dokument i brendshëm”.

(56) Indeksi i dokumenteve nuk është një inventar i dokumenteve të dosjes por ka për qëllim t'u mundësojë palëve që të kuptojnë lidhjen ndërmjet versioneve konfidenciale dhe jokonfidenciale të një dokumenti ose, në rastin e një dokumenti plotësisht të paaksesueshëm, për të dhënë një përshkrim të shkurtër, në mënyrë që ata të vlerësojnë nëse është e përshtatshme që të kërkojnë akses në disa dokumente të caktuara, të cilat mund të jenë të dobishme për mbrojtjen e tyre<sup>27</sup>.

### 3.3. Ofrimi i aksesit në dosje

(57) Palëve iu jepet akses në dosje pas njoftimit të Raportit Hetimor.<sup>28</sup>

- **Në letrën shoqëruese, palët zakonisht informohen** se nëse dëshirojnë të kenë akses në dosje, ato duhet të bëjnë një kërkesë me shkrim, në mënyrë që të marrin një kopje të dokumenteve të raportit hetimor dhe të njihet me provat në të cilat raporti hetimor është mbështetur.

(73) Palët (ose avokati i mandatuar siç duhet) duhet të **nënshkruajnë një procesverbal ku listohen**

<sup>27</sup> Shihni Çështjen C-110/10 P *Solvay v Commission* [1995] ECR II-1775, paragrafi 66.

<sup>28</sup> Neni 15, paragrafi 1 i Rregullores 773/2004 dhe paragrafët 26 dhe 27 të Njoftimit për aksesin në dosje.

## **dokumentat.**

- (74) Nëse një palë nuk dëshiron të marrë CD-ROM/DVD-në me dosjen, mund të planifikohet një formë alternative aksesi.

### **3.2. Refuzimi i ankesave: aksesi në informacionin ku Komisioni është bazuar për pikëpamjet (opinionet) paraprahe**

- (75) Gjykata e Përgjithshme ka vendosur<sup>29</sup> se ankuesit nuk kanë të njëjtat të drejta dhe garanci si palët nën hetim. Për këtë arsye, ankuesit nuk mund të pretendojnë të drejtën e aksesit në dosje me të njëjtat kushte si palët nën hetim.
- (76) Megjithatë, ankuesi ka të drejtë aksesi në informacionin ku Komisioni e ka bazuar opinionin paraprahe, që parashtrohet në letrën për refuzimin e ankesës<sup>30</sup>.
- (77) Ankuesit nuk kanë të drejtë aksesi në sekretet tregtare ose në informacione të tjera konfidenciale, të cilat Komisioni i ka marrë gjatë hetimit.
- (78) Në njoftimin për ankesat<sup>31</sup> shpjegohet se aksesi në informacionin ku Komisioni e ka bazuar refuzimin e tij, zakonisht do të jepet duke i bashkëngjitur letrës një kopje të dokumentacionit përkatës<sup>32</sup>.

---

<sup>29</sup> Shihni çështjen T-17/93 *Matra-Hachette SA v Commission* [1994] ECR II-595, paragrafi 34. Gjykata vendosi se të drejtat e palëve të treta, siç parashikohen nga neni 19 i Rregullores nr. 17 (tashmë zëvendësuar nga neni 27 i Rregullores (KE) nr. 1/2003), ishin të kufizuara në të drejtën për të marrë pjesë në procedurën administrative.

<sup>30</sup> Neni 8, paragrafi 1 i Rregullores 773/2004.

<sup>31</sup> Njoftimi i Komisionit "Për trajtimin e ankesave nga Komisioni sipas neneve 81 dhe 82 të Traktatit të KE-së", Gazeta Zyrtare C 101, 27.4.2004, f. 65

<sup>32</sup> Njoftimi për ankesat, paragrafi 69.

# 13 E drejta për t'u dëgjuar

---

1.	Hyrje	2
2.	Faza me shkrim: përgjigja lidhur me DK-në	2
2.1.	Ndërmarrjet dhe personat e tjerë që mund të paraqesin konstatimet e tyre mbi Deklaratën e Kundërshtimeve (DK)	2
2.1.1.	<i>"Palët e përfshira" kanë të drejtë të dëgohen</i>	2
2.1.2.	<i>"Ankuesit" mund të paraqesin me shkrim pikëpamjet e tyre</i>	2
2.1.3.	<i>Palët e treta mund të dëgohen vetëm nëse shfaqin " interes të mjaftueshëm" (Neni 27, paragrafi 3 i Rregullores 1/2003)</i>	3
2.2.	Afatet kohore dhe shtyrja	4
2.3.	Identifikimi dhe mbrojtja e informacionit konfidencial të përgjigjeve	5
2.4.	Shpërndarja e përgjigjeve të palëve	5
2.4.1.	<i>Shërbimet e Komisionit dhe shtetet anëtare</i>	5
2.4.2.	<i>Palët, palët e treta dhe ankesat</i>	6
3.	Seanca dëgjimore	6
3.1.	Dispozitat ligjore	6
3.2.	Seanca dëgjimore – Organizimi	7
3.3.	Përfaqësimi në seancën dëgjimore	7
3.4.	Zyrtarët dhe shtetet anëtare	7
3.5.	Përgatitja e seancës dëgjimore	8
3.5.1.	<i>Informacioni që do t'i jepet kryetarit të seancës dëgjimore</i>	8
3.5.2.	<i>Hapat përgatitorë</i>	8
3.6.	Procedura në seancën dëgjimore	9
3.7.	Regjistrimi i seancës dëgjimore	9
4.	Takimi për situatën aktuale	9
5.	Raportet e kryetarit të seancave dëgjimore	10
5.1.1.	<i>Raporti i ndërmjetëm dhe konstatimet</i>	10
5.1.2.	<i>Raporti përfundimtar</i>	10
6.	Marrëdhëniet me kryetarin e seancës dëgjimore në procedurat për angazhimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për kartelet 11	

## **1. Hyrje**

- (1) Neni 19 i Rregullores për procedurat hetimore parashikon shprehimisht se ndërmarrjeve duhet t'u jepet mundësia për t'u dëgjuar. Procedurat konsistojnë në fazën verbale dhe atë me shkrim (përgjigja lidhur me raportin hetimor). Faza verbale, e quajtur seanca dëgjimore, e cila plotëson procedurën në formë të shkruar, rregullohet përmes nenit 21 të rregullores.

## **2. Faza me shkrim: përgjigja lidhur me raportin hetimor.**

### **2.1. Ndërmarrjet dhe personat e tjerë që mund të paraqesin konstatimet e tyre mbi Deklaratën e Kundërshtimeve (DK)**

#### **2.1.1. "Palët e përfshira" kanë të drejtë të dëgjoen**

- (1) Neni 19 i rregullores parashikon se “Komisioni (në zbatim të nenit 39 të Ligjit), duhet t'u japë palëve, tek të cilat Sekretariati ka dërguar Raportin e Hetimit, në bazë të nenit 18 të kësaj Rregulloreje, mundësinë për t'u dëgjuar para se të merret një vendim.”

#### **2.1.2. "Ankuesit" mund të paraqesin me shkrim pikëpamjet e tyre**

- (2) Komisioni në vendimet e tij shprehet vetëm mbi pretendimet për të cilat palët, referuar pikës (1) të këtij neni u është dhëna e drejta për t'u dëgjuar. Komisioni u jep palëve, tek të cilat është dërguar Raporti i Hetimit nga Sekretariati, mundësinë për të paraqitur argumentet e tyre në një seancë dëgjimore verbale, nëse kjo është kërkuar në prapësimet e tyre me shkrim.

#### **2.1.3. Palët e treta mund të dëgjoen vetëm nëse shfaqin “interes të mjaftueshëm”**

- (3) Neni 20 i rregullores për procedurat hetimore parashikon dëgjimin e palëve të tjera
- (4) Nëse personat fizik dhe juridik, përveç palëve të cilave i drejtohet Raporti i Hetimit, ose ankuesi, kërkojnë të dëgjoen dhe që kanë interes të ligjshëm, atëherë Komisioni mund t'i kërkojë Sekretariatit informimin e tyre me shkrim për natyrën dhe objektin e hetimit. Sekretariati cakton një afat kohor brenda të cilit ata mund të paraqesin argumentet e tyre me shkrim.
- (5) Komisioni, kur është e nevojshme, mund t'i kërkojë Sekretariatit të ftojë personat sipas pikës (1) më sipër, të sjellin argumentet e tyre në seancën dëgjimore të palëve, të cilave u është dërguar Raporti i Hetimit, nëse këta persona e kërkojnë këtë me shkrim.
- (6) Komisioni mund të kërkojë nga Sekretariati që të ftojë çdo person tjetër për të shprehur pikëpamjet e tij në formë të shkruar dhe për të marrë pjesë në seancën dëgjimore të palëve, të cilave u është dërguar Raporti i Hetimit. Komisioni gjithashtu mund t'i kërkojë Sekretariatit të ftojë personat e përmendur në pikën (1) të këtij neni, që të shprehin pretendimet e tyre në këtë seancë.

### **3. Seanca dëgjimore**

#### **3.1. Dispozitat ligjore**

- (7) Neni 21 i rregullores për procedurat hetimore parashikon organizimin e seancave dëgjimore. Komisioni fton personat që do të dëgjojnë, për të marrë pjesë në seancën dëgjimore, në datën e caktuar prej tij.

#### **3.2. Seanca dëgjimore – Organizimi**

- (8) Para seancës dëgjimore, Sekretariati është përgjegjës për hartimin e axhendës së seancës dëgjimore, e cila miratohet nga Komisioni dhe që në vijim i dërgohet palëve pjesëmarrëse për komente dhe sugjerime nga ana e tyre.
- (9) Personat e ftuar të marrin pjesë mund të paraqiten personalisht, ose të përfaqësohen nga përfaqësuesit e tyre ligjor, ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.
- (10) Ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve mund të përfaqësohen nga një person i autorizuar. Personat që do të dëgohen nga Komisioni mund të asistohen nga avokatët e tyre apo dhe persona të tjerë të kualifikuar, të cilët pranohen nga Komisioni.

#### **3.3. Përfaqësimi në seancën dëgjimore**

- (11) Personat e ftuar për të marrë pjesë duhet të paraqiten personalisht ose të përfaqësohen nga përfaqësuesit ligjorë (p.sh. anëtarët e bordit) ose nga përfaqësues statutorë.
- (12) Komisioni mund të ftojë edhe persona të tjerë për të shprehur pikëpamjet e tyre në seancën dëgjimore.

#### **3.6. Procedura në seancën dëgjimore**

- (13) Seanca dëgjimore nuk është publike. Çdo person mund të dëgjohet veçmas ose në praninë e personave të tjerë të pjesëmarrës në seancë, duke pasur parasysh interesin e ligjshëm të ndërmarrjeve për mbrojtjen e sekreteve të tyre tregtare dhe informacione të tjera konfidenciale.
- (14) Komisioni mund t'u lejojë palëve, të cilave u është dërguar Raporti i Hetimit, ankuesve, si dhe personave të tjerë pjesëmarrës në seancë dëgjimore, si dhe inspektorëve të Sekretariatit, të bëjnë pyetje gjatë seancës.

#### **3.7. Regjistrimi i seancës dëgjimore**

- (15) Deklarimet e dhëna nga çdo person duhet të regjistrohen. Sipas kërkesës, regjistrimi i seancës dëgjimore vihet në dispozicion të personave të cilët marrin pjesë në seancë, duke mbrojtur interesin e ligjshëm të palëve, sekretet e tyre biznesit dhe informacione të tjera konfidenciale të palëve.

## **14 Miratimi i një vendimi sipas neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003**

1. Mbledhjet e Komisionit të Konkurrencës
2. Marrja e vendimeve
3. Procesi pas miratimit

*3.1 Arsyetimi i vendimit*

*3.2 Forma e vendimit*

*3.3 Publikimi i vendimit*

## **1. Mbledhjet e Komisionit të Konkurrencës**

- (1) Mbledhjet thirren nga Kryetari i Komisionit i cili vendos për datën dhe orën e mbledhjeve. Në rast të ndryshimit të datës dhe orës së mbledhjes, Anëtarët e Komisionit njoftohen menjëherë, për çdo ndryshim.
- (2) Si rregull mbledhjet e Komisionit të Konkurrencës zhvillohen 1 herë në javë, përveç rasteve kur Komisioni me shumicë votash vendos ndryshe. Kryetari vendos për rendin e ditës të çdo mbledhje. Rendi i ditës i shpërndalet Anëtarëve të Komisionit 7 ditë kalendarike para datës së mbledhjes.
- (3) Në rast nevojë, Kryetari mund të thërrasë Mbledhje të Jashtëzakonshme kur kjo përligjet nga ngarkesa e punëve të krijuar në Komision, dhe emergjenca e çështjeve për shqyrtim, në këtë rast procedura konsiderohet e rregullt nëse në mbledhje marrin pjesë shumica e nevojshme e Anëtarëve të Komisionit.
- (4) Në mbledhjet e Komisionit mund të marrin pjesë Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i Drejtorisë përkatëse të Sekretariatit, në rast nevojë apo për sqarime të mëtejshme mund të marrin pjesë edhe specialistë të tjerë të Sekretariatit, apo ekspert të jashtëm që kanë qenë të përfshirë në trajtimin e çështjeve në shqyrtim.
- (5) Kryetari mund ta shtyjë, apo ta mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastet kur situata e zhvillimit të mbledhjes e përligj këtë veprim. Në këto raste duhet të merret një vendim verbal i arsyetuar, i cili do të pasqyrohet në proces-verbalin e mbledhjes.

## **2. Marrja e vendimeve**

- (6) Marrja e vendimeve është e vlefshme kur në mbledhjen e Komisionit janë të pranishëm të paktën katër anëtarë, prej të cilëve njëri duhet të jetë Kryetari ose Zëvendëskryetari, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 23 të këtij ligji.
- (7) Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm. Në rast barazimi të votave, vota e kryesuesit të mbledhjes është vendimtare. Abstenimi nuk lejohet.
- (8) Komisioni merr vendim për të ndërmarrë një Hetim të Përgjithshëm në një Sektor të Ekonomisë në zbatim të nenit 41 të ligjit.
- (9) Komisioni merr vendim për fillimin e një procedure paraprake hetimore, në zbatim të nenit 42 të ligjit, kur vihen re shenja të kufizimit të konkurrencës, Komisioni merr vendim për fillimin e procedurës së hetimit të thelluar në zbatim të nenit 43 të ligjit.
- (10) Komisioni, në bazë të raportit hetimor të paraqitur nga Sekretariati, vendos miratimin pjesërisht ose tërësisht të propozimeve të Sekretariatit ose refuzimin pjesor apo tërësor të tyre.
- (11) Komisioni i Konkurrencës vlerëson shkallën e kufizimit apo pengimit të konkurrencës që rrjedh nga projekt-aktet e institucioneve qendrore dhe vendore.
- (12) Relatimi i përfundimeve dhe propozimeve të raportit hetimor të përgatitur nga Sekretariati, në çdo fazë të hetimit, bëhet nga Sekretari Përgjithshëm, Kryetari mund të caktojë për relatimin e çështjes një Anëtar të Komisionit ose nga Kabineti.

### **3. Procesi pas miratimit**

#### **3.1. Arsyetimi i vendimit**

- (13) Vendimet e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës, jepen të arsyetuara, por jo më vonë se 15 ditë nga marrja e tyre në mbledhjen përkatëse të Komisionit.

#### **3.2. Forma e vendimit**

- (14) Çdo Vendim i miratuar nga Komisioni i Konkurrencës, është i shkruar dhe përmban:
- a) Stemën e Republikës së Shqipërisë;
  - b) Emrin e institucionit;
  - c) Titullin e aktit;
  - d) Objektin e aktit;
  - e) Bazën ligjore;
  - f) Pjesën arsyetuese;
  - g) Pjesën urdhëruese;
  - h) Emrat e anëtarëve që kanë marrë pjesë në votim;
  - i) Numrin dhe datën e miratimit.
- (15) Në rast se gjatë procesit të votimit ka vota kundër, anëtari i Komisionit e evidenton atë në pjesën e nënshkrimit të vendimit, duke i shtuar nënshkrimit të tij dhe shënimin “kundër”. Vota kundër shoqërohet me mendim të argumentuar.

#### **3.3. Publikimi i vendimit**

- (16) Vendimet e Komisionit të Konkurrencës, së bashku me mendimin e argumentuar të pakicës, nëse ka, botohen në Buletinin Zyrtar të Vendimeve të Autoritetit të Konkurrencës, si dhe afishohen në ëbsite-in zyrtar të Autoritetit të Konkurrencës.

## 15 Vendimet me angazhime

---

1. Hyrje	2
2. Konsideratat dhe objektivat kryesore	2
3. Vendimet me angazhime	4
3.1. Nisja e diskutimeve për angazhim	4
3.1.1. <i>Takimi paraprak</i>	4
3.1.2. <i>Depozitimi i një oferte joformale për angazhime</i>	5
3.2. Përgatitja e Vlerësimit Paraprak	5
3.3. Miratimi i Vlerësimit Paraprak	6
3.4. Depozitimi i tekstit të angazhimeve për testimin e tregut	7
3.4.1. <i>Kuadri procedural / formati i vendimeve me angazhime</i>	7
3.4.2. <i>Përmbajtja e angazhimeve</i>	7
3.4.3. <i>Kohëzgjatja e angazhimeve – klauzola e rishikimit</i>	9
3.5. Testimi i tregut	9
3.5.1. <i>Forma e testimit të tregut</i>	9
3.5.2. <i>Informacioni për diskutime të mëtejshme</i>	10
3.5.3. <i>Ankuesit</i>	11
3.6. Miratimi i vendimit	11
3.6.1. <i>Përmbajtja e vendimit me angazhime</i>	11
3.6.2. <i>Ankesat dhe Informimi i ankuesit</i>	12
3.6.3. <i>Mbyllja e dosjes</i>	13
3.6.4. <i>Publikimi i vendimit</i>	13
Zbatimi i angazhimeve	

## 1. Hyrje

(1) Neni 45, paragrafi 2 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003) i jep mundësinë Autoritetit të Konkurrencës që të mbyllë çështjet përmes një “vendimi me angazhime”, nëpërmjet të cilit angazhimet e ofruara nga ndërmarrja bëhen të detyrueshme për të. Një vendim i tillë përcakton se nuk ka më arsye për veprim nga ana e Autoritetit.

## 2. Konsideratat dhe objektivat kryesore

(2) Avantazhet dhe disavantazhet e një vendimi me angazhime duhet të vlerësohen me kujdes në çdo çështje individuale.

(3) Në mënyrë të ngjashme me vendimet sipas neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003, vendimet me angazhime kanë objektiv kryesor rivendosjen e konkurrencës efektive. Ato duhet të përdoren vetëm në rastet kur angazhimet adresojnë shqetësimet e konkurrencës të identifikuar nga Autoriteti. Vendimet me angazhime i bëjnë angazhimet e ofruara nga ndërmarrjet ligjërish të detyrueshme, gjë që krijon siguri ligjore dhe garanton ruajtjen e konkurrencës efektive. Vendimet me angazhime shërbejnë gjithashtu për të qartësuar politikën e konkurrencës së Autoritetit duke qenë se publikohet një version jokonfidencial i vendimit. Pjesëmarrësit e tjerë të tregut mund të mësojnë nga vendimi dhe angazhimet se çfarë është konsideruar e mjaftueshme nga Autoriteti për të eliminuar shqetësimet e konkurrencës.

(4) Vendimet me angazhime nuk bazohen në hetime të plota dhe nuk arrijnë në konkluzione përfundimtare mbi faktet e një çështjeje ose zbatimin e ligjit. Gjithashtu, vendimet me angazhime përfshijnë më pak hapa proceduralë sesa një vendim përfundimtar sipas nenit 4 ose 9 të Ligjit nr. 9121/2003 (p.sh. vendim ndalues ose vendim me kushte dhe detyrime).

(5) Fakti që angazhimet nuk imponohen nga Autoriteti por paraqiten vullnetarisht dhe zbatohen vetëm pas diskutimeve me palët dhe testit të tregut, mund të lehtësojë zbatimin e mëvonshëm të angazhimeve.

(6) Nga këndvështrimi i një ndërmarrjeje, procedurat më të shpejta dhe mungesa e konstatimit të një shkeljeje mund të jenë arsye të rëndësishme për të ofruar angazhime.

(7) Megjithatë, opsioni për të hyrë në diskutime për angazhime, mund të ketë edhe disavantazhe. Duke qenë se angazhimet mund të tërhiqen përpara miratimit të vendimit me angazhime, si dhe testimi i tregut mund të tregojë se angazhimet nuk janë të përshtatshme, ekziston gjithmonë rreziku që procedurat hetimore të vonohen ndjeshëm nga diskutimet (e pasuksesshme) për angazhime. Për rrjedhojë, është thelbësore që të sigurohet vullneti i palëve për të arritur një marrëveshje përpara se të përfshihen në këtë procedurë dhe që angazhimet të jenë të përshtatshme të zgjidhin shqetësimet e identifikuar të konkurrencës (kjo është arsyeja pse Vlerësimi Paraprak paraqitet vetëm pas diskutimeve të para për angazhime).

(8) Një aspekt tjetër që mund të pengojë “rrugën drejt angazhimeve”, është ndryshimi i rëndësisë së vendimeve me angazhime në krahasim me vendimet përfundimtare sipas nenit 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003. Vendimet me angazhime nuk konstatojnë shkelje, dhe për këtë arsye vlerësimi i rrethanave dhe analiza ligjore mund të jetë më e shkurtër se sa në vendimet përfundimtare. Për rrjedhojë, nëse Autoriteti dëshiron të krijojë një precedent të rëndësishëm, ai mund të preferojë marrjen e një vendimi sipas nenit 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

(9) Mungesa e konstatimit të një shkeljeje mund ta bëjë gjithashtu më të vështirë ndjekjen e proceseve gjyqësor nga palët e treta kundër praktikave antikonkurrese.

(10) Një vendim me angazhime nuk është i mundur në rastet kur Autoriteti vlerëson se natyra e shkeljes kërkon vendosjen e një gjobe. Gjithashtu, nuk zbatohet procedura me angazhime në rastet e marrëveshjeve të ndaluara, për të cilat mund të zbatohet “Programi i lehtësimit nga gjobat”.

(11) Në rastet kur Komisioni ka dërguar një Raport Hetimi duke bërë të ditur synimin e tij për të vendosur një gjobë, do të preferohej që vendimi me angazhime të shpjegonte pse gjoba nuk

- është më e nevojshme.
- (12) Zakonisht, një vendim me angazhime ka për qëllim t'i japë fund një shkeljeje të dukshme të vazhdueshme dhe të rivendosë konkurrencën në treg. Megjithatë, angazhimet mund të jenë të përshtatshme edhe nëse ndërmarrjet kanë ndërprerë praktikën e tyre të prezumuar antikonkurrese para ose përgjatë hetimit. Vendimi me angazhime merret për të siguruar që ndërmarrjet do të vazhdojnë edhe në të ardhmen të respektojnë rregullat e konkurrencës.
  - (13) Këto aspekte duhet të mbahen parasysh kur vlerësohet kërkesa e një ndërmarrjeje për të hyrë në diskutime për angazhime. Duhet t'i kushtohet vëmendje përpjekjeve të ndërmarrjeve për të (keq)përdorur procedurat e angazhimeve me qëllim për të marrë siguri ligjore lidhur me kontratat që sillen në vëmendje të Autoritetit në këmbim të disa angazhimeve të vogla. Vendimet me angazhime nuk konstatojnë shkelje dhe nuk konstatojnë nëse një sjellje e ka shkelur ligjin e konkurrencës. Ndërmarrjet nuk kanë të drejtën e një vendimi me angazhime, edhe nëse Autoriteti ka zgjidhur më parë një çështje të ngjashme përmes kësaj mënyre.
  - (14) Sa i përket dallimit ndërmjet një vendimi sipas nenit 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 dhe një vendimi me angazhime sipas nenit 45, paragrafi 2 të këtij ligji, në rastin e parë zbulohet një shkeljeje, ndërsa në të dytin vendoset një angazhim detyrues, pa arritur në konkluzionin nëse ka patur apo ka ende shkelje. Për rrjedhojë, një vendim me angazhime përshkruan vetëm shqetësimet e konstatuara në hetim dhe konstaton se “nuk ka më arsye për veprim” nga ana e Autoritetit.
  - (15) Niveli i kërkuar i detajeve në një vendim me angazhime mund të jetë më i ulët se në rastin e një vendimi ndalimi ose një vendimi për kushte dhe detyrime. Megjithatë, Autoriteti duhet të ketë në dispozicion fakte të mjaftueshme, për të bërë një vlerësim të informuar të shqetësimeve të konkurrencës. Pra, duhet të ketë arritur në përfundimin, edhe pse mbi baza paraprake, se mund të ketë ose mund të ketë patur një shkelje të legjislacionit të konkurrencës, e cila duhet të adresohet. Shpeshherë, Vlerësimi Paraprak do të përmbajë më shumë detaje sesa vetë vendimi me angazhime.

### **3. Vendimet me angazhime**

#### **3.1. Nisja e diskutimeve për angazhim**

- (16) Ndërmarrjet mund të kontaktojnë Autoritetin e Konkurrencës në çdo moment për të shfaqur gatishmërinë e tyre për të hyrë në diskutime në lidhje me angazhimet, duke i inkurajuar të sinjalizojnë në fazën më të hershme të mundshme interesin e tyre. Megjithatë, edhe në rastet kur palëve u është dërguar Raporti i Hetimit, angazhimet sërish mund të pranohen.

##### **3.1.1. Takimi paraprak**

- (17) Autoriteti i Konkurrencës cakton një takim me palët nën hetim, të cilat shfaqin interes për të diskutuar lidhur me angazhimet e mundshme. Në takimin, në të cilin marrin pjesë edhe anëtarët e grupit të punës, Autoriteti do të paraqesë problematikat e shfaqura lidhur me konkurrencën, të ngritura gjatë procedurave hetimore. Duke qenë se përshkrimi i rastit në takimin që bëhet, është baza kryesore për ndërmarrjen që të vendosë nëse do të depozitojë angazhime apo jo, kjo përmbledhje e shqetësimeve të konkurrencës duhet të jetë e përgatitur me kujdes të veçantë. Edhe nëse shqetësimet e Autoritetit do t'u paraqiten palëve vetëm në mënyrë verbale, prezantimi duhet të jetë i mirëstrukturuar, në mënyrë që palët të mund të kuptojnë saktë problematikat e ngritura. Palëve duhet t'u jepet gjithashtu mundësia që të bëjnë pyetje në lidhje me shqetësimet e konkurrencës, në mënyrë që të jenë të gjendje të raportojnë qartë shqetësimet e Autoritetit pranë organeve të tyre të brendshme vendimmarrëse. Autoriteti gjithashtu do të vendosë në dijëni ndërmarrjen për afatin kohor brenda së cilit duhet të përfundojnë diskutimet

mbi angazhimet e mundshme.

- (18) Grupi i Punës duhet të sqarojë se në fund i takon Komisionit të Konkurrencës të vendosë nëse do të miratojë një vendim me angazhime ose jo. Për rrjedhojë, është e rëndësishme të theksohet fakti se përgjatë diskutimeve pasuese mbi angazhimet e mundshme, të mos mbahet asnjë qëndrim përfundimtar nga grupi i punës rreth përshtatshmërisë së tyre.

### **3.1.2. Depozitimi i një oferte joformale me angazhime**

- (19) Nëse palët, pasi informohen për shqetësimet e konkurrencës në takimin paraprak, vendosin të ofrojnë angazhime, ato duhet të jenë bindëse se kjo ofertë është serioze dhe e besueshme. Për këtë qëllim, palët duhet të nënvizojnë elementët kryesorë të propozimit të angazhimeve joformale në këtë fazë. Në praktikë, kjo bëhet e mundur duke depozituar një propozim me elementët kryesorë të angazhimeve, dhe ndonjëherë edhe me një tekst i cili është drafti i parë i angazhimeve.
- (20) Pasi grupi i punës vlerëson se angazhimet e propozuara në mënyrë joformale nga ndërmarrja mund të adresojnë shqetësimet e lidhura me konkurrencën dhe se ndërmarrja është seriozisht e interesuar të paraqesë angazhime formale të përshtatshme, ai duhet të propozojë hartimin e një Vlerësimi Paraprak.

### **3.2. Përgatitja e Vlerësimi Paraprak**

- (21) Autoriteti i Konkurrencës informon ndërmarrjet rreth shqetësimeve të konkurrencës me anë të një dokumenti që quhet Vlerësimi Paraprak (Raporti i Hetimit mund të përbëjë gjithashtu një Vlerësim Paraprak). Vlerësimi Paraprak përmbledh faktet kryesore të çështjes dhe identifikon shqetësimet e konkurrencës që do të kërkonin marrjen e një vendimi për ndërprerjen e shkeljes.
- (22) Vlerësimi Paraprak shërben si një bazë e rëndësishme që ndihmon palët të formulojnë angazhime të përshtatshme duke adresuar plotësisht shqetësimet e konkurrencës të shprehura nga Autoriteti ose të përcaktojnë më mirë angazhimet e diskutuara më parë.
- (23) Vlerësimi Paraprak nuk kërkon të njëjtën gjatësi dhe nivel detajesh si Raporti i Hetimit. Vlerësimi Paraprak varion nga rasti në rast, në varësi të kompleksitetit të çështjes ose interesit të Autoritetit për të krijuar një rast precedent në vendimet e mëvonshme me angazhime.
- (24) Në rast se në një çështje është përgatitur një Raport Hetimi, nuk është e nevojshme që të dërgohet një Vlerësim Paraprak shtesë, pasi në këtë rast vetë Raporti i Hetimit përbën një Vlerësim Paraprak. Kjo për shkak se Raporti i Hetimit përmban një përmbledhje të fakteve kryesore si dhe një vlerësim të shqetësimeve të konkurrencës.

### **3.3. Miratimi i Vlerësimi Paraprak**

- (25) Raporti i Hetimit/Vlerësimi Paraprak duhet të përmbajë jo vetëm diskutimet e mëparshme joformale për angazhime dhe angazhimet e ofruara (në mënyrë joformale) nga palët, por gjithashtu të specifikojë elementët kryesorë të nevojshëm për të adresuar problemet e konkurrencës dhe të përcaktojë se cilat çështje janë ende në diskutim me palët.
- (26) Pas marrjes së Vlerësimi Paraprak, ndërmarrja nën hetim, ndryshe nga rasti i një vendimi sipas nenit 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003, nuk ka të drejtë të kërkojë një seancë dëgjimore. Gjithashtu nuk parashikohet akses në dosje.
- (27) Për ankuesit, nxjerrja e një Raporti të Hetimit/Vlerësimi Paraprak nuk do të thotë se do të kenë të drejta të caktuara procedurale. Ankuesi nuk ka të drejtën e një seance dëgjimore ose të marrë një kopje (jokonfidenciale) të Vlerësimi Paraprak, ose të ketë akses në dosje. Ankuesi është në pozitë të ngjashme me çdo ndërmarrje tjetër e cila informohet kur zhvillohet publikisht testimi i tregut. Qëllimi i vetëm i Vlerësimi Paraprak është të informojë ndërmarrjen nën hetim

formalisht për shqetësimet e konkurrencës. Ai nuk do të publikohet dhe nuk do të vihet në dispozicion të palëve të treta.

- (28) Megjithatë, në raste të caktuara mund të këshillohet që ankuesi të informohet për përmbajtjen kryesore të Vlerësimit Paraparak. Grupi i punës mund ta përdorë këtë mundësi nëse mendon se ankuesi mund të japë informacion të rëndësishëm për diskutimet pasuese mbi objektin e saktë të angazhimeve. Ky avantazh duhet të mendohet mirë duke e balancuar me riskun që mund të ketë në lidhje me ecurinë e diskutimeve për angazhime. Palët e treta gjithashtu nuk duhet të diskriminohen nga ofrimi i informacionit mbi përmbajtjen e Vlerësimit Paraparak përtej asaj që përmbledhet në testimin e tregut.
- (29) Përpara miratimit të Vlerësimit Paraparak, palëve do t'u ofrohet një takim paraparak shtesë.

### **3.4. Depozitimi i tekstit të angazhimeve lidhur me testimin e tregut**

#### **3.4.1. Kuadri procedural / formati i vendimeve me angazhime.**

- (30) Pas marrjes së Raportit të Hetimit/Vlerësimit Paraparak, ndërmarrja nën hetim do të ketë një muaj kohë për të reaguar dhe për të depozituar një tekst të propozimit me angazhime që duhen testuar në treg.
- (31) Ndërmarrja mund të paraqesë një përgjigje me shkrim ndaj Vlerësimit Paraparak. Nëse përgjigja nuk përmban prova të reja që prekin ndjeshëm pozicionin e Autoritetit të Konkurrencës të përcaktuar në Vlerësimin Paraparak, nuk do të ketë diskutime apo takime të mëtejshme mbi përgjigjen ndaj Vlerësimit Paraparak. Megjithatë, përgjigja me shkrim do të merret parasysht gjatë hartimit të vendimit përfundimtar me angazhime (p.sh. në lidhje me korrigjimet e gabimeve faktike etj.).
- (32) Duke qenë se ndërmarrjet mund të përpiqen të kufizojnë angazhimet e ofruara sa më shumë të jetë e mundur, Autoriteti mund t'i kërkojë ndërmarrjes që ta ndryshojë tekstin përpara testimit të tregut. Edhe pse angazhimet paraqiten vullnetarisht nga palët, Autoriteti mund të bëjë propozime gjatë diskutimeve për ndryshimin e disa elementëve të tekstit, madje mund të ofrojë propozime konkrete për çështje specifike. I takon palëve të vendosin nëse do t'i pranojnë këto propozime.

#### **3.4.2. Përmbajtja e angazhimeve**

- (33) Angazhimet duhet të adresojnë shqetësimet e identifikuar të konkurrencës. Angazhimet të cilat nuk lidhen me shqetësimet e konkurrencës ose nuk i adresojnë ato, nuk do të pranohen nga Komisioni. Palët mund të ofrojnë angazhime të një natyre strukturore (p.sh. shitje të një pjese të ndërmarrjes) ose të sjelljes (p.sh. detyrim për të furnizuar). Angazhimet e sjelljes zakonisht kanë disavantazhin që kërkojnë monitorim afatgjatë.
- (34) Në parim, angazhimet e ofruara duhet të jenë proporcionale, *d.m.th.* të mos shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për të zgjidhur shqetësimin e lidhur me konkurrencën. Megjithatë, duhet sqaruar se testi i proporcionalitetit është më pak i rreptë se në rast të një vendime me kushte dhe detyrime. Kjo për shkak se angazhimet paraqiten vullnetarisht nga palët dhe nuk vendosen nga Komisioni i Konkurrencës. Komisioni duhet të verifikojë që: a) angazhimet janë të mjaftueshme për të adresuar shqetësimet e konkurrencës, dhe b) ndërmarrjet nuk kanë ofruar angazhime më të lehta që adresojnë gjithashtu shqetësimet siç duhet.
- (35) Gjithashtu, është thelbësore për zbatueshmërinë e angazhimeve që ato të jenë të qarta dhe të vetë ekzekutueshme. Kjo do të thotë se zbatueshmëria e tyre nuk duhet të varet nga vullneti i një pale të tretë. Gjithashtu, procesi i zbatueshmërisë duhet të dizajnohet në mënyrë të tillë që ndërmarrja të ketë një nxitje për të zbatuar angazhimet në mënyrën e duhur. Angazhimet strukturore të cilat parashikojnë një afat kohor të përcaktuar për procedurat e strukturimeve dhe

i japin administratorit të besuar të drejtën që të zhveshin/shesin biznesin respektiv duhet të ndiqen nga afër përderisa bëhet fjalë për një rast të caktuar antikonkurrues. Prandaj është në interesin e ndërmarrjes që të shesë/strukturojë biznesin brenda afatit kohor. Angazhime kontradiktore ose jo të plota, mund të dështojnë në eliminimin e shqetësimeve të konkurrencës dhe mund të jetë e vështirë që të korrigjohen në një fazë të mëvonshme. Megjithatë, Komisioni mund të rihapë procedura hetimore nëse një ndërmarrje vepron në kundërshtim me angazhimet.

- (36) Nëse është e nevojshme, mund të caktohet një administrator i besuar për të asistuar Komisionin lidhur me zbatimin e angazhimeve (një administrator i besuar për monitorimin dhe/ose shitjen). Gjithashtu, kur angazhimet nuk mund të zbatohen pa miratimin e palëve të treta (p.sh. e drejta e parablerjes së një ndërmarrjeje që nuk do të ishte një blerës i përshtatshëm sipas angazhimeve), ndërmarrja duhet të paraqesë prova që miratimi mund të arrihet më vonë kur angazhimet të paraqiten formalisht.
- (37) Është me rëndësi të veçantë që të mbahen procesverbale të diskutimeve, duke marrë në konsideratë në veçanti faktin që zbatimi i angazhimeve në një fazë të mëvonshme mund të kërkojë një interpretim të tekstit të angazhimit, për të cilin shënime të tilla mund të jenë të dobishme. Kjo është shumë e rëndësishme, sidomos kur flitet për angazhime të cilat kanë natyrë sjelljeje, duke qenë se ato mund të vazhdojnë për disa vjet me radhë dhe mund të kërkojnë një kohë të gjatë për t'u monitoruar.
- (38) Angazhimet përfundimtare duhet të nënshkruhen nga ndërmarrja përkatëse.

### **3.4.3. Kohëzgjatja e angazhimeve - klauzola e rishikimit**

- (39) Kohëzgjatja e angazhimeve mund të jenë e kufizuar në kohë. Angazhimet duhet të parashikojnë që do të arrihet një përmirësim i qëndrueshëm i strukturës së tregut brenda një afati kohor të parashikueshëm. Kjo mund të ndryshojë ndjeshëm nga tregu në treg, në varësi të reagueshmërisë së tregut ose të investimeve të nevojshme për të realizuar këto përmirësime. Megjithatë, duhet të merret në konsideratë parimi i proporcionalitetit, d.m.th. serioziteti i shkeljes dhe nevoja për të përshtatur efektet ashtu siç duhet.
- (40) Klauzolat e rishikimit, duke përfshirë klauzolat për zgjatjen e afateve të angazhimeve, zakonisht duhet të zbatohen në rrethana të caktuara. Këto rrethana, të cilat janë të mundura të ndodhin, duhet të mirëpërcaktohen që në fillim në vetë angazhimet dhe të mos lihen në klauzolën e rishikimit. Vlen të theksohet se, në një çështje të antitrustit, një klauzolë rishikimi është shtesë dhe nuk do të çënojë mundësinë për të kërkuar rihapjen e procedurës në raste të ndodh një ndryshim i madh i fakteve.

### **3.5. Testimi i tregut**

- (41) Në rastet kur Autoriteti i konsideron angazhimet e ofruara si të mjaftueshme, në përputhje me shqetësimet e ngritura të konkurrencës, mund të kryejë edhe një testim të tregut lidhur me këto angazhime.
- (42) Autoriteti, ka të drejtë edhe jo zyrtarisht të testojë tregun apo të diskutojë angazhimet e ofruara, me palë të treta të interesuara rreth çështjes.
- (43) Në rast se Autoriteti nuk është i bindur se angazhimet e ofruara “prima facie/ në pamje të parë” i adresojnë shqetësimet e konkurrencës, nuk duhet të vazhdojë me përgatitjen e testimit të tregut, por të diskutojë lidhur me ecurinë e mëtejshme të procedurës.

#### **3.5.1. Forma e testimit të tregut**

- (44) Autoriteti mund të publikojë në faqen zyrtare të institucionit, një përmbledhje të shkurtër të çështjes dhe përmbajtjes kryesore të propozimit të angazhimit dhe ti japë palëve të treta një

mundësi, që të paraqesin vërejtjet e tyre, para se të mund të miratohen vendimet sipas nenit 45, paragrafi 2 të Ligjit nr. 9121/2003. Ky është i ashtuquajti “testim i tregut”.

- (45) Për këtë qëllim, "njoftimi për testimin e tregut" botohet në faqen zyrtare, dhe përmban një përmbledhje të shkurtër të çështjes (sjelljes dhe shkëljes së dyshuar të ligjit të konkurrencës) dhe përmbajtjes kryesore të propozimit mbi angazhimet, duke respektuar detyrimin e ruajtjes së sekretit profesional. Përmbledhja duhet t'i lejojë palët e treta të kuptojnë elementet thelbësore të angazhimeve dhe se si eliminohen shqetësimet e konkurrencës të identifikuar nga Autoriteti.
- (46) Zakonisht, njoftimi për testimin e tregut fton palët e treta të interesuara “të paraqesin konstatimet e tyre” mbi angazhimet e propozuara.
- (47) Teksti i plotë i propozimit për angazhim në versionin e tij jokonfidencial do të publikohet në faqen e internetit të Autoritetit të Konkurrencës.
- (48) Për të rritur transparencën e procesit dhe për të informuar palët e treta për testimin e tregut, zakonisht Autoriteti publikon edhe një njoftim për shtyp, me anë të të cilit njofton testimin e tregut dhe përshkruan aspektet kryesore të çështjes dhe angazhimet e propozuara.
- (49) Nëse çështja bazohet në një ankesë, testimi i tregut duhet t'i dërgohet ankuesit. Komisioni ka të drejtë të dërgojë njoftimin edhe tek palët e tjera të treta të interesuara, të cilat dihet se kanë interes të njihen me rezultatin e rastit (p.sh. palë të treta në procedurë, shoqatat e konsumatorëve etj) dhe duke kërkuar komentet e tyre në mënyrë të qartë. Kjo siguron përfshirjen e plotë të ndërmarrjeve në këtë proces.
- (50) Grupi i punës mund të vendosë gjithashtu të diskutojë draft-angazhimet verbalisht me pjesëmarrësit e tregut (sipas rastit edhe në takime trepalëshe). Kjo mund të bëhet për të sqaruar disa përgjigje. Në një rast të tillë, të anketuarve duhet t'u kërkojë të përmbledhin komentet e tyre në formë të shkruar ose grupi i punës duhet të hartojë një procesverbal, të cilin mund ta dërgojë më pas për miratim.
- (51) Në testimin e tregut, Autoriteti duhet të ftojë palët e treta të interesuara për të paraqitur konstatimet e tyre brenda një afati kohor të caktuar, i cili nuk mund të jetë më pak se një muaj.

### 3.5.2. Informacioni për diskutime të mëtejshme

- (52) Ndërmarrjet që ofrojnë angazhime duhet të informohen për rezultatet e testimit të tregut. Kjo mund të bëhet në mënyrë verbale ose me shkrim. Identiteti i palëve të treta nuk mund të zbulohet.
- (53) Gjithashtu, pas marrjes së përgjigjeve lidhur me testimin e tregut, duhet të organizohet një takim për situatën aktuale me palët.
- (54) Detyrimi për të kryer një testim të tregut nuk duhet të keqkuptohet si kërkim i miratimit të angazhimeve nga tregu. Testimi i tregut nuk është një sondazh i opinionit, i cili përcakton fatin e këtyre angazhimeve. Komisioni mund të marrë një vendim me angazhime edhe në rastet kur pjesëmarrësit në testimin e tregut kërkojnë që të refuzohen angazhimet e propozuara nga palët. Nga ana tjetër, testimi i tregut shpesh i siguron Komisionit informacione të dobishme se si mund të përmirësohen angazhimet.
- (55) Në varësi të çështjes, pas testimit të tregut mund të nevojiten modifikime të mëdha ose të vogla në tekstin e angazhimit të propozuar. Këto ndryshime duhet të diskutohen me palët. Ndryshimet më të vogla (“teknike”) në tekstin e angazhimit nuk kërkojnë hapa të rinj proceduralë. Në veçanti, zakonisht nuk kërkojë asnjë testim i ri i tregut në rast të angazhimeve të rishikuara, me përjashtim të rasteve kur rishikimi i angazhimit është thelbësor. Një ndryshim është thelbësor vetëm nëse ndryshon vetë natyra ose objekti i angazhimeve. Për shembull, nëse palët fillimisht kanë ofruar shkurtimin e kohëzgjatjes së detyrimeve që lidhen me ndalimin e konkurrencës në kontratat me palët e treta nga 5 në 2 vjet dhe pas testit të tregut kjo kohëzgjatje është shkurtuar më tej në 1 vit, nuk është e nevojshme që të përsëritet testimi i tregut.

### **3.5.3. Ankuesit**

- (56) Në rastet e një ankese formale, para miratimit të vendimit me angazhime, ankuesi informohet se, Komisioni ka pranuar angazhime të përshtatshme dhe për këtë arsye vlerëson se nuk ka baza të mëtejshme për të vazhduar me rastin.

## **3.6. Miratimi i vendimit**

### **3.6.1. Përmbajtja e vendimit me angazhime**

- (57) Grupi i punës harton një vendim me angazhime në bazë të Vlerësimit Paraprak. Vendimi me angazhime duhet të përmbajë një përmbledhje të fakteve të çështjes dhe vlerësimit ligjor. Në veçanti, është e rëndësishme të shpjegohet se janë identifikuar shqetësime të konkurrencës por nuk janë konstatuar shkelje. Për rrjedhojë, teksti duhet të përdorë rregullisht mënyrën kushtore (“*X mund të ketë shkelur...*”). Vendimi duhet të përshkruajë gjithashtu angazhimet e paraqitura nga ndërmarrjet dhe të shpjegojë pse angazhimet i zgjidhin shqetësimet e identifikuara të konkurrencës në mënyrë proporcionale.
- (58) Në rastet kur Komisioni fillimisht mund të ketë synuar të vendosë një gjobë, mund të jetë e nevojshme një deklaratë e shkurtër se pse kjo nuk është më e përshtatshme.
- (59) Një vendim me angazhime mund të jetë më i shkurtër se një vendim sipas nenit 4 dhe 9 Ligjit nr. 9121/2003. Megjithatë, gjatësia e vendimit me angazhime mund të ndryshojë nga rasti në rast, në varësi të kompleksitetit të çështjes ose interesit të Komisionit për të dhënë informacion mbi vlerësimin e tij të praktikave të caktuara antikonkurruese.

### **3.6.2. Ankesat dhe informimi i ankuesit**

- (60) Në rastet kur pranë Autoritetit është paraqitur një ankesë kundër marrëveshjes ose praktikës për të cilën ndërmarrjet kanë ofruar angazhime, Komisioni duhet të miratojë dy vendime të ndryshme (me përjashtim të rastit kur ankesa tërhiqet): një që e refuzon ankesën dhe një që i deklaron angazhimet të detyrueshme. Kjo për faktin se vendimi me angazhime nuk konstaton shkelje siç kërkohet në ankesë.
- (61) Në rastet kur pas marrjes së një vendimi me angazhime, depozitohet një ankesë pranë Autoritetit të Konkurrencës, dhe institucioni vihet në dijeni në lidhje me argumente të reja, të cilat kërkojnë një rivlerësim të situatës, mund të kryhet një rivlerësim i rastit. Pas këtij rivlerësimi, ankuesit i dërgohet një letër ku shpjegohen arsyet e marrjes së një vendimi të tillë.
- (62) Nëse ankuesi nuk ka bërë ndonjë koment, atëherë ankesa konsiderohet se është tërhequr. Nëse ankuesi ka bërë komente, por këto komente nuk janë aq thelbësore dhe të rëndësishme, sa të çojnë në rivlerësimin e angazhimeve, atëherë procedura mund të vazhdojë pa ndonjë ndryshim në angazhimet e dhëna dhe ankesa do të duhet të refuzohet.
- (63) Vendimi për refuzimin e ankimit bëhet menjëherë pas nxjerrjes së vendimit me angazhime që përshkruan, se pas angazhimeve, nuk ka më arsye për Autoritetin e Konkurrencës që të vazhdojë procedurat hetimore. Rekomandohet të bashkëngjitet një version jokonfidencial i vendimit për angazhim. Nëse ankesa parashtron me shumë argumente se sa ato të trajtuara në vendimin me angazhimin, atëherë është i nevojshëm shpjegimi i arsyeve për refuzimin e ankesës.

### **3.6.3. Mbyllja e dosjes**

- (64) Dosja duhet të mbyllet sapo të jetë dërguar Vendimi për palët.

#### **3.6.4. Publikimi i vendimit**

- (65) Vendimi me angazhime, është i nevojshëm të publikohet në përputhje me nenin 47 të Ligjit nr. 9121/2003.

#### **3.7. Zbatimi i angazhimeve**

- (66) Nga pikëpamja e konkurrencës, zbatimi me sukses i angazhimit pas miratimit të vendimit është vendimtar për suksesin përfundimtar të ndërhyrjes së Autoritetit të Konkurrencës. Për këtë arsye, është thelbësor monitorimi i kujdesshëm i procesit të zbatimit të angazhimeve të dhëna.
- (67) Monitorimi që do të kryhet varet nga natyra e angazhimeve. Në shumicën e rasteve dhe, në veçanti, kur bëhet fjalë për angazhime strukturore, angazhimet parashikojnë që duhet të caktohet një administrator i besuar, menjëherë pas miratimit të vendimit me angazhime. Administratori i besuar duhet të jetë i pavarur dhe i kualifikuar për kryer detyrën e monitorimit. Ai do të monitorojë në mënyrë të detajuar hapat e ndryshëm të zbatimit të angazhimeve dhe do t'i raportojë rregullisht Komisionit të Konkurrencës në lidhje me këtë.
- (68) Në rastet e angazhimeve strukturore, duhet të verifikohet fakti që blerësi i përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara në vendimin me angazhime. Autoriteti i Konkurrencës duhet të mbikëqyr këtë proces dhe të qëndrojë në kontakt të rregullt me administratorin e besuar dhe ekipin e tij, në mënyrë që të shmangë ose të adresojë çfarëdolloj problemi të mundshëm, i cili sjell pasoja për angazhimet dhe i bën ato më pak efektive nga sa janë parashikuar.

## **16 Masat e përkohshme**

---

1.	Hyrje	2
2.	Veprimi “kryesisht”	2
3.	Kushtet3	
3.1.	<i>Shkelja prima facie</i>	4
3.2.	<i>Urgjenca</i>	4
4.	Zbatimi i masave të përkohshme	5

## 1. Hyrje

- (1) Neni 44 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës (Ligji nr. 9121/2003) i jep shprehimisht Komisionit të Konkurrencës kompetencat për të miratuar masa të përkohshme. Ai parashikon se:

“Në rast urgjence, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën dhe kur ka të ngjarë të ketë shkelje të neneve 4 dhe 9 të këtij ligji, Komisioni, me nismën e tij, ose në bazë të një kërkesë nga palët e interesuara dhe në çdo kohë të procedurës, mund të vendosë marrjen e masave të përkohshme, të përcaktuara në nenin 61 shkronjat “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të këtij ligji”.

- (2) Gjithashtu, Komisionit i është dhënë shprehimisht kompetenca për të miratuar masa të përkohshme përmes akteve nënligjore të caktuara, si Rregullorja “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës” dhe Udhëzimi “Për praktikat më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

## 2. Veprimi “kryesisht”

- (3) Neni 44, paragrafi 1 i Ligjit nr. 9121/2003 parashikon shprehimisht se Komisioni mund të mund të vendosë marrjen e masave të përkohshme “duke vepruar me nismën e tij”.
- (4) Ankuesit ose palët e treta të interesuara mund të inkurajojnë gjithashtu Komisionin të miratojë masa të përkohshme. Megjithatë, në raste të tilla, Komisioni vepron kryesisht. Kjo do të thotë që edhe pse ankuesit mund të kërkojnë vendosjen e masave të përkohshme, Komisioni nuk është i detyruar që të marrë një vendim të tillë dhe, nëse është e nevojshme, mund t’i refuzojë ato. Vendimi i Komisionit për të miratuar masa të përkohshme mund të ankimohet pranë gjykatës përkatëse.
- (5) Nga ana tjetër, ankuesit mund të kërkojnë marrjen e masave të përkohshme përpara gjykatës përkatëse në përputhje me kuadrin ligjor procedural.

## 3. Kushtet

- (6) Qëllimi i ligjit nr. 9121/2003 është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, dhe masat e përkohshme duhet të jepen vetëm në të mirë të interesit publik, jo të ndërmarrjeve individuale. Për rrjedhojë, dëmi i mundshëm individual i bërë kundrejt një ndërmarrjeje duhet të konsiderohet vetëm në rastin kur përkon me dëmin e bërë ndaj konkurrencës, rast në të cilin interesat e një ndërmarrjes mund të mbrohen në mënyrë indirekte.
- (7) Neni 44 i Ligjit nr. 9121/2003 përcakton se masa e përkohshme do të merret në rast urgjence, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën dhe kur ka të ngjarë të ketë shkelje të neneve 4 dhe 9 të këtij ligji.

### 3.1. Shkelja prima facie

(12) Praktikrat e adresuara nga masat e përkohshme duhet që *prima facie* të kenë gjasa të përbëjnë një shkelje të rregullave të konkurrencës.

### 3.2. Urgjenca

(13) Ligji nr. 9121/2003 parashikon që masat e përkohshme duhet të jepen vetëm në raste urgjence për shkak të rrezikut të dëmit të rëndë dhe të pariparueshëm të konkurrencës.

(14) Për t'u cilësuar si "urgjente", çështja duhet të kërkojë veprim të menjëhershëm nga ana e Komisionit, për të shmangur një "dëm të rëndë dhe të pariparueshëm" të palës që kërkon miratimin e masave të përkohshme, ose për të shmangur një situatë që është e patolerueshme për interesin publik.

(15) Për të përcaktuar nëse mund të shkaktohet dëm "i rëndë", duhet të kryhet një analizë rast pas rasti, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të çështjes specifike.

(16) Nga ana tjetër, dëmi konsiderohet të jetë "i pariparueshëm" nëse nuk mund të korrigjohet me një vendim pasues gjatë procedurës hetimore të Autoritetit. Për rrjedhojë, dëmi mund të konsiderohet "i pariparueshëm" edhe në një skenar ku dëmi në fjalë mund të riparohet me anë të një vendimi të gjykatës. Humbja financiare nuk konsiderohet e pariparueshme nëse nuk kërcënohet vijueshmëria e ndërmarrjes në fjalë. Por dëmi do të konsiderohet i pariparueshëm nëse çon në ndryshime të tregut të cilat do të jenë shumë të vështira për t'u zhbërë.

## 4. Zbatimi i masave të përkohshme

(17) Në zbatim të nenit 44 të Ligjit, në çdo kohë gjatë procedurave hetimore Sekretariati i Autoritetit mund t'i propozojë Komisionit marrjen e masave të përkohshme kur ka të ngjarë që ndërmarrja nën hetim të ketë kryer një shkelje *prima facie* të nenit 4 dhe/ose 9 të Ligjit, e cila mund të shkaktojë dëme rënda dhe të pariparueshme të konkurrencës në treg.

(18) Komisioni nuk mund të marrë masa të përkohshme "pa marrë parasysh interesat legjitime të ndërmarrjes nën hetim". Me fjalë të tjera, Komisioni duhet të respektojë të drejtën për t'u dëgjuar të ndërmarrjes ndaj të cilës po merret vendimit.

(19) Para marrjes së një vendimi për masë të përkohshme, Komisioni i jep mundësinë personit, ndërmarrjes ose përfaqësuesit të ndërmarrjes, apo grupimeve të ndërmarrjeve, për të dhënë këndvështrimet e tyre lidhur me pretendimet e Sekretariatit. Ata mund të japin një përgjigje me shkrim ndaj këtyre pretendimeve. Kjo do të thotë se Autoriteti duhet t'i dërgojë ndërmarrjes ndaj të cilës mund të masa të përkohshme një raport hetimor.

(20) Gjithashtu, ndërmarrjes duhet t'i jepet një seancë dëgjimore me kërkesë paraprake, por për shkak të urgjencës, brenda një afati kohor më të shkurtër. Po kështu, palët e treta të cilat tregojnë interes të mjaftueshëm për t'u dëgjuar duhet gjithashtu të merren në konsideratë.

(21) Neni 44, paragrafi 2 i Ligjit nr. 9121/2003 përcakton shprehimisht që masat e përkohshme duhet të zbatohen "për një kohë të caktuar". Gjithashtu, e njëjta dispozitë parashikon se ky afat kohor i zbatimit të masave të përkohshme "mund të shtyhet në rast nevojë".

(22) Vendimi i Komisionit që urdhëron masa të përkohshme duhet të arsyetohet dhe mund të apelohe pranë gjykatës.

- (23) Sipas nenit 74 të Ligjit nr. 9121/2003, Komisioni vendos gjoba, në masën deri në 10 për qind të xhiros së ndërmarrjes, të vitit financiar paraardhës, për çdo ndërmarrje pjesëmarrëse që nuk zbaton vendimin për marrjen e masave të përkohshme.

## 17 Detyrimet (Remedies)

- |    |                                   |   |
|----|-----------------------------------|---|
| 1. | Baza ligjore                      | 2 |
| 2. | Parimet e përgjithshme            | 2 |
| 3. | Masat strukturore dhe të sjelljes | 3 |

## 1. Baza ligjore

- (1) Neni 45, paragrafi 1 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003) parashikon se, për ndalimin e shkeljes së nenit 4 ose 9 të këtij ligji, Komisioni mund të kërkojë nga ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve të interesuara të marrin masat e nevojshme, përfshirë dhe ato strukturore.

## 2. Parimet e përgjithshme

- (2) Nëse Komisioni synon të vendosë detyrime ndaj palëve, në përputhje me nenin 45, paragrafi 1 të Ligjit nr. 9121/2003, Raporti i Hetimit duhet të specifikojë masat e parashikuara, të cilat mund të jenë të nevojshme për t’i dhënë fund shkeljes së dyshuar. Informacioni i dhënë duhet të jetë mjaftueshëm i detajuar për t’u dhënë mundësinë palëve që të mbrohen për sa i përket nevojës dhe proporcionalitetit të masave të parashikuara.
- (3) Detyrimet duhet të shërbejnë për t’i dhënë fund, në mënyrë efektive, shkeljes së identifikuar të rregullave të konkurrencës. Ato nuk duhet të shërbejnë si sanksione, për arsye se sanksionet e vetme të parashikuara në Ligjin nr. 9121/2003 janë gjobat.
- (4) Duke qenë se çdo detyrim i vendosur duhet të ketë për qëllim që t’i japë fund shkeljes në mënyrë efektive, duhet të ekzistojë një lidhje ndërmjet shkeljes dhe masës së vendosur. Për më tepër, bazuar në parimin e proporcionalitetit, detyrimi i vendosur ndaj ndërmarrjes për t’i dhënë fund shkeljes, nuk duhet të tejkalojë atë që është e përshtatshme dhe e nevojshme për të arritur objektivin e kërkuar, pra rivendosjen e përputhshmërisë me rregullat e shkelura. Vlerësimi i efektivitetit dhe nevojës së çdo mase duhet të bazohet në faktet dhe rrethanat e çështjes specifike. Në varësi të tyre, një masë efektive mund të konsistojë në “kryerjen e disa veprimeve ose në dhënien e disa avantazheve të caktuara të cilat janë mbajtur pa të drejtë, si dhe në ndalimin e vazhdimësisë së disa veprimeve, praktikave apo situatave që janë në kundërshtim me legjislacionin për konkurrencën”. Gjithashtu, parimi i efektivitetit i jep Komisionit të drejtën që të vendosë detyrime, të cilat kanë për qëllim eliminimin e efekteve antikonkurruese të sjelljes së jashtëligjshme, me qëllim rivendosjen e konkurrencës efektive në tregjet e prekura.
- (5) Kur disponohen disa masa të cilat janë njëloj efektive, në parim, i takon ndërmarrjes e cila ka kryer shkeljen që të zgjedhë masën e përshtatshme. Për më tepër, me qëllim respektimin e këtij parimi, në disa raste Komisioni mund të ftojë palët që të japin propozime për t’i dhënë fund në mënyrë efektive shkeljes së konstatuar në vendim. Masat të cilat nuk i japin fund shkeljes në mënyrë efektive duhen refuzuar.

## 3. Masat strukturore dhe të sjelljes

- (6) Neni 45, paragrafi 2 i Ligjit nr. 9121/2003 i jep Komisionit kompetencën që të vendosë masat e nevojshme për ndalimin e shkeljes, qoftë “strukturore” apo “të sjelljes”.
- (7) Në rastin e masave të sjelljes, ndërmarrja të cilës i drejtohet vendimi duhet të marrë disa masa <sup>61</sup> të caktuara (p.sh., të ndryshojë kushtet e përgjithshme ose të japë akses në facilitete esenciale

mbi baza jodiskriminuese) dhe/ose të mos kryejë disa veprimeve të caktuara (p.sh., të mos aplikojë zbritje (rebates) të jashtëligjshme).

- (8) “Masat strukturore” përfshijnë një shumëllojshmëri masash, të cilat lidhen me asetet e ndërmarrjes. Shembuj të masave strukturore janë detyrimet për të shitur aksionet tek një konkurrent ose për të mbyllur pjesërisht apo plotësisht një bashkim shoqërisht. Forma më ekstreme e masave strukturore është shpërbërja e një subjekti të mëparshëm, pra e një subjekti që ka ekzistuar para shkeljes.
- (9) Neni 45, paragrafi 1 i Ligjit nr. 9121/2003 përcakton se masat strukturore, në bazë të parimit të proporcionalitetit, parashikohen kur masat për të vepruar ose për të mos vepruar në një mënyrë të caktuar (masat e sjelljes) nuk janë efektive. Kjo bazohet në supozimin se, në parim, masat e sjelljes janë më pak rënduese se sa masat strukturore për një ndërmarrje, dhe për këtë arsye nuk do të ishte proporcionale vendosja e një mase strukturore kur disponohet një masë e sjelljes njëloj efektive. Megjithatë, ky supozimi mund të mos qëndrojë në çështje të caktuara. Prandaj, është e nevojshme që të vlerësohet se cila prej masave njëloj efektive (strukturore dhe të sjelljes) është më pak rënduese. Këtu, gjëja më e rëndësishme është të përcaktohet nëse një masë alternative më pak rënduese është “njëlloj efektive”. Komisioni nuk është i detyruar që të zgjedhë një masë të sjelljes më pak efektive nëse një masë strukturore është më efektive për t’i dhënë fund shkeljes. Për rrjedhojë, synimi është që të garantohet se, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, kur disponohen dy masa njëloj efektive, Komisioni zgjedh masën më pak rënduese për ndërmarrjen.

## **18 Gjobat periodike**

---

1. Kuadri ligjor 2
2. Miratimi i një vendimi sipas nenit 76, paragrafi 1 2
3. Miratimi i një vendimi mbi shumën përfundimtare të gjobës 3

## 1. Kuadri ligjor

- (1) Në përputhje me nenin 76 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003), Komisioni, në bazë të një vendimi, vendos mbi ndërmarrjet gjoba në pagesa periodike ditore jo më shumë se 5 për qind të xhiros mesatare ditore në vitin financiar paraardhës, e cila llogaritet nga data e marrjes së vendimit, në mënyrë që ato:
  - të ndërpresin shkëlqet e neneve 4 dhe 9, në përputhje me vendimin e marrë, sipas nenit 45 të këtij ligji;
  - të veprojnë në përputhje me vendimin për marrjen e masave të përkohshme, sipas nenit 44 të këtij ligji;
  - të veprojnë në përputhje me detyrimet në mbështetje të vendimit, sipas neneve 45, 50 pika 2, neneve 56, 57 dhe 60 pika 2 të këtij ligji;
  - të japin të dhëna të plota dhe të sakta, të cilat Komisioni i ka kërkuar, sipas vendimit të parashikuar në nenin 33 pika 2 të këtij ligji;
  - të lejojnë një inspektim, i cili është urdhëruar në bazë të një vendimi, sipas nenit 35 të këtij ligji;
  - të përmbushin angazhimin për marrjen e masave të nevojshme për rivendosjen e konkurrencës, sipas nenit 62 të këtij ligji.
- (2) Shuma përfundimtare e pagesës llogaritet sipas nenit 76, paragrafi 2 i Ligjit nr. 9121/2003 dhe në raste të caktuara, sipas nenit 76, paragrafi 3 i Ligjit nr. 9121/2003.
- (3) Vendimi për përcaktimin e shumës përfundimtare të pagesës mund të kontestohet para gjykatës. Gjithashtu, ndërmarrja ndaj të cilës merret vendimi ka të drejtën të dëgjohet (pra, duhet të marrë një Raport të Hetimit, duhet t’i jepet akses në dosje, si dhe t’i jepet mundësia që të shprehë pretendimet e saj me shkrim dhe në një seancë dëgjimore) përpara se të miratohet vendimi ku përcaktohet shuma përfundimtare e gjobës periodike në bazë të nenit 76, paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit nr. 9121/2003.
- (4) Neni 76 i Ligjit nr. 9121/2003 krijon një procedurë me dy faza, sipas të cilës merret një vendim i parë për të përcaktuar shumën ditore (të përkohshme) të sanksionit financiar periodik dhe datën e fillimit të llogaritjes, si dhe një vendim i dytë ku përcaktohet shuma përfundimtare.

## 2. Miratimi i një vendimi sipas nenit 76, paragrafi 1

- (5) Komisioni i Konkurrencës ka kompetencë të marrë një vendim sipas nenit 76 pika 1 në bazë të të cilit vendos mbi ndërmarrjet gjoba në pagesa periodike ditore jo më shumë se 5 për qind të xhiros mesatare ditore në vitin financiar paraardhës, e cila llogaritet nga data e marrjes së vendimit.
- (6) Duke qenë se vendimi sipas nenit 76, paragrafi 1 është një hap i ndërmjetëm dhe nuk ndikon negativisht të drejtat e palëve, në këtë fazë nuk është e nevojshme që të lëshohet një Raport i Hetimit, të jepet akses në dosje dhe të dëgjohen palët.
- (7) Vendosja e një gjobe periodike mund të nisë duke miratuar një vendim sipas nenit 76, paragrafi 1, në mënyrë të pavarur, ose duke përfshirë dispozitën mbi vendosjen e gjobës periodike në një vendim tjetër.

## 3. Miratimi e një vendimi mbi shumën përfundimtare të gjobës

- (8) Xhiro totale e ndërmarrjes apo të grupimit të ndërmarrjeve ndaj të cilave do të vendoset një gjobë periodike do të llogaritet sipas parashikimet të neneve 15, 16 dhe 17 të Ligjit nr. 9121/2003.
- (9) Kur ndërmarrjet plotësojnë detyrimin për të cilin është vendosur një gjobë periodike, Autoriteti mund të përcaktojë një shumë përfundimtare të pagesës periodike të gjobës më të ulët sesa ajo që do të ishte në mbështetje të vendimit fillestar, nëse e gjykon të arsyeshme. Llogaritja e xhiros së ndërmarrjes do të kryhet në të njëjtën mënyrë si pika më lart.
- (10) Përpara se të mund të miratohet vendimi për shumën përfundimtare të gjobës, ndërmarrja ndaj të cilës vendoset gjoba duhet të marrë një Raport të Hetimit, ku të informohet rreth pretendimeve ndaj saj, me qëllim që t'i jepet mundësia të ushtrojë të drejtat e saj për t'u mbrojtur, me shkrim dhe në mënyrë verbale (seancë dëgjimore).
- (11) Për dërgimin e Raportit Hetimor zbatohen rregullat procedurale të ndjekura zakonisht në një procedurë hetimore.
- (12) Vendimi mbi shumën përfundimtare të gjobës miratohet nga Komisioni i Konkurrencës, në përputhje me dispozitat në fuqi për vendimmarrjen e tij.

# 19 Trajtimi i ankesave

---

1.	Vlerësimi fillestar	2
1.1.	Pranueshmëria	2
1.2.	Vlerësimi fillestar	3
1.3.	Hetimi i mëtejshëm	3
2.	Refuzimi i ankesave	6
2.1.	Procedura për refuzimin e ankesave	9
2.1.1.	<i>Hapi i parë: Shkresa sipas nenit 15, paragrafi 1 të Rregullores</i>	9
2.1.2.	<i>Hapi i dytë: Vendimi sipas nenit 15, paragrafi 2 të Rregullores</i>	10

## 1. Vlerësimi fillestar

### 1.1. Pranueshmëria

- (1) Informacione, të cilat janë të rëndësishme në nxitjen e hetimeve nga Autoriteti, mund të merren edhe nga qytetarët apo edhe nga ndërmarrjet. Prandaj, Autoriteti i Konkurrencës inkurajon qytetarët dhe ndërmarrjet që ta informojë për shkelje të dyshuar të rregullave të konkurrencës. Kjo mund të bëhet ose me paraqitjen e një ankese zyrtare ose thjesht duke i dhënë Autoritetit informacione për tregun.
- (2) Procedurat për trajtimin e ankesave rregullohen sipas nenit 29/1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003), si dhe dispozitave përkatëse të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës” dhe të Rregullores “Për Funkcionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.
- (3) Palë të treta ose të interesuara për çështje që lidhen me kufizime, shtrembërime ose pengime të konkurrencës, mund paraqesin pranë Autoritetit të Konkurrencës ankesa a njoftime për këto konstatime. Autoriteti ruan dhe garanton mbetjen anonim të ankuesit, sa herë që ky i fundit e kushtëzon një gjë të tillë.
- (4) Ankesat ose njoftimet, pavarësisht nga mënyra e paraqitjes, pasi shënohen në regjistrin e protokollit, përcillen për trajtim profesional, brenda një afati të përcaktuar, në Sekretariatit e Autoritetit.
- (5) Ankesat, kërkesat dhe njoftimet nga personat që do të paraqiten pranë Autoritetit të Konkurrencës, duhet të plotësohen në gjuhën shqipe, sipas Formularit-Tip të ankesës, i cili jepet si shtojcë e Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”. Ata që nuk janë në gjendje të paraqesin një ankesë me shkrim, apo nuk dëshirojnë të bëjnë një gjë të tillë, mund ta paraqesin atë me gojë. Në këtë rast punonjësi i Protokollit do të marrë shënim ankesën, kërkesën apo njoftimin e bërë, do të bëjë shënim se personi që e paraqet atë nuk dëshiron ta depozitojë formalisht dhe do ta firmosë vetë së bashku me një person tjetër të pranishëm nga institucioni.
- (6) Në rastet kur në Autoritet paraqiten ankesa, kërkesa, apo njoftime me shkrim, që dorëzohen dorazi apo me postë elektronike për çështje që janë në juridiksionin e institucionit, ato duhet të regjistrohen në librin përkatës të protokollit. Ankuesi duhet gjithashtu të paraqesë një version jo-konfidencial të ankesës në qoftë se konfidencialiteti është deklaruar për çdo pjesë të ankesës.
- (7) Autoriteti i Konkurrencës, merr në shqyrtim edhe ankesat anonime për çështje që janë në juridiksionin e institucionit. Këto ankesa regjistrohen në librin e protokollit dhe kalojnë për vlerësim paraprak në Sekretariat. Sekretariati nuk kufizohet në ankesën anonime por kryen verifikimet dhe analizat e nevojshme lidhur me çështjen.
- (8) Një ankesë formale mund të bëhet vetëm për një shkelje të supozuar të neneve 4 dhe/ose 9 të Ligjit nr. 9121/2003 nga ndërmarrjet. Gjithashtu, ankuesi, duhet të shfaqë një interes legjitim, pra të jetë direkt dhe individualisht i prekur nga një shkelje e mundur e konkurrencës.
- (9) Nëse dokumenti i depozituar është jashtë objektit të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003, <sup>67</sup> ankuesi informohet rreth këtij fakti.

(10) Në parim, palët të cilat do të konsiderohen se kanë një interes legjitim, janë:

- ndërmarrjet të cilat mund të pretendojnë se kanë një interes legjitim kur operojnë në tregun përkatës të produktit ose kur sjellja për të cilën bëhet ankesa ka gjasa të ndikojë drejtpërdrejtë dhe negativisht në interesat e tyre;
- shoqatat e konsumatorëve të cilat mund të depozitojnë gjithashtu ankesa pranë Autoritetit;
- konsumatorët individualë të cilët konsiderohen se kanë një interes legjitim kur interesat e tyre ekonomikë janë dëmtuar ose ka gjasa të dëmtohen si rezultat i kufizimit të konkurrencës në fjalë;
- organet e administratës qendrore dhe vendore të cilët mund të kenë një interes legjitim në cilësinë e tyre si blerës apo si përdorues të mallrave ose shërbimeve të prekura nga sjellja për të cilën bëhet ankesa.

## **1.2. Vlerësimi fillestar**

(11) Brenda 24 orëve nga koha e shpërndarjes së korrespondencës nga Kryetari, Sekretari i Përgjithshëm ja kalon drejtorisë në kompetencën e të cilës është ndjekja e çështjes.

(12) Sekretari i Përgjithshëm vlerëson nëse ankesa është në juridiksionin e Autoritetit të Konkurrencës apo jo dhe njofton menjëherë Kryetarin mbi këtë vlerësim.

(13) Vlerësimi fillestar shërben për të përcaktuar nëse ankesa mund të hetohet më tej nga ana e Autoritetit të Konkurrencës. Për këtë qëllim, Autoriteti mund të realizojë një vlerësim paraprak për të përcaktuar nëse çështja ka indikacione *prima facie* të shkeljes së supozuar dhe të mundohet të përcaktojë një teori të mundshme të dëmit.

(14) Si rezultat i vlerësimit fillestar, duhet të arrihet në një konkluzion të qartë për të përcaktuar nëse ankesa:

- përbën një çështje të mundshme për hetim të mëtejshëm nga Autoriteti;
- nuk përmban arsye të mjaftueshme për të vepruar.

(15) Subjekti që ka bërë ankesën apo kërkesën, njoftohet nga Sekretariati për përfundimet e procedimit administrativ të ankesës, kërkesës apo njoftimit.

## **1.3. Hetimi i mëtejshëm**

(16) Nëse synimi është të hetohet më tej çështja, atëherë ankuesi duhet të informohet për nisjen e procedurave, përveçse në rastet kur dhënia e informacionit vlerësohet si e papërshtatshme.

(17) Autoriteti, në çështjet e hapura në bazë të një ankese formale, do t'u japë palëve që janë subjekt i procedurave mundësinë për të dhënë komente rreth një versioni jokonfidencial të ankesës. Kjo mundësi do t'u jepet palëve në një fazë të hershme (përveçse kur konsiderohet se diçka e tillë ka gjasa të cenojë hetimin) dhe maksimumi pak kohë pas hapjes së procedurave.

(18) Ankuesit duhet të jenë të përfshirë ngushtësisht në procedurat hetimore, për arsye se mund

të ndihmojnë në sigurimin e provave lidhur me praktikën antikonkurruese dhe rrjedhimisht në përcaktimin e shkeljes.

- (19) Në rastet kur Komisioni autorizon Sekretariatit për dërgimin e Raportit të Hetimit, (në bazë të nenit 18 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”), në lidhje me një çështje për të cilën ajo ka marrë një ankesë, Sekretariati i jep ankuesit një kopje të Raportit ku janë fshirë të dhënat konfidenciale dhe i vendos një afat kohor brenda të cilit parashtruesi i ankesës mund të prezantojë pretendimet e tij me shkrim.
- (20) Komisioni i Konkurrencës kur është e nevojshme, mund t’i kërkojë Sekretariatit që t’i japi ankuesit mundësinë për të shprehur pretendimet e tij në seancë dëgjimore të palëve të cilave ju është dërguar Raporti i Hetimit, nëse ankuesit e kërkojnë këtë në komentet e tyre me shkrim.
- (21) Ankuesit mund t’i jepet një version jokonfidencial i përgjigjes që ka dhënë pala subjekt i hetimit në lidhje me ankesën. Megjithatë, kjo mund të mos ndodhë në rast se ankesa është refuzuar në një fazë të hershme pa një hetim të mëtejshëm të thelluar.

## 2. Refuzimi i ankesave

- (22) Ankesat mund të refuzohen bazuar në arsyetimin se nuk ka arsye të mjaftueshme për të vepruar. Në veçanti, mund të mos ketë arsye të mjaftueshme për të vepruar nëse ankesa nuk është e argumentuar ose nëse nuk ka provat minimale *prima facie* për të përcaktuar ekzistencën e një shkeljeje të nenit 4 dhe/ose 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

### 2.1 Procedura për refuzimin e ankesave

- (23) Në rastet kur Komisioni konstaton se në bazë të informacionit të vënë në dispozicion të tij nuk ka prova të mjaftueshme për të vepruar mbi një ankesë, në përputhje me nenin 15, paragrafi 1 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës” (‘Rregullorja’) ai kërkon nga Sekretariati të informojë ankuesin mbi vendimin e Komisionit dhe të vendosë një afat kohor brenda të cilit ankuesi mund të paraqesë pretendimet e tij me shkrim.

#### 2.1.1 Hapi i parë: Shkresa sipas nenit 15, paragrafi 1 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”

- (24) Shkresa sipas nenit 15, paragrafi 1 të Rregullores së sipërpërmendur përcakton pozicionin e përkohshëm të Komisionit ndaj ankesës, i cili mund të ndryshojë në varësi të konstatimeve që mund të paraqesë ankuesi në përgjigje të letrës.
- (25) Komisioni nuk është i detyruar të marrë parasysh asnjë pretendim me shkrim të dorëzuar pas këtij afati kohor. Nëse ankuesi nuk reagon brenda afatit kohor ndaj shkresës së parashikuar në nenin 15, paragrafi 1 të Rregullores, ankesa konsiderohet si e tërhequr dhe çështja mbyllet. Ankuesi duhet të informohet mbi mbylljen administrative të çështjes.
- (26) Nëse ankuesi kërkon një shtyrje të afatit për dhënien e përgjigjes, kjo shtyrje mund të jepet përmes një shkrese të nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm. Shtyrja duhet dhënë nëse konsiderohet e përshtatshme dhe me kusht që ankuesi të paraqesë një kërkesë të qartë dhe të arsyetuar, e cila të përmbajë një justifikim bindës.
- (27) Kur Komisioni i kërkon Sekretariatit të informoje ankuesin mbi vendimin e tij për refuzimin e ankesës, sipas Nenit 15, paragrafi 1 të Rregullores, ankuesi ka të drejtën të

shqyrtojë dokumentet mbi të cilat Komisioni bazon vlerësimin e tij. Megjithatë, ankuesi nuk mund të shqyrtojë dokumentet që përmbajnë sekretet tregtare dhe informacionet e tjera konfidenciale që u përjasin palëve të tjera të përfshira në procedurë. Procedura do të ndiqej në praktikë si në vijim:

- nëse ankuesi i disponon të gjitha dokumentet e dosjes mbi të cilat është bazuar Komisioni për vlerësimin e tij, atëherë nuk është e nevojshme t'i jepet akses i mëtejshëm.
  - nëse ankuesi nuk i disponon dokumentet e dosjes mbi të cilat është bazuar Komisioni për vlerësimin e tij, atëherë shkresës së parashikuar në nenin 15, paragrafi 1 të Rregullores i bashkëngjiten kopjet e këtyre dokumenteve.
- (28) Dokumentet të cilat ankuesi i ka shqyrtuar gjatë procedimeve të kryera sipas neneve 4 dhe/ose 9 të Ligjit mund të përdoren prej tij vetëm për qëllime të procedurave gjyqësore ose administrative për zbatimin e këtyre dispozitave.
- (29) Nëse Komisioni merr në konsideratë miratimin e një vendimi me angazhime, atëherë kjo nënkupton se nuk ka më arsye të mjaftueshme për të kryer një hetim të mëtejshëm të shkeljes së pretenduar. Në raste të tilla, Komisioni do të informojë gjithashtu ankuesin rreth testimit të tregut dhe do e ftojë atë që të paraqesë komente. Ankuesi do të informohet përmes një shkrese sipas nenit 15, paragrafi 1 të Rregullores, në të cilën Komisioni do të informojë ankuesin rreth qëllimit të tij për të refuzuar ankesën nëse angazhimet pranohen formalisht. Kjo letër duhet dërguar përpara se të miratohet vendimi me angazhime.

### **2.1.2 Hapi i dytë: Vendimi sipas nenit 15, paragrafi 2 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”**

- (30) Nëse ankuesi paraqet pretendimet e tij brenda afatit kohor të caktuar nga Sekretariati dhe pretendimet me shkrim të bëra prej tij nuk çojnë në një vlerësim ndryshe nga ai i ankesës, Komisioni e refuzon ankesën me vendim. Ky vendim mund të ankimohet para gjykatës kompetente.
- (31) Vendimi i refuzimit të ankesës të marrë nga Komisioni, duhet të paraqesë arsyetimin e ndjekur nga Komisioni me qëllim që ankuesi të mund të vlerësojë arsyet e refuzimit dhe gjykata kompetente të mund t'a shqyrtojë atë. Komisioni nuk është i detyruar që të mbajë një qëndrim për të gjitha argumentet e ngritura, por mjafton vetëm të parashtojë aspektet të cilat janë vendimtare për refuzimin e ankesës.
- (32) Në praktikë, vendimi i refuzimit hartohet bazuar në shkresën sipas nenit 15 paragrafi 1, duke marrë në konsideratë elementët shtesë apo argumentet e paraqitura nga ankuesi në përgjigjen e tij.

## **20 Udhëzimet joformale**

---

1.	Hyrje	2
2.	Kontaktet ndërmjet Autoritetit të Konkurrencës dhe aktorëve të tregut	2
3.	Letrat udhëzuese	3
3.1.	Kushtet për lëshimin e një letre udhëzuese	3
3.1.1.	<i>Kushtet formale për kërkimin e një letre udhëzuese</i>	3
3.1.2.	<i>Parakushtet për lëshimin e një letre udhëzuese</i>	4
3.2.	Efektet e letrave udhëzuese	5
3.3.	Përpunimi i kërkesës	5
3.3.1.	<i>Analiza e kërkesës në raport me kriteret, prioritetet dhe faktet</i>	5
3.3.2.	<i>Refuzimi për të lëshuar një letër udhëzuese</i>	6
3.4.	Miratimi i një letre udhëzuese	6
3.4.1.	<i>Publikimi në faqen e internetit të Autoritetit të Konkurrencës</i>	7

## 1. Hyrje

- (1) Sipas ligjit nr. 9121/2003 “Per Mbrojtjen e Konkurrences” i cili i jep Autoritetit të Konkurrencës fuqi për të hetuar shkeljetne lidhje me nenet 4 dhe 9 per marrevshjet e ndaluara, abuzimin me poziten dominuese dhe për të vendosur gjoba. Një objektiv kryesor i Ligjit nr. 9121/2003 është të sigurojë zbatim efikas të rregullave të konkurrencës në Republikën e Shqipërisë, duke vendosur një sistem vetëvlerësimi nga ndërmarrjet përpara njoftimit në Autoritet, duke lejuar Autoritetin të përqendrojë politikën e tij për zbatimin e nenit 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003.
- (2) Megjithëse ligji nr. 9121/2003 nuk pengon Autoritetin e Konkurrencës për të dhënë udhëzime jozyrtare për ndërmarrjet, siç është përcaktuar në këtë Udhëzim, kjo nuk duhet të pengojë objektivin kryesor të Ligjit nr. 9121/2003, që është të sigurojë zbatim efektiv të nenit 4 dhe 9. Prandaj, Autoriteti mund të ofrojë udhëzime jozyrtare për ndërmarrjet nëse është në përputhje me prioritetet e tij të zbatimit të kuadrit ligjor për mbrojtjen e konkurrencës.
- (3) Autoriteti, në rast se merr një kërkesë për një letër udhëzuese, do të shqyrtojë nëse është e përshtatshme t’u procesojë atë. Lëshimi i një letre udhëzuese mund të merret në konsideratë vetëm nëse Autoriteti, pas një vlerësimi prima facie të fakteve dhe konsideratave ligjore të sjelljes ose sjelljes të parashikuar, ka arsye të vlefshme për të dhënë qartësime mbi zbatimin e nenit 4 ose 9 të Ligjit për marrëveshjen ose praktikën në fjalë përmes një letre udhëzuese.
- (4) Ndërmarrjet janë në përgjithësi në pozitë të mirë për të vlerësuar ligjshmërinë e veprimeve të tyre në mënyrë që të marrin një vendim të informuar nëse do të vazhdojnë me një marrëveshje ose praktikë të ndaluar dhe në cilën formë do ta bëjnë atë. Ato janë pranë fakteve dhe kanë në dispozicion kuadrin e rregulloreve të përjashtimit në bllok, praktikën gjyqësore dhe vendimet ekzistuese të Komisionit të Konkurrencës, si dhe udhëzime dhe rregullore të Komisionit, të cilat janë dhënë për të ndihmuar më tej vetëvlerësimin nga ndërmarrjet. Komisioni gjithashtu ka miratuar akte nënligjore në zbatim të nenit 6 të Ligjit nr. 9121/2003. Kjo u lejon ndërmarrjeve në shumicën e rasteve të vlerësojnë me besueshmëri marrëveshjet e tyre në lidhje me nenin 4 të Ligjit nr. 9121/2003.
- (5) Në raste kur, pavarësisht elementeve të mësipërme, ndodhin realisht raste paqartësie, sepse ato prezantojnë pyetje të reja ose të pazgjidhura për zbatimin e neneve 4 ose 9 të Ligjit nr. 9121/2003, ndërmarrjet mund të kërkojnë individualisht udhëzime jozyrtare nga Autoriteti i Konkurrencës. Në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë Udhëzim, një kërkesë nuk do t’i japë të drejtë kërkuarit për t’u udhëzuar nga Autoriteti i Konkurrencës. Megjithatë, kur e konsideron të përshtatshme dhe në varësi të prioriteteve të tij të zbatimit, Autoriteti mund të japë një udhëzim jozyrtar në lidhje me 72 interpretimin e neneve 4 ose 9 në një deklaratë me shkrim (letër udhëzuese).

## 2. Kontaktet ndërmjet Autoritetit të Konkurrencës dhe aktorëve të tregut.

- (6) Një kërkesë mund të paraqitet nga një ndërmarrje ose disa ndërmarrje që kanë lidhur ose synojnë të hyjnë në një marrëveshje ose praktikë që mund të përfshihet në objektin e neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

Një kërkesë për një letër udhëzuese duhet të drejtohet në adresën e mëposhtme:

Autoriteti i Konkurrencës

Rruga "Sami Frashëri", Nr. 4, Kati IV

Tiranë, 1004

Ose në adresën e email: [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)

Përpara dorëzimit zyrtar të kërkesës për një letër udhëzuese, ndërmarrja(et) mund të kontaktojë Autoritetin e Konkurrencës, për të diskutuar paraqitjen e tyre në mënyrë jozyrtare dhe konfidenciale.

## 3. Letrat udhëzuese

- (7) Një letër udhëzuese e lëshuar nga Autoriteti përmban:

- një përshkrim të përgjithshëm të fakteve në të cilat bazohet;
- vlerësimin ligjor të Autoritetit mbi zbatimin e nenit 4 ose 9 të Ligjit nr. 9121/2003 mbi pyetjet e reja ose të pazgjidhura që ngrihen nga marrëveshja ose praktika.

- (8) Një letër udhëzuese mund t'u përgjigjet vetëm një pjesë të pyetjeve të ngritura, ose mund të përfshijë aspekte shtesë nga ato që janë përcaktuar në kërkesë. Nëse është e nevojshme, Autoriteti mund të përcaktojë në një letër udhëzuese një afat kohor për zbatimin e saj ose të specifikojë se letra udhëzuese është e bazuar në ekzistencën ose mungesën e rrethanave të caktuara faktike.

Letrat udhëzuese do të publikohen në faqen e internetit të Autoritetit, duke marrë parasysh mbrojtjen e sekreteve tregtare të kërkuesit(ve). Autoriteti do të bjerë dakord me kërkuesin (it) për një version publik përpara publikimit të letrës udhëzuese.

### 3.1. Kushtet për lëshimin e një letre udhëzuese

- (9) Në kërkesën për letër udhëzuese, kërkuesi duhet të përfshijë:

- të dhënat e të gjitha ndërmarrjeve në fjalë si dhe një adresë të vetme për kontaktet me Autoritetin;
- pyetjet specifike mbi të cilat kërkohet udhëzimi jozyrtar;
- informacion të plotë dhe shterues për të gjitha pikat e rëndësishme për një vlerësim të pyetjeve të ngritura, duke përfshirë dokumentacionin përkatës, në mënyrë që të lejojë Autoritetin të lëshojë një letër udhëzuese;

- vlerësimin paraprak të vetë kërkuetit(ve), duke pasur parasysh pikën 6(a) të këtij Udhëzimi, se përse kërkesa paraqet pyetje(a) të reja ose të pazgjdhura në funksion të kuadrit ligjor ekzistues të Republikës së Shqipërisë, të praktikës vendimmarrëse të Komisionit ose letrat e mëparshme udhëzuese;
- vlerësimi paraprak i vetë kërkuetit(ve), duke pasur parasysh elementët e renditur në pikën 6(b) të këtij Udhëzimi, se përse një sqarim publik i zbatueshmërisë së neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 nëpërmjet një letre udhëzuese do të kishte vlerë të shtuar në lidhje me sigurinë juridike;
- vlerësimin paraprak të kërkuetit(ve), sipas aftësive të tij (të tyre), të zbatimit të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 për çështjet e reja ose të pazgjdhura të ngritura nga marrëveshja ose praktika;
- të gjitha informacionet e tjera që lejojnë një vlerësim të kërkesës në zbatim të pikave 7-8 të këtij Udhëzimi, duke përfshirë në veçanti një deklaratë që, sipas njohurive të kërkuetit(ve), marrëveshja ose praktika të cilës i referohet kërkesa nuk i nënshtrohet procedurave në pritje përpara një gjykate.
- kur kërkesa përmban elemente që konsiderohen si sekrete tregtare, një identifikim i qartë i këtyre elementeve;
- çdo informacion ose dokumentacion tjetër të rëndësishëm për vlerësimin e marrëveshjes ose praktikës.

### 3.2. Efektet e letrave udhëzuese

- (10) Letrat udhëzuese synojnë në radhë të parë të ndihmojnë ndërmarrjet të kryejnë një vetëvlerësim të informuar të marrëveshjeve apo praktikave. Në këtë aspekt, kërkueti(t) mbetet(n) përgjegjës për të kryer vetëvlerësimin e tyre për zbatueshmërinë e nenit 4 ose 9 të Ligjit nr. 9121/2003. Letrat udhëzuese reflektojnë pikëpamjet e Autoritetit mbi faktet e paraqitura dhe nuk krijojnë asnjë të drejtë apo detyrim për kërkuetin(t) ose për ndonjë palë të tretë.
- (11) Një letër udhëzuese nuk mund të paragjykojë vlerësimin e së njëjtës pyetje nga gjykata.
- (12) Në atë rast, Autoriteti do të marrë parasysh letrën e mëparshme udhëzuese, në veçanti në varësi të ndryshimeve në faktet themelore, të çdo aspekti të ri të zbuluar nga Autoriteti ose të ngritur nga një ankesë, ndaj zhvillimeve në praktikën gjyqësore ose ndryshime më të gjera të politikës në tregjet përkatëse. Në parim dhe në varësi të pikës 26 të këtij Njoftimi, Autoriteti nuk do të vendosë asnjë gjobë ndaj aplikantit(ve), në lidhje me çdo veprim të ndërmarrë nga aplikanti(ët) duke u mbështetur në mirëbesim në letrën udhëzuese të Autoritetit. Aty ku e kërkon interesi publik, Autoriteti mund të modifikojë ose revokojë një letër udhëzuese në përputhje me rrethanat, me vendim të Komisionit të Konkurrencës.
- (13) Sqarimet mbi zbatueshmërinë e nenit 4 ose 9 të Ligjit nr. 9121/2003, të përfshira në një letër udhëzuese, kushtëzohen shprehimisht nga saktësia dhe vërtetësia e informacionit të dhënë nga kërkueti(t) dhe çdo ndryshim substancial i informacionit të dhënë nga kërkueti(t) e bëjnë letrën udhëzuese të pavlefshme.
- (14) Letrat udhëzuese nuk janë vendime të Komisionit dhe nuk detyrojnë gjykatat të marrin në konsideratë një letër udhëzuese të lëshuar nga Autoriteti i Konkurrencës, në kontekstin e një

rasti.

### **3.2.1. Refuzimi për të lëshuar një letër udhëzuese**

- (15) Autoriteti nuk do të shqyrtojë një kërkesë për një letër udhëzuese në asnjërën nga rrethanat e mëposhtme:
- (16) pyetjet e ngritura në kërkesë janë të njëjta ose të ngjashme me çështje të ngritura në një rast në pritje përpara gjykatës; ose
- (17) marrëveshja ose praktika në të cilën kërkesa referohet është nën hetim nga Autoriteti i Konkurrencës.

Autoriteti nuk do shqyrtojë pyetje dhe nuk do të lëshojë letra udhëzuese në lidhje me marrëveshje ose praktikë që nuk po zbatohen më nga palët. Megjithatë, ndërmarrjet mund të paraqesin një kërkesë për një letër udhëzuese pranë Autoritetit në lidhje me pyetje mbi një marrëveshje ose praktikë që ato parashikojnë, para zbatimit të kësaj marrëveshjeje ose praktike. Në këtë rast, planifikimi i marrëveshjes ose praktikës duhet të ketë arritur një fazë mjaft të përparuar që kjo kërkesë të shqyrtohet.

### **3.3. Miratimi i një letre udhëzuese**

Autoriteti do të vlerësojë në parim kërkesën në bazë të informacionit të dhënë dhe nuk do të trajtojë kërkesa që nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë Udhëzim. Megjithatë, Autoriteti mund të përdorë informacion shtesë që ka në dispozicion nga burime publike, praktika të mëparshme vendimmarrëse apo çdo burim tjetër dhe mund të kërkojë nga kërkuuesi(t) ose, në raste të jashtëzakonshme, nga palët e zgjedhura të japin informacione shtesë, duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit të dhënë nga kërkuuesi(t). Kur ky informacion përmban të dhëna personale, Autoriteti i përpunon të dhënat personale në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Autoriteti mund të ndajë informacionin e dorëzuar me autoritetet e konkurrencës së Shteteve Anëtare dhe të marrë vlerësime prej tyre. Ai mund të diskutojë me autoritetet e konkurrencës së Shteteve Anëtare për substancën e kërkesës përpara se të lëshojë një letër udhëzuese.

Duke iu referuar pikave 12-14 të këtij Udhëzimi, rregullat mbi ruajtjen e konfidencialitetit dhe e sekreteve tregtare të përcaktuara në nenin 30 të Ligjit nr. 9121/2003 zbatohen për informacionin e dhënë nga kërkuuesi(t) ose palët e treta të zgjedhura.

Autoriteti do të informojë kërkuuesin për rrjedhën e veprimeve që ai ka në plan të ndërmarrë në lidhje me kërkesën për udhëzim brenda një kohe të arsyeshme, duke u bazuar në rrethanat e secilit rast. Në rast se nuk lëshohet një letër udhëzuese, Autoriteti do të informojë kërkuuesi(n) për këtë me shkrim.

Kërkuuesi mund të tërheqë kërkesën e tij/saj në çdo moment. Në raste të tilla, nuk do të lëshohet asnjë letër udhëzuese. Megjithatë, informacioni i dhënë në kontekstin e një kërkesë për udhëzim jozyrtar mbetet i disponueshëm për Autoritetin dhe mund të përdoret për të nisur procedura të mëtejshme sipas Ligjit nr. 9121/2003.

Kërkesa për një letër udhëzuese nuk çënon kompetencën e Autoritetit për të hapur procedura hetimore në përputhje me Ligjin nr. 9121/2003 në lidhje me faktet e paraqitura në kërkesë.

## **21 Mbyllja e procedurave**

1.	Hyrje	2
2.	Procesi i konsultimit	2
2.1.	Shërbimi Juridik	2
2.2.	Drejtoritë e tjera të Përgjithshme	3
3.	Miratimi i vendimit për mbylljen e procedurave	3
4.	Njoftimi i palës/palëve	3

## 1. Hyrje

1. Komisioni, në zbatim të Nenit 41 të Ligjit, mund të autorizojë në çdo kohë Sekretariatën për të filluar mbledhjen e fakteve për hetim, me qëllim vlerësimin e konkurrencës në treg, si dhe evidentimin e shtrembërimeve të mundshme të saj. Ky hetim mund të kërkohet nga Kuvendi ose nga entet rregullatorë të sektorëve të veçantë.

2. Gjatë periudhës së hetimit referuar pikës 1 të këtij neni, Autoriteti mund të kërkojë informacione dhe dokumente si dhe të urdhërojë inspektime, dëshmi ekspertësh, analiza statistikore dhe ekonomike, apo të konsultohet me ekspertë duke ndjekur procedurat sipas neneve 8, 9, 10 dhe 12, të kësaj Rregulloreje. Gjithashtu, janë të zbatueshme sanksionet e parashikuara në nenet 73 dhe 76 të Ligjit. Gjatë kësaj procedure hetimore nuk lejohet konsultimi me dosjen.

3. Sekretariati informon Komisionin për rezultatet e hetimit. Njoftimi mbi rezultatet e hetimit publikohet në Buletinin Zyrtar të Autoritetit, në faqen e internetit 2 të Autoritetit, si dhe mund të ftojë palët e interesuara të shprehen për rezultatet e hetimit.

4. Nëse gjatë këtij hetimi ka të dhëna që tregojnë se nenet 4 dhe/ose 9 të Ligjit, mund të jenë shkelur, Sekretariati njofton menjëherë Komisionin, i cili, nëse është i bindur që ka shenja të mjaftueshme lidhur me shkeljen e nenit 4 dhe /ose 9 të Ligjit, autorizon Sekretariatën që të fillojë procedurat e hetimit të thelluar siç përcaktohen në nenin 5 të kësaj rregulloreje.

## 2. Miratimi i vendimit për mbylljen e procedurave

Kur vihen re shenja të kufizimit të konkurrencës, fillohet procedura e hetimit të thelluar. Komisioni merr vendim për fillimin e procedurës së hetimit të thelluar dhe përcakton hapat për realizimin e tij. Vendimi zbatohet nga sekretariati i komisionit.

Afati i përfundimit të procedurave të hetimit të thelluar është deri në 6 muaj nga data e vendimit të komisionit për hapjen e hetimit të thelluar.

Afati, sipas pikës 2 të këtij neni, mund të zgjatet me vendim të komisionit, në rast se kërkohen hetime të mëtejshme, që kanë të bëjnë me prova, të dhëna shtesë dhe ekspertizë të specializuar për shqyrtimin e rastit.

Procedurat hetimore, të parashikuara në nenet 41, 42 e 43 të këtij ligji, kryhen sipas rregulloreve të dala në zbatim të këtij ligji.

Komisioni shprehet me vendim për mbylljen e hetimit, në zbatim të neneve 41, 42, e 43 të këtij ligji, edhe në rastet kur nuk konstatohen shenja të kufizimeve të konkurrencës.

## 3. Njoftimi i palës/palëve

Aplikimi, kërkesat, dërgimi i dokumentave dhe thirrja e palëve, kryhet si vijon:

1. Me postë, me shpërndarje te regjistruar;
2. Dorazi me konfirmimin e marrjes dijëni;
3. Faks, me një kërkesë për konfirmimin me shkrim në datën e mbërritjes;

#### 4. Teleks ose telegram;

Të njëjtat disapozita zbatohen edhe për dorëzimin e dokumenteve dhe të kërkesave për Komisionin dhe Sekretariatit në lidhje me hetimin, nga ana e palëve të interesuara, ose nga palët e treta. Në rastin e shërbimit me teleks, telegram ose me faks, dokumentet konsiderohen se janë marrë në datën në të cilën janë dërguar, përveç rasteve kur mund të provohet e kundërta.

Kur njoftimet nënshkruhen nga përfaqësuesit e individëve, të ndërmarrjeve ose të subjekteve, këta përfaqësues duhet të jenë të pajisur me dokument përfaqësimi.

#### 4. Publikimi

Autoriteti publikon fillimin e hetimit të thelluar në “Buletinin zyrtar” të Autoritetit. Në njoftim përcaktohen qëllimi i hetimit, argumentet për fillimin e hetimit dhe palët që hetohen. Autoriteti, nëpërmjet njoftimit, fton edhe palë të treta të marrin pjesë në hetim, nëse ato janë të interesuara. Mungesa e publikimit nuk pengon fillimin dhe kryerjen e hetimit. Në këtë rast publikimi botohet në numrin e parë të ardhshëm të “Buletinit zyrtar” të Autoritetit.

Vendimet e Komisionit, të marra për shkeljen e neneve 4 dhe 9, botohen në “Buletinin zyrtar” të Autoritetit. Publikimi përmban emërtimin, selinë, veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, përmbajtjen kryesore të vendimit, si dhe gjobat e vëna.

## **22 Mbyllja administrative e dosjes**

1. Hyrje 2
2. Mbyllja e dosjes 2
3. Informacioni rreth mbylljes së çështjes 3

## 1. Hyrje

Legjislacioni shqiptar mbi të drejtën e informimit, i njeh të drejtën qytetarëve për të pasur akses në informacionin publik, si për shembull çdo të dhëne, të regjistruar në çfarëdo lloj forme apo formati, gjatë kryerjes së funksionit publik. Çdo qytetar mund të kontaktojë administratën publike dhe të kërkojë akses/qasje në informacionin publik, duke marrë dokumentin origjinal ose një kopje të tij, pa pasur nevojë të shpjegojë arsyet që justifikojnë kërkesën.

Ligji për të drejtën e informimit përcakton disa kufizime në të drejtën për të pasur akses kur, ndër të tjera, zbulimi/dhënia e informacionit mund të dëmtojë tregtinë ose sekretet e biznesit. Për më tepër, e drejta për të aksesur informacionin, ndër të tjera, mund të kufizohet edhe në rastet kur dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe serioz, në "parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale".

Shtrirja e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës (këtu e në vijim AK) i nënshtrohet kufizimeve, të parashikuara nga nenet 28 dhe 29 të Ligjit "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", siç janë monitorimi dhe analizimi i kushteve të tregut, kryerja e hetimeve dhe mbikëqyrja e zbatimit të vendimeve. Për këtë arsye, e drejta e përgjithshme për të aksesuar informacionin /mund të kufizohet në raste specifike gjatë procedurave të veprimtarisë së AK.

Në fakt, kufizime të caktuara për të drejtën për të aksesuar dokumente të dosjes janë përfshirë në Ligjin "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe në disa rregullore të AK-së (konkretisht, Rregullorja Për funksionimin, Rregullorja Për Procedurat Hetimore dhe Rregullorja Për procedurat e Përqendrimit).

### II.1.1 Aksesit në dosjen e procedurave hetimore

Bazuar në rregulloret e sipër përmendura, ndërmarrjet nuk kanë të drejtë të konsultohen me dosjen, as në fazën e procedurës paraprake të hetimit, as gjatë hetimit në sektorët e ekonomisë. Pra, të gjitha hetimet e kryera gjatë të dy procedurave fillestare janë plotësisht konfidenciale.

Sidoqoftë, Rregullorja për Procedurat Hetimore, vlerëson që, pas fillimit të një hetimi të thelluar, konsultimi me dosjen e hetimit mund të ndodhë vetëm pasi të jetë dorëzuar raporti përkatës tek palët përkatëse.

Për më tepër, nëse AK vendos në lidhje me një ankese duke e hedhur poshtë ankimin e bërë, ankuesi ka të drejtë të shqyrtojë dokumentat, për sa kohë ato nuk përmbajnë sekrete biznesi dhe informacione të tjera konfidenciale, mbi të cilat Autoriteti mbështet vlerësimet e veta.

Për sa i përket asaj se kush mund të ketë akses në dosje pas fillimit të hetimit të thelluar, Rregullorja për Procedurat e Hetimit përcakton që hetimi mund të përfshijë gjithë ndërmarrjet e përfshira, si dhe personin që ka një interes të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm në hetim dhe që ka depozituar të dhëna dhe /ose ka bërë ankese në lidhje me fillimin e këtij hetimi<sup>9</sup>.

Sa i përket palëve të treta, si në Rregulloren e AK-së Për Procedurat Hetimore, ashtu edhe në Kodin e Procedurave Administrative, parashikohet se në një procedurë hetimore, mund të përshihen edhe persona të cilët përfaqësojnë interesa publike apo private, interesat e të cilëve mund të preken.

Nëse një palë e tretë dëshiron të njihet/përshihet në procesin hetimor, duhet ti drejtohet AK me një kërkesë të arsyetuar, brenda 30 ditë nga data e publikimit të Vendimit për fillimin e një hetimi.

Prandaj, në procedurat hetimore, vetëm (i) palët nën hetim; (ii) një person me interes të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm i cili i ka siguruar/depozituar AK-së informacione ose ka bërë ankesë; dhe (iii) palët e treta që janë njohur nga AK, mund të kenë akses në dosje dhe kjo vetëm pasi Raporti i Hetimit ju është bërë me dije/ju është njoftuar.

Në çdo rast, aksesin në dosje nuk është automatik, por duhet drejtuar fillimisht një kërkesë AK. Rregullorja e AK përcakton që e drejta e aksesit duhet të ushtrohet nëpërmjet bërjes së një kërkesë të arsyetuar me shkrim, dhe Sekretariatit i shqyrton ato rast pas rasti, brenda një periudhë 30 ditore, duke njoftuar Komisionin.

#### **Aksesi në dosje pas përfundimit të procedurave.**

Për të siguruar veprime efektive /nisma private në bazë të ligjit civil dhe zbatimin e ligjit të AK, një person që pretendon kompensim për dëme të pësuar si rezultat shkeljes së ligjit të konkurrencës, ka të drejtën të aksesojë informacionin përkatës që përmban dosja e AK-së. Sidoqoftë, kjo duhet të vlerësohet me kujdes, nëse ekziston rreziku i zbulimit të dokumenteve që mund të ndikojnë negativisht në mënyrën në të cilën ndërmarrjet bashkëpunojnë me AK.

Bazuar mbi këto parime si dhe Udhëzimit mbi dëmet, një paraqitës i kërkesës për dëme, duhet të ketë akses në dokumentet e përcaktuara nga gjykata. AK do t'i paraqesë/depozitojë dokumentet në gjykatë.

Në asnjë rast, nuk do të zbulohet aplikimi i kryer për të përfituar nga Programi i Lehtësimi nga Gjobat. Vetëm informacionet e përgatitura për procedurat e AK, si dhe informacioni i përgatitur dhe dërguar palëve nga AK do të zbulohen, duke ndjekur kriteret e proporcionalitetit, dhe vetëm pasi AK të ketë mbyllur procedurat hetimore të saj.

### 1. Mbledhja e gjobave/sanksioneve financiare periodike dhe revokimi i mbledhjes

#### 1.1. Lista e rregullave të zbatueshme

Autoriteti ne përlllogaritjen e gjobës fillimisht përcakton vlerën bazë të saj, për çdo ndërmarrje apo grupim ndërmarrjesh . Vlera bazë mund të zmadhohet duke marrë parasysh rrethanat rënduese ose zvogëlohet duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese

#### 1.2. Mbledhja

Komisioni në përcaktimin e vlerës bazë, përdor vlerën e të ardhurave nga shitja e produkteve të ndërmarrjes, me të cilat lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose të tërthortë, shkelja e kryer në tregun përkatës. Komisioni merr për bazë vlerën e shitjeve të realizuara nga ndërmarrja gjatë vitit të fundit financiar të pjesëmarrjes në shkelje. (këtu e më pas “vlera e shitjeve”).

Kur shkelja nga një grupim ndërmarrjesh lidhet me veprimtarinë e anëtarëve të këtij grupimi, vlera e shitjeve do të përputhet me shumën e vlerës së shitjeve të anëtarëve të grupimit.

Autoriteti, ne përcaktimin e vlerës së shitjeve nga një ndërmarrje, përdor të dhëna të plota dhe më të besueshme që disponon për atë ndërmarrje. Kur të dhënat që janë vënë në dispozicion nga një ndërmarrje janë të paplota ose jo të besueshme, Autoriteti mund të përcaktojë vlerën e shitjeve të saj mbi bazën e të dhënave të pjesshme që ai ka siguruar dhe/ose çdo informacioni tjetër të cilin ai e sheh si të përshtatshëm.

Vlera e shitjeve përcaktohet pas zbritjes së tatimeve, taksave dhe tarifave të tjera që lidhen drejtpërdrejt me shitjet, siç parashikohet në ligj.

Kur shtrirja gjeografike e një shkelje kalon kufijtë e territorit të Republikës së Shqipërisë, Autoriteti: a) përcakton vlerën totale të shitjeve të produkteve, me të cilat lidhet shkelja në zonën gjeografike të tregut përkatës; ose, b) përcakton pjesën e shitjeve në këtë treg të çdo ndërmarrje pjesëmarrëse në shkelje. Llogaritja e xhiros në tregun përkatës shërben për llogaritjen e vlerës bazë të gjobës.

Vlerësimi i rëndësisë së shkeljes bëhet rast pas rasti, për të gjitha llojet e shkeljeve, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes.

Vlera bazë e gjobës lidhet me një përqindje të vlerës së shitjeve, në varësi të shkallës së rëndësisë së shkeljes, e shumëzuar me numrin e viteve të shkeljes.

Përqindja e vlerës së shitjeve që merret parasysh, do të jetë në një nivel deri në 30% të vlerës së shitjeve. Autoriteti, me qëllim që vendosë nëse përqindja e vlerës së shitjeve që do të merret parasysh në një çështje të dhënë do të jetë në nivelin e sipërm apo të poshtëm

të shkallës, vlerëson një numër faktorësh, të tillë si natyra e shkeljes, pjesa e kombinuar e tregut të të gjitha ndërmarrjeve në fjalë, shtrirja gjeografike e shkeljes dhe nëse praktika antikonkurruese është zbatuar ose jo.

Marrëveshjet horizontale që caktojnë çmimin, ndarja e tregut dhe kufizimi i prodhimit, të cilat konsiderohen sekrete nga natyra e tyre, janë ndër kufizimet më të dëmshme të konkurrencës. Prandaj, përbindja e vlerës së shitjeve që merret parasysh për një shkelje të tillë përgjithësisht do të jetë në nivelin e sipërm të shkallës.

Bazuar në kohëzgjatjen e pjesëmarrjes së çdo ndërmarrjeje në shkelje, vlera e përcaktuar mbi bazën e shitjeve shumëzohet me numrin e viteve të pjesëmarrjes në shkelje duke patur parasysh që: a) Periudhat më të vogla se gjashtë muaj llogariten si gjysmë viti; b) Periudhat më të gjatë se gjashtë muaj por më të shkurtra se një vit llogariten si një vit i plotë.

Pavarësisht nga kohëzgjatja e pjesëmarrjes së ndërmarrjes në shkelje, Autoriteti do të përfshijë në vlerën bazë edhe një shumë ndërmjet 15% deri 25% të vlerës së shitjeve, siç është cituar më sipër, me qëllim pengimin e ndërmarrjeve për të mos hyrë në marrëveshje horizontale në të ardhmen, të fiksimit të çmimit, ndarjes së tregut, ose te furnizuesve dhe kufizime të prodhimit. Autoriteti mund t'a zbatojë këtë vlerë shtesë edhe në rastet e shkeljeve të tjera.

### **1.2.1. Detyrimi për të paguar brenda afatit kohor të përcaktuar nga vendimi dhe përjashtimet**

Masa e gjobës për shkeljet e lehta

1. Komisioni vendos gjoba, në masën jo më shumë se 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet ose grupimet e ndërmarrjeve nëse:

a) japin të dhëna të pasakta, të paplota ose të rreme në përgjigje të kërkesës ose vendimit të komisionit, sipas nenit 33 pikat 2 e 3 të këtij ligji, ose nuk japin të dhëna brenda afatit kohor, të përcaktuar në vendimin e komisionit apo në kërkesën e sekretariatit, sipas nenit 33 pika 3 të këtij ligji;

b) japin të dhëna të pasakta, të paplota ose të rreme në njoftimet, sipas neneve 12 e 49 të këtij ligji, ose të dhëna dhe dokumente plotësuese të pasakta e të paplota, sipas nenit 55 të këtij ligji;

c) japin të paplotë librat e kërkuar ose regjistrat e tjerë të veprimtarisë së tyre ekonomike, gjatë inspektimeve, sipas nenit 36 shkronjat "b" dhe "c" të këtij ligji, ose refuzojnë të pranojnë inspektimet në mbështetje të vendimit të marrë, sipas neneve 35 pika 1 dhe 36 shkronja "a" të këtij ligji;

ç) refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve për faktet dhe, sipas shkronjës "d" të nenit 36 të këtij ligji, japin përgjigje të pasakta, të paplota, të rreme ose pengojnë inspektimin e parashikuar në nenin 36;

d) heqin vulat e vëna në autorizimin zyrtar të Autoritetit, sipas nenit 36 shkronja "ç" të këtij ligji.

dh) nuk njofton një përqendrim, sipas neneve 10 dhe 12 të këtij ligji. 2. Parashikimet e neneve 15, 16 dhe 17 zbatohen edhe për pikën 1 të këtij neni, për llogaritjen e xhiros totale.

Masa e gjobës për shkelje të rënda

Komisioni vendos gjoba, në masën deri në 10 për qind të xhiros së ndërmarrjes, të vitit financiar paraardhës, për çdo ndërmarrje pjesëmarrëse që:

a) shkel nenet 4 e 9 të këtij ligji;

b) nuk zbaton vendimin për marrjen e masave të përkohshme, sipas nenit 44;

c) nuk përmbush kushtet dhe detyrimet në mbështetje të një vendimi të marrë, sipas neneve 45, 50 pika 2, 56, 57 dhe 60 pika 2 të këtij ligji;

d) realizon një përqendrim i cili ka efekte të kufizimit të konkurrencës në treg<sup>47</sup>, duke mos respektuar detyrimin e nenit 14, përveç rastit kur realizimi i përqendrimit është autorizuar shprehimisht, sipas nenit 60 të këtij ligji;

dh) realizon një përqendrim të ndaluar nga Komisioni ose nuk merr masat e nevojshme për rivendosjen e konkurrencës, sipas nenit 62 të këtij ligji.

#### **1.2.1.1 Ofrimi i lehtësirave për pagesat dhe/ose reduktimet e gjobave**

Komisioni mund të japë lehtësim të plotë nga çdo gjobë, nëse kjo ndërmarrje është e para që ndihmon në zbulimin dhe ndalimin e marrëveshjes së të ndaluar, si dhe në përcaktimin e personave përgjegjës duke siguruar prova dhe të dhëna, të pazotëruara më parë nga Autoriteti, që i mundësojnë këtij të fundit të :

a) të fillojë një hetim në lidhje me një marrëveshje të ndaluar;

b) të zbulojë një shkelje në bazë të nenit 4 të Ligjit.

2. Për përfitim nga lehtësimi plotë i gjobës ndërmarrja duhet:

a) Ti sigurojë Autoritetit një kopje ose përkrahje të marrëveshjes së ndaluar, ku përfshihen: qëllimi, veprimtaria, funksionimi, produktet përkatëse, tregu përkatës, zgjatja dhe vlerësimi i volumit të tregut të ndikuar nga marrëveshja e ndaluar, data e lidhjes së marrëveshjes, vendndodhja, përmbajtja dhe pjesëmarrësit në marrëveshje si dhe përshkrime të tjera të cilat ndihmojnë Autoritetin në zbulimin e shkeljes.

b) Të japë emrin dhe adresën e ndërmarrjes që aplikon për lehtësim nga gjoba si dhe emrat dhe adresat e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje.

c) Të japë emrat, pozicionet, vendndodhjet e zyrave dhe kur është e nevojshme, adresat e të gjithë individëve të cilët, për sa ka dijeni ndërmarrja kërkuese, janë ose kanë qenë të përfshirë në marrëveshjen e ndaluar, duke përshirë të gjithë ata individë të cilët kanë qenë të përfshirë për llogari të kërkuesit.

d) Të informojë Autoritetin nëse ndërmarrja është tërhequr nga pjesëmarrja në

marrëveshjen e ndaluar;

e) Të qëndrojnë në dispozicion të Autoritetit për t'iu përgjigjur kërkesave që mund të kontribuojnë për rastin;

f) Të mos shkatërrojë, falsifikojë ose korrigjojë informacionin përkatës ose të dhënat që lidhet me marrëveshjen e ndaluar;

g) Të japë të dhëna të tjera që lidhen me marrëveshjen e ndaluar.

3. Lehtësimi nga gjocat, sipas pikës 2 të këtij neni, nuk do të jepet nëse, në kohën e aplikimit, Autoriteti ka pasur të dhëna të mjaftueshme:

a) për të ndërmarrë një hetim, në lidhje me një marrëveshje të ndaluar;

b) ka ndërmarrë një hetim të tillë;

c) Për të marrë një vendim nga Komisioni.

4. Lehtësimi nga gjocja, sipas pikës 2 të këtij neni, do të jepet në rastin kur Autoriteti në kohën e aplikimit nuk kishte të dhëna të mjaftueshme për të zbuluar një shkelje sipas nenit 4 të Ligjit.

5. Ndërmarrja, e cila ka ndërmarrë nismën të detyrojë ndërmarrjet e tjera të bashkohen në marrëveshje, ose të qëndrojnë në të, nuk përfiton nga ky lehtësim.

### **1.2.2. Pamundësia për të paguar brenda afatit kohor**

Vendosja e gjobave, sipas pikës 1 të këtij neni, u nënshtrohet afateve të parashkrimit prej tre vjetësh, në rastin e përcaktuar në nenin 73 “Masa e gjobës për shkelje të lehta” të këtij ligji dhe prej 5 vjetësh, në rastin e përcaktuar në nenin 74 pika “Masa e gjobës për shkelje të rënda” të Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”

### **1.2.2 Revokimi i Vendimeve**

Komisioni mund të revokojë ose të ndryshojë vendimet e veta, duke vendosur kushte a detyrime, ose të rifillojë procedurën kur:

a) njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit, kanë ndryshuar;

b) palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;

c) vendimi është bazuar në të dhëna jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.

## **1.3. Monitorimi i urdhrave të ndërprerjes dhe ndalimit (Neni 7, paragrafi 1 i Rregullores 1/2003)**

Angazhimet duhet të lidhen me shqetësimet e identifikuara të konkurrencës. Për ato angazhime të cilat nuk lidhen me shqetësimet e konkurrencës ose nuk i plotësojnë ato, nuk pranohen nga

Komisioni. Palët mund të ofrojnë angazhime të cilat kanë natyrë sjelljeje (p.sh. detyrim për të ofruar/furnizuar) ose natyrë strukturore (p.sh shitje të një pjesë të ndërmarrjes).

Angazhimet e sjelljes zakonisht kanë dis-avantazhin që ato kërkojnë kohë të gjatë për tu monitoruar.

Në parim, angazhimet e ofruara duhet të jenë proporcionale, d.m.th ato të mos shkojnë përtej asaj ç'ka është e nevojshme për të rregulluar/ndrequr shqetësimet e konkurrencës. Megjithatë, në krahasim me përqendrimet duhet të kihet parasysh fakti se angazhimet depozitohen vullnetarisht në të kundërt të përqendrimeve të cilat vendosen nga Komisioni.

Komisioni në çdo rast duhet të verifikojë se:

- a) angazhimet janë të mjaftueshme për të adresuar shqetësimet e konkurrencës dhe
- b) ndërmarrja ka ofruar angazhimet e duhura.

Megjithatë, është e rëndësishme për zbatueshmërinë e angazhimeve që ato të jenë të qarta dhe të vetë ekzekutueshme. Kjo do të thotë se zbatueshmëria e tyre nuk duhet të varet nga vullneti i palëve të treta. Gjithashtu, duhet që procesi i zbatueshmërisë duhet të dizajnohet në mënyrë të tillë që ndërmarrja të ketë nxitjen për ta zbatuar angazhimin në mënyrën e duhur. Angazhimet strukturore të cilat parashikojnë një afat kohor të përcaktuar për procedurat e strukturimeve dhe i jep administratorit të besuar të drejtën që të zhveshë/shesë biznesin respektiv duhet të ndiqen nga afër përderisa bëhet fjalë për një rast të caktuar ati konkurrues. Prandaj është në interesin e ndërmarrjes që të shesë/strukturojë biznesin brenda afatit kohor. Angazhime kontradiktore ose jo të plota, mund të rezultojnë në një dështim në eliminimin e shqetësimeve të konkurrencës dhe mund të jetë e vështirë që të korrigjohen në një fazë të mëvonshme. Megjithatë, Komisioni mund të rihapë procedura hetimore nëse një ndërmarrje vepron në kundërshtim me angazhimet.

Nëse është e nevojshme, administratori i besuar mund të caktohet për të asistuar Komisionin në zbatimin e angazhime (administrator monitorimi dhe/ose strukturor).

Ka një rëndësi të veçantë që të regjistrohen dhe të mbahen rekorde/procesverbale të diskutimeve, duke marrë në konsideratë, në veçanti faktin që zbatimi i angazhimeve mund të ndodhë në një fazë të mëvonshme dhe kjo mund të kërkojë një interpretim të tekstit të angazhimeve, për të cilat regjistrimet e mbajtura do të ishin shumë të nevojshme. Kjo është shumë e rëndësishme, sidomos kur flitet për angazhime të cilat kanë natyrë sjelljeje, duke qenë se ato mund të vazhdojnë për disa vjet me radhë dhe mund të kërkojnë një kohë të gjatë për tu monitoruar. 8. Angazhimet finale duhet të firmosen nga ndërmarrjet në fjalë.

#### **1.4. Monitorimi i angazhimeve të detyrueshme**

Monitorimi që do të kryhet varet nga natyra e angazhimeve. Në shumicën e rasteve, por dhe në veçanti, kur bëhet fjalë për angazhime strukturore, angazhimet duhet të parashikojnë që duhet të caktohet një administrues i besuar, menjëherë pas miratimit të vendimit me angazhime. Administratori i besuar, duhet të jetë i pavarur dhe i kualifikuar për të kryer detyrën e monitorimit. Ai do të monitorojë në mënyrë të detajuar hapat e ndryshme të zbatimit të angazhimeve dhe i raportojnë rregullisht mbi këtë, Komisionit të Konkurrencës.

### 1.2.1. Ankimet

Kundër vendimeve të komisionit për vendosjen e sanksioneve mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin. 2. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

### 1.2.2. Masat e përkohshme

Në raste urgjence të justifikuar nga rreziku i shkakimit të një dëmi të rëndë e të pariparueshëm për paditësin dhe kur ka të ngjarë të ketë shkelje të neneve 4 dhe 9 të këtij ligji, me kërkesë të paditësit, Gjykata e Tiranës mund të marrë vendime për marrjen e masave të përkohshme.

## 1.1. Veçoritë e përbashkëta për të gjitha llojet e veprimeve ligjore

Drejtoria Juridike, Integritetit dhe e Çështjeve Gjyqësore kryen vlerësime të akteve dhe projekt-akteve ligjore dhe nënligjore lidhur me përputhshmërinë e tyre me ligjin dhe shkallen e kufizimit, ose te pengimit të konkurrencës, me synim përafrimin e legjislacionit vendas me “Acquis Communautaire” dhe mbrojtjen e konkurrencës. Drejtoria në fillim të çdo muaji i paraqet Sekretarit të Përgjithshëm një raport të aktivitetit mujor të drejtorisë si dhe një plan të punëve që do të trajtohen nga drejtoria në muajin në vijim. Drejtoria me autorizim ndjek dhe mbron interesat e Autoritetit në proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit, nëpërmjet përgatitjes së prapësimeve, ankimeve, rekurseve, përgatitjes dhe hartimit të materialeve për në gjykatë dhe informon Kryetarin dhe Sekretarin e Përgjithshëm për mbarëvajtjen e tyre.

### 1. Konfirmimi i marrjes së njoftimit.

Autoriteti u jep ndërmarrjeve njoftuese një vërtetim me shkrim për marrjen e njoftimit, ku u bën të ditur se njoftimi është i plotë. Kur njoftimi nuk është i plotë, Autoriteti i njofton ndërmarrjet që, brenda një afati, ta plotësojnë atë.

### 2. Të dhënat dhe dokumentet plotësuese

Ndërmarrjet pjesëmarrëse, ato që bëjnë pjesë në një grup, sipas nenit 16 të ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe ndërmarrjet që shesin një pjesëmarrje ose pjesë ndërmarrjeje, edhe nëse atyre u është dërguar vërtetimi, që konfirmon marrjen e njoftimit të plotë, detyrohen t'i sigurojnë Autoritetit, brenda një afati të caktuar prej tij, të dhënat dhe dokumentet shtesë, që janë me interes për vlerësimin e përqendrimit.

Autoriteti mund të sigurojë nga ndërmarrje të tjera të dhëna dhe dokumente shtesë që janë me interes për vlerësimin e përqendrimit dhe mund t'i njoftojë ato për përqendrimin në fjalë, duke ruajtur sekretin tregtar të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, atyre që bëjnë pjesë në një grup, sipas nenit 16 të këtij ligji, si dhe të ndërmarrjeve që shesin një pjesëmarrje ose pjesë ndërmarrjeje.

## 25 Publikimi i vendimeve

1.1.	Objekti i publikimit	2
1.2.	Përmbajtja e publikimit në Gazetën Zyrtare	3
1.2.1.	<i>Përmbledhja e vendimit</i>	3
1.2.2.	<i>Raporti përfundimtar i kryetarit të seancës dëgjimore</i>	3
1.2.3.	<i>Opinionit i Komitetit Këshillimor</i>	3
2.1.	Koha e publikimit në Gazetën Zyrtare	4
2.2.	Vendi i publikimit në Gazetën Zyrtare	4
2.3.	Korrigjimet	4
3.1.	Objekti i publikimit	5
3.2.	Përmbajtja e publikimit	5
3.3.	Cilat informacione nuk mund të publikohen?	5
3.4.	Koha e publikimit në faqen e internetit	5
3.5.	Vendi i publikimit në faqen e internetit	5
3.6.	Korrigjimet	6
4.1.	Identifikimi i informacioneve që nuk mund të publikohen	6
4.1.1.	<i>Letra e parë që u dërgohet marrësve</i>	7
4.1.2.	<i>Kërkesa për shtyrje</i>	7
4.1.3.	<i>Ndjekja në rastin e moskthimit të përgjigjes</i>	8
4.1.4.	<i>Menaxhimi i kërkesave për konfidencialitet</i>	9
4.2.	Të dhënat personale – Veprimet e marra me iniciativën e vetë Komisionit	10
4.3.	Informacioni që mund të vërë në rrezik hetimet e Komisionit nëse publikohet – Veprimet e marra me iniciativën e vetë Komisionit	10
5.1.	Si duhet të identifikohet informacioni konfidencial?	10
5.2.	Si të përgatitet një version i konsoliduar nga i cili të jenë hequr të gjitha informacionet që nuk mund të publikohen	
5.3.	Përkthimet	11
5.3.1.	<i>Publikimi në Gazetën Zyrtare</i>	12
5.3.2.	<i>Publikimi në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme për Konkurrencën</i>	12
5.4.	Aspektet praktike të publikimit	12

5.4.1.	<i>Publikimi në Gazetën Zyrtare</i>	12
5.4.2.	<i>Publikimi në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme për Konkurrencën</i>	13
6.1.	Informacioni konfidencial	14
6.2.	Të dhënat personale	15
6.3.	Informacioni që mund të vërë në rrezik hetimet e Komisionit nëse publikohet	15
6.4.	Parimi i prezumimit të pafajësisë	16
6.5.	Rregullorja për transparencën	16

## **1. Publikimi në Website-in Zyrtar**

### **1.1. Objekti i publikimit**

Sekretariati i Konkurrencës siguron publikimin e vendimeve të marra, të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji, si dhe të raportit vjetor të Autoritetit;

Autoriteti publikon fillimin e hetimit të thelluar në “Buletinin zyrtar” të Autoritetit. Në njoftim përcaktohen qëllimi i hetimit, argumentet për fillimin e hetimit dhe palët që hetohen. Autoriteti, nëpërmjet njoftimit, fton edhe palë të treta të marrin pjesë në hetim, nëse ato janë të interesuara. Mungesa e publikimit nuk pengon fillimin dhe kryerjen e hetimit. Në këtë rast publikimi botohet në numrin e parë të ardhshëm të “Buletinit zyrtar” të Autoritetit.

Vendimet e Komisionit, të marra për shkeljen e neneve 4 dhe 9, botohen në “Buletinin zyrtar” të Autoritetit. Publikimi përmban emërtimin, selinë, veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, përmbajtjen kryesore të vendimit, si dhe gjobat e vëna.

## **2. Cilat informacione nuk mund të publikohen?**

(1) Informacionet që nuk mund të publikohen mund të përmbliken si në vijim:

- Informacionet konfidenciale, në veçanti sekretet tregtare,<sup>1</sup>
- Të dhënat personale,
- Informacioni që mund të vërë në rrezik hetimet e Komisionit nëse publikohet.

(2) Përmbledhja, raporti përfundimtar i kryetarit të seancës dëgjimore dhe opinioni i Komisionit të Konkurrencës duhet të jenë hartuar në mënyrë të tillë që të mos përmbajnë informacione që nuk mund të publikohen. Në parim, nuk duhet të lindin mosmarrëveshje mbi përmbajtjen e përmbledhjes, të raportit përfundimtar të kryetarit të seancës dëgjimore dhe të opinionit të Komitetit Këshillimor.

### **2.1. Korrigjimet**

(3) Në rast se një vendim i miratuar përmban gabime, do të bëhen korrigjime në përputhje me procedurën përkatëse. Nëse publikimi në Gazetën Zyrtare nuk është bërë ende, përmbledhja do të korrigjohet dhe do të përmendet vendimi për korrigjimin. Në rast se përmbledhja e vendimit është publikuar në Gazetën Zyrtare, duhet të publikohet një përmbledhje e vendimit për korrigjimin.

## **3. Publikimi në faqen e internetit**

### **3.1. Objekti i publikimit**

Komisioni ka një praktikë të gjatë dhe të konsoliduar të publikimit të vendimeve përfundimtare për antitrustin në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme për

---

<sup>1</sup> Në përputhje me nenin 30, paragrafi 2 të Rregullores 1/2003, publikimi i vendimit duhet të marrë në konsideratë interesin legjitim të ndërmarrjeve për të mbrojtur sekretet e tyre tregtare. E njëjta gjë vlen edhe për raportin përfundimtar të kryetarit të seancës dëgjimore (neni 17, paragrafi 3, Termat e Referencës për kryetarët e seancave dëgjimore), si dhe për opinionin e Komitetit Këshillimor (neni 14, paragrafi 6 i Rregullores 1/2003).

Konkurrencën, me qëllim garantimin e transparencës, parashikueshmërisë dhe sigurisë ligjore, edhe pse Komisioni nuk ka detyrimin ligjor që ta bëjë diçka të tillë.

Për më tepër, të gjitha dokumentet e publikuara në Gazetën Zyrtare, janë gjithashtu të disponueshme në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme për Konkurrencën përmes një lidhjeje të drejtpërdrejtë.

### **3.2. Përmbajtja e publikimit**

- (4) Në faqen e internetit publikohet teksti i plotë i vendimit, ashtu siç u është njoftuar palëve, por pa informacionin që nuk mund të publikohet.

### **3.3. Cilat informacione nuk mund të publikohen?**

- (5) Zbatohen të njëjtat rregulla si për publikimin në Faqen Zyrtare. Për ta ritheksuar, informacionet që nuk mund të publikohen mund të përmbliidhen si në vijim:
  - informacionet konfidenciale, në veçanti sekretet tregtare,
  - të dhënat personale,
  - informacioni që mund të vërë në rrezik hetimet e Komisionit nëse publikohet.

### **3.4. Koha e publikimit në faqen e internetit**

- (6) Nuk ka kërkesa ligjore lidhur me kohën e publikimit në faqen e internetit. Publikimi duhet bërë sa më shpejt të jetë e mundur.
- (7) **Vendi i publikimit në faqen e internetit**

**<https://caa.gov.al/>**

### **3.5. Korrigjimet**

- (8) Në rast se një vendim i miratuar përmban gabime, do të bëhen korrigjime në përputhje me procedurën përkatëse.
- (9) Versioni jokonfidencial i vendimit formal të korrigjimit duhet të publikohet i plotë në faqen e internetit, në të njëjtin vend ku është publikuar edhe vendimi i Komisionit.
- (10) Në rastin e gabimeve në përmbajtje, të zbuluara përpara publikimit të versionit jokonfidencial, për të cilat nuk nevojitet një korrigjim formal përmes miratimit të një vendimi për korrigjim, atëherë korrigjimi specifikohet në versionin publik jokonfidencial (përmes një shënimi në fund të faqes: “\* Gabim në përmbajtje: duhet të lexohet si ...”).

## **4. Mënyra e përgatitjes së dokumenteve për publikim**

- (11) Ky seksion trajton (i) hapat për identifikimin e informacionit që nuk mund të publikohet dhe (ii) aspektet praktike të publikimit.
- (12) Siç është treguar më sipër, në tekstet e publikuara nuk mund të përfshihen:

- informacionet konfidenciale, në veçanti sekretet tregtare,
  - të dhënat personale,
  - informacioni që mund të vërë në rrezik hetimet e Komisionit nëse publikohet.
- (13) Përpara publikimit, ekipi i ngarkuar me çështjen konsolidon (i) kërkesat e pranuar të konfidencialitetit të të gjitha palëve, (ii) fshirjet e të dhënave personale dhe (iii) fshirjet e informacionit që mund të vërë në rrezik hetimet e Komisionit nëse publikohet, si dhe kërkesat për informacion të të gjitha palëve lidhur me këtë tekst.

#### **4.1. Identifikimi i informacioneve që nuk mund të publikohen**

- (14) Për të identifikuar informacionin konfidencial, është e nevojshme që të shkëmbehen korrespondenca dhe të vendosen kontakte me marrësit e vendimeve.
- (15) Sipas nenit 16, paragrafi 3 të Rregullores nr. 773/2004, brenda një afati kohor të përcaktuar nga Komisioni, marrësve mund t'u kërkohej:
- të identifikojnë çdo pjesë të një vendimi përkatës që, sipas pikëpamjes së tyre, përmban sekrete tregtare dhe informacione të tjera konfidenciale;
  - të argumentojnë çdo kërkesë për konfidencialitet;
  - t'i japin Komisionit një version jokonfidencial të vendimit, ku të jenë fshirë paragrafët konfidencialë;
  - të japin një përshkrim konciz të çdo pjese të informacionit të fshirë.
  - Nëse palët nuk i përmbushin këto kërkesa, Komisioni mund të supozojë se vendimi përkatës nuk përmban informacione konfidenciale

##### **4.1.1. Letra e parë që u dërgohet marrësve**

- (16) Pa vonesa të paarsyeshme pas miratimit të vendimit nga Komisioni, të gjitha palët marrin një letër të nënshkruar nga menaxheri i çështjes ose Drejtuesi i Njësisë.
- (17) Në këtë letër, marrësve u kërkohej që të konfirmojnë se
- përmbledhja e vendimit,
  - raporti përfundimtar i kryetarit të seancës dëgjimore dhe
  - opinioni i Komisionit të Konkurrencës, nuk përmbajnë informacione konfidenciale dhe në veçanti, sekrete tregtare.
- (18) Për më tepër, atyre u kërkohej që
- të dorëzojnë një version të plotë jokonfidencial të vendimit që u është drejtuar. Kjo nënkupton se ata do të duhet të identifikojnë çdo informacion konfidencial në vendimin që u është drejtuar (duke nënvizuar (jo duke fshirë) pjesët përkatëse në të gjithë vendimin),
  - të argumentojnë kërkesat e tyre për konfidencialitet, lidhur me çdo pjesë informacioni që

pretendohet se është konfidencial,

- të japin një përmbledhje koncize të çdo pjese të informacionit të fshirë.

Kjo letër u rikujton marrësve se informacioni konfidencial u referohet, në veçanti,

- sekreteve tregtare
  - informacionit që marrësit kanë dorëzuar në kuadër të Njoftimit për Lehtësim nga Gjobat
- (19) Përmbledhja e vendimit duhet t'i bashkëngjitet kësaj letre në formë të printuar ose në format "pdf".
- (20) Zakonisht, afati kohor për përgjigje është dy javë, duke filluar nga dita e marrjes së letrës së parë nga Komisioni.
- (21) Kjo letër specifikon se, në mungesë të një përgjigjeje, Komisioni do konsiderojë se asnjë nga dokumentet në fjalë nuk përmban informacione konfidenciale. Shënim: Përmbledhja, raporti përfundimtar i kryetarit të seancës dëgjimore dhe opinionimi i Komitetit Këshillimor nuk kanë shumë gjasa që të përmbajnë informacione konfidenciale ndërsa vendimi që u përcillet marrësve ("versioni konfidencial") do të përmbajë informacione të tilla.

#### **4.1.2. Kërkesa për shtyrje**

- (22) Në rastin e një kërkesë për shtyrjen e afatit:

- Kjo kërkesë duhet të bëhet me shkrim (mjafton një email).
- Kërkesa duhet të jetë e arsyetuar me qëllim që ekipi i ngarkuar me çështjen të mund të bëjë një vlerësim të përshtatshëm.
- Në përgjithësi, nevoja për t'u përgatitur, në të njëjtën kohë, për një procedurë përpara gjykatës (ankimim, përgatitje për një seancë dëgjimore) nuk është një arsye e pranueshme për shtyrjen e afatit, duke qenë se ajo zbatohet për të gjitha palët.
- Në përgjithësi, një shtyrje e justifikuar nuk duhet të jetë më e gjatë se një javë. Megjithatë, duhet marrë në konsideratë kohëzgjatja e vendimit, çka mund të justifikojë një shtyrje më të gjatë, në rrethana të caktuara.
- Përgjigja ndaj kërkesës për shtyrje duhet të bëhet me shkrim (mjafton një email nga ekipi i ngarkuar me çështjen).

#### **4.1.3. Ndjekja në rastin e moskthimit të përgjigjes**

- (23) Në rast se palët nuk kthejnë përgjigje brenda afatit kohor (duke marrë në konsideratë shtyrjet e mundshme):

- Menaxheri i çështjes mund ta ndjekë këtë situatë me palët, në mënyrë joformale.
- Në të kundërt, ose nëse ndjekja joformale nuk është e suksesshme, palët do të marrin një letër kujtesë.
- Për sa i përket detajeve të kërkesës, letra kujtesë i referohet letrës së parë.

- Ajo specifikon se nuk është respektuar afati origjinal (ose i shtyrë).
- Kjo letër vendos një afat të ri kohor prej 48 orësh për të dhënë përgjigje.
- Letra specifikon se nëse marrësi nuk përgjigjet brenda afatit të ri, Komisioni do të publikojë vendimin, duke supozuar se ai nuk përmban informacione konfidenciale në përputhje me nenin 16, paragrafi 4 të Rregullores 773/2004.
- Nëse vendimi përmban informacione të cilat, sipas pikëpamjes së ekipit të ngarkuar me çështjen, janë qartësisht konfidenciale në lidhje me marrësin përkatës, letra kujtesë (i) specifikon gjithashtu këto informacione konfidenciale, si dhe (ii) fton marrësin që të shqyrtojë specifikisht pozicionin e tij lidhur me këto informacione.
- Kjo letër nënshkruhet nga Drejtuesi i Njësisë ose nga menaxheri i çështjes.

(24) Hapi i radhës që duhet marrë varet nga reagimi i palëve:

- Nëse palët nuk reagojnë brenda afatit të ri kohor, dokumentet mund të publikohen në përputhje me nenin 16, paragrafi 4 të Rregullores 773/2004. Megjithatë, ekipi i ngarkuar me çështjen duhet t'i fshijë informacionet që, sipas pikëpamjes së ekipit të ngarkuar me çështjen, janë qartësisht konfidenciale<sup>2</sup>.
- Nëse palët u përgjigjen kërkesave për konfidencialitet brenda afatit të ri, zbatohen hapat në vijim.

#### **4.1.4. Menaxhimi i kërkesave për konfidencialitet**

##### *4.1.4.1 Pranimi i kërkesave për konfidencialitet*

- (25) Kur marrësit dorëzojnë kërkesa për konfidencialitet.
- (26) Nëse i pranon të gjitha kërkesat për konfidencialitet, ekipi i ngarkuar me çështjen përgatit një version të konsoliduar të vendimit dhe merr të gjitha hapat e nevojshme për publikimin në faqen e internetit.

##### *4.1.4.2 Mospranimi i kërkesave për konfidencialitet*

- (27) I takon punonjësve të ngarkuar me çështjen të përcaktojë nëse kërkesat për konfidencialitet janë të justifikuara bazuar në arsyet e argumentuara të paraqitura nga palët, në përputhje me kërkesat themelore të detajuara në seksionin 6 më poshtë.
- (28) Zakonisht, nuk duhet të lindin mosmarrëveshje me palët lidhur me kërkesat për konfidencialitet për dokumentet që do të publikohen në Faqen Zyrtare (përmbledhja e vendimit, raporti përfundimtar i kryetarit të seancës dëgjimore dhe opinioni i KK), pasi në përgjithësi këto dokumente nuk përmbajnë informacione konfidenciale. Megjithatë, mosmarrëveshje to tilla mund të lindin gjatë përgatitjes së versionit jokonfidencial të vendimit që do të publikohet në faqen e internetit.

<sup>2</sup> Neni 16, paragrafi 4 i Rregullores 773/2004 nuk e detyron Komisionin që t'i lërë informacionet qartësisht konfidenciale në versionin publik: "Nëse ndërmarrjet [...] nuk respektojnë [...], Komisioni **mund** të supozojë se dokumentet ose deklaratat përkatëse nuk përmbajnë informacione konfidenciale." (Është shtuar ngjyra e zezë në një prej fjalëve).

- (29) Në rastin e një mosmarrëveshjeje me një palë lidhur me çështjet e konfidencialitetit, ekipi i ngarkuar me çështjen informon të gjitha palët rreth mosmarrëveshjes me qëllim që të marrë miratimin e të gjitha palëve për një version që është i pranueshëm për Komisionin.
- (30) Fillimisht, ky proces mund të bëhet në mënyrë joformale, por duhet bërë me shkrim dhe të jetë i arsyetuar. Duhet të caktohet një afat kohor për dorëzimin e komenteve me shkrim nga palët. Për këtë mjafton një email nga personi përgjegjës për trajtimin e çështjes.

#### **4.1.4.3 Mosmarrëveshjet e pazgjidhura lidhur me kërkesat për konfidencialitet – përfshirja e kryetarit në seancë dëgjimore.**

- (31) Në rastet kur një mosmarrëveshje lidhur me kërkesat për konfidencialitet nuk mund të zgjidhet:
- Marrësit përkatës informohen përmes një letre të nënshkruar nga Drejtuesi i Njesisë ose nga menaxheri i çështjes rreth kërkesave për konfidencialitet që nuk konsiderohen të justifikuar, rreth arsyeve se pse ato nuk konsiderohen të justifikuar,<sup>3</sup> si dhe rreth faktit që:
  - marrësit, brenda një afati kohor të arsyeshëm që do të caktohet duke marrë në konsideratë rrethanat e çështjes (në disa raste një javë mund të jetë një afat i përshtatshëm), mund t'i drejtohen kryetarit të seancës dëgjimore, i cili mund të vendosë rreth kërkesave të kontestuara për konfidencialitet dhe,
  - nëse marrësit nuk i drejtohen kryetarit të seancës dëgjimore brenda afatit të caktuar kohor, kërkesat përkatëse për konfidencialitet do të konsiderohen të tërhequra dhe informacioni përkatës që mbulojnë këto kërkesa do të publikohet.
- (32) Nëse marrësit i drejtohen kryetarit të seancës dëgjimore brenda afatit të caktuar kohor:
- Zbatohet procedura përkatëse lidhur me përfshirjen e kryetarit të seancës dëgjimore – në përputhje me nenin 8 të Termave të Referencës
  - Në rastin e përfshirjes së kryetarit të seancës dëgjimore, në faqen e internetit do të publikohet një version i përkohshëm i vendimit, pa pjesët e kontestuara.
  - Versioni përfundimtar jokonfidencial do të publikohet në datën e specifikuar në vendimin e arsyetuar të kryetarit të seancës dëgjimore që i është njoftuar dhënësit të informacionit, përveçse kur marrësit e kontestojnë vendimin e kryetarit të seancës dëgjimore përpara Gjykatës së Përgjithshme dhe paraqesin pranë Gjykatës një kërkesë për zgjidhje ligjore të përkohshme me qëllim pezullimin e vendimit.

## **4.2. Të dhënat personale – Veprimet e marra me iniciativën e vetë Komisionit**

- (33) Duke qenë se shpeshherë, gjatë procesit të identifikimit të informacionit konfidencial me marrësit, kërkesat e tyre për konfidencialitet mbulojnë gjithashtu të dhënat personale të punonjësve të tyre të mëparshëm dhe aktualë, është e nevojshme që ekipi i ngarkuar me çështjen, me iniciativën e tij, të identifikojë dhe heqë çdo të dhënë personale nga dokumentet përpara publikimit të tyre (në veçanti nga vendimi).

---

<sup>3</sup> Shihni nenin 8, paragrafi 1 të Termave të Referencës për kryetarët e seancave dëgjimore.

## **5. Aspektet praktike**

(34) Ky seksion trajton aspektet praktike të lidhura me përgatitjen e një teksti për publikim dhe me publikimin e tij.

### **5.1. Si duhet të identifikohet informacioni konfidencial?**

(35) Letra e parë që u dërgohet marrësve kërkon që ata të dorëzojnë një draft në të cilin të identifikojnë kërkesat për konfidencialitet duke i nënvizuar ato.

(36) Vetëm pasi të jetë zgjidhur çështja e kërkesave për konfidencialitet, të gjitha palëve u kërkohet të konfirmojnë dakordësinë e tyre me versionin përfundimtar të konsoliduar të vendimit, në të cilin ekipi i ngarkuar me çështjen ka hequr çdo informacion konfidencial.

### **5.2. Si të përgatitet një version i konsoliduar nga i cili të jenë hequr të gjitha informacionet që nuk mund të publikohen**

(37) Ekipi i ngarkuar me çështjen do të përgatisë një version të konsoliduar për publikim duke aplikuar hapat në vijim në dokumentin përkatës (vendim, përmbledhje e vendimit etj.):

- fshirja e informacioneve konfidenciale (informacionet për të cilat janë pranuar kërkesat për konfidencialitet) të të gjithë marrësve;
- fshirja e të dhënave personale;
- fshirja e informacioneve, të cilat nëse publikohen, mund të vënë në rrezik qëllimin e hetimeve të Komisionit.

(38) Teksti i fshirë zëvendësohet nga një përmbledhje jokonfidenciale në kllapa katrore ose paraqitet në formën.

(39) Për sa u përket përmbledhjeve të informacionit konfidencial, nëse disa palë ofrojnë përmbledhje të ndryshme të të njëjtit informacion konfidencial, i takon ekipit të ngarkuar me çështjen që të vendosë nëse do të japë edhe ai një përmbledhje, nëse do të zgjedhë një prej përmbledhjeve të paraqitura nga palët, ose nëse do të përgatisë një përmbledhje tjetër bazuar në ato të sugjeruara nga palët.

(40) Teksti në vijim duhet të paraqitet si një shënim me “yll” në faqen e parë të versionit jokonfidencial të vendimit:

(41) Në rrethana të caktuara, mund të përdoren diapazone të përshtatshme për të zëvendësuar informacionin e detajuar rreth xhiros ose pjesës së tregut të kompanisë (p.sh., një pjesë tregu prej 12,5% mund të zëvendësohet me një diapazon të pjesës së tregut prej 10-20%).

(42) Ekipi i ngarkuar me çështjen ua dërgon këtë version të konsoliduar të gjitha palëve, duke i informuar se ky version do të publikohet nga Komisioni, nëse ata nuk ngrenë kundërshtime brenda afatit të caktuar kohor.

(43) Në letrën shoqëruese të nënshkruar nga menaxheri i çështjes caktohet një afat i shkurtër, por i arsyeshëm.

- (44) Versioni i konsoliduar duhet të përgatitet duke treguar kujdes të posaçëm që të shmangët çdo mundësi që informacionet konfidenciale të një pale t'u zbulohen aksidentalisht një pale tjetër. Të paktën dy persona do të duhet ta kenë verifikuar tekstin përpara se versioni përfundimtar i konsoliduar (në të cilin është hequr çdo informacion konfidencial) t'u dërgohet palëve. Në këtë kontekst, duhet të tregohet një nivel i lartë kujdesi dhe vëmendjeje ashtu si në rastin e aksesit në dosje.
- (45) Pasi të ketë kaluar afati dhe asnjë palë të mos e ketë kundërshtuar versionin përfundimtar të konsoliduar (në të cilin është hequr çdo informacion konfidencial) të versionit jokonfidencial, mund të nisë procesi i publikimit.

### **5.3.1. Publikimi në faqen e internetit të Autoritetit të Konkurrencës**

#### **5.3.1.1 Gjuhët e kërkuara**

- (46) Versioni jokonfidencial i vendimit publikohet në faqen e internetit të Autoritetit të Konkurrencës, në gjuhën shqipe.

#### **5.3.1.2 Organi përgjegjës dhe përgatitja e versioneve në gjuhët përkatëse**

- (47) Pasi vihet në zotërim të versionit të konsoliduar jokonfidencial të vendimit, ekipi i ngarkuar me çështjen, bazuar në tekstin e versionit të konsoliduar, përgatit një version jokonfidencial në gjuhët përkatëse. Të gjitha tekstet e fshira në “kopjen origjinale” duhet të pasqyrohen në versionet në gjuhët përkatëse, nëse ka të tilla.

### **5.4. Aspektet praktike të publikimit**

- (48) Ky seksion trajton aspektet praktike të publikimit të tekstit përkatës në Gazetën Zyrtare dhe në faqen e internetit.

#### **5.4.1. Publikimi në Gazetën Zyrtare**

- (49) Pasi të jenë marrë të gjitha versionet në gjuhët zyrtare, ekipi i ngarkuar me çështjen e dërgon tekstin që duhet publikuar (përmbledhja, raporti përfundimtar i kryetarit të seancës dëgjimore, opinioni i Komisionit të Konkurrencës) në kutinë postare funksionale përkatëse, duke specifikuar emrin dhe numrin e çështjes, si dhe datën e miratimit të vendimit.

#### **5.4.2. Publikimi në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme për Konkurrencën**

##### *5.4.2.1 Publikimi i vendimit në faqen e internetit*

- (50) Në datën e miratimit të vendimit, një dokument i quajtur “nuk ka version publik të disponueshëm” publikohet në faqen e internetit. Ky dokument zëvendësohet më vonë nga përmbledhja e vendimit/versioni jokonfidencial i vendimit.

##### *5.4.2.2 Heqja e dokumenteve nga faqja e internetit*

- (51) Edhe pse shtimi i dokumenteve në faqen e internetit bëhet në mënyrë automatike përmes aplikacioneve për menaxhimin e çështjeve, këto aplikacione nuk mund të përdoren për heqjen e dokumenteve pas publikimit të tyre në faqen e internetit.

- (52) Nëse nevojitet heqja e dokumenteve nga faqja e internetit, është e nevojshme që të kërkohet në

mënyrë specifike përditësimi i sistemit të menaxhimit të dokumenteve.

*Verifikimi i dokumenteve që do të publikohen*

- (53) Për të garantuar publikimin e dokumenteve dhe teksteve të duhura është e nevojshme që të realizohet një verifikim i saktësisë së dokumenteve të publikuara.
- (54) Kini parasysh se pasi dokumentet publikohen, ato mund të kopjohen ose ruhen nga palët e treta, si p.sh., motorët e kërkimit ose ofruesit e bazave të të dhënave. Për rrjedhojë, nëse identifikohet një gabim pas publikimit, korrigjimi i atij gabimi në versionin e publikuar në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme për Konkurrencën nuk garanton heqjen e versionit të mëparshëm me gabime nga hapësira publike. Edhe pse Komisioni mund të kërkojë fshirjen e kopjeve në momentin që vihet në dijeni të një ripublikimi të tillë, së pari nuk ka garanci se Komisioni do të vihet në dijeni të ripublikimit dhe së dyti, edhe nëse vihet në dijeni, nuk ka garanci se do të respektohen kërkesat për heqjen e këtyre publikimeve nga interneti.

#### 5.4.2.3 *Kërkimi në faqen e internetit*

Kërkimi në faqen e internetit të Autoritetit të Konkurrencës është <https://caa.gov.al/>

### **6. Përmbajtja e versionit jokonfidencial të vendimit**

- (55) Gjatë përgatitjes për publikim të versionit jokonfidencial të vendimit, Komisioni duhet të gjejë një ekuilibër ndërmjet detyrimit të tij të ruajtjes së sekretit profesional dhe interesit për mbrojtjen e hetimeve nga njëra anë dhe synimit të ofrimit të transparencës maksimale nga ana tjetër.
- (56) Gjatë publikimit të vendimeve dhe përmbajtjeve të tyre, Komisioni duhet të marrë në konsideratë (i) një sërë kërkesash ligjore për fshirjen e informacionit, si mbrojtja e informacioneve konfidenciale, në veçanti e sekreteve tregtare, mbrojtja e të dhënave personale, parimi i prezumimit të pafajësisë dhe (ii) efektin që mund të ketë publikimi i informacioneve të caktuara në aftësinë e Komisionit për të realizuar hetime në çështje specifike dhe në përgjithësi. Këto informacione fshihen nga versioni jokonfidencial i vendimit për qëllimin e publikimit e tij.
- (57) Nga ana tjetër, kërkesat e transparencës, në veçanti ato të parashikuara në Rregulloren për Transparencën (Rregullorja nr. 1049/2001)<sup>4</sup>, si dhe interesi i operatorëve ekonomikë për të kuptuar llojin e sjelljes që mund të shkaktojë penalizimin e tyre dhe interesi që kanë personat e dëmtuar nga shkelja për t'u informuar rreth detajeve të kësaj sjelljeje në mënyrë që, sipas rastit, të vlerësojnë të drejtat e tyre kundrejt ndërmarrjeve të ndëshkuara,<sup>5</sup> duhet të merren në konsideratë gjatë përgatitjes së versionit jokonfidencial për t'u publikuar.

### **6.1. Informacioni konfidencial**

- (58) Sipas nenit 339 të TFBE-së, Komisioni dhe stafi i tij duhet të respektojnë detyrimin e ruajtjes

<sup>4</sup> Rregullorja (KE) nr. 1049/2001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 30 maj 2001, "Për aksesin publik në dokumentet e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit", Gazeta Zyrtare L145, 31.5.2001, f. 43.

<sup>5</sup> Shihni Çështjen T-198/03 *Bank Austria Creditanstalt/Commission* [2006] ECR II-1429, paragrafi 78.

së sekretit profesional.<sup>6</sup> Ky detyrim mbulon sekretet tregtare<sup>7</sup> dhe informacionet e tjera konfidenciale me kusht që të përmbushin kriteret e parashikuara nga praktika gjyqësore.

- (59) Sipas Gjykatës, në mënyrë që të përfshihet në detyrimin e ruajtjes së sekretit profesional, informacioni duhet të:
- zbulohet vetëm për një numër të kufizuar personash,
  - nëse zbulohet, mund të shkaktojë dëm serioz ndaj personit që e ka dhënë këtë informacion ose ndaj palëve të treta, dhe
  - nëse zbulohet, interesat që mund të dëmtohen si pasojë e zbulimit, mbi baza të arsyeshme, duhet të gëzojnë mbrojtje.
- (60) Për rrjedhojë, palët kanë të drejtën të kërkojnë që sekretet e tyre tregtare dhe informacionet e tjera konfidenciale të redaktohen në një version jokonfidencial.
- (61) Koncepti i sekreteve tregtare ose informacioneve të tjera konfidenciale ka të bëjë me informacionet të cilat mund të dëmtojnë seriozisht interesat e palës që i ka dhënë këto informacione nëse ato i zbulohen publikut apo thjesht nëse i përcillen një personi tjetër përveç palës që i ka dhënë këto informacione.
- (62) Për rrjedhojë, përmbajtja e vendimeve të publikuara kufizohet nga detyrimi i Komisionit për të mbrojtur sekretet tregtare të ndërmarrjeve apo informacionet e tjera konfidenciale që mund të jenë pjesë e arsytimit të vendimit. Shembuj tipikë të informacioneve që fshihen nga një version jokonfidencial janë shifrat e sakta dhe të kohëve të fundit të lidhura me xhiron, informacionet e klientëve (p.sh., emrat e tyre, sasi të e blera apo çmimet e paguara) dhe pjesët e tregut<sup>8</sup>. Për rrjedhojë, versioni jokonfidencial mund të përmbajë diapazone të shifrave, të dhënave dhe pjesëve, ose një përshkrim neutral në rastin e emrave.
- (63) Vendimi për pranimin ose jo të kërkesave për konfidencialitet bazohet në rregullat ligjore në fuqi, si dhe në praktikën përkatëse gjyqësore.
- (64) Komisioni ua ka deleguar kryetarëve të seancave dëgjimore kompetencën për të refuzuar kërkesat për sekrete tregtare për qëllime të publikimit. Për rrjedhojë, kryetarët e seancave dëgjimore mund të marrin vendim në emër të Komisionit me miratimin e Kryetarit të AK.

## **6.2. Të dhënat personale**

- (65) Komisioni duhet të marrë në konsideratë kërkesat e Rregullores (KE) nr. 45/2001.<sup>9</sup> Në parim, të dhënat personale duhet të hiqen nga dokumentet përpara publikimit të tyre.

---

<sup>6</sup> Neni 339 i TFBE-së parashikon: “Anëtarët e institucioneve të Bashkimit Evropian, anëtarët e komiteteve, si dhe zyrtarët dhe nëpunësit e tjerë të Bashkimit Evropian nuk duhet të zbulojnë, duke përfshirë edhe pas përfundimit të detyrave të tyre, informacione të mbuluara nga detyrimi i ruajtjes së sekretit profesional, në veçanti informacione rreth ndërmarrjeve, marrëdhënieve të tyre të biznesit ose komponentëve të kostove të tyre”.

<sup>7</sup> Të cilat përmenden shprehimisht në nenin 30, paragrafi 2 të Rregullores 1/2003.

<sup>8</sup> Shihni Çështjen T-383/03 *Hynix Semiconductor v Commission* [2005] ECR II-627 dhe Çështjen T-271/03 *Deutsche Telekom v Commission* [2006] ECR II-1749.

<sup>9</sup> Rregullorja (KE) nr. 45/2001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 18 dhjetor 2000, “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet dhe organet e Komunitetit dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”, Gazeta Zyrtare L 8, 12.1.2001, f. 1–22.

- (66) Në Rregulloren (KE) nr. 45/2001 të dhënat personale përkufizohen si: “çdo informacion i lidhur me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm”. Të dhënat e lidhura me individët duhet të trajtohen me kujdes të veçantë në çdo procedurë administrative, duke përfshirë në hetimet e kartelit. Kjo detyrë e trajtimit me kujdes të këtyre të dhënave është veçanërisht e rëndësishme kur një vendim që përfshin të dhëna të tilla vihet në dispozicion të publikut. Si rregull i përgjithshëm, rrjedhimisht këto informacione nuk duhet të përfshihen në një version jokonfidencial të një vendimi. Për rrjedhojë, informacionet që mund të identifikojnë një person mund të zëvendësohen nga një përshkrim më i përgjithshëm (p.sh., “Znj. Y” ose “Drejtori i Marketingut i kompanisë X gjatë periudhës 1998-2000” mund të zëvendësohen me “një nga përfaqësuesit e kompanisë X”). Megjithatë, mund të ekzistojnë arsye të veçanta, të cilat e justifikojnë përfshirjen e këtyre të dhënave në një version jokonfidencial. Kjo mund të ndodhë në rastet kur specifikimi i funksionit të një personi është i nevojshëm për të kuptuar vendimin ose kur ndërmarrja të cilës i është drejtuar vendimi është një individ.
- (67) Këta individë kanë disa të drejta të caktuara aksesi lidhur me të dhënat e tyre personale.

Në këto çështje përfshihet koordinatori për mbrojtjen e të dhënave i Titullari i AK.

### **6.3. Informacioni që mund të vërë në rrezik hetimet e Komisionit nëse publikohet**

- (68) Publikimi i llojeve të caktuara të informacionit mund të vërë në rrezik aftësinë e Komisionit për të kryer hetimet e tij në çështje specifike dhe në përgjithësi. Në veçanti, këtu mund të përfshihet rasti i provave të dorëzuara nga palët në kuadër të Njoftimit për Lehtësim nga Gjobat dhe provat lidhur me pjesëmarrjen në një shkelje, të cilat janë dorëzuar vullnetarisht nga palët në përgjigje të kërkesave për informacion dhe gjatë seancave dëgjimore. Për rrjedhojë, Komisioni mund të redaktojë informacione të caktuara, të cilat përfshihen në këtë kategori, në versionin publik të vendimit.
- (69) Politika e Komisionit për lehtësim nga gjobat, e shprehur në Njoftimin për Lehtësim nga Gjobat, është instrumenti kyç hetimor i Komisionit në hetimet e kartelit dhe funksionimi optimal i saj ka rëndësi thelbësore në aftësinë e Komisionit për të zbuluar, hetuar dhe ndëshkuar me sukses kartelet e mirëthemeluara. Një politikë mirëfunktionale për lehtësim nga gjobat përmirëson parandalimin e sjelljes së kartelit.
- (70) Mbrojtja e konfidencialitetit të dokumenteve të dorëzuara për lehtësim nga gjobat është shumë e rëndësishme për të ruajtur interesin ndaj politikës së Komisionit për lehtësim nga gjobat dhe për të garantuar funksionimin optimal të saj. Nga ana tjetër, publiku (në veçanti, aplikantët e ardhshëm për lehtësim nga gjobat, viktimat e shkeljeve të ligjit për konkurrencën dhe komuniteti juridik) ka interes që të informohet rreth procedurës për lehtësim nga gjobat dhe trajtimit të aplikantëve për lehtësim nga gjobat.
- (71) U takon vetë palëve që të identifikojnë informacionet e propozuara për redaktim, si p.sh., të citimeve që rezultojnë nga deklaratat e tyre të korporatës ose të informacioneve të tjera që rezultojnë nga deklaratat e tyre të korporatës, deri në masën që ato të jenë të gjurmueshme. Megjithatë, Komisioni merr vendimin përfundimtar lidhur me faktin nëse publikimi i informacioneve të caktuara do të vinte në rrezik hetimin e tij dhe nëse duhet të redaktohen informacione të tjera, krahas atyre të identifikuar nga palët, për të shmangur këto efekte negative në funksionimin e Komisionit.

### **6.4. Rregullorja për transparencën**

- (72) Preferohet që versioni jokonfidencial i një vendimi të mund të përdoret për t'iu përgjigjur një kërkesë për akses në dokumente, në përputhje me Rregulloren 1049/2001.
- (73) Kjo Rregullore i mundëson akses çdo personi, në të gjitha dokumentet e Komisionit, pa qenë e nevojshme që të japë arsye specifike. Ky akses mund të refuzohet vetëm në përputhje me përjashtimet specifike të parashikuara në Rregullore. Ato përfshijnë, ndër të tjera, mbrojtjen e interesave tregtare dhe mbrojtjen e qëllimit të inspektimeve dhe hetimeve.
- (74) Rrjedhimisht, për arsye të efikasitetit administrativ, versionet jokonfidenciale të vendimeve të Komisionit duhet të përgatiten duke pasur parasysh kërkesat e mundshme për akses. Nëse, në raste përjashtimore, një kërkesë sipas Rregullores 1049/2001 rezulton në publikimin e informacionit që nuk ishte pjesë e versionit publik të vendimit, atëherë në faqen e internetit duhet të publikohet një version publik i përshtatur.





























